



TË DREJTAT E GRAVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

GRATË NË POLITIKË, DHUNA ME BAZË GJINORE DHE SIGURIA
PËR GRATË MBROJTËSE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI,
BOSNJE DHE HERCEGOVINË, MAL TË ZI, MAQEDONI TË VERIUT
DHE SERBI 2020

RRETH FONDACIONIT KVINNA TILL KVINNA

Fondacioni Kvinna till Kvinna mbron të drejtat e grave që nga viti 1993, duke e siguruar dhe duke i dhënë zë secilës së drejtë të grave.

Sot ne jemi një nga organizatat kryesore botërore për të drejtat e grave, duke punuar drejtpërdrejt në zonat e prekura nga lufta dhe konfliktet, për të rritur ndikimin dhe fuqinë e grave. Ne kemi bashkëpunim të ngushtë me mbi 100 organizata lokale partnere në 20 vende të ndryshme në botë, me të cilat bashkëpunojmë për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave, për të arritur paqe të qëndrueshme dhe për të mbyllur hendekun gjinor një herë e përgjithmonë. E ardhmja është e barabartë. Dhe së bashku, ne jemi ndryshimi.

www.kvinnatillkvinna.org

Hulumtuar dhe shkruar nga:

Lejla Gačanica

Raba Gjoshi

Sofija Vrbaški

Redaktuar nga:

Sofija Vrbaški

Stina Magnuson Buur

Mirënjohje:

Giulia Pasquinelli, Ristin Thomasson, Voskre Naumoska Ilieva, Elin Dellås, Lori Mann, Lejla Somun.

Organizatave partnere: Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri; Shoqata e grave Sandglass; ASTRA - Aksioni kundër trafikimit; Qendra Autonome e Grave; Bolja Budućnost; Shoqata e Edukimit dhe Kërkimit Shëndetësor; Asambleja Helsinki Qytetarëve Banja Luka; Qendra Kosovare e Studimeve Gjinore; Rrjeti i Grave të Kosovës; Rrjeti Kombëtar për t'i dhënë fund Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje "Zëri Kundër Dhunës"; Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës; Reaktori - Kërkime në veprim; Të drejta për të gjithë; Qendra Rome për Gratë dhe Fëmijët - Daje; Gratë e Bashkuara; Qendra për të Drejtat e Grave

Faqesja:

UrbanGRAF

Fotografia e ballinës:

Maja Janevska-Ilieva

Nëntor 2020

KVINNA
KVINNA

 **Sweden**
Sverige

Ky botim i Fondacionit Kvinna till Kvinna financohet nga Sida/Suedi.

Përgjegjësia e përmbajtjes u takon autoreve.

RRETH KËTIJ HULUMTIMI

Raporti Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor shërben si një pikë referimi në lidhje me të drejtat dhe ndikimin e grave në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që synojnë të hyjnë në BE, si dhe për mundësi krahasimi ndër vite. Ky është botimi i pestë i raportit. Raporti është përgatitur si pjesë e programit rajonal "Fuqizimi i të drejtave të grave, pjesëmarrja dhe ndikimi në Ballkanin Perëndimor 2015 - 2020", për të forcuar avokimin e bazuar në prova. Ky program financohet nga Agjencia Suedeze për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar (Sida) dhe zbatohet nga Fondacioni Kvinna till Kvinna në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile të grave në Ballkanin Perëndimor. Programi përfshin Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Synimi i përgjithshëm i programit është fuqizimi i të drejtave të grave dhe pjesëmarrjes së barabartë të grave në vendimmarrje në Ballkanin Perëndimor, me synim specifik të përfshirjes gjinore në procesin e anëtarësimit në BE.

Tri fushat e përfshira në këtë pikë referimi janë: gratë në politikë, dhuna me bazë gjinore dhe situata për gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut, pasi këto janë fushat prioritare për avancimin e të drejtave të grave. Këto fusha u zgjodhën, u përcaktuan dhe u përshkruan në raportin e parë Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor, në botimin e parë në vitin 2016. Qëllimi i edicionit aktual është të përditësojë statistikën dhe burimet përkatëse për periudhën 2019/2020 për secilin nga treguesit, në secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Për secilin tregues, autorët testuan numrat/shifrat për periudhën 2019/2020 kundrejt atyre të mëparshme për të përcaktuar se në çfarë mase pozitat shoqërore të grave në Ballkanin Perëndimor u përmirësuan ose përkeqësuan. Raporti pasqyron të dhënat e mbledhura gjatë periudhës qershor 2019 deri në qershor 2020. Megjithatë treguesit në këtë botim mbetën të njëjtë, disa nën-seksione u ndryshuan. Ky botim, për herë të dytë, përfshiu dërgimin e kërkesave me shkrim te institucionet përkatëse në secilin nga gjashtë vendet, për ofrim të të dhënave zyrtare përkitazi me hulumtimin. Kjo u bë për të mbledhur të dhëna që nuk ishin të qasshme në internet dhe për të përcaktuar se në çfarë mase institucionet ishin të përgjegjshme në respektimin e ligjeve të Lirisë së Informacionit kur bëhet fjalë për të dhëna mbi dhunën me bazë gjinore në veçanti. Organizatat për të drejtat e grave, përfshirë organizatat partnere të Fondacionit Kvinna till Kvinna, kanë dhënë kontributin e tyre në raport. Rekomandimet bazohen në konkluzionet nga raporti; rekomandimet për qeveritë vijnë nga organizatat për të drejtat e grave, ndërsa rekomandimet për aktorët ndërkombëtarë janë nga Fondacioni Kvinna till Kvinna dhe organizatat e grave të shoqërisë civile. Përgjegjësia e përmbajtjes, megjithatë, mbetet vetëm përgjegjësi e autoreve.

Autoret pranojnë se ka kufizime në hulumtim dhe në treguesit e krahasimit gjinor. Për shkak të fushës së detyrës, kornizës kohore dhe burimeve të kufizuara, autoret zhvilluan tregues specifik brenda secilës prej fushave tematike të përmendura më lart. Një nga sfidat ishte kufizimi në numrin e treguesve, pasi që autoret pranojnë se ka tregues të tjerë të shumtë që mund të ishin përdorur për të matur pozitat shoqërore të grave. Pengesa më e madhe mbetet mungesa e informatave të përditësuara nga faqet zyrtare të qeverisë në secilin prej vendeve të studiara.

Shpresojmë që ky raport të jetë një mjet i dobishëm, duke treguar trendet e të drejtave të grave në Ballkanin Perëndimor ndër vite.

GRATË NË POLITIKË 4

DHUNA ME BAZË GJINORE 42

GRATË MBROJTËSE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT 75

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
ASTRA	ASTRA – Veprimi Anti Trafikim, Serbi
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore, BeH Agjencia për Barazi Gjinore, Kosovë
BeH	Bosnja e Hercegovina
CEDAW	Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave
OShC	Organizata e Shoqërisë Civile
DhF	Dhuna në Familje
ECHO	Organizata Edukative-Humanitare, Maqedonia Veriore
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EEAS	Shërbimi Evropian për Marrëdhënie me Jashtë
FBeH	Federata e Bosnjës e Hercegovinës
GAP II	Dokument i Përbashkët Pune – Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020 (gjithashtu i njohur si Plani i Veprimit Gjinor II)
DhBGj	Dhuna me Bazë Gjinore
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar)
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
HERA	Asociacioni për Shëndetësi Arsim dhe Hulumtim, Maqedoni Veriore
FDH	Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi
MDNJ	Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
QKSGj	Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Kosovë
Kvinna till Kvinna	Fondacioni Kvinna till Kvinna
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës, Kosovë
MSMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shqipëri
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Maqedoni Veriore
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kosovë
AP	Deputet (Anëtar i Parlamentit)
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PKIMSA	Programi Kombëtar për Implementimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim
N/A	Nuk aplikohet ose nuk është në dispozicion
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Reactor	Reactor – Hulumtimi në Veprim, Maqedoni Veriore
SEA	Sekretariati për Çështje Evropiane
Sida	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi Popullor i Kombeve të Bashkuara
ZNAV	Zyra për Ndihmë dhe Avokim të Viktimave, Kosovë
GMDNJ	Gratë Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut

% E PËRFAQËSIMIT TË GRAVE NË POLITIKË DHE/OSE NË POZITA TË LARTA ME FUQI VENDIMMARRËSE

Gjatë kësaj periudhe të raportimit (tetor 2019 – maj 2020) në Ballkanin Perëndimor nuk pati ndryshime thelbësore sa i përket përfaqësimit të grave në politikë. Në Kosovë dhe në Serbi u mbajtën zgjedhjet e Përgjithshme (Parlamentare). Në Kosovë, konsolidimi i strukturave me fuqi vendimmarrëse ishte një proces i stërgjatë dhe me sfida, ndërsa formimi i qeverisë zgjati disa muaj; respektivisht pothuajse gjatë tërë periudhës së raportimit. Qeveria e re në përbërjen e saj kishte më shumë gra se ndonjëherë më parë, qysh nga shpallja e pavarësisë. Megjithatë, gratë ende mbeten të nënpërfaqësuara derisa qeveria në fjalë u rrëzua më vonë.¹ As themelimi i shumëpëritur i Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës (BeH) për fat të keq nuk solli ndonjë përmirësim për gratë në pozita ministore.

Gratë vazhdojnë të mbesin të nënpërfaqësuara në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, dhe në të gjitha organet vendimmarrëse. Këtu bën përjashtim vetëm qeveria e Shqipërisë, me përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në pozita ministore. Kuota gjinore kërkon që partitë politike të përfshijnë së paku 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e tyre të kandidatëve (40% në Bosnjë e Hercegovinë dhe Maqedoni Veriore), megjithatë kuotat nuk janë duke u implementuar në mënyrë konsistente. Një zhvillim pozitiv ndodhi në Serbi, kur Parlamenti aprovoi një kuotë deri në minimum 40% për përfshirjen e kandidateve nga gjinia më pak e përfaqësuar në listat zgjedhore për zgjedhje Parlamentare dhe Lokale (kjo ka shënuar një rritje nga kuota 30% në të kaluarën). Në vitin 2020, Maqedonia Veriore përmbushi kuotën minimale prej 40% të grave në Parlamentin Nacional. Kuotat gjinore janë një instrument i rëndësishëm për arritjen e barazisë gjinore sa i përket pjesëmarrjes së grave në politikë, në

të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Deri më tani, kuotat kanë treguar rezultate pozitive për sa i përket qasjes së grave në pozita vendimmarrëse, sidoqoftë është mëse e domosdoshme të kuptohet rëndësia e kuotës për progresin shoqëror, e jo të vazhdohet të perceptohet thjesht si një 'kuti boshe për plotësim'.

Të dhënat e grumbulluara në Kosovë dhe Shqipëri kanë treguar boshllëqe dhe kufizime për gratë në partitë politike, si dhe mbi qasjen e tyre në financim, përfaqësimin mediatik, dhe përfaqësimin në strukturat e partive politike. Gjetje të ngjajshme pati edhe për pjesën tjetër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke reflektuar në këtë mënyrë normat patriarkale dhe rolet gjinore në rajon. Gratë të cilat mbajnë pozita në politikë ende perceptohen më tepër si “asistente” e më pak si vendimmarrëse, dhe më pak të shkathta se homologët e tyre burra. Është e rëndësishme të theksohet se gratë në politikë janë më të ekspozuara ndaj formave të ndryshme të dhunës politike në raport me burrat.

Të dhënat e grumbulluara në Kosovë dhe Shqipëri kanë treguar boshllëqe dhe kufizime për gratë në partitë politike, si dhe mbi qasjen e tyre në financim, përfaqësimin mediatik, dhe përfaqësimin në strukturat e partive politike. Gjetje të ngjajshme pati edhe për pjesën tjetër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke reflektuar në këtë mënyrë normat patriarkale dhe rolet gjinore në rajon. Gratë të cilat mbajnë pozita në politikë ende perceptohen më tepër si “asistente” e më pak si vendimmarrëse, dhe më pak të shkathta se homologët e tyre burra. Është e rëndësishme të theksohet se gratë në politikë janë më të ekspozuara ndaj formave të ndryshme të dhunës politike në raport me burrat.

¹ Qeveria e Kosovës zgjati deri në qershor 2020.

SHQIPËRIA

Krahas vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor, bazuar në të dhënat e disponueshme, Shqipëria ndodhet në një pozitë më të mirë për sa i përket pjesëmarrjes politike të grave. Krahasuar me BE-në, Shqipëria qëndron mbi përqindjen mesatare të pjesëmarrjes siç përcaktohet me *Indeksin e Barazisë Gjinore*. Sipas *Indeksi për Barazi Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020*, pjesëmarrja e grave në pozita ministrore në Shqipëri shënon 45%, një shifër më e lartë se 28% e mesatares në 28 shtete anëtare të BE-së. Përveç kësaj, gratë janë më shumë të përfaqësuara në mesin e anëtarëve të asambleve rajonale në Shqipëri në krahasim me ato në BE (36% krahasuar me 28%). Parlamenti aktual i Shqipërisë shquhet për përfaqësimin më të madh të deputeteve gra gjatë 30 viteve të fundit.²

Përkundër kësaj, nëse shikojmë strukturat gjinore të trupave të ndryshëm ekzekutiv, pozitat udhëheqëse mbahen nga burrat. Për shembull, të gjitha pozitat e nivelit të lartë siç janë Kryetari i Parlamentit,³ administratorët nacionalë (veçanërisht dy nivelet e

larta të administratorëve në funksione qeveritare) mbahen kryesisht nga burrat. Shtatëdhjetë e tetë të pozitave vendimmarrëse të nivelit të lartë mbahen nga gratë, në krahasim me 96 tjera që mbahen nga burrat.⁴ Vetëm njëra nga gratë është udhëheqëse e partisë më të madhe politike, dhe tre tjerët janë burra. Për më tepër, nuk kemi gra në mesin e Zëvendës Kryetarëve të partive kryesore politike. Presidenti i Gjykatës Supreme është burrë ndërsa nuk kemi asnjë grua në mesin e nëntë gjykatësve të Gjykatës Supreme.⁵

Përkundër përmirësimeve të bëra gjatë viteve të fundit, pjesëmarrja politike e grave vështirësohet tutje nga barrierat ligjore dhe rregullative të kombinuara me boshllëkun e implementimit të kuotave. Kjo mbështetet edhe nga analiza e *Kostos së Politikave në Shqipëri 2019*⁶ e cila sygjeron se përveç kuotës ka vend për përmirësim edhe në shumë fusha tjera. Gratë janë ende të nënpërfaqësuara në procese demokratike, jo vetëm në vendimmarrje por edhe në politikbërje demokratike.

² Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë, *Gender Equality Index for the Republic of Albania 2020 (Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020)*, Tiranë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti Statistikor i Republikës së Shqipërisë http://ëwww.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf, (e qasur më 10 qershor 2020), fq.21-22.

³ Unioni Ndër-Parlamentar, *Shqipëri: Parlament* [faqja e internetit], https://data.ipu.org/content/albania?chamber_id=13313, (e qasur më 10 prill 2020).

⁴ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, *Gender Statistics Database (Databaza e Statistikave Gjinore)* [faqja e internetit], <https://eige.europa.eu/lt/gender-statistics/dgs/browse/wmidm>, (e qasur më 10 prill 2020).

⁵ Ibid.

⁶ B. Kadia, and R. Pifti, *The Cost of Politics in Albania (Kosto e Politikës në Shqipëri)*, Fondacioni Westminster për Demokraci WFD, 2019, https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2019/09/Costs-of-Politics-in-Albania_Final.pdf, (e qasur më 10 qershor 2020).

BOSNJA E HERCEGOVINA

Zgjedhjet e përgjithshme u mbajtën në vitin 2018, megjithatë, vetëm gjatë kësaj periudhe raportuese 2019, në dhjetor u mbyll një ngërç 14-mujor për formimin e një qeverie zyrtare dhe u krijua Këshilli i ri i Ministrave të BeH. Paafhtësia e qeverisë së BeH për t'u formuar në kohën e duhur pati një ndikim të jashtëzakonshëm në politikën kombëtare dhe në funksionimin e shtetit. Numri i grave ministre mbeti i njëjtë me atë në qeverinë e mëparshme, dhe gratë përbënin vetëm dy nga nëntë pozitat ministrore. Ka rreth 3.2 milion votues të regjistruar në BeH: 2.04 milion në Federatën e BeH (FBeH) dhe 1.24 milion në Republikën Srpska, ndërsa afërsisht 51% janë gra në total. Përkundër kësaj, gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e tjera të jetës politike dhe publike.⁷

Pavarësisht kuotave ekzistuese gjinore për listat zgjedhore, ende kemi pabarazi të theksuara në raport me përfaqësimin gjinor në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet e qeverisë. Gratë ende janë nënpërfaqësuar në të gjitha pozitat udhëheqëse të nivelit të lartë, derisa burrat janë të mbipërfaqësuar.⁸ Si Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve ashtu edhe Sekretari i Përgjithshëm janë burra. Parlamentet në nivel entiteti dhe shteti në BeH kanë mungesë të sensibilizimit gjinor,⁹ dhe nga 26 trupat punuese të Kuvendit Kombëtar të Republikës Serbe, gratë udhëheqin vetëm gjashtë prej tyre. Krahësimisht, në Parlamentin e BeH, nga gjithsej 26 grupe punuese gratë janë shefe vetëm në

pesë prej tyre.¹⁰ Në kuadër të 12 komisioneve në Parlamentin e BeH, vetëm një grua është presidente.¹¹

Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në raportin e *Vërejtjeve Përfundimtare të Raportit të Gjashtë Periodik të Bosnjës dhe Hercegovinës* ka ritheksuar shqetësimin e tyre rreth nënpërfaqësimit të grave në parlamente dhe qeveri, mungesës së pjesëmarrjes së grave nga grupet e pafavorizuara, përfshirë gratë rome, mungesës së qasjes së grave në jetën politike dhe publike, mungesës së trajnimit në leadership politik, shkathtësi për negociim dhe udhëheqje të fushatave për kandidatet gra, përfaqësimit të kufizuar të grave në gjyqësor dhe në organizata ndërkombëtare. Në veçanti, CEDAW thërret për aprovimin e amandamenteve për rritjen e kuotës për kandidatet gra në listat zgjedhore të partive politike deri në 50%, në përputhje me Ligjin Zgjedhor të BeH, si dhe Ligji për Këshillin e Ministrave të përfshijë kuotën minimale prej 40% të përfaqësimit të grave dhe burrave. Kjo kërkon zëvendësimin e sistemit të listave të hapura me një "sistem zinxhir" për emërimin e kandidatëve në listat zgjedhore të partive politike, duke siguruar renditjen e kandidatëve gra dhe burra në secilin vend të dytë të listave zgjedhore.¹² Për më tepër, kjo do të përfshinte aplikimin e sistemit të vendeve të rezervuara për gjininë më pak të përfaqësuar në Parlamentet e të gjitha njësive.¹³

⁷ Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara Bosnja dhe Hercegovina, *Women in Elections Project (Projekti Gratë në Zgjedhje)* [faqja e internetit], https://www.ba.undp.org/content/bosnia_and_herzegovina/en/home/sustainable-development/WomenInElections.html, (e qasur më 10 qershor 2020).

⁸ D. Hasanbegović, et al., *Orange Report 5: Report on the State of the Human Rights of Women in Bosnia and Herzegovina for the period 2016-2019 (Raporti i Gjendjes së të Drejtave të Njeriut të Grave në Bosnjë dhe Hercegovinë)*, Sarajevë, Qendra e Hapur e Sarajevës, 2019, https://soc.ba/site/ep-content/uploads/2019/12/Orange-report-2016-2019_ENG_web.pdf, (e qasur më 10 qershor 2020), fq. 80.

⁹ Parlamentet me ndjeshmëri gjinore si parlamente të cilat, përmes organizimit dhe metodave të tyre përfaqësojnë nevojat dhe interesat e burrave dhe grave. Kjo gjithashtu përfshin heqjen aktive të pengesave (materiale, strukturore dhe / ose kulturore) për pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe sigurimin e burimeve për promovimin e barazisë gjinore.

¹⁰ Asambleja e Qytetarëve të Helsinkit Banja Luka, *Assessing Gender Sensitivity of Entity and State Parliament, (Vlerësimi i Ndjeshmërisë Gjinore në Parlamentin e Shtetit dhe të Njesisë)* Banja Luka, Asambleja e Qytetarëve të Helsinkit Banja Luka, 2020, <http://hcabl.org/wp-content/uploads/2020/07/Assessing-Gender-Sensitivity-of-Entity-and-State-Parliament-1.pdf>, (e qasur më 11 shtator 2020), fq. 6.

¹¹ Po aty.

¹² Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, *Concluding Observations on the Sixth Periodic Report of Bosnia and Herzegovina (Vërejtjet Përfundimtare mbi Raportin e Gjashtë Periodik të Bosnjës dhe Hercegovinës)*, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, 2019, https://arsbih.gov.ba/wp-content/uploads/2019/11/CEDAW-C-BIH-Concluding-Observations-6_AsAdopted.pdf, (e qasur më 1 qershor 2020).

¹³ Po aty.

KOSOVA

Zgjedhjet e tetorit 2019 ishin zgjedhjet e katërta legislative që nga shpallja e pavarësisë. Lista e kandidatëve të certifikuar përfshinte 724 burra dhe 343 gra; gratë përbënin 32% të të gjithë kandidatëve, në përputhje me kuotën ekzistuese për listat zgjedhore.¹⁴ Vetëm një grua garoi për pozitën e Kryeministres.¹⁵ Sipas Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë, platformat politike nuk i kanë adresuar mjaftueshëm çështjet gjinore gjatë zgjedhjeve, dhe vetëm 17% të mbulimit të përgjithshëm mediatik të zgjedhjeve ishte dedikuar për kandidatet gra.¹⁶

Përkundër sfidave me të cilat përballen gratë gjatë zgjedhjeve, shumë më tepër gra u zgjodhën si deputete në Parlament drejtpërdrejt nga vota popullore sesa që ishte rasti në të kaluarën (kur ato fitonin ulëse vetëm për hir të kuotës).¹⁷ Për herë të parë, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, kishte të emëruara gra në 30% të pozitave më të larta hierarkike; nga gjithsej 15 pozitat ministore, pesë udhëhiqeshin nga gratë (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Pushtetit Lokal). Ndërkohë, një grua — Vjosa Osmani — u zgjodh Kryetare e Kuvendit për herë të parë, ndërsa një tjetër grua — Arbërie Nagavci — Zëvendës Kryetare e Kuvendit. Megjithatë, kjo qeveri e sapoformuar u rrëzua më 25 mars 2020, më pak se dy muaj nga formimi i saj. Qeveria e Kosovës u përmbys me votën e mosbesimit për Kryeministrin Kurti.

Edhe pse Ligji për Barazi Gjinore përcakton përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat sociale, ekonomike dhe publike (e definuar si 50/50), Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përsëri kërkon një kuotë minimale prej 30% për

gjininë më pak të përfaqësuar për sa i përket pjesëmarrjes në listat partiake. Në praktikë, kuota e Ligjit Zgjedhor gëzon më shumë përkrahje sesa Ligji i ri për Barazinë Gjinore. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ)¹⁸ dhe Institucioni i Ombudspersonit¹⁹ kanë bërë thirrje për implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore, duke përfshirë përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave në lista partiake.

Një shembull tjetër i implementimit të dobët është rasti i kandidatës Tinka Kurti nga partia politike Vetëvendosje, i cili ilustron barrierat e vazhdueshme legislative në zbatimin e duhur të Ligjit për Barazi Gjinore. Përkundër faktit që më tepër gra ishin zgjedhur në parlament drejtpërdrejt nga vota popullore si asnjëherë më parë (për dallim nga sigurimi i ulëseve vetëm përmes kuotës), zyrtarët e zgjedhur të cilët rrjedhimisht ju bashkuan degës ekzekutive duhet të zëvendësohen me kandidatë të rinj të gjinisë së njëjtë.²⁰ Në këtë rast, ishin dy burra që zëvendësuan deputetët burra të emëruar si ministra, edhe pse secili nga ta kishte marrë më pak vota se Tinka Kurti.²¹

Aktualisht kemi vetëm një grua udhëheqëse nga partia politike në pushtet. Si në të gjitha botimet e mëparshme të raportit *Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor*, është duke vazhduar trendi i mbifinancimit të burrave në raport gratë anëtare të partive politike: "rregulloret e pamjaftueshme dhe mungesa e transparencës për mënyrën sesi shpërndahen fondet midis anëtarëve burra dhe gra brenda partisë, shpiejnë drejt priorizimit të kandidatëve burra. Në kontekst të patronazhit të burrave, burrat shihen si kandidatë më të dëshiruar dhe të sigurt".²² Kjo praktikë e dëmshme e nënvlerëson pjesëmarrjen e grave në politikë.

¹⁴ Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë, *Kosovo 2019: Final Report – Early Legislative Elections, 6 October 2019 (Kosova 2019: Raporti Final-Zgjedhjet e Parakohshme Legjislative, 6 tetor 2019)*, Misioni Vëzhgues i BE-së në Kosovë 2019, http://www.epgencms.europarl.europa.eu/cmsdata/upload/1e4f1465-9cdd-4565-a837-a0487b092e51/Kosovo_early-legislative-elections_6-October-2019_final-report.pdf, (e qasur më 10 qershor 2020), fq. 33.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizatat partnere në Kosovë.

¹⁸ Agjencia për Barazi Gjinore, 'Press Release – The Law on Gender Equality Shall be Adhered to in Terms of Equal Representation of 50% during the 6 October 2019 Parliamentary Elections' (Komunikatë për Media–Të respektohet Ligji për Barazi Gjinore me përfaqësim të barabartë 50% me rastin e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit 2019), *Agjencia për Barazi Gjinore*, 04 shtator 2019, https://abgj.rks-gov.net/en/lajmi_single/739, (e qasur më 1 shtator 2020).

¹⁹ Institucioni i Ombudspersonit, 'Ombudsperson's Statement Related to Equal Gender Representation in the Process of Early Parliamentary Elections 2019' (Deklarata e Ombudspersonit lidhur me përfaqësimin e barabartë gjinor në procesin e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2019), *Institucioni i Ombudspersonit në Republikën e Kosovës*, 5 shtator 2019, <https://www.oik-rks.org/en/2019/09/05/ombudspersons-statement-related-to-equal-gender-representation-in-the-process-of-early-parliamentary-elections-2019/>, (e qasur më 1 shtator 2020).

²⁰ D. Halili, 'Women's Political Empowerment Meets its Limit' (Fuqizimi Politik i Grave Prek Gurin e Kufirit), *Kosovo 2.0*, 14 shkurt 2020, <https://kosovotwopointzero.com/en/womens-political-empowerment-meets-its-limit/>, (e qasur më 11 qershor 2020).

²¹ Po aty.

²² Lj. Cvetanoska dhe A. Elbasani, 'Kosovo: Corruption, Electoral Funding and Political Participation of Women' (Kosova: Korrupsioni, Fondet Elektorale dhe Pjesëmarrja Politike e Grave), *OBC Transeuropa*, 1 qershor 2020, <https://www.balkanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/Kosovo-corruption-electoral-funding-and-political-participation-of-women-202255>, (e qasur më 21 qershor 2020)

MALI I ZI

Gratë në Mal të Zi janë të nënpërfaqësuar për sa i përket pozitive me pushtet politik, dhe nuk e kanë të njëjtin ndikim si burrat në aspektin e politikave, ligjeve dhe reformave që formësojnë zhvillimin socio-ekonomik. Gratë përbëjnë më pak se një e treta (rreth 29%) të deputeteve në Parlamentin Nacional. Pjesëmarrja proporcionale e tyre në mesin e anëtarëve është rreth 18%, ku burrat mbajnë pozitën më të larta qeveritare (Kryeministri dhe Zv. Kryeministri).²³ Kryetari i Parlamentit dhe Sekretari i Përgjithshëm janë poashtu burra. Fushatat politike kryesisht fokusohen në kandidatët burra, të cilët janë edhe folësit kryesorë në pothuajse të gjitha fushatat

partiake. Kjo tregon se kandidatët burra kanë prioritet në raport me kandidatet gra dhe fushatat e partive politike dedikojnë më shumë burime për shtrirje dhe hapësirë publike për fushatat e burrave në krahasim me ato të grave.

Megjithëse numri i grave në pozita ekzekutive me ndikim është në rritje e sipër, sipas *Indeksit të Barazisë Gjimore 2019* për Malin e Zi, ekzistojnë ende shqetësime se burrat mbajnë pozitën më të tepër fuqi vendimmarrëse, gjersa gratë mbajnë pozitën në të ashtuquajtura portfolio "të buta", siç janë çështjet sociokulturore.²⁴

MAQEDONIA VERIORE

Nuk pati ndryshime madhore nga periudha raportuese e mëparshme: 40% të anëtarëve të Parlamentit janë gra (48 gra dhe 72 burra) dhe dy nga pesë Zv. Kryeministrit janë gra. Qeveria aktuale përbëhet nga Kryeministri, tre Zv. Kryeministrit, 15 Ministra dhe shtatë Ministra pa portfolio, gjithsej 26 prej tyre. Nga 26 prej tyre, katër (apo 15%) janë gra dhe 22 (85%) janë burra. Përqindjet për organet tjera ekzekutive për këtë periudhë raportuese janë si vijon: 13% e Zv. Ministrave në 16 ministri janë gra; afërsisht 27% e Sekretarëve Shtetërorë në 16 ministri janë gra; 33% e Nënkyetarëve në Parlament janë gra; 50% e deputetëve brenda institucionit të Ombudspersonit janë gra; 50% e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë janë gra; 22% e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese janë gra.²⁵ Ndërsa Kryetari i Parlamentit të Republikës është një burrë, Sekretari i Përgjithshëm është një grua.²⁶ Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të grave kanë pohuar se që nga formimi i qeverisë në 2017, gratë politike dhe deputete nga partia më e madhe e opozitës "Organizata e Brendshme Revolucionare e Maqedonisë - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar të Maqedonisë" u bënë më të hapura për bashkëpunim me OSHC-të, dhe filluan të punojnë në mënyrë aktive në ngritjen e njohurive të tyre në lidhje me barazinë gjinore, të organizojnë takime dhe të planifikojnë ngjarje të përbashkëta me përfaqësues të OSHC-ve.²⁷

Indeksi i Barazisë Gjimore për Maqedoninë Veriore 2019 tregoi se nëse nuk do të ekzistonte kuota për pjesëmarrjen e gjinisë më pak të përfaqësuar në fusha të ndryshme të pushtetit politik (qeveria qendrore, Parlamenti, qeveritë lokale), pjesëmarrja e grave do të ishte dukshëm më e vogël në krahasim me burrat, dmth shpërndarja e pushtetit politik në mënyrë disproporcionale është më e lartë në favor të burrave.²⁸ Kjo e përforcon pohimin se megjithëse sistemi i kuotave zgjedhore nuk është një sistem perfekt ai është treguar i suksesshëm për të siguruar se pjesëmarrja e grave në politikë ekziston në njëfarë mase, edhe nëse nuk arrihet 50% proporcional. Për më tepër, pa kuota zërat e grave do të mungonin gati krejtësisht në hapësirat politike.

Në vitin 2020, Aleanca Qeverisëse e Maqedonisë Veriore²⁹ njoftoi rreth një iniciativë për të barazuar numrin e burrave dhe grave kandidatë për zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme në të ardhmen. Ky veprim do të përfshinte barazimin e numrit të grave dhe burrave kandidatë për deputetë në listat partiake. Aleanca Qeverisëse gjithashtu konfirmoi që listat e saj të kandidatëve në të gjashtë zonat zgjedhore do të drejtoheshin nga një tandem i kandidatëve kryesorë, një kandidat burrë dhe një kandidat grua.³⁰

²³ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *OSCE-led Survey on Violence against Women: Montenegro (Sondazh mbi Dhunën kundër Grave i udhëhequr nga OSBE: Mali i Zi)*, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2019, https://www.osce.org/files/f/documents/8/7/424985_1.pdf, (e qasur më 21 qershor 2020), fq. 10.

²⁴ O. Komar, *Gender Equality Index Montenegro (Indeksi i Barazisë Gjimore për Malin e Zi) - 2019*, Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara, 2020, https://www.me.undp.org/content/montenegro/en/home/library/womens_empowerment/GEI2019.html, (e qasur më 12 qershor 2020).

²⁵ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Maqedoni Veriore.

²⁶ Unioni Ndër-Parlamentar, *North Macedonia: Assembly of the Republic (Maqedonia Veriore: Kuvendi i Republikës)* [faqja në internet], https://data.ipu.org/content/north-macedonia?chamber_id=13391, (e qasur më 10 prill 2020).

²⁷ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Maqedoni Veriore.

²⁸ M. Bashevska, *Gender Equality Index North Macedonia 2019: Measuring Gender Equality (Indeksi i Barazisë Gjimore për Maqedoninë Veriore 2019: Matja e Barazisë Gjimore)*, Shkup, UNDP- UN Women, 2019, https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender_equality_index_macedonia_eng.pdf, (e qasur më 15 qershor 2020), fq. 24.

²⁹ Gjatë periudhës raportuese. Deri në gusht 2020, qeveria e re ende nuk është formuar.

³⁰ S.J. Marusic, 'North Macedonia Ruling Alliance Pushes Gender Equality in Elections' (Aleanca Qeverisëse e Maqedonisë Veriore Shtyn Barazinë Gjimore në Zgjedhje), *BIRN*, 16 mars 2020, <https://balkaninsight.com/2020/03/16/north-macedonia-ruling-alliance-pushes-gender-equality-in-elections/>, (e qasur më 10 qershor 2020).

SERBIA

Gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm në pjesëmarrjen politike të grave në pozitat vendimmarrëse në Serbi. Asambleja Kombëtare kryesohet nga një grua dhe Sekretari i Përgjithshëm është një burrë. Nga 120 parti të regjistruara, vetëm gjashtë drejtohen nga gra.³¹

Në *Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë*, CEDAW ka rekomanduar miratimin e Projektligjit për Barazinë Gjinore. Zbatimi i këtij përfaqësimi do të vendoste kuota të detyrueshme deri në 50% për përfaqësimin e grave në të gjitha autoritetet publike dhe administrative.³² Gjatë periudhës raportuese 2020, Parlamenti Serb miratoi një ndryshim në ligjet e tij zgjedhore me një kuotë të re minimale prej 40% për kandidatet e gjinisë më pak të përfaqësuar (nga 30% e mëparshme) për

listat zgjedhore në zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Parlamenti miratoi këtë amendament në raport me dy ligje; Ligji për Zgjedhjen e Anëtarëve të Parlamentit (deputetëve) dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale, duke synuar rritjen e përfaqësimit të grave në politikë.³³

Zgjedhjet parlamentare ishin planifikuar fillimisht për 26 Prill, 2020, por u shtynë për 21 Qershor 2020, pasi gjendja e jashtëzakonshme për COVID-19 ishte hequr. Vetëm një kandidat foli për të drejtat e grave gjatë fushatës elektorale 2020.³⁴ Në kohën kur po hartohet ky raport, rezultatet e zgjedhjeve ende nuk janë finalizuar dhe si e tillë ende nuk është formuar një qeveri zyrtare. Për shkak të parregullsive në procesin zgjedhor, votimi duhej të përsëritej në 234 vendvotime.³⁵

”

"Praktika tregon se nëse doni të arrini të njëjtin sukses si kolegu juaj burrë, duhet të jeni dy herë më e mirë se ai në mënyrë që të jeni të barabartë,"

Gordana Čomić, deputete serbe³⁶

”

"Nuk thuhet që vetëm 30% e parlamentit duhet të jenë gra. Aty thuhet se minimumi prej 30% gra duhet të renditen në listat zgjedhore,"

Luljeta Demolli, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore³⁷

³¹ A. Janković dhe M. Čvorić Gubelić, 'Kvote su Uvele Žene u Politički Život, ali ne i na Funkcije' (Kuotat i Futën Gratë në Jetën Politike, por jo në Funkcione), *Blic*, 31 dhjetor 2019, <https://www.blic.rs/vesti/politika/samo-dve-partije-u-srbiji-imaju-predsednice-kvote-su-uvele-zene-u-politicki-zivot-ali/58gdnyg>, (e qasur më 12 qershor 2020).

³² CEDAW, *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Serbia (Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë)*, CEDAW, 2019, https://www.womenngo.org.rs/images/CEDAW/CEDAW_Concluding_observations.pdf, (e qasur më 6 qershor 2020).

³³ Unioni Ndër-Parlamentar 'Serbia Steps up Efforts for Gender Parity' (Serbia Rrit Përpjekjet për Barazi Gjinore), *Unioni Ndër-Parlamentar*, 2020, <https://www.ipu.org/news/news-in-brief/2020-02/serbia-steps-up-efforts-gender-parity>, (e qasur më 11 qershor 2020).

³⁴ Izbori 2020, Žene i Politika u Srbiji: "Mnogo Ljudi mi je Reklo da mi Tako Nešto Nije Trebalo u Životu" (Zgjedhjet 2020, Gratë dhe Politika në Serbi: "Shumë Njerëz më kanë Thënë se Diçka e Tillë nuk më është Dashur në Jetë"), *BBC News*, 11 qershor 2020, <https://www.021.rs/story/BBC/245671/Izbori-2020-zene-i-politika-u-Srbiji-Mnogo-ljudi-mi-je-reklo-da-mi-tako-nesto-nije-trebalo-u-zivotu.html>, (e qasur më 11 qershor 2020).

³⁵ 'Ponavljanje Izbor na 234 Biračka Mesta u Srbiji' (Përsëritja e Zgjedhjeve në 234 Vendvotime në Serbi), *Radio Slobodna Evropa*, 26 qershor 2020, <https://www.slobodnaevropa.org/a/30691628.html>, (e qasur më 20 qershor 2020).

³⁶ Izbori 2020, Žene i Politika u Srbiji: "Mnogo Ljudi mi je Reklo da mi Tako Nešto Nije Trebalo u Životu" (Zgjedhjet 2020, Gratë dhe Politika në Serbi: "Shumë Njerëz më kanë Thënë se Diçka e Tillë nuk më është Dashur në Jetë"), *BBC News*, 11 qershor 2020.

³⁷ D. Halili, 'Women's Political Empowerment Meets its Limit' (Fuqizimi Politik i Grave Prek Gurin e Kufirit), *Kosovo 2.0*, 14 shkurt 2020.

TË DHËNAT STATISTIKORE TREGOJNË:


Përqindja e Grave dhe Burrave në Parlamentin Nacional

	Numri i grave	Numri i burrave	Numri total i ulëseve	Përqindja e grave (%)	Përqindja e burrave (%)
Shqipëria	39	81	122	30	70
BeH	11	31	42	26	74
Kosova	39	81	120	32	68
Mali i Zi	24	57	81	30	70
Maqedonia Veriore	48	72	120	40	60
Serbia	93	154	247	38	62

33%**Info:**

Përqindja mesatare e deputeteve gra në Ballkanin Perëndimor është afërsisht 33%, që përfaqëson një rritje të përgjithshme prej 4 pikë përqindjeje në rajon krahasuar me statistikat nga 2019.

Përqindja e Grave dhe Burrave në Parlamentet Nacionale të Ballkanit Perëndimor



Përqindja e Ministrave Gra dhe Burra


	Numri i grave	Numri i burrave	Numri total i ulëseve	Përqindja e grave (%)	Përqindja e burrave (%)
Shqipëria	7	7	14	50	50
BeH	2	7	9	22	78
Kosova*	4	16	20	20	80
Mali i Zi	4	14	18	22	78
Maqedonia Veriore	6	18	24	25	75
Serbia*	4	17	21	19	81

* Vendet që mbajtën zgjedhje pas 1 qershorit, data e ndërprerjes së mbledhjes së të dhënave për këtë botim aporti. Këto numra pasqyrojnë qeveritë në kohën e hartimit të këtij raporti, prandaj mund të jenë subjekt i ndryshimeve në kohën e publikimit.

**Info:**

Përqindja mesatare e grave Ministre është afërsisht 27% (me përjashtim të Shqipërisë, ku mesatarja është 22%). Kjo përfaqëson një rritje të përgjithshme prej 1.6 pikë përqindjeje në rajon krahasuar me statistikën nga viti 2019.


Përqindja e Ministrave Gra dhe Burra në Ballkanin Perëndimor



Tabelë Krahاسimi:

Përqindja e Deputeteve Gra në Parlamentet Nacionale 2016-2020³⁸

	2016		2017		2018		2019		2020 ³⁹	
	% Ž	% M	% Ž	% M	% Ž	% M	% Ž	% M	% Ž	% M
Shqipëria	21	79	30	70	30	70	30	70	30	70
BeH	21	79	21	79	21	79	21	79	26	74
Kosova	33	67	32	68	32	68	32	68	32	68
Mali i Zi	19	81	24	76	24	76	23	77	30	70
Maqedonia Veriore	35	65	31	69	38	62	38	62	40	60
Serbia	34	66	34	66	36	64	37	63	38	62




³⁸ Burime të ndryshme japin përqindje të ndryshme të grave dhe burrave deputetë midis 2016-2020 në secilin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në varësi të burimit, mund të ketë një ndryshim prej disa pikësh përqindjeje për çdo vit. Ky raport i jep përparësi statistikave nga baza e të dhënave të EIGE. Për statistikë arkivore, u përdor baza e të dhënave e Unionit Ndërparlamentar për të plotësuar statistikë ku EIGE nuk i kishte ato

³⁹ Të dhënat për 2020 reflektojnë numrat vetëm deri më 1 qershor, 2020

Tabelë Krahاسimi:

Përqindja e Grave Ministra 2016-2020

	2016		2017		2018		2019		2020	
	% G	% B	% G	% B	% G	% B	% G	% B	% G	% B
Shqipëria	40	60	50	50	50	50	50	50	50	50
BeH	14	86	25	75	22	78	/	/	22	78
Kosova	5	95	12	88	5	95	10	90	20	80
Mali i Zi	18	82	22	78	22	78	22	78	22	78
Maqedonia Veriore	10	90	15	85	18	82	22	78	25	75
Serbia	21	79	21	79	19	81	19	81	19	81



% E PËRFAQËSIMIT TË GRAVE NË POLITIKË NË KËSHILLAT LOKALE/KOMUNALE

Përfaqësimi dhe ndikimi i barabartë i grave dhe burrave në jetën politike, në të gjitha nivelet e qeverisjes, është një e drejtë themelore dhe një parakusht për një shoqëri demokratike. Strukturat lokale në shtetet e Ballkanit Perëndimor mbeten relativisht të pandryshuara gjatë periudhës së raportimit. Ndryshime më të vogla ndodhën në nivelin lokal, por këto ndryshime nuk ndikuan shumë në raportin midis përfaqësuesve të grave dhe burrave në këshillat lokale/komunale. Përgjithësisht në rajon, zërat e burrave janë më të përfaqësuar dhe më të pranishëm sesa ato të grave. Përkundër disa përmirësimeve në pjesëmarrjen e grave në nivelin kombëtar, politika komunale mbetet një fushë beteje për kandidatet gra; derisa në nivelin lokal ndryshimi midis pjesëmarrjes së burrave dhe grave është më i dukshëm. Të dhënat për numrin e grave kryetare në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë dëshpruese. Përfaqësimi i grave si anëtare të këshillave regjistron një rritje të lehtë, por mbetet i ulët në mënyrë disproporcionale.

Gratë nga grupet e pakicave etnike si dhe komuniteti LGBTQI + kanë qasje të kufizuar për sa i përket hyrjes në politikë. Adresimi i mungesës së qasjes së tyre nuk paraqet prioritet në shtetet e Ballkanit Perëndimor, në çdo nivel të qeverisjes. Në nivelin lokal, pjesëmarrja

politike e komuniteteve pakicë është thelbësore, por edhe kur ajo ekziston, ka mungesë të sensibilizimit gjinor për të. Ka dukshëm më pak (ose pothuajse fare) gra nën moshën 31 vjeç në politikë në nivelin lokal, gjë që nuk është rasti për kandidatët politikë burra. Si rrjedhojë, hendeuku i moshës së grave dhe burrave të zgjedhur në pozitat vendimmarrëse në qeverisjen lokale është i dukshëm. Ekzistojnë pretendime se gratë duhet të bëjnë më shumë për periudha më të gjata kohore për të "dëshmuar" veten e tyre dhe se kjo praktikë diskriminuese kontribuon në numrin disproporcionalisht të ulët të grave të reja në politikën lokale krahasuar me burrat e rinj.

Shoqëritë e Ballkanit Perëndimor janë akoma shumë tradicionale me norma të rrënjosura thellë në raport me gratë, duke e bërë hyrjen në politikë më të vështirë, të pabarabartë dhe dekurajuese. Ky është një problem strukturor, si dhe sociologjik, dhe duhet të adresohet në shumë nivele të ndryshme, duke filluar nga procesi i përzgjedhjes dhe sistemi zgjedhor, vetë-perceptimi dhe imazhi shoqëror i grave në politikë, konsideratat e baraspeshimit të punës dhe jetës, deri tek qasja e barabartë në financim dhe media.

SHQIPËRIA

Janë 1 595 anëtarë të këshillit që përfaqësojnë të gjitha partitë e regjistruara në 61 komunat e Shqipërisë,⁴⁰ nga të cilat 555 janë gra (rreth 35%) dhe 1 040 janë burra (65%). Megjithatë zgjedhjet e fundit komunale sollën një numër më të lartë të grave kryetare komunash në 2017, ka shumë pak gra që mbajnë role drejtuese brenda partive politike.⁴¹

Raporti i *Kostos së Politikës në Shqipëri* zbulon se ku janë gratë për sa i përket financimit dhe drejtimit të fushatave. Gjetjet e hulumtimit tregojnë se kandidatet gra dhe politikanet gra kishin një mbulim shumë të kufizuar gjatë fushatës zgjedhore.⁴² Për më tepër, gratë anëtare të këshillave besojnë se shpenzimet me të cilat përballen gjatë fushatave janë të larta dhe për këtë arsye mund të ndikojnë në gatishmërinë e grave për të marrë pjesë në politikë: të gjitha sugjeruan që partia të mos i dëmshpërblente ato për ndonjë nga kostot në lidhje me fushatën.⁴³ Përjashtimi i grave nga qarqe të caktuara të pushtetit, përveç statusit të tyre ekonomik, i cili në përgjithësi është inferior në

krahasim me burrat, ndikon në emërimin dhe rekrutimin e tyre si kandidate në zgjedhjet lokale.⁴⁴ Gratë nuk kanë të njëjtën qasje në burimet e fushatës dhe si rezultat ato nuk mund të pretendojnë pozita të ndryshme brenda partisë. Këto pozita të pabarabarta krijojnë pengesa të jashtëzakonshme për gratë që duan të marrin pjesë në çështjet politike, pengesa me të cilat nuk përballen kolegët dhe koleget e tyre burra.⁴⁵

Në përgjithësi, ka një përfshirje të ulët të grave në strukturat lokale të vendimmarrjes në Shqipëri. Shumë pak kandidate gra janë të përfshira në zgjedhje, kuota gjinore nuk respektohet ose nuk zbatohet plotësisht nga qeveritë lokale, dhe për ato pak gra që janë të afta të marrin pozita politike, ato nuk arrijnë të veprojnë në kushte të barabarta dhe të drejta krahasuar me burrat. Për më tepër, shumë gra nuk janë të vetëdijshme se duhet të kenë një përfaqësim real në strukturat vendimmarrëse; një pasojë e vlerave të qëndrueshme patriarkale dhe tradicionale.⁴⁶

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Ka pasur përmirësime të dukshme nga zgjedhjet e vitit 2018 në nivelin kantonal në FBiH, ku katër në 10 kantone (Bosnja Qendrore, Hercegovina-Neretva, Sarajeva dhe Tuzla) kanë 40% ose më shumë gra të zgjedhura si përfaqësuese në asamblatë e tyre përkatëse, duke reflektuar dispozitat e Ligjit për Barazinë Gjinore. Degët Ekzekutive që janë formuar në kohën e hartimit të këtij raporti, megjithatë, edhe një herë pasqyrojnë një pjesëmarrje shumë të ulët të grave në formimin e qeverive, veçanërisht në nivelet kantonale.⁴⁷ Kjo tregon se megjithë sukseset e sistemit të kuotave, gratë janë të nënpërfaqësuar në Degët Ekzekutive dhe pozitat e larta me fuqi vendimmarrëse. Kërkesat për kuota mund të

arrihen, por tejkalimi i tyre mbetet një sfidë dhe hyrja në nivelet më të larta të qeverisë mbetet disproporcionale.

Gjetjet e fundit të hulumtimit nga *Studimi Bazë mbi Pengesat në Pjesëmarrjen Politike të Grave në Bosnjë dhe Hercegovinë* tregojnë se rolet tradicionale gjinore, mungesa e mbështetjes nga gratë dhe burrat, dhe mungesa e përgjithshme e mbështetjes nga elektorati janë faktorë që parandalojnë dhe dekurajojnë gratë nga hyrja në politikë. Visibiliteti dhe prania publike e grave kandidate në BeH janë veçanërisht të ulëta përpara zgjedhjeve komunale.

⁴⁰ B. Kadia, dhe R. Prifti, *The Cost of Politics in Albania (Kosto e Politikës në Shqipëri)*, WFD, 2019, fq. 18.

⁴¹ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Republic of Albania: Local Elections 30 June 2019 - ODIHR Election Observation Mission Final Report (Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet Lokale 30 qershor – Raporti Final i Misionit të ODIHR-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve)*, Varshavë, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, 2019, https://www.osce.org/files/f/documents/1/1/429230_0.pdf, (e qasur më 21 qershor 2020), fq. 2.

⁴² B. Kadia, dhe R. Prifti, *The Cost of Politics in Albania (Kosto e Politikës në Shqipëri)*, WFD, 2019.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty., fq. 19.

⁴⁵ Po aty., p. 20.

⁴⁶ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Shqipëri.

⁴⁷ Po aty.

KOSOVA

Ndërsa kuota gjinore rezultoi në rritjen e numrit të grave në qeverinë qendrore, asnjë zgjedhje nuk ndodhi në nivelin lokal gjatë kësaj periudhe. Kosova akoma nuk ka një kryetare të vetme grua në asnjë nga 38 komunat e saj. Dispozitat ligjore për barazinë gjinore nuk janë integruar mjaftueshëm brenda ligjeve të ndryshme, duke shkaktuar paqartësi rreth zbatimit të duhur të tyre.⁴⁸ Gratë mbeten të nënpërfaqësuar brenda partive politike dhe administratës zgjedhore. Partitë politike mbeten një nga pengesat më të mëdha për përparimin e grave dhe pjesëmarrjen kuptimplote në jetën publike.⁴⁹

Masat afirmative, si kuotat, janë të rëndësishme për përforcimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, siç ka përshkruar ky botim dhe botimet e mëparshme të këtij raporti. Zbatimi adekuat i Ligjit për Barazinë Gjinore në Kosovë duke përfshirë ligjet zgjedhore me të mund të kontribuojë drejtpërdrejt në pjesëmarrjen më të barabartë të grave në nivelin lokal.

MALI I ZI

Për sa i përket tendencave pozitive në përqindjen e grave të zgjedhura në pozitë të qeverisjes lokale, Mali i Zi mban vendin e dytë në Ballkanin Perëndimor (pas Shqipërisë), duke rritur numrin e grave të zgjedhura në nivelin lokal nga 11% në 2008 në 30% në 2019.⁵⁰ Gjatë dy cikleve të fundit zgjedhore, rritja më e madhe e pjesëmarrjes së grave u regjistrua në asamblenë komunale, ku numri i grave anëtare ishte afërsisht 29%, ndërsa burrat mbanin 71% të pozitave të anëtarëve të këshillave. Numri më i lartë i grave anëtare përfaqësohet në Asamblenë Komunale të Nikshiqit me 40%, dhe më i ulët në Gusinje, me afërsisht 20%.

Vetëm 2% e kryetarëve të komunave të Malit të Zi janë gra, që do të thotë se burrat mbajnë fuqinë më të lartë vendimmarrëse në 98% të komunave.⁵¹ Një fakt tjetër shqetësues është numri i pamjaftueshëm i grave nga grupet etnike në politikë dhe vendimmarrje në nivelin lokal. Mungesa e zërit të grave në politikën komunale përkeqësohet nga fakti që gratë e pakicave në këtë sferë nuk kanë pothuajse fare fuqi vendimmarrëse.



"Kush pyet një politikan burrë nëse është mjaft i aftë të jetë në pozitë vendimmarrëse? Derisa për një grua që gjendet në atë pozitë, kjo është një pyetje e pashmangshme."

Edina Dešić, Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë për Tregun e Punës dhe Punësim në Ministrinë e Punës së Malit të Zi⁵²

⁴⁸ Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë, *Kosovë 2019: Final Report – Early Legislative Elections, 6 October 2019 (Raporti Final-Zgjedhjet e Parakohshme Legjislative, 6 tetor 2019)*, Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë, 2019, fq. 4.

⁴⁹ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Kosovë.

⁵⁰ S. Ceciari, *Women in Politics Local and European Trends (Gratë në Politikë Trendet Lokale dhe Evropiane)*, Këshilli i Komunave dhe Rajoneve Evropiane (CEMR), 2019,

https://ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/CEMR_Study_Women_in_politics_EN.pdf, (e qasur më 21 qershor 2020), fq. 23.

⁵¹ OSBE, *OSCE-led Survey on Violence against Women: Montenegro (Sondazh mbi Dhunën kundër Grave i udhëhequr nga, OSBE)*, 2019, p. 10.

⁵² M. Boričić, dhe A. Jelić, 'Nedovoljno Žena iz Manjinskih Naroda u Politici i Odlučivanju: Tvrdja Odbrana "Muškog Posla"' (Pamjaftueshëm Gra nga Minoritetet në Politikë dhe Vendimmarrje: Mbrojtje e Fortë e "Biznesit të Burrave", *Vijesti*, 31 January 2020, <https://www.vijesti.me/vijesti/drustvo/419786/nedovoljno-zena-iz-manjinskih-naroda-u-politici-i-odlucivanju-tvrda-odbrana-muskog-posla>, (e qasur më 21 qershor 2020).

MAQEDONIA VERIORE

Mungesa e grave në politikën e nivelit lokal është veçanërisht e dukshme në vetëqeverisjet lokale, veçanërisht në zonat rurale. Të dhënat mbi pjesëmarrjen e grave në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes lokale nga kjo periudhë e raportimit janë gjithashtu shqetësuese: sondazhi i fundit i qytetarisë lokale tregon se afërsisht 78% e grave të anketuara nuk kanë qenë kurrë të përfshira në ndonjë formë në proceset e vendimmarrjes politike.⁵³ Vetëm rreth 15% e Kryetarëve të Këshillit Komunal në 81 komuna janë gra (gjithsej 12 gra, 69 burra), ndërsa 30% e anëtarëve të këshillave të zgjedhur në njësitë e vetëqeverisjes lokale janë gra (415 nga 1388, 973 janë burra)⁵⁴. Gjetjet tregojnë se "shumica e grave, pavarësisht nga grupi shoqëror që i përkasin,

kanë vështirësi të lidhin problemet e tyre të përditshme me kompetencat dhe përgjegjësitë e qeverisjes vendore për shkak të mungesës së informatave mbi proceset kryesore dhe rolin e qeverisjes vendore".⁵⁵ *Women's Political Participation in North Macedonia, Study and Scientific Research Papers [Pjesëmarrja Politike e Grave në Maqedoninë Veriore, Punime Studimore dhe Kërkimore Shkencore]* konkludon se ekziston një diskriminim sistematik ndaj grave brenda partive politike, si dhe në procesin e rekrutimit për këshillat komunale, duke deklaruar se "partitë politike u japin burrave një shans bazuar në potencialin e tyre, ndërsa gratë duhet të dëshmojnë veten para se të kenë një shans".⁵⁶

SERBIA

Në *Vërejtjet Përmblylëse të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë*, CEDAW vuri në dukje shqetësimin e tyre se gratë janë shumë të nënpërfaqësuar në administratën lokale, me vetëm 9 nga gjithsej 169 komuna që kanë gra si kryetare komunash,⁵⁷ duke zënë vetëm 5% të të gjitha pozitave të kryetarëve të komunave, e gjerë, ndërsa burrat mbajnë 95% të pozitave të njëjta. Kjo tregon që ekziston një shkallë e lartë e nën-përfaqësimit të zërave të grave në nivelin

lokal. Sipas hulumtimit të Komisionerit për Mbrojtjen e Barazisë, ndryshimi më i madh në pjesëmarrjen e grave dhe burrave në nivel të komunave dhe qyteteve është në pozitën e kryetarit. Lidhur me presidentët e asambleve komunale/qytetare, 14% janë gra, 86% janë burra. Sipas të njëjtit burim, gratë kanë një më tepër shanse për t'u emëruar në pozitat e deputetëve.⁵⁸

”

“Në takimet me bazë komunitare në zonat rurale, pjesëmarrja e grave vlerësohet të jetë rreth 5 deri në 10% krahasuar me pjesëmarrjen prej 90 deri 95% të burrave në takimet e strukturave komunale apo edhe në takimet e fshatrave”

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 - 2024⁵⁸

”

Në reklamat e fushatës televizive parazgjedhore, "forma më efektive e reklamave parazgjedhore me pagesë, gratë janë pothuajse gjithmonë ato që flasin në favor të bartësit të listës"

Dubravka Valić Nedeljković, analiste në Shkollën e Gazetarisë në Novi Sad dhe profesore në Universitetin e Novi Sadit⁶⁰

⁵³ M. Dokmanovikj et al., *Women's Political Participation in North Macedonia (Pjesëmarrja Politike e Grave në Maqedoninë Veriore)*, Dokumenta Studimi dhe Hulumtimi Shkencor, WDF, 2019, <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/Women-Political-Participation-2019-EN-for-web-.pdf>, (e qasur më 15 qershor 2020), fq. 20.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty., fq. 33.

⁵⁶ Po aty, fq. 49.

⁵⁷ CEDAW, *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Serbia (Vërejtjet Përfundimtare e Raportit të Katërt Periodik të Serbisë)*, CEDAW, 2019.


⁵⁸ A. Janković dhe M. Čvorić Gubelić, 'Kvote su Uvele Žene u Politički Život, ali ne i na Funkcije' (Kuotat i Futën Gratë në Jetën Politike, por jo në Funksione), *Blic*, 31 dhjetor 2019.

⁵⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës, *Kosovo Program for Gender Equality 2020-2024 (Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024)*, Qeveria e Republikës së Kosovës, 2020, <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>, (e qasur më 23 shtator 2020), fq. 44.

⁶⁰ Izbori 2020, Žene i Politika u Srbiji: "Mnogo Ljudi mi je Reklo da mi Tako Nešto Nije Trebalo u Životu" (Zgjedhjet 2020, Gratë dhe Politika në Serbi: "Shumë Njerëz më kanë Thënë se Diçka e Tillë nuk më është Dashur në Jetë"), *BBC News*, 11 qershor 2020.

TË DHËNAT STATISTIKORE TREGOJNË:

Përqindja e Grave dhe Burrave Kryetarë/e të Komunave


**7%****Info:**

Përqindja mesatare e grave kryetare të komunave në Ballkanin Perëndimor është shumë e ulët, mesatarisht rreth 7%.



Nuk ka asnjë kryetare komune në Kosovë.

Përqindja e Grave dhe Burrave Këshilltarë/e Komunale

**30%****Info:**

Përqindja mesatare e grave këshilltare komunale në Ballkanin Perëndimor është 30%, që përfaqëson një rritje prej 1.7 pikë përqindjeje krahasuar me statistikat nga botimi i kaluar i këtij raporti (2019).

Tabelë Krahاسimi:


Gratë në Pozita të Kryetareve të Komunave 2016-2020

	2016		2017		2018		2019		2020	
	% G	% B	% G	% B	% G	% B	% G	% B	% G	% B
Shqipëria	14	86	14	86	15	85	15	85	15	85
BeH	2	98	2	98	4	96	4	96	4	96
Kosova	3	97	3	97	0	100	0	100	0	100
Mali i Zi	4	96	4	96	12	88	8	92	8	92
Maqedonia Veriore	4	96	4	96	7	93	7	93	7	93
Serbia	5	95	5	95	7	93	7	93	7	93

**Info:**

Nuk ka ndryshime në numrin e grave në pozita të kryetareve të komunave në Ballkanin Perëndimor krahasuar 2019.


Gratë në Pozita të Kryetareve të Komunave 2017-2020 (%)



Tabelë Krahاسimi:

Gratë Këshilltare Komunale 2016-2020

	2016		2017		2018		2019		2020	
	% G	% B	% G	% B	% G	% B	% G	% B	% G	% B
Shqipëria	35	65	35	65	37	63	35	65	35	65
BeH	16	84	16	84	16	84	4	96	18	82
Kosova	39	61	39	61	39	61	35	65	35	65
Mali i Zi	32	68	32	68	28	72	28	72	30	70
Maqedonia Veriore	30	70	30	70	35	65	33	67	32	68
Serbia	24	76	24	76	35	65	35	65	31	69



GRATË ROME NË POLITIKË

Gratë që janë pjesë e grupeve të pakicave etnike në Ballkanin Perëndimor përballen me forma ndërprerëse të diskriminimit dhe pengesa për të hyrë në jetën dhe pozitën publike me fuqi vendimmarrëse. Në rajon, grupet e pakicave etnike përballen me racizëm sistematik në të gjitha nivelet e shoqërisë. Gratë rome janë më shumë të marginalizuara për shkak të gjinisë së tyre. Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë një përfaqësim të përgjithshëm të ulët të burrave dhe grave romë në politikë, dhe në rastet kur ka një përfaqësues rom në një pozitë me fuqi vendimmarrëse, në shumicën e rasteve ata janë burra. Shkalla e ulët e arsimit të lartë, shkalla e lartë e analfabetizmit, rolet specifike tradicionale dhe stereotipet gjinore ndikojnë në qasjen e grave rome në pozitën publike dhe politike.⁶¹

Shqipëria, BeH, Kosova, Maqedonia Veriore⁶² dhe Mali i Zi nuk kanë gra rome në politikë ose në pozitën vendimmarrëse në nivelin kombëtar (deputete, ministra/zëvendësministra). Serbia zgjodhi deputeten e saj të parë rome në 2018.⁶³ Në nivelin lokal, BeH ka një këshilltare komunale grua rome dhe Maqedonia Veriore ka një grua rome Presidente të Këshillit në Suto Orizari.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në BeH ka gjithsej 14 këshilltarë romë në këshillat komunalë dhe të qytetit (nga gjithsej 143 komuna/qytete), nga të cilët njëra është një grua rome (komuna e Visoko) dhe 13 janë burra. Romët nuk mund të jenë as kandidatë, të zgjedhur si anëtarë të Presidencës së BeH, as në Asamblenë Parlamentare të vendit, pasi ata janë

njohur si një pakicë kombëtare dhe grupet e pakicave nuk mund të mbajnë këto pozita, sipas Kushtetutës së BeH.⁶⁴

Gratë rome nuk janë fare të pranishme në funksione politike në Shqipëri ose Mal të Zi, as në nivelin lokal dhe as atë kombëtar sipas organizatave të grave në këto shtete.⁶⁵ Gjithashtu, nuk ka gra rome, ashkali ose egjiptiane të përfshira në politikë ose pozita vendimmarrëse në nivelin kombëtar ose lokal në Kosovë.⁶⁶ Në Parlamentin e Maqedonisë Veriore dy parti politike janë parti etnike rome, dhe mbajnë dy ulëse në parlament nga gjithsej 120. Asnjë nga këto ulëse nuk mbahen nga gratë.⁶⁷

Përbërjet e partive politike në Ballkanin Perëndimor pasqyrojnë pothuajse të njëjtën situatë. Në Kosovë, ka gra rome, ashkali dhe egjiptiane që u përkasin dhe kontribuojnë partive të ndryshme politike dhe të cilat gjithashtu merrnin pjesë në zgjedhje si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë qendror, por deri më tani asnjëra nga këto gra nuk është zgjedhur.⁶⁸ Asnjë parti politike rome në Maqedoninë Veriore nuk ka pasur kurrë një grua si udhëheqëse të partisë dhe ekziston vetëm një grua rome aktualisht në një pozitë të lartë në strukturën e partisë politike, Ljatif Shikovska, e cila është anëtare e Bordit Ekzekutiv të Shoqërisë Sociale - Bashkimi Demokratik i Maqedonisë⁶⁹ (partia aktuale në pushtet). Në BeH, pjesëmarrja e grave rome në shoqëri dhe politikë është shumë e ulët, madje edhe në organet që përfaqësojnë interesat e komuniteteve rome.

⁶¹ A. Kadribašić et al., *Baseline Study on Barriers to Political Participation of Women in Bosnia and Herzegovina (Studim Themelor mbi Barrierat e Pjesëmarrjes Politike të Grave në Bosnjë e Hercegovinë)*, Sarajevë, Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Bosnjë e Hercegovinë, 2019, https://www.ba.undp.org/content/bosnia_and_herzegovina/en/home/library/democratic_governance/polazna-studija-o-barrierama-politikom-ueu-ena-u-bosni-i-hercego.html, (e qasur më 12 qershor 2020), fq. 41.

⁶² Gjatë shkrimit të këtij edicioni, zgjedhjet Parlamentare ishin duke u mbajtur në Maqedoni Veriore, rezultatet e të cilave nuk janë përfshirë në këtë edicion të raportit.

⁶³ 'Jelena Jovanović - Prva Romkinja u Skupštini AP Vojvodine' (Jelena Jovanović - Romja e Parë në Kuvendin e Krahinës Autonome të Vojvodinës), *Radio-Televizioni i Vojvodinës*, 23 maj 2018, https://www.rtv.rs/sr_lat/vojvodina/novi-sad/jelena-jovanovic-prva-romkinja-u-skupstini-ap-vojvodine_920566.html, (e qasur më 12 qershor 2020).

⁶⁴ Teksti i Kushtetutës u referohet 17 pakicave kombëtare si "të tjerët" dhe u mohon anëtarëve të tyre të drejtën për të kandiduar për presidencën dhe dhomën e lartë të parlamentit. Përkundër vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg (Sejdić-Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës) të vitit 2009 e cila e detyron BeH të heqë dispozitat diskriminuese të Kushtetutës, kjo nuk është bërë ende.

⁶⁵ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizatat partnere.

⁶⁶ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizatat partnere në Kosovë.

⁶⁷ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizatat partnere në Maqedoni Veriore.

⁶⁸ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizatat partnere në Kosovë.

⁶⁹ Emri i partisë ende mban emërtimin "Maqedonia", në vend të "Maqedonia Veriore".

Këto shifra ilustrjnë nën-përfaqësimin e romëve në përgjithësi dhe grave rome në veçanti në politikën e Ballkanit Perëndimor, në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në partitë politike. Bazuar në pozicionin e marginalizuar të grave rome, këto të dhëna janë shqetësuese dhe tendencat statistikore nuk tregojnë ndonjë përmirësim pozitiv dhe domethënës. Çështje shtesë në lidhje me numrin e ulët të pjesëmarrjes politike të grave rome janë: mungesa e të dhënave të besueshme që mund të demonstrojnë me saktësi pjesëmarrjen ekzistuese të grave rome në politikë, pasi që disa të dhëna në dispozicion të Shtetit nuk janë të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, (të tilla si në Maqedoninë Veriore); mungesa e analizave kërkimore dhe boshllëqet e përgjithshme të kërkimit në literaturën mbi këtë temë; dhe një mungesë transparence në zgjedhjen dhe emërimin e këshilltarëve ekzistues të pakicave, që shpesh përjashton gratë (të tilla si në BeH). Pavarësisht nga tendencat dekurajuese statistikore, ka OSHC të grave që punojnë për këto çështje, si dhe ka iniciativa të shumta në të gjithë rajonin për të ndryshuar situatën aktuale dhe për të adresuar këto boshllëqe. Një shembull është Bolja Budućnost në Tuzla, BeH, që po

punon për të siguruar që të gjitha organet dhe grupet që përfaqësojnë interesat e grave dhe burrave romë në të gjitha nivelet e qeverisjes të rrisin pjesëmarrjen e grave rome të paktën deri në 40%, siç përcaktohet në Ligjin për Barazinë Gjinore.⁷⁰

Gratë aktiviste rome në shoqërinë civile gjithashtu përballen me sfida të veçanta, për shkak të kundërshtimit të normave tradicionale si gra pjesëtare të një grupi etnik tashmë të stigmatizuar..⁷¹ Stereotipet në lidhje me gratë rome dekurajojnë më tej pjesëmarrjen e tyre si dhe elektoratin. Gratë rome janë të marginalizuara jo vetëm brenda shoqërive kombëtare, por edhe shpesh brenda komuniteteve rome. Si e tillë, për shkak të sfidave të tjera ekzistenciale, me të cilat përballen gratë rome në Ballkanin Perëndimor, mungesa e qasjes në pjesëmarrjen politike mbetet e jotrajtuar mjaftueshëm si çështje. Zgjidhja e këtij problemi kërkon artikulimin e tij të qartë në lidhje me diskriminimin ndër-sektorial, si dhe ndërhyrje që do të iniconin ndryshime dhe procese të pjesëmarrjes së barabartë të grave rome në politikë, si nga aspekti legjislativ ashtu edhe i vetëdijësisimit shoqëror.

⁷⁰ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

⁷¹ Banka Botërore, Closing the Gender Gaps among Marginalized Roma in the Western Balkan - A Summary of Findings and Policy Recommendations (Mbyllja e Hendeut Gjini në mesin e Romëve të Margjinalizuar në Ballkanin Perëndimor - Një Përmbledhje e Gjetjeve dhe Rekomandimeve të Politikave, Banka Botërore, 2019, <http://documents1.worldbank.org/curated/en/994401560763568796/text/Closing-the-Gender-Gaps-among-Marginalized-Roma-in-the-Western-Balkans.txt>, (e qasur më 4 gusht 2020).

% E GRAVE NË POZITA VENDIMARRËSE NË PROCESET E ANËTARËSIMIT NË BE

Barazia midis grave dhe burrave është një vlerë themelore e Bashkimit Evropian (BE), që daton që nga Traktati i Romës i vitit 1957. Barazia gjinore ka qenë një përbërës i integritimit në BE që nga fillimi, dhe për këtë arsye është një pjesë integrale e kushteve të pranimit të cilat duhen të përmbushen nga vendet candidate dhe candidate potenciale të Ballkanit Perëndimor.⁷² Në 2002, BE prezantoi një Program të Veprimit për Barazinë Gjinore që synonte rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë në vendet aderuese.⁷³ Komisioni Evropian monitoron përparimin e vendeve të anëtarësimit dhe boton Raporte Vjetore të Vendeve. Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia Veriore dhe Serbia janë vendet candidate të cilat kanë filluar negociatat e anëtarësimit,⁷⁴ ndërsa BeH dhe Kosova janë vende candidate potenciale.⁷⁵

Vendeve potenciale dhe candidate u kërkohet të harmonizojnë legjislacionin e tyre në përputhje me acquis të BE-së për barazinë gjinore dhe të përfshijnë perspektivën gjinore. Përveç angazhimeve për barazinë gjinore, procesi i anëtarësimit në BE në Ballkanin Perëndimor duhet të pasqyrojë një kuptim dhe zbatim të vërtetë të integritimit gjinor, që do të thotë: miratimin ose

ndryshimin e legjislacionit përkatës, përpunimin e strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit, dhe krijimin e mekanizmave institucionalë për të zbatuar dhe monitoruar politikat përkatëse, të gjitha brenda një kornize të sensibilizuar gjinore. Në këtë botim të pestë të të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor, Kvinna till Kvinna ka vendosur të vëzhgojë një element të integritimit gjinor në kuadër të gjithë procesit të BE-së. Ky indikator kërkon të analizohet në çfarë mase gratë në Ballkanin Perëndimor janë të përfshira në vendimarrje në negociatat brenda proceseve të anëtarësimit në BE. Për më tepër, ky indikator ofron një analizë sasiore dhe cilësore të pjesëmarrjes politike të grave në organe ose institucione që janë të mandatuara për të zbatuar procesin e anëtarësimit në BE në secilin vend.

Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë në faza të ndryshme të negociatave dhe organet përkatëse të negociatave nuk janë të efektshme në të gjashtë shtetet. Meqenëse ekzistojnë institucione të ndryshme në secilin vend, dhe pasi që të gjitha janë strukturuar ndryshe, vërejtjet hyrëse mbi strukturën e përgjithshme janë si më poshtë:

⁷² V. Lilyanova, *Women in the Western Balkans - Gender Equality in the EU Accession Proces (Gratë në Ballkanin Perëndimor – Barazia Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE)*, Seksioni i Hulumtimit në Parlamentin Evropian, 2018, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/625139/EPRS_BRI\(2018\)625139_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/625139/EPRS_BRI(2018)625139_EN.pdf), (e qasur më 10 qershor 2020), fq. 1.

⁷³ Komisioni i Komuniteteve Evropiane, *Report from the Commission to the Council, the European Parliament, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions - Annual Report on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union (Raport nga Komisioni tek Këshilli, Parlamenti Evropian, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve - Raporti Vjetor mbi Mundësitë e Barabarta për Gratë dhe Burrat në Bashkimin Evropian)* 2002, Bruksel, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, 2003, [https://www.europarl.europa.eu/meetdocs/committees/empl/20030909/COM\(03\)0098_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/meetdocs/committees/empl/20030909/COM(03)0098_EN.pdf), (e qasur më 11 qershor 2020).

⁷⁴ Një vend konsiderohet të jetë një vend kandidat kur pasi ka shqyrtuar aplikimin e tij për anëtarësim në BE, Këshilli i BE-së njeh zyrtarisht vendin si kandidat, duke i dhënë kështu statusin e vendit kandidat.

⁷⁵ Vendet/njësitë të cilat kanë një perspektivë të qartë për t'u bashkuar me BE-në në të ardhmen por ende nuk u është dhënë statusi i vendit kandidatë.

- **Ministri i Jashtëm:** përfaqëson interesat e shtetit përmes bashkëpunimit të jashtëm, përfshirë pjesërisht edhe procesin e integrimit në BE
- **Ministri i Ministrisë përgjegjëse për Integrim në BE:** një organ zyrtar qeveritar i përfshirë drejtpërdrejt në negociatat në lidhje me pranimin në BE. Në shtetet e Ballkanit Perëndimor, këto Ministri kanë forma të ndryshme organizative:
 - Ministria e Integrimit Evropian: Shqipëria, Serbia.
 - Drejtoria për Integrim Evropian në BeH (e cila mori rolin e ish-Ministrisë së Integrimit Evropian).
 - Sekretariati për Çështje Evropiane: Maqedonia Veriore
 - Agjencia për Integrim Evropian: Kosovë (që punon brenda zyrës së Kryeministrit)
 - Zyra e Integrimit Evropian në Mal të Zi
- **Koordinatori i Instrumentit Kombëtar të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA):** një mekanizëm financimi i BE-së. Vendet potenciale dhe candidate janë vendet përfituese të këtyre fondeve. Çdo vend i Ballkanit Perëndimor ka Koordinatorin Kombëtar të IPA-s.
- **Kryenegociatori:** përfaqësuesi zyrtar i vendit gjatë negociatave të anëtarësimit të vendit në BE.

Në përgjithësi, këto pozita të renditura janë kryesisht të zëna nga burrat. Burrat gjithashtu përbëjnë shumicën në kuadër të strukturave negociuese, si dhe të deputetëve, sekretarëve të përgjithshëm dhe komisionëve brenda parlamenteve nacionale (në vendet ku të dhënat ishin të disponueshme). Në secilin vend, literatura dhe të dhënat e disponueshme tregojnë se ka shumë përmirësime të nevojshme dhe se duhet të bëhet shumë nga

institucionet përkatëse për të siguruar që gratë të përfshihen në negociatat për anëtarësim në të dy nivelet kombëtare dhe të BE-së. Përbërja e ekipeve negociuese është e ndryshme ndërmjet vendeve, gjë që krijon një sfidë për paraqitjen e një analize krahasuese rajonale. Për të adresuar këtë kufizim në analizë, ky indikator do të krahasojë institucionet e ngjashme dhe pozitat vendimmarrëse në secilin vend me sa është e mundur, duke analizuar numrin e grave të përfshira në këto institucione dhe pozita.

Raportet e BE-së për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu pasqyrojnë statusin e barazisë gjinore. Dallimet në këto Raporte të Shteteve janë të dukshme: çështjet e ndërlidhura me gjininë janë mbuluar disi sistematikisht (të tilla si në Kosovë dhe Mal të Zi), ku përmirësimi është i dukshëm (Shqipëri), ose ku ka mungesë të analizës koherente të të dhënave ose përfaqësimit (BeH, Maqedoni Veriore, Serbi). Gjinia është një çështje ndërthurëse dhe nuk kufizohet vetëm në proceset e integrimit në BE, pasi barazia midis grave dhe burrave është një parim themelor i BE-së. Fatkeqësisht, mungesa e një analize gjinore gjithëpërfshirëse dhe sistematike që informon Raportet e Shteteve, e kombinuar me nën-përfaqësimin e grave në vendet me ndikim dhe proceset e negociatave për integrim, krijon një kontekst ku proceset e mirëfillta të barazisë gjinore rrezikojnë të bëhen ushtrime 'duke shënjuar kutinë'. Për të adresuar këtë çështje dhe për të siguruar që gratë janë të përfshira në të gjitha aspektet e integrimit në BE, OShC-të e grave në rajon investojnë përpjekje dhe energji për të siguruar që gratë janë pjesëmarrëse dhe zërat e tyre dëgjohen në integrimin në BE.

SHQIPËRIA

Në Shqipëri, të gjitha pozitat e lartpërmendura për negociatat e integritit në BE (Ministri i Jashtëm, Ministri i Integritit në BE, Koordinator Kombëtar i IPA-s dhe Kryenegociatori) mbahen nga burrat. Gratë përbëjnë 30% të Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian (5 nga 16 përfaqësues), ndërsa burrat mbajnë 70% të pozitave.⁷⁶

Sipas analizës nga Kvinna till Kvinna, Raporti i Komisionit Evropian 2019 për Shqipërinë përfshin referenca për situatën e grave dhe përfshin disa të dhëna të ndara sipas gjinisë në seksionet për demokracinë, të drejtat themelore, politikën sociale dhe punësimin. Seksioni për barazinë midis grave dhe burrave është përmirësuar ndjeshëm krahasuar

me vitin 2018.⁷⁷ Këto përmirësime në Raportin e Vendit janë të mirëseardhura, pasi ato ofrojnë mundësi më të mira për monitorimin e zbatimit të proceseve të integritit të perspektivës gjinore.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) janë mjaft të përfshirë në avokimin për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut të grave në kontekstin e anëtarësimit në BE. Nismat e AWEN në këtë drejtim përfshijnë: monitorimin e veprimeve në instrumentet e rëndësishme të anëtarësimit në BE; fushatat kombëtare të ndërgjegjësimit; aktivitetet avokuese dhe punëtoritë me OSHC-të lokale mbi gjininë dhe legjislacionin e BE-së; dhe zhvillimin e kapaciteteve për anëtarët e rrjetit të tyre.⁷⁸



“Një shoqëri që është pa zërin dhe vizionin e grave nuk është më pak femërore. Është më pak njerëzore”.

Mary Robinson, Komisionerja e Lartë për të Drejtat e Njeriut në Kombet e Bashkuara⁷⁹

⁷⁶ INSTAT, *Women and Men in Albania 2018, (Gratë dhe Burrat në Shqipëri)* Tirana, INSTAT, 2018, , <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20albania/attachments/publications/2018/06/women%20and%20men%20in%20albania%202018.pdf?la=en&vs=3558>, (e qasur më 21 qershor 2020), fq. 102.

⁷⁷ G. Pasquinelli, *Two Steps Forward, One Step Back - Gender Analysis of 2019 EC Country Reports for the Western Balkans (Dy Hapa Para, Një Hap Mbrapa – Analiza Gjinore 2019 e Raporteve të Vendit për Ballkanin Perëndimor e BE-së)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, <https://kvinna.tillkvinna.org/2019/10/30/two-steps-forward-one-step-back-2019/>, (e qasur më 11 June 2020), p. 9.

⁷⁸ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna.

⁷⁹ B. Barlovac, 'Albanian and Serbian Gender Activists Join Efforts for Gender Equality Under the Patronage of UN WOMEN' (Përpjekjet e Përbashkëta të Aktivisteve Gjinore Shqiptare dhe Serbe për Barazi Gjinore nën patronatin e UN WOMEN), *Kombet e Bashkuara Serbi*, 2016, <https://serbia.un.org/en/13494-albanian-and-serbian-gender-activists-join-efforts-gender-equality-under-patronage-un-women>, (e qasur më 21 qershor 2020).

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Në BeH, nuk ka gra në pozita drejtuese dhe të rangut të lartë në institucionet që lidhen me integrimin në BE. Gratë janë të nënpërfaqësuar në pothuajse të gjitha organet që përbëjnë Mekanizmin Kombëtar të Koordinimit.⁸⁰ Gratë përbëjnë 10% ndërsa burrat 90%, të Kolegjiumit të Integritimit në BE, organi më i lartë i Mekanizmit të Koordinimit, përgjegjës për vendimet më të rëndësishme politike në procesin e integritimit.⁸¹ Për më tepër, gratë përbëjnë 14% të Konferencave Ministrore (burrat 86%). Përqindjet e ulëta të përfaqësimit të grave tregojnë përjashtimin e grave nga dialogët e politikave dhe kontribuojnë në diskriminimin e mëtejshëm të grave.⁸² Procesi i anëtarësimit në BE është një vazhdim i praktikës së grave që nënvlerësohen vazhdimisht në të gjitha nivelet e organeve qeveritare të BeH.⁸³ Në 2019, Komisioni Evropian nuk publikoi një Raport të Vendit për BeH, por më tepër një Opinion mbi aplikimin e BeH për anëtarësim në BE. Opinioni ishte veçanërisht i dobët për sa i përket barazisë gjinore.⁸⁴ Gjinia si bazë për diskriminim është nën hije për shkak të përkatësisë etnike dhe rrjedhimisht gratë janë pothuajse krejtësisht të padukshme dhe mungojnë në Opinion.⁸⁵

OSHC-të në BeH, përkatësisht Asambleja e Qytetarëve të Helsinkit dhe Të Drejtave për Të Gjithë, formuan përkatësisht një Grup të Lobit të Grave dhe një Grup Avokimi për Gratë. Grupi i Lobit të Grave, i përbërë nga feministe, politikanë dhe ekspertë të shquar nga BeH dhe rajoni është kryesisht përgjegjës për ngritjen e çështjeve kryesore të të drejtave të grave në lidhje me proceset e anëtarësimit në BE, në nivel të BE-së dhe ndërkombëtar. Grupi i Avokimit për Gratë është i përbërë nga OSHC-të e grave nga BeH, duke mbrojtur bashkërisht rritjen e dukshmërisë së të drejtave të njeriut të grave në një

nivel kombëtar dhe në të përfaqësuesve të Delegacionit të BE-së. Qëllimet e këtyre grupeve janë përfshirja e zërave të grave dhe grave në të gjithë procesin e integritimit të BeH në BE dhe të sigurojnë një perspektivë të grave për të gjitha çështjet në nivele të ndryshme të qeverive kombëtare dhe ndërkombëtare. Të Drejtat për Të Gjithë gjithashtu monitorojnë formimin dhe përbërjen e Komisioneve Parlamentare për Integrim në BE në të gjitha nivelet, duke vendosur bashkëpunim me anëtarët e Komitetit për Integrim Evropian të Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Federatës së BeH.⁸⁶ Bashkëpunimi midis OSHC-ve, duke përfshirë OSHC-të e grave, dhe komisioneve përgjegjëse për procesin e negociatave është një komponentë e rëndësishme e anëtarësimit në BE, pasi krijon një urë midis institucioneve dhe shoqërisë civile, duke ofruar një platformë mbi të cilën mund të artikulohe çështjet e OSHC-ve.

Gjatë periudhës së raportimit, një Bord Këshillimor i Grave u krijua si pjesë e iniciativës së mbështetur nga BE "Përfshini gratë në proceset e ndryshimit"⁸⁷ që synon të avokojë dhe këshillojë për çështje që lidhen me barazinë gjinore në politikë dhe të gjithë sferën e jetës publike, si pjesë e integritimit në BE.⁸⁸ Bordi Këshillimor i Grave përbëhet nga 10 anëtarë të cilët janë në dispozicion për konsultime në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në BeH dhe Përfaqësuesin Special të BE-së dhe kjo buroi nga zbatimi i Dokumentit të Përbashkët të Punës së Shtabit - Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Vajzat dhe Gratë në prizmën e Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020 (i njohur edhe si Plani i BE-së për Veprim Gjinor II) (GAP II).⁸⁹

⁸⁰ Mekanizmi Koordinues definon systemin operativ dhe institucional dhe metodat e arritjes së koordinimit të institucioneve të BeH mbi implementimin e aktiviteteve lidhur me procesin e anëtarësimit në BE.

⁸¹ Prava Za Sve, *How to Ensure Gender Equality through the Process of EU Integration? (Si të Sigurohet Barazia Gjinore përmes Procesit të Integritimit Evropian)*, Prava Za Sve, 2018, http://rightsforall.ba/wp-content/uploads/2018/11/Engleska-verzija-How-to-ensure-gender-equality-through-the-process-of-EU-integration_finalna-verzija.pdf, (e qasur më 15 qershor 2020), fq. 4.

⁸² Po aty.

⁸³ A. Hanušić Bećirović, et al. *Shadow Report for the 3rd Universal Periodic Review on the state of human rights in Bosnia and Herzegovina (Raporti në Hijë për Rishikimin e 3-të Periodik Universal mbi Gjendjen e të Drejtave të Njeriut)*, Sarajevo Open Centre, 2019, <https://soc.ba/site/wp-content/uploads/2019/08/UPR-ENG-final.pdf>, (e qasur më 15 qershor 2020), fq. 13.

⁸⁴ G. Pasquinelli, *Two Steps Forward, One Step Back - Gender Analysis of 2019 EC Country Reports for the Western Balkans (Dy Hapa Para, Një Hap Mbrapa - Analiza Gjinore 2019 e Raporteve të Vendit për Ballkanin Perëndimor nga BE)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, fq. 11.

⁸⁵ Po aty.

⁸⁶ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

⁸⁷ "Përfshirja e Grave në Proceset e Ndryshimit" është e iniciativës së përbashkët të Përfaqësuesve Specialë të BE-së, SIDA dhe Kvinna till Kvinna, e lansuar në dhjetor 2017.

⁸⁸ Delegacioni i Bashkimit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë, 'Women's Advisory Board holds its first session in Sarajevo' (Bordi Këshilldhënës i Grave mban sesionin e saj të parë në Sarajevë), *Delegacioni i Bashkimit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë*, 2019, <https://europa.ba/?p=63835>, (e qasur më 20 qershor 2020).

⁸⁹ Plani i Veprimtimit Gjinor të BE-së II 'Gender Equality and Women's Empowerment: Transforming the Lives of Girls and Women through EU External Relations 2016-2020' (Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i Jetëve të Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020).

KOSOVA

Sipas informatave të disponueshme për këtë periudhë raportuese, të gjitha pozitat udhëheqëse brenda Ministrisë mbahen nga burrat: ministri, zv. ministër, dhe Sekretari i Përgjithshëm. Kordinatori Kombëtar për IPA është burrë, siç janë Kryenegociatori dhe Ministri i Punëve të Jashtme.⁹⁰ Edhe ekipi negociator në nivel shteti janë të gjithë burra.

Raportet e Vendit për Kosovën nga BE vazhdojnë me trendin pozitiv të integritetit të perspektivës gjinore në kuadër të kriterëve të ndryshme dhe kapitujve ku ofrohet një pasqyrë e thuktë e roleve të grave dhe sfidat me të cilat ato përballen në vazhdimësi, duke shkuar përtej analizës së barrierave që pengojnë arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.⁹¹ Si të tilla, disavantazhet e Kosovës të vëzhguara nga ana e BE-së janë të dukshme: ka mangësi në rolet e makinerisë gjinore në politikbërje; implementimi efektiv i Ligjit për Barazinë Gjinore ka mbetur mbrapa; legjislacioni sekondar që ka për qëllim institucionalizimin e buxhetimit të integruar gjinor ende është duke ngecur; si dhe integrimi i perspektivës gjinore në legjislacion dhe politika nuk është sistematik.⁹²

Perspektiva gjinore nuk është integruar mjaftueshëm në shumicën e ligjeve, politikave, programeve qeveritare dhe të procesit të anëtarësimit në BE të Kosovës. Organizatat e shoqërisë civile të grave raportojnë që konteksti politik e bën shumë të vështirë arritjen e rezultateve në kontekst të anëtarësimit në BE, me rrëzimin e qeverisë së Kosovës dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme. Një numër i projektligjeve dhe politikave për të cilat ka avokuar Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) kanë ngecje, duke pritur aprovimin e Qeverisë dhe/ose Parlamentit. Disa nga fushat kyçe të RrGK për avokim nuk kanë ecur përpara gjatë kësaj periudhe raportuese për shkak të kësaj ngecjeje. RrGK dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) monitorojnë në mënyrë aktive dhe kontribuojnë në procesin e integritetit në BE nga

perspektiva e grave. Këto organizata janë duke parashtruar bashkarisht inpute nga perspektiva gjinore për Raportin e Vendit për Kosovën, duke bashkëpunuar me organizata të ndryshme dhe think tanks, duke monitoruar pjesëmarrjen e grave në dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit, duke marrë pjesë në disa grupe punuese, si dhe duke marrë pjesë aktivisht në përpjekje të përbashkëta avokimi me OSHC-të e grave.⁹³

Ngecja politike ka ndikuar gjithashtu në përparimin në lidhje me anëtarësimin në BE dhe dialogun thelbësor me Serbinë, i cili ka qenë i pezulluar.⁹⁴ Akoma, në procesin e anëtarësimit në BE, shoqëria civile në përgjithësi dhe OSHC-të e grave në veçanti, luajnë një rol aktiv në promovimin e agjendës së barazisë gjinore.⁹⁵ Kjo është arsyeja pse është thelbësore që të ruhet bashkëpunimi i tyre me institucionet përkatëse, për të siguruar që këto procese të jenë të vazhdueshme dhe kuptimplota.

Në vitin 2019 Zyra e BE-së/Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë filloi një seri diskutimesh, nën titullin *Bisedat Gjinore të BE-së: Sepse Ne Bëjmë Një Ndryshim*.⁹⁶ I gjithë stafi i BE-së në Kosovë raportohet se ishte trajnuar për barazinë gjinore dhe udhëzimet e brendshme dhe udhëzuesit praktikë për programet e integritetit të perspektivës gjinore, monitorimin, zbatimin dhe mbledhjen e të dhënave. Zyra e BE-së në Kosovë kontrakttoi RrGK-në për të mbështetur BE-në për të zhvilluar një Plan të Veprimit Gjinor 2019-2020 të përshtatur për Zyrën e BE-së në Kosovë, dhe për të mbështetur zbatimin e EU GAP II në Kosovë.⁹⁷ Është e rëndësishme që OSHC-të e grave të përfshihen dhe të konsultohen për proceset politike dhe politikbërëse. Është gjithashtu e rëndësishme që institucionet të zbatojnë trajnimet e tyre për sensibilizim gjinor në punën dhe strukturat e tyre të përditshme, në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe rekomandimet e përshkruara në planet e shumta të veprimit dhe raportet e grave të OSHC-ve.

⁹⁰ Në përfundim të këtij raporti, Kosova ka formuar qeverinë e re ku Ministre e Punëve të Jashtme është një grua (Meliza Haradinaj).

⁹¹ G. Pasquinelli, *Two Steps Forward, One Step Back - Gender Analysis of 2019 EC Country Reports for the Western Balkans (Dy Hapa Para, Një Hap Mbrapa - Analiza Gjinore 2019 e Raportëve të BE-së për Shtetet e Ballkanit Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, fq. 13.

⁹² Komisioni Evropian, *Kosovo* 2019 Report (Raporti i Kosovës* 2019)*, Bruksel, Komisioni Evropian, 2019,

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>, (e qasur më 21 qershor 2020), fq. 28.

⁹³ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Kosovë.

⁹⁴ Po aty.

⁹⁵ Ibid.

⁹⁶ A. Selmani, *Talking Women - One Year of EU Support to Gender Equality and Women Empowerment in Kosovo*, (Kur Flasin Gratë - Një Vit i Mbështetjes së BE-së për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Kosovë) Europe House, 2020, https://europehouse-kosovo.com/wp-content/uploads/2020/03/EU-Talking-Women_publication_ENG-2-1.pdf, (e qasur më 21 qershor 2020), fq. 7.

⁹⁷ Po aty, fq. 54.

MALI I ZI

Mali i Zi ka numrin më të lartë të grave në pozitat me fuqi vendimmarrëse në negociatat dhe proceset dhe institucionet përkatëse të anëtarësimit krahasuar me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Pak gra mbajnë pozita të niveleve të larta vendimmarrëse në proceset e anëtarësimit në BE në Mal të Zi ndërsa për sa i përket pozitave të shqyrtuara në këtë raport, ekziston vetëm një, Koordinatori Nacional i IPA-s. Ministri i Çështjeve Evropiane, Kryenegociatori dhe Drejtori i Zyrës së Integritimit Evropian janë të gjithë burra. Sipas literaturës nga viti 2019, struktura negociuese përbëhet nga një aparat administrativ mjaft i madh dhe i burokratizuar, me 909 anëtarë të grupeve të ndryshme të punës nga të gjithë sektorët (përfshirë qeverinë, Asamblenë, shoqërinë civile, komunitetin akademik, komunitetin e biznesit, sindikatat). Një analizë gjinore e grupeve të punës tregon se 524 nga këta anëtarë janë gra (58%), dhe 385 janë burra (42%), dhe nga 15 anëtarët e Grupit Negociator, gjashtë janë gra, nëntë janë burra. Të dy negociatorët kryesorë të mëparshëm ishin burra.⁹⁸

Raporti i BE-së 2019 për Malin e Zi vazhdoi trendin pozitiv të integritimit të një perspektive gjinore në seksione të ndryshme.⁹⁹ Sidoqoftë, integrimi i perspektivës gjinore dhe analiza gjinore në procesin e hartimit të politikave, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, nuk janë zbatuar ende.¹⁰⁰

OSHC-të e grave raportojnë se ligjet dhe politikat e miratuara që janë në përputhje me direktivat e BE-së nuk kanë pasur pothuajse asnjë ndikim pozitiv në jetën e përditshme të grave. Shtetit i mungojnë burimet financiare të nevojshme për t'i zbatuar ato në mënyrë efektive. Qendra për të Drejtat e Grave në Mal të Zi është një nga OSHC-të më aktive të grave në procesin e anëtarësimit në BE dhe organizata ka vazhduar të përforcojë dialogun midis shoqërisë civile dhe Delegacionit të BE-së, Parlamentit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit Evropian për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit, Shërbimin e Marrëdhënieve me Jashtë (EEAS), si dhe me akterë të tjerë kryesorë, siç janë ambasadat e huaja dhe vendimmarrësit kombëtarë. Ky bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe institucioneve të BE-së gjithashtu u përkthye në një grup rekomandimesh që u hartuan dhe miratuan nga Grupi Punues për Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe u shpërndanë në të gjitha institucionet përkatëse në lidhje me mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave dhe standardet ndërkombëtare kundër diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore.¹⁰¹

⁹⁸ Po aty., fq. 6.

⁹⁹ G. Pasquinelli, *Two Steps Forward, One Step Back - Gender Analysis of 2019 EC Country Reports for the Western Balkans (Dy Hapa Para, Një Hap Mbrapa - Analiza Gjinore 2019 e Raporteve të BE-së për Shtetet e Ballkanit Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, fq. 15.

¹⁰⁰ Komisioni Evropian, *Montenegro 2019 Report (Raporti i Malit të Zi 2019)*, Bruksel, Komisioni Evropian, 2019, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-montenegro-report.pdf>, (e qasur më 12 qershor 2020), fq. 12.

¹⁰¹ Po aty.

MAQEDONIA VERIORE

Burrat mbajnë shumicën e pozitave të vëzhguara të nivelit të lartë në proceset e anëtarësimit në BE në Maqedoninë Veriore: Kryenegociatori, Kordinatori Kombëtar për IPA, dhe Zv. Kryeministri për Çështje të Integritimit Evropian në kuadër të Sekretariatit për Çështje Evropiane (SEA). Pozita e Kordinatorit për IPA dhe pozita e Zv. Kryesministrit mbahen nga i njëjti burrë. Në qeverinë e kaluar, kjo vlente për trija pozitave. Sekretari i Shtetit i SEA është grua, dhe Këshilltarët e Shtetit në SEA janë të përfaqësuar barabartë nga gratë dhe burrat. Komisioni për Çështje Evropiane poashtu ka përfaqësim të barabartë të anëtarëve gra dhe burra (7 gra dhe 7 burra).¹⁰² Proceset e Integritimit Evropian ju mundësojnë deputete gra të parashtrojnë argumente shumë më të fuqishme për ligje të caktuara me ndikim në të drejtat e grave.¹⁰³ Përfshirja e shtuar e deputete gra në Maqedoninë Veriore është një përfitim i mirëseardhur i proceseve të anëtarësimit në BE, por ende ka shumë për të bërë për t'u arritur përfaqësimi i barabartë i grave apo OSHC-ve të grave në të gjitha dialogjet për negociim. Raporti i BE-së për Maqedoninë Veriore 2019 përfshin analizë koherente të barrierave kryesore për arritjen e barazisë gjinore siç janë normat shoqërore, diskriminimi në vendin e punës apo ndikimi i dhunës në baza gjinore (DHBGJ).¹⁰⁴

Në vitin 2019, Reaktori i OshC-ve – Hulumtimi në Veprim (Reactor) ishin aktiv në një numër iniciativash për avokim me synim të rritjes së pjesëmarrjes së grave si dhe visibilitetit të të drejtave të njeriut të grave në dokumentet e anëtarësimit në BE. Puna e Reactor përgjatë periudhës raportuese (e bazuar në vite të tëra pune) ka shpjerë në përmirsimet të

dukshme sa i përket integritetit të perspektivës gjinore në proceset e konsultimit, dhe në raportim të përmirësuar në aspektin gjinor nga ana e Delegacionit të BE-së në kontributin e tyre për Raportet e Vendit. Reaktori i OSHC-ve, HERA – Shoqata për Shëndet Edukim dhe Hulumtim (HERA) dhe Rrjeti Kombëtar për Ndalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në familje – Zëri kundër Dhunës (Rrjeti Kombëtar), të gjitha kontribuan në këto procese me punën e tyre dhe përfshirjen e drejtpërdrejt me institucione, përmes rrjetëzimit dhe ndërtimit të koalicionëve me OSHC-të e grave, duke punuar në barazi gjinore, dhe përmes iniciativave të përbashkëta të avokimit me OSHC-të tjera të angazhuara me Delegacionin e BE-së, ambasadat e shteteve anëtare të BE-së, agjencitë e Kombeve të Bashkuara (KB), mediat, partitë politike dhe opinionin e gjerë.¹⁰⁵ HERA ka prezantuar një raport në hije për Komisionin Evropian lidhur me pabarazitë gjinore në Maqedoninë Veriore. Rrjeti Kombëtar ka punuar sipas strategjisë vetanake për avokim në BE, përfshirë këtu takimet, kontribut me informata për legjislacion, debatet publike, analizat dhe studimet, me synimin e përgjithshëm për implementimin e Konventës së Stambollit në Maqedoninë Veriore si dhe parandalimin e dhunës kundër grave duke mbrojtur njëkohësisht gratë viktimat/të mbijetuarat.¹⁰⁶

Megjithëse qeveria ka deklaruar zyrtarisht se barazia gjinore është një prioritet, burimet financiare rrallë ndahen për Planet Strategjike Kombëtare ose dokumentet e Planit të Veprimit për avancimin e barazisë gjinore, duke treguar që nuk janë marrë hapat e nevojshëm për ta bërë prioritet barazinë gjinore.

¹⁰² Dokmanovikj, M. et al., Women's Political Participation in North Macedonia (Pjesëmarrja Politike e Grave në Maqedoninë Veriore), Punime Hulmuese Studimore dhe Shkencore, Westminster Foundation for Democracy, 2019, <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/Women-Political-Participation-2019-EN-for-web-.pdf>, (e qasur më 15 qershor 2020), fq. 125.

¹⁰³ „When such laws are linked to the European agenda and are part of a reform package for harmonising with EU legislation, then women MPs can have a much stronger impact” (“Kur ligje të tilla kanë të bëjnë me Agjendën Evropiane dhe janë pjesë e paketës së reformave për harmonizimin me legjislacionin e BE-së, atëherë gratë deputete mund të kenë një ndikim edhe më të fuqishëm”). - Dokmanovikj, M. et al., Women's Political Participation in North Macedonia (Pjesëmarrja Politike e Grave në Maqedoninë Veriore), Punime Hulmuese Studimore dhe Shkencore, Westminster Foundation for Democracy, 2019, fq. 15.

¹⁰⁴ G. Pasquinelli, *Two Steps Forward, One Step Back - Gender Analysis of 2019 EC Country Reports for the Western Balkans (Dy Hapa Para, Një Hap Mbrapa - Analiza Gjinore 2019 e Raporteve të BE-së për Shtetet e Ballkanit Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, fq. 17.

¹⁰⁵ Informata e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Maqedoninë Veriore.

¹⁰⁶ Po aty.

SERBIA

Përvec pozitës së lirë¹⁰⁷ të Kryenegociatorit, Ministri i Punëve të Jashtme është një burrë dhe dy pozita tjera të vëzhguara (Kordinatori Nacional për IPA dhe Ministri i Integritimit Evropian) mbahen nga gratë. Përkundër kësaj, *Vërejtjet Përfundimtare lidhur me Raportin e Katërt Periodik të Serbisë* nga CEDAW ritheksojnë se gratë janë të nënpërfaqësuar në shkallë të lartë në pozitë vendimmarrëse në të gjitha sektoret, përfshirë proceset e anëtarësimit në BE.¹⁰⁸

Raporti i BE-së për Serbinë i vitit 2019 ofron një pasqyrë të zhvillimeve aktuale legislative dhe institucionale për sa i përket barazisë gjinore, por ka mungesë të seksioneve dhe të dhënave të rëndësishme mbi komunitetin LGBTQI+, një analize ndërthurëse lidhur me komunitetet e marginalizuara, një analize të formave të ndryshme të dhunës në familje, dhe qasjes me sensibilizim gjinor në raport me luftërat e viteve nëntëdhjetë si dhe përpjekjeve për ndërtimin e paqes dhe pajtimit.¹⁰⁹

Qendra Rome për Gra dhe Fëmijë Daje ka dorëzuar inputin e saj për Kornizën Rome të BE-së Post-2020 duke qenë aktive në avokimin për përfshirjen politike dhe shoqërore të grave rome në proceset kombëtare

dhe të integritimit evropian. Qendra Autonome e Grave dhe ASTRA – Veprimi Anti Trafikim, në partneritet me pesë OSHC tjera nga “Koalicioni prEugovor”, ka monitoruar reformat në lidhje me Kapitullin 23 (Të Drejtat Gjyqësore dhe Themelore) dhe Kapitullin 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) të Kriteve të Kopenhagës. Në vitin 2019, prEugovor ka hartuar 11 rekomandime të përgatitura për Raportin e Alarmit,¹¹⁰ nga të cilat vetëm tre prej tyre ishin marrë parasysh në revidimin e parë të Planit të Veprimit për Kapitullin 23. Raporti i Alarmit 2020 nga prEugovor ka vënë në dukje se nga tetori 2019 deri në prill 2020 nuk është bërë asnjë përmirsim në fushën e politikave anti-diskriminim, ndërsa niveli i barazisë gjinore dhe statusi i grave, veçanërisht në sferën seksuale dhe riprodiktive, është përkeqësuar për shkak të rrëshqitjes në politika tradicionale dhe ortodokse shtetërore.¹¹¹ Raporti i Alarmit ofron mundësi për organizatat e grave për të adresuar boshllëqet dhe për të kërkuar nga shteti llogaridhënie për ngecjet në kornizën e procesit të anëtarësimit në BE, duke ritheksuar rëndësinë e këtij procesi dhe përfshirjen e shoqërisë civile ku procesi shërben si instrument monitorues dhe vëzhgues.

¹⁰⁷ Pozita ishte e zbrazët deri në fund të periudhës së mbledhjes së të dhënave për këtë edicion të raportit, 1 qershor 2020.

¹⁰⁸ CEDAW, *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Serbia* (Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë), CEDAW, 2019, fq. 8.

¹⁰⁹ G. Pasquinelli, *Two Steps Forward, One Step Back - Gender Analysis of 2019 EC Country Reports for the Western Balkans* (Dy Hapa Para, Një Hap Mbrapa – Analiza Gjinore 2019 e Raportëve të BE-së për Shtetet e Ballkanit Perëndimor), Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, fq. 19.

¹¹⁰ Raport i pavarur gjysmëvjetor mbi progresin e Serbisë në lidhje me zbatimin e politikave në fushat e mbuluara nga kapitujt 23 dhe 24 të kriteve të Kopenhagës për negociatat e anëtarësimit në BE. Raportet e Alarmit monitorojnë shkallën në të cilën autoritetet përgjegjëse përbushin detyrimet e tyre të parashikuara nga Planet e Veprimit për të dy kapitujt, si dhe iniciativat e tjera plotësuese të rëndësishme për Sundimin e Ligjit.

¹¹¹ J. Pejić Nikić, (ed), *prEugovor Alarm: Report on Progress of Serbia in Chapters 23 and 24* (Raport mbi Progresin e Serbisë në Kapitujt 23 and 24) Beograd, Belgrade Centre for Security Policy, 2020, <http://preugovor.org/Alarm-Reports/1596/Coalition-prEugovor-Report-on-Progress-of-Serbia.shtml>, (e qasur më 21 qershor 2020), fq. 11.

TË DHËNAT STATISTIKORE TREGOJNË:

Struktura gjinore e institucioneve të integritit në BE sipas vendit:

Pozita	Shqipëria	Bosnjë dhe Hercegovinë	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia Veriore	Serbia
Ministri i Jashtëm	burrë	grua	grua ¹¹²	burrë	burrë	burrë
Kryenegociatori	burrë	-	-	burrë	burrë	upražnjeno (ishte grua)
Koordinatori Nacional për IPA	burrë	burrë	grua	grua	burrë	grua
Ministri i Ministrisë përgjegjëse për Integritim në BE	burrë	burrë (Drejtore)	grua	burrë	burrë	grua



"Edhe pse kemi një kryeministre të parë grua, anëtare të komunitetit LGBT dhe 34% të grave në Parlament, pozicioni i të gjitha grave të tjera në Serbi nuk ka qenë kurrë më i keq"

Vanja Macanović në Deklaratën e Koalicionit të OJQ-ve – Re të Zeza mbi Serbi në seancën e 72-të të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave ¹¹³



"Ne jemi duke miratuar ligje që janë në interes të përmirësimit të të drejtave të grave, të cilat ndoshta nuk do të ishin një prioritet nëse proceset e integritit evropian nuk do të ishin aktuale."

Maja Morachanin, deputete në Parlamentit e Maqedonisë Veriore ¹¹⁴

¹¹² Në përfundim të këtij raporti, Kosova ka formuar qeverinë e re ku Ministre e Punëve të Jashtme është një grua (Meliza Haradinaj).

¹¹³ V. Macanović et al., 'Statement of Coalition of Women NGOs – Dark Clouds over Serbia' ('Deklarata e Koalicionit të OShC-ve të Grave – Re të Zeza mbi Serbi'), 2019, <https://tinyurl.com/y55y3kdp>, (e qasur më 21 qershor 2020).

¹¹⁴ M. Dokmanovikj et al., *Women's Political Participation in North Macedonia (Pjesëmarrja Politike e Grave në Maqedoninë Veriore)*, Punime Hulumtuese Studimore dhe Shkencore, WFD, 2019, fq. 143.

Trendet e Grave në Politikë

Ky raport i pestë i të *Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor* përfshin një analizë të trendeve në lidhje me indikatorët e Grave në Politikë dhe nën-indikatorët përkatës. Kjo pjesë ofron një përmbledhje të tendencave gjatë pesë viteve të fundit, duke përdorur katër botimet e mëparshme të të *Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor* si themelin e përmbledhjes. Kryesisht, sfida më e madhe për përmirësimin e barazisë gjinore ndër vite mbetet mentaliteti i grave dhe burrave ndaj roleve tradicionale gjinore, dhe ndryshimi i këtyre mentaliteteve patriarkale. Midis 2015 dhe 2020, ndryshimet statistikore, në favor të grave, ishin të vogla dhe u regjistrua një rritje e lehtë e numrit të grave në organet vendimmarrëse në nivel kombëtar. Në të njëjtën kohë, u vërejt një trend negativ i një progresi shumë të ngadaltë dhe të vështirë

në nivelin lokal për sa i përket pjesëmarrjes së grave në politikën komunale gjatë periudhës pesë-vjeçare, e cila gjithashtu u reflektua në rekomandimet e përsëritura të raporteve. Prandaj, seksionet e mëposhtme të kësaj përmbledhjeje trajtojnë trendet që ndërlidhen me:

- Ndikimet e zbatimit të sistemeve të kuotës gjinore në Ballkanin Perëndimor
- Numrin e grave në organet vendimmarrëse

Një analizë e këtyre trendeve do të ndihmojë në artikulimin e situatës (mungesës) së progresit lidhur me pjesëmarrjen politike të grave në Ballkanin Perëndimor në pesë vitet e kaluara.

A do të ekzistojnë gratë në politikë pa kuota? Ndikimet e zbatimit të sistemeve të kuotës gjinore në Ballkanin Perëndimor

Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë kuota gjinore si mekanizëm për të siguruar përfaqësim më të lartë gjinor në Parlamentet Nacionale. Kuotat lëvizin nga 30% (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi) në 40% (BeH, Maqedoni Veriore, Serbi), për përfaqësimin legjislativ dhe elektoral në qeveri.¹¹⁵ Përqindjet e përcaktuara pasqyrojnë përfaqësimin minimal të kërkuar (të paktën përqindjen e përshkruar të kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar). Megjithatë, pothuajse asnjë vend i Ballkanit Perëndimor nuk i ka përmbyllur kriteret e kuotës - gratë vazhdojnë të përballen me sfida në përfaqësimin politik përkundër kuotave gjinore.¹¹⁶

Gjatë periudhës vëzhguese (2016-2020) u shfaqën një sërë mospërputhjesh dhe keqpërdorimesh në sistemet e kuotave - zëvendësimi i kandidatëve gra të zgjedhura me kolegët e tyre burra nga partia;¹¹⁷ implementimi i pjesërisht të kuotave (për shembull i kufizuar në nivele të caktuara të qeverisë, pozita të caktuara);¹¹⁸ prezantimi i kuotave si "rezervim vendesh" për gratë, nga dekurajimi i votuesve për të

votuar për kandidatet gra (dekurajimi i votuesve nga "hedhja e votës");¹¹⁹ deri në interpretimin e përqindjes së kuotës më shumë si përfaqësim maksimal sesa minimal (ngajshëm me zgjedhjet 2019 në Kosovë). Mos përmbyllja e drejtpërdrejt e kuotave ose shtypja "e lehtë" e tyre i ka filltet në partitë politike dhe vazhdon edhe gjatë procesit zgjedhor dhe në implementimin e rezultateve zgjedhore. Partitë politike ende i përdorin kuotat si instrumentin kryesor apo të vetëm për avancimin e grave në politikë, në vend se t'u ofrojnë atyre hapësirë dhe burime, përkrahje në fuqizimin e mëtejshëm dhe në avancimin strategjik të karrierave të tyre politike.¹²⁰ Pyetja mbetet - pse nuk përcaktohen kuotat në 50%, e cila do të ishte e vetmja përqindje që përfaqëson vërtet barazinë gjinore? Fakti që kuotat nuk janë caktuar në 50% mund të shtyjë posht listës emrat e kandidatëve gra në mënyrë të konsiderueshme në listat e partive politike, duke respektuar vetëm zyrtarisht kuotën, në minimumin e duhur dhe në një mënyrë të argumentuar. Duke vepruar kështu, partitë janë ende duke favorizuar kandidatët burra dhe duke investuar në promovimin dhe fushatat e tyre, gjë që çon në faktin se hendeuku midis përfaqësimit të grave dhe burrave në listë është zgjeruar më tej në rezultatet e zgjedhjeve.¹²¹

¹¹⁵ Kosova ka një formë ndryshe të kuotës të quajtur "ulëse të rezervuara" në raport proporcional me listat zgjedhore, e cila është si vijon: në secilën listë të kandidatëve të Subjektit Politik, së paku 30% duhet të jenë burra dhe së paku 30% duhet të jenë gra, me një kandidat nga secila gjini të përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej 3 kandidatëve, duke numëruar nga kandidati i parë në listë.

¹¹⁶ S. Tadić, et al., *Women's Rights in Western Balkans (Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2016, <http://hcabl.org/wp-content/uploads/2019/04/Womens-Rights-in-Western-Balkans-Indicators-Kvinna-till-Kvinna-2016.pdf>, (e qasur më 19 qershor 2020), fq. 3.

¹¹⁷ Po aty.

¹¹⁸ L. Gačanica et al., *Women's Rights in Western Balkans (Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, <https://kvinnaatillkvinna.org/wp-content/uploads/2019/11/Womens-rights-in-Western-Balkans.pdf>, (e qasur më 19 qershor 2020), fq. 3.

¹¹⁹ S. Tadić et al., *Women's Rights in Western Balkans (Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2016, fq. 4.

¹²⁰ Ibid., p. 13.

¹²¹ A. Hanušić Bećirović et al., *Shadow Report for the 3rd Universal Periodic Review on the State of Human Rights in Bosnia and Herzegovina (Raporti në Hije i Shqyrtimit të Tretë Periodik Universal të Gjendjes së të Drejtave të Njeriut në Bosnjë dhe Hercegovinë)*, Sarajevo Open Centre, 2019, p. 12-13.

Implementimi i sistemit të kuotave është veçanërisht i dobët në nivelin lokal (zgjedhjet lokale), dhe në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor¹²² nuk ka kuotë ekzistuese gjinore për gjininë më pak të përfaqësuar në nivel të këshilltarëve.¹²³ Në nivel komunal, gratë zgjedhen kryesisht në pozita të rangut të ulët, derisa burrat mbajnë shumicën e pozitave të fuqishme.¹²⁴ Gjatë periudhës vëzhguese, kjo ishte më e theksuar në Serbi, Maqedoni Veriore dhe Kosovë.

Në BeH, është e nevojshme që të aprovohen amandamentet e ligjeve relevante për të siguruar garanci të dyfishtë për përfaqësimin minimal të gjinisë më pak të përfaqësuar deri në 40%, si dhe amandamentet për Ligjin Zgjedhor të BeH i cili do të përfshinte kuotën gjinore prej 50% për listat zgjedhore të partive, me obligimin shtesë për të listuar kandidatet burra dhe gra në mënyrë të alternuar, në secilin vend të dytë të listave zgjedhore.¹²⁵

Sidoqoftë, në disa vende sistemet e kuotës gjatë katër periudhave të mëparshme raportuese kanë merita për avancimin e dukshëm të grave në organet në nivel kombëtar, sic është rasti i Maqedonisë Veriore. Zhvillimi i legjislacionit zgjedhor duke zbatuar minimumin e përfaqësimit prej 40%, në kombinim me “sistemin sanduiq”, p.sh. Vendosja e gjinisë të nënpërfaqësuar në (të paktën) vendin e tretë për secilin listë të kandidatëve, si dhe zëvendësimin e obliguar të grave të zgjedhura meandidate tjera gra, ka rritur dukshëm qasjen e grave në pozita të zgjedhura.¹²⁶ Gjatë periudhës vëzhguese, përqindja e grave në Parlamentin Shqiptar është rritur nga afërsisht 17% në 2013 deri në 23% në 2015. Nga viti 2017 e tutje, Shqipëria ka pasur 50% të ministrave gra dhe 50% tjerë burra. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të implementimit të kuotës gjinore, ngritjes së ndërgjegjësimit të përgjithshëm dhe iniciativat e vazhdueshme për avokim nga OSHC-të e grave.¹²⁷

Në Serbi, prezantimi i kuotave për kandidatë të garantuara me ligj me rregulla rigoroze të listimit dhe sanksione të ashpra (diskualifikimi i listës në rast të mospërputhjes) patën efekte pozitive në shtimin e numrit të grave të zgjedhura në Parlamentin Nacional, në krahasim me parlamentet e mëparshme.¹²⁸ Në Mal të Zi, pati rritje në pjesëmarrjen politike pas prezantimit të kuotës gjinore në legjislacionin zgjedhor në vitin 2011 të cilat u amandamentuan tutje në vitin 2014. Megjithatë, numri i grave që marrin pjesë në politikë mbetet i ulët dhe gratë janë veçanërisht të nënpërfaqësuar kur kemi të bëjmë me fuqi ekzekutive.¹²⁹

Gjatë kësaj periudhe raportuese, mund të përmenden disa shembuj pozitiv: koalicioni politik në Maqedoni Veriore ka mbështetur kuotën prej 50% në listat e tyre zgjedhore; Parlamenti serb ka aprovuar kuotën minimale të re prej 40% të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat zgjedhore për zgjedhjet lokale dhe parlamentare.

Përkundër shumë sfidave në implementim, kuotat gjinore mbesin një instrument i rëndësishëm për baraspeshën gjinore në përfaqësimin politik në Ballkanin Perëndimor si një instrument për të tejkaluar normat sociale të rrënjësura thellë që vështirësojnë përfaqësimin e barabartë politik.



“Asnjë nga gratë që marrin këtë pozitë nuk dëshiron të jetë një grua kuote dhe të jetë atje vetëm sepse ajo është një grua. Theksi vihet në faktin se gratë kanë aftësi, njohuri dhe duan të vendosin për jetën e tyre dhe jetën e vendit dhe qytetit në të cilin jetojnë”

Nada Drobnjak, Presidente e Komisionit Parlamentar për Barazi Gjinore, Mali i Zi¹³⁰

¹²² Me përjashtim të Kosovës. Ju lutem referojuni fusnotës #115

¹²³ S. Tadić, et al., *Women's Rights in Western Balkans (Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2018, <https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2018/11/WRWB2018.pdf>, (e qasur më 19 qershor 2020), fq. 7.

¹²⁴ Po aty., fq. 9.

¹²⁵ A. Hanušić Bećirović et al., *Shadow Report for the 3rd Universal Periodic Review on the State of Human Rights in Bosnia and Herzegovina (Raporti në Hije i Shqyrtimit të Tretë Periodik Universal të Gjendjes së të Drejtave të Njeriut në Bosnjë dhe Hercegovinë)*, Sarajevo Open Centre, 2019, fq. 12-13.

¹²⁶ WFD, *Women's Political Participation in North Macedonia, Study and Scientific Research Papers (Pjesëmarrja Politike e Grave në Maqedoninë Veriore)*, Punime Hulumtuese Studimore dhe Shkencore, Shkup, WFD, 2019, <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/Women-Political-Participation-2019-EN-for-web-.pdf>, (e qasur më 19 qershor 2020).

¹²⁷ S. Tadić et al. *Women's Rights in Western Balkans (Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2016, fq. 3.

¹²⁸ Po aty., fq. 6.

¹²⁹ O. Komar, *Gender Equality Index Montenegro – 2019 (Indeksi i Barazisë Gjinore për Malin e Zi – 2019)*, -UNDP, 2020, fq. 29.

¹³⁰ Ž. Vučinić, 'Žene Polako idu ka Vrh' (Gratë ju Ngjiten Majeve Ngadalë), *Vijesti*, 29 qershor 2019, <https://www.vijesti.me/vijesti/politika/391699/zene-polako-idu-ka-vrhu>, (e qasur më 19 qershor 2020).

Ku janë gratë në politikë? Numri i grave në organet vendimmarrëse

Të dhënat nga botimet e kaluara të *Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor* për periudhën 2016-2020 tregojnë trende të rritjes së numrit të grave në pozita vendimmarrëse në rajon. Rajoni ende është larg nga arritja e barazisë gjinore në secilin segment të strukturave shoqërore apo politike, megjithatë, duhet të njihet progresi i bërë. Ndryshimi në Ballkanin Perëndimor shfaqet brenda proceseve të ngadalshme, i shoqëruar me ndryshime të nevojshme në ndërgjegjësim dhe qëndrime kundrejt grave në shoqëritë (ende mjaft patriarkale) e Ballkanit Perëndimor.

Gjersa numri i grave në politikë në përgjithësi është në rritje për sa i përket anëtarëve të partive politike dhe kandidatëve në listat zgjedhore, numri i grave të zgjedhura dhe në pozita vendimmarrëse është dukshëm më i ulët. Kjo është vërejtur në nivelin komunal në veçanëti.

Përqindja e Deputeteve Gra në Parlamente në kuadër të Parlamenteve Nacionale në periudhën 2016-2020 tregon se numrat nuk kanë ndryshuar dukshëm. Përqindjet në Shqipëri, BeH dhe Mal të Zi lëvizin midis 20 and 30%, gjersa Kosova, Maqedonia Veriore dhe Serbia kanë përfaqësim të grave midis 30% and 38%. Pika më e lartë e përqindjes është regjistruar në Shqipëri në shkallë prej nëntë pikë përqindje në 2017, dhe në Maqedoni Veriore me pesë pikë përqindje nga viti 2016 deri në 2020. Poashtu është e rëndësishme të theksohet se Maqedonia Veriore ka arritur 40% përfaqësim në këto pozita.

Përqindja e Grave Ministra 2016-2020 shënon ndryshimin më të madh në raport me pozitat vendimmarrëse në nivel lokal dhe kombëtar. Shqipëria ka arritur një raport të barabartë përfaqësimi midis burrave dhe grave në pozitat ministrore prej vitit 2017. Në Kosovë, gratë ministra përbënin 5% në 2016, ndërsa shënuan rritje deri në 20% në 2020. Maqedonia Veriore ka arritur rritje vjetore në përfaqësimin e grave ministre nga 10% në 2016 deri në 25% në 2020. Në BeH dhe Mal të Zi, përqindjet janë duke u rritur poashtu, por në shkallë më të ulët, ndërsa progresi është shumë i ngadaltë. Në anën tjetër, Serbia gjindet në një status quo me një rënie të lehtë nga 21% në 19% të grave në pozita ministrore gjatë periudhës 2016-2020. Mesatarja e grave ministra në BE është 28%.

Të dhënat mbi pjesëmarrjen politike të grave në nivel komunal, megjithatë, mbesin dekurajuese. Numrat e Grave në Pozitat e Kryetareve të Komunave 2016-2020 reflektojnë realitetin e vrazhdë të pjesëmarrjes politike të grave në nivele që ishte dashur të jenë pika hyrëse për veprimin e tyre politik. Në Kosovë, nga 38 pozitat komunale, asnjë grua nuk ka qenë kryetare e komunës prej vitit 2018. BeH ka vetëm 4% kryetare komunash gra, Maqedonia Veriore dhe Serbia arrijnë shifrën prej 7%, ndërsa Mali i Zi 8%, duke ju lënë burrave 90% të pozitave në të gjitha katër vendet. Këto katër vende kanë rritje të vogël të përfaqësimit të grave, deri në dy pikë përqindje përgjatë viteve. Shqipëria shënon përqindjen më të lartë të grave kryetare komunash deri në 15%, një rritje prej një pikë përqindjeje nga viti 2016, dhe megjithëse Shqipëria është lider rajonal në këtë aspekt, nëse përkthehet në numra, kjo përbën vetëm nëntë nga gjithsej 61 kryetarë komunash, ku burrat ende mbajnë 85% të këtyre pozitave. Gratë Këshilltare Komunale 2016-2020 numërojnë përqindje më të larta por mbesin larg arritjes së barazisë gjinore. Numrat e grave këshilltare janë ende stabile dhe nga më të lartat në Shqipëri (35%), Maqedoni Veriore (32%, një rritje prej 2% gjatë katër viteve të fundit), dhe Serbi (31% dhe me rritje të ngadaltë gjatë viteve). Kosova aktualisht ka arritur 35%, por ka rënie prej katër përqind nga viti 2019, gjatë periudhës së kaluar raportuese. Në Mal të Zi përqindja aktuale prej 30% të grave është dy pikë më shumë se në vitin 2018 por dukshëm një rënie prej dy përqind nga viti 2016. Gjatë periudhës vëzhguese, BeH pati rritje prej dy përqind, megjithëse numri aktual i grave këshilltare mbetet mjaft i ulët: vetëm 587 gra nga gjithsej 3 278 pozita të këshilltarëve.

Me përjashtim të Atifete Jahjagës, e cila ka shërbyer si grua e parë Presidente e Kosovës nga 2011 deri në prill 2016, të gjithë Udhëheqësit e Shtetit në Ballkanin Perëndimor në periudhën 2016-2020 ishin burra. Në nivel të Parlamenteve Nacionale, është vetëm një grua Kryeministre e Qeverisë në Serbi. Nuk ka grua Presidente të Asambleve Rajonale në asnjërën nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Gratë rome, dhe gratë nga grupet e tjera të pakicave etnike janë të përjashtuara sistematikisht nga pjesëmarrja politike, veçanërisht në organet vendimmarrëse dhe kjo vlen për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.



"Aktivizmi në partitë politike është i rëndësishëm, sepse inkurajon si gratë ashtu edhe burrat në partitë politike të luftojnë për të drejtat e tyre."

Ismeta Dervoz, ish-deputete në BeH dhe aktiviste e kahmotshme

Si duhet vepruar? Trendet në rekomandime 2016-2020

Pjesëmarrja e grave në politikë është një temë kryesore për OSHC-të e grave dhe iniciativat e tyre të avokimit në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Megjithëse indikatorët e përfaqësimit janë të matshëm, ndikimet dhe ndryshimet e këtyre statistikave, si dhe faktorët që i pengojnë gratë nga arritja e barazisë në proceset e vendimmarrjes dhe të politikave në përgjithësi, shpesh janë të pavlerësueshme, cilësore dhe indirekt të matshme. Në lidhje me pjesëmarrjen dhe qasjen e grave në politikë, janë këta faktorë të papërcaktueshëm, të cilët kërkojnë më shumë vëzhgim, analizë më të plotë dhe konsideratë serioze krahas analizës së të dhënave sasiore. Shkaqet e pabarazisë gjinore, përfshirë pjesëmarrjen e ulët politike, i kanë rrënjët në qëndrimet patriarkale, normat shoqërore dhe nocionet stereotipike të roleve të grave në shoqëri. Sidoqoftë, përveç ndryshimeve në vetëdijen shoqërore, ndryshimet duhet të ndodhin edhe në nivelin e legjislacionit përmes zbatimit të masave pozitive të veprimit që shkojnë përtej kuotave dhe përfshijnë një rrjet akterësh të ndryshëm në të gjitha nivelet e ndryshme të qeverisjes. Botimet e të *Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor* nga 2016 në 2020 lëshuan rekomandime në këtë drejtim, në përputhje me gjetjet, në baza vjetore. Përmbytja e rekomandimeve, ose mospërmbytja, mund të vërehet përmes përsëritjes së tyre dhe tregon se sa i kufizuar ishte progresi gjatë periudhave raportuese.

Për shumë nga çështjet e identifikuar ku kërkohet ndryshim përmes veprimeve afatgjata dhe afatshkurtra, planifikimit, zbatimit dhe përmirësimeve, nuk është vërejtur asnjë progres në arritjen e rekomandimeve për periudhën 2016-2020. Kjo ka të bëjë veçanërisht me zbatimin e legjislacionit (kuotat gjinore, standardet anti-diskriminim), futjen e risive për nivelin lokal të pjesëmarrjes politike dhe ndryshimin e paradigmave në trajtimin e anëtareve dhe kandidateve gra nga ana e partive politike. Çështje tjetër e përsëritur janë qasja e dobët e grave në financimin e partive politike, visibiliteti më i ulët në media gjatë fushatave, pengesat për ngritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave, si dhe sfidimi i narrativës dominante në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor dhe krijimi i një imazhi pozitiv të grave si politikane dhe udhëheqëse politike. Siç u tha më parë, nuk ka asnjë mundësi për të përmirësuar pozicionin e grave në skenën politike duke përdorur vetëm legjislacionin ose fushatat sporadike. Promovimi i barazisë gjinore duhet të jetë i vazhdueshëm dhe këmbëngulës në të gjitha nivelet: shoqëri, parti politike, qeveri të nivelit lokal dhe kombëtar. Politikat e përgjegjshme gjinore në buxhet(e) mbeten të pareaizuara. Është e rëndësishme të theksohet se eliminimi i stereotipeve dhe normave shoqërore patriarkale të ngulitura thellësisht është thelbësor, dhe një rekomandim i theksuar edhe nga CEDAW¹³¹ për secilin vend të Ballkanit Perëndimor.

¹³¹ Në Rekomandimet Përmbyllëse të CEDAW për secilin raport të vendit përveç Kosovës.

”

"Mediat janë plot me deklarata seksiste dhe mizogjene, të cilat vijnë gjithashtu nga zyrtarë të lartë të shtetit, profesorë universitarë, udhëheqës fetarë dhe figura të tjera publike, me pothuajse asnjë pasojë".

Tanja Ignjatović, Autonomni Ženski Centar¹³²

”

"Çdo ligj i vetëm që vjen në kuvend duhet të shihet përmes lenteve gjinore. Do të na shihni duke biseduar dhe luftuar për barazinë gjinore, pa marrë parasysh se cila është tema në Parlament dhe në Qeveri"

Vjosa Osmani, Kryetare e Parlamentit të Kosovës¹³³

¹³² T. Ignjatović, 'Gde su Danas Prava Žena u Srbiji' ('Ku janë sot të Drejtat e Grave në Serbi'), *Danas*, 10 dhjetor 2019, <https://www.danas.rs/dijalog/licni-stavovi/gde-su-danas-prava-zena-u-srbiji/>, (e qasur më 21 qershor 2020).

¹³³ N. Đorđević, 'Women Make their Mark in Kosovo's New Government' ('Gratë Lënë Gjurmën e tyre në Qeverinë e Re të Kosovës'), *Emerging Europe*, 9 mars 2020, <https://emerging-europe.com/news/women-make-their-mark-in-kosovos-new-government/>, (e qasur më 21 qershor 2020).

Rekomandimet^{134*}

% e grave në politika dhe/ose në pozita të larta me fuqi vendimmarrëse

SHKURTIMISHT:

Gratë nuk kanë arritur barazi politike në shkallë të lartë në kuadër të parlamenteve dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor, çështjet e barazisë gjinore mbeten të marginalizuara në diskursin politik dhe gratë politikane përballen me diskriminim, ngacmim dhe dhunë nga publiku, si dhe nga partitë e tyre dhe ato opozitare.

BRENDA NJË VITI:

Reforma legjislativë mund të imponojë sanksione për mosrespektim të kërkesave aktuale në raport me kuotën; parlamentet mund të instalojnë mekanizma të ankesës dhe të ndihmës juridike falas për të adresuar dhunën, diskriminimin dhe ngacmimin me të cilin përballen gratë politikane.

Qeveritë:

- Të miratojnë kuota për të siguruar përfaqësimin minimal prej 40% për gjininë më pak të përfaqësuar në parlamente, pozita ekzekutive në kabinet dhe në shërbimin civil (p.sh., në të gjitha funksionet shtetërore) (Shembuj: Republika Çeke, Franca).
- Të miratojnë kuota për të siguruar përfaqësimin minimal prej 40% në listat partiake, duke kërkuar që kandidatet të listohen duke alternuar në listat e partise sipas gjinisë për të parandaluar praktikën e radhitjes së grave në fund të listave në raste kur kjo ndodh (p.sh., grua, burrë, grua, etj.).
- Të ndryshojnë legjislacionin ekzistues duke reflektuar kuotat në listat partiake dhe duke përfshirë sanksione për mosrespektim, përfshirë mbajtjen pezull të fondeve të shtetit (Shembuj: Belgjika).
- Të themelojnë një mekanizëm për ankesa në kuadër të parlamentit për të adresuar diskriminimin, ngacmimin dhe dhunën kundër grave në politikë, që ofron shërbime mbështetëse të nevojshme, duke përfshirë njohjen si një kategori që kualifikohet për ndihmë juridike falas, dhe që grumbullon të dhëna mbi fenomenin (Shembull: Spanja).
- Të rregullojnë/të obligojnë me ligj mediat transmetuese për të ofruar kohë transmetimi pa pagesë për kandidatet gra dhe për partitë që nominojnë më shumë kandidatë gra dhe ato që përfshijnë gra në fushatat e tyre zgjedhore.

Institucionet e BE-së, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe organizatat donatore:

- Të përfshijnë standarde të qarta në Raportet e KE-së për shtetet e Ballkanit Perëndimor lidhur me pjesëmarrjen më të madhe të grave në parlamentet kombëtare, në pozitat e kabinetit ekzekutiv dhe në shërbimin civil.
- Të mbështesin rrjetet parlamentare ose forumet parlamentare të grave në vende ku ato ekzistojnë për të zhvilluar agjenda specifike të avokimit për çështjet gjinore.
- Të mbështesin trajnimin e gazetarëve për mbulim mediatik të ndjeshëm ndaj gjinisë gjatë zgjedhjeve.
- Të mbështesin bashkëpunimin midis OSHC-ve të grave dhe organeve rregullatore të mediave për të monitoruar mbulimin e fushatave nga perspektiva gjinore.
- Të përfshijnë një perspektivë ndër-thurëse (ndër-sektoriale) në të gjitha programet që synojnë përkrahjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.

^{134*} Duke pasur parasysh situatën e larmishme në secilin vend, rekomandimet janë të përgjithësuara, duke qenë të aplikueshme në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për secilin veprim të rekomanduar

% e grave në politikat lokale (kryetare komunash, këshillat lokal/komunal)

SHKURTIMISHT:

Përfaqësimi politik i grave në nivel të kryetarëve të komunave dhe niveleve lokale/komunale të qeverisjes është jashtëzakonisht i ulët, dhe kërkon kuota të detyrueshme me legjislacion në raport me listat partiake dhe në emërimet dhe emërimet e ekzekutivëve lokalë.

BRENDA NJË VITI:

Legjislacioni dhe rregulloret e nivelit lokal duhet të modifikohen për të siguruar një përfaqësim minimal prej 40%, *de facto*, në raste kur nuk ekzistojnë dispozita të tilla, dhe fushata lokale të ndërgjegjësimit publik me shtrirje të gjerë për të adresuar paragjykimet aktuale gjinore gjatë zgjedhjeve.

Qeveritë:

- Të ndryshojnë legjislacionin për kuotat për të rritjen e kuotës në 40% për gjininë më pak të përfaqësuar duke siguruar barazi midis kandidatëve.
- Të ndryshojnë legjislacionin për kuotat për të kërkuar radhitjen e alternuar në listat e partive sipas gjinisë për listat e kryetarëve dhe këshillit bashkiak.
- Të ndryshojnë legjislacionin për të vendosur sanksione për palët që nuk janë në përputhje me kërkesat e kuotave.
- Të krijojnë një mekanizëm ankimi brenda këshillave lokalë të komunës për adresimin e diskriminimit, ngacmimit dhe dhunës ndaj grave në politikë.
- Të prezantojnë leja prindërore dhe/ose kujdestare për përfaqësuesit politikë (Shembull: Suedi).
- Të angazhohen në fushata të ndërgjegjësimit me shtrirje të gjerë të nivelit lokal mbi paragjykimin gjinor në politikë.

Institucionet e BE-së, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe organizatat donatore:

- Në Raportet e BE-së për shtetet e Ballkanit Perëndimor të përfshihen standarde të qarta për pjesëmarrje më të gjerë të grave si kryetare komune dhe në këshillat lokale dhe komunale.
- Të përkrahin angazhimin e OShC-ve duke përfshirë organizatat e grave si agjentë të llogaridhënies në konsultimet mbi hartimin e bugjetit dhe politikave në nivel lokal.
- Të përkrahin organizatat e grave për të zhvilluar fushata të ndërgjegjësimit publik me shtrirje të gjerë në nivel lokal për të adresuar diskriminimin gjinor në vendimmarrjen politike.
- Të përkrahin trajnimet e gazetarëve mbi mbulimin mediatik të ndjeshëm ndaj gjinisë në zgjedhjet lokale.
- Të përfshijnë perspektiva ndërthurëse (ndër-sektoriale) në të gjitha programet që synojnë pjesëmarrjen politike të grave.

Lista e Referencave

- Agency for Gender Equality, 'Press Release – The Law on Gender Equality Shall be Adhered to in Terms of Equal Representation of 50% during the 6 October 2019 Parliamentary Elections', *Agency for Gender Equality*, 04 September 2019, https://abgj.rks-gov.net/en/lajmi_single/739, (accessed 1 September 2020).
- Barlovac, B., 'Albanian and Serbian Gender Activists Join Efforts for Gender Equality Under the Patronage of UN WOMEN', *United Nations Serbia*, 2016, <https://serbia.un.org/en/13494-albanian-and-serbian-gender-activists-join-efforts-gender-equality-under-patronage-un-women>, (accessed 21 June 2020).
- Bashevska, M., *Gender Equality index North Macedonia 2019: Measuring Gender Equality*, 2019, Skopje: UNDP- UN Women, 2019, https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender_equality_index_macedonia_eng.pdf, (accessed 15 June 2020).
- Boričić, M.
- and Jelić, A., 'Nedovoljno Žena iz Manjinskih Naroda u Politici i Odlučivanju: Tvrdi Odbor "Muškog Posla"', *Vijesti*, 31 January 2020, <https://www.vijesti.me/vijesti/drustvo/419786/nedovoljno-zena-iz-manjinskih-naroda-u-politici-i-odlucivanju-tvrda-odbrana-muskog-posla>, (accessed 21 June 2020).
- Ceciarini, S., *Women in Politics Local and European Trends*, The Council of European Municipalities and Regions (CEMR), 2019, https://ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/CEMR_Study_Women_in_politics_EN.pdf, (accessed 21 June 2020).
- Commission of the European Communities, *Report from the Commission to the Council, the European Parliament, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions: Annual Report on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union*, Commission for European Communities, 2003, [https://www.europarl.europa.eu/meetdocs/committees/empl/20030909/COM\(03\)0098_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/meetdocs/committees/empl/20030909/COM(03)0098_EN.pdf), (accessed 11 June 2020).
- Committee on the Elimination of Discrimination against Women (CEDAW), *Concluding Observations on the Sixth Periodic Report of Bosnia and Herzegovina*, Committee on the Elimination of Discrimination against Women (CEDAW), 2019, https://arsBeH.gov.ba/wp-content/uploads/2019/11/CEDAW-C-BEH-Concluding-Observations-6_AsAdopted.pdf, (accessed 1 June 2020).
- Committee on the Elimination of Discrimination against Women (CEDAW), *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Serbia*, Committee on the Elimination of Discrimination against Women (CEDAW), 2019, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/SRB/C/O/4&Lang=En, (accessed 21 June 2020).
- Cvetanoska, Lj. and Elbasani, A., 'Kosovo: Corruption, Electoral Funding and Political Participation of Women', *IBC Transeuropa*, 2020, <https://www.balkanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/Kosovo-corruption-electoral-funding-and-political-participation-of-women-202255>, (accessed 21 June 2020).
- Delegation of the European Union to Bosnia and Herzegovina, 'Women's Advisory Board holds its first session in Sarajevo', *Delegation of the European Union to Bosnia and Herzegovina*, 2019, <https://europa.ba/?p=63835>, (accessed 20 June 2020).
- Dokmanovik, M. et al., *Women's Political Participation in North Macedonia, Study and Scientific Research Papers*, Westminster Foundation for Democracy, 2019, <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/Women-Political-Participation-2019-EN-for-web-.pdf>, (accessed 15 June 2020).
- Đorđević, N., 'Women Make their Mark in Kosovo's New Government', *Emerging Europe*, 9 March 2020, <https://emerging-europe.com/news/women-make-their-mark-in-kosovos-new-government/>, (accessed 21 June 2020).
- EU Election Observation Mission in Kosovo, *Kosovo 2019: Final Report – Early Legislative Elections, 6 October 2019*, EU Election Observation Mission in Kosovo, 2019, http://www.epgencms.europarl.europa.eu/cmsdata/upload/1e4f1465-9cdd-4565-a837-a0487b092e51/Kosovo_early-legislative-elections_6-October-2019_final-report.pdf, (accessed 10 June 2020).
- European Commission, *Kosovo* 2019 Report*, Brussels, European Commission, 2019, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>, (accessed 21 June 2020).
- European Commission, *Montenegro 2019 Report*, Brussels, European Commission, 2019, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-montenegro-report.pdf>, (accessed 12 June 2020).
- European Institute for Gender Equality, *Gender Statistics Database* [website], <https://eige.europa.eu/lt/gender-statistics/dgs/browse/wmidm>, (accessed 10 April 2020).
- European Union's Gender Action Plan II 'Gender Equality and Women's Empowerment: Transforming the Lives of Girls and Women through EU External Relations 2016-2020'.
- Gaćanica, L. et al., *Women's Rights in Western Balkans*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2019, <https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2019/11/Womens-rights-in-Western-Balkans.pdf>, (accessed 19 June 2020).
- Government of Republic of Kosovo, *Kosovo Program for Gender Equality 2020-2024*, Government of Republic of Kosovo, 2020, <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>, (accessed 23 September 2020).
- Halili, D., 'Women's Political Empowerment Meets its Limit', *Kosovo* 2.0, 14 February 2020, <https://kosovotwopointzero.com/en/womens-political-empowerment-meets-its-limit/>, (accessed 11 June 2020).

- Hanušić Bećirović, A. et al., *Shadow Report for the 3rd Universal Periodic Review on the State of human rights in Bosnia and Herzegovina*, Sarajevo Open Centre, 2019, <https://soc.ba/site/wp-content/uploads/2019/08/UPR-ENG-final.pdf>, (accessed 15 June 2020).
- Hasanbegović, D. et al., *Orange Report 5: Report on the State of the Human Rights of Women in Bosnia and Herzegovina for the period 2016-2019*, Sarajevo, Sarajevo Open Centre, 2019, https://soc.ba/site/wp-content/uploads/2019/12/Orange-report-2016-2019_ENG_web.pdf, (accessed 10 June 2020).
- Helsinki Citizens' Assembly Banjaluka. *Assessing Gender Sensitivity of Entity and State Parliament*, Banja Luka, Helsinki Citizens' Assembly Banjaluka, 2020, <http://hcabl.org/wp-content/uploads/2020/07/Assessing-Gender-Sensitivity-of-Entity-and-State-Parliament-1.pdf>, (accessed 11 September 2020).
- Ignjatović, T., 'Gde su Danas Prava Žena u Srbiji', *Danas*, 10 December 2019, <https://www.danas.rs/dijalog/licni-stavovi/gde-su-danas-prava-zena-u-srbiji/>, (accessed 21 June 2020).
- INSTAT, *Women and Men in Albania 2018*, Tirana, INSTAT, 2018, <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20albania/attachments/publications/2018/06/women%20and%20men%20in%20albania%202018.pdf?la=en&vs=3558>, (accessed 21 June 2020).
- Inter-Parliamentary Union, *Albania: Parliament* [website], https://data.ipu.org/content/albania?chamber_id=13313, (accessed 10 April 2020).
- Inter-Parliamentary Union, *North Macedonia: Assembly of the Republic* [website], https://data.ipu.org/content/north-macedonia?chamber_id=13391, (accessed 10 April 2020).
- Inter-Parliamentary Union 'Serbia Steps up Efforts for Gender Parity', *Inter-Parliamentary Union*, 2020, <https://www.ipu.org/news/news-in-brief/2020-02/serbia-steps-up-efforts-gender-parity>, (accessed 11 June 2020).
- 'Izbori 2020, Žene i Politika u Srbiji: "Mnogo ljudi mi je Reklo da mi Tako Nešto Nije Trebalo u Životu"', *BBC News*, 11 June 2020, <https://www.021.rs/story/BBC/245671/Izbori-2020-zene-i-politika-u-srbiji-Mnogo-ljudi-mi-je-reklo-da-mi-tako-nesto-nije-trebalo-u-zivotu.html>, (accessed 11 June 2020).
- Janković, A. and Čvorić Gubelić, M., 'Kvote su Uvele Žene u Politički Život, ali ne i na Funkcije', *Blic*, 31 December 2019, <https://www.blic.rs/vesti/politika/samo-dve-partije-u-srbiji-imaju-predsednice-kvote-su-uvele-zene-u-politicki-zivot-ali/58gdnng>, (accessed 12 June 2020).
- 'Jelena Jovanović - Prva Romkinja u Skupštini AP Vojvodine', *Radio-Televizija Vojvodine*, 23 May 2018, https://www.rtv.rs/sr_lat/vojvodina/novi-sad/jelena-jovanovic-prva-romkinja-u-skupstini-ap-vojvodine_920566.html, (accessed 12 June 2020).
- Kadia, B. and Prifti, R., *The Cost of Politics in Albania*, Westminster Foundation for Democracy, 2019, https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2019/09/Costs-of-Politics-in-Albania_Final.pdf, (accessed 10 June 2020).
- Kadribašić, A. et al., *Baseline Study on Barriers to Political Participation of Women in Bosnia and Herzegovina*, United Nations Development Programme Bosnia and Herzegovina, 2019, https://www.ba.undp.org/content/bosnia_and_herzegovina/en/home/library/democratic_governance/polazna-studija-o-barijerama-politikom-ueu-ena-u-bosni-i-hercego.html, (accessed 12 June 2020).
- Komar, O., *Gender Equality Index Montenegro - 2019*, United Nations Development Programme, 2020, https://www.me.undp.org/content/montenegro/en/home/library/womens_empowerment/GEI2019.html, (accessed 12 June 2020).
- Lilyanova, V., *Women in the Western Balkans - Gender Equality in the EU Accession Process*, European Parliamentary Research Service, 2018, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/625139/EPRS_BRI\(2018\)625139_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/625139/EPRS_BRI(2018)625139_EN.pdf), (accessed 10 June 2020).
- Macanović, V. et al., 'Statement of Coalition of Women NGOs - Dark Clouds over Serbia', 2019, <https://tinyurl.com/y55y3kdp>, (accessed 21 June 2020).
- Marusic, S. J., 'North Macedonia Ruling Alliance Pushes Gender Equality in Elections', *BIRN*, 16 March 2020, <https://balkaninsight.com/2020/03/16/north-macedonia-ruling-alliance-pushes-gender-equality-in-elections/>, (accessed 10 June 2020).
- Ministry of Health and Social Protection and Institute of Statistics of the Republic of Albania, *Gender Equality Index for the Republic of Albania 2020*, Tirana, Ministry of Health and Social Protection and Institute of Statistics of the Republic of Albania, 2020, http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf, (accessed 10 June 2020).
- Office for Democratic Institutions and Human Rights, *Republic of Albania: Local Elections 30 June 2019 - ODIHR Election Observation Mission Final Report*, Warsaw, Office for Democratic Institutions and Human Rights, 2019, https://www.osce.org/files/f/documents/1/f/429230_0.pdf, (accessed 21 June 2020).
- Ombudsperson Institution, 'Ombudsperson's Statement Related to Equal Gender Representation in the Process of Early Parliamentary Elections 2019', *Ombudsperson Institution of the Republic of Kosovo*, 5 September 2019, <https://www.oik-rks.org/en/2019/09/05/ombudspersons-statement-related-to-equal-gender-representation-in-the-process-of-early-parliamentary-elections-2019/>, (accessed 1 September 2020).
- Organisation for Security and Co-operation in Europe, *OSCE-led Survey on Violence against Women: Montenegro*, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, https://www.osce.org/files/f/documents/8/7/424985_1.pdf, (accessed 21 June 2020).
- Pasquinelli, G., *Two Steps Forward, One Step Back - Gender Analysis of 2019 EC Country Reports for the Western Balkans*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2019, <https://kvinna.tillkvinna.org/2019/10/30/two-steps-forward-one-step-back-2019/>, (accessed 11 June 2020).

-
- Pejić Nikić, J. (ed), *prEugovor Alarm: Report on Progress of Serbia in Chapters 23 and 24*, Belgrade, Belgrade Centre for Security Policy, 2020, <http://preugovor.org/Alarm-Reports/1596/Coalition-prEugovor-Report-on-Progress-of-Serbia.shtml>, (accessed 21 June 2020).
- 'Ponavljanje izbora na 234 Biračka Mesta u Srbiji', *Radio Slobodna Evropa*, 26 June 2020, <https://www.slobodnaevropa.org/a/30691628.html>, (accessed 20 June 2020).
- Prava Za Sve, *How to Ensure Gender Equality through the Process of EU Integration?*, Prava Za Sve, 2018, http://rightsforall.ba/wp-content/uploads/2018/11/Engleska-verzija-How-to-ensure-gender-equality-through-the-process-of-EU-integration_finalna-verzija.pdf, (accessed 15 June 2020).
- Selmani, A., *Talking Women – One Year of EU Support to Gender Equality and Women Empowerment in Kosovo*, Europe House, 2020, https://europehouse-kosovo.com/wp-content/uploads/2020/03/EU-Talking-Women_publication_ENG-2-1.pdf, (accessed 21 June 2020).
- Tadić, S. et al., *Women's Rights in Western Balkans*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2016, <http://hcabl.org/wp-content/uploads/2019/04/Womens-Rights-in-Western-Balkans-Indicators-Kvinna-till-Kvinna-2016.pdf>, (accessed 19 June 2020).
- Tadić, S. et al., *Women's Rights in Western Balkans*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2018, <https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2018/11/WRWB2018.pdf>, (accessed 19 June 2020).
- Tadić S. et al., *Women's Rights in Western Balkans*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2018, <https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2018/11/WRWB2018.pdf>, (accessed 19 June 2020).
- The World Bank, *Closing the Gender Gaps among Marginalized Roma in the Western Balkan - A Summary of Findings and Policy Recommendations*, The World Bank, 2019, <http://documents1.worldbank.org/curated/en/994401560763568796/text/Closing-the-Gender-Gaps-among-Marginalized-Roma-in-the-Western-Balkans.txt>, (accessed 4 August 2020).
- United Nations Development Programme, *Women in Elections Project* [website], https://www.ba.undp.org/content/bosnia_and_herzegovina/en/home/sustainable-development/WomenInElections.html, (accessed 10 June 2020).
- Vučinić, Ž. 'Žene Polako idu ka Vrhui', *Vijesti*, 29 June 2019, <https://www.vijesti.me/vijesti/politika/391699/zene-polako-idu-ka-vrhui>, (accessed 19 June 2020).
-

DHUNA ME BAZË GJINORE

Dhuna me bazë gjinore (DhBGj) mbetet një problem i përhapur në të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Sfidat për të luftuar DhBGj janë të shumta. Legjislacioni, kryesisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është në fuqi, megjithatë, ekziston nevoja për të zgjeruar shtrirjen e tij në adresimin e DhBGj përtej fushës së dhunës në familje (DhF), pasi nuk është forma e vetme e DhBGj, përkundrazi është një të shumë formave të ndryshme të dhunës gjinore.

Ky kapitull shqyrton zbatimin e aspekteve kryesore të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje¹³⁵ (e ashtuquajtura Konventa e Stambollit). Do të fokusohet në detyrimet e shteteve për të siguruar strehimore dhe linja ndihme për viktimat/të mbijetuarat e DhBGj (Nenet 23 dhe 24 të Konventës së Stambollit), për të siguruar sanksione dhe masa të përshtatshme për kryerësit dhe masat e DhBGj (neni 49), për të mbledhë të dhëna të ndara për të gjitha rastet e DhBGj në intervale të rregullta (neni 11), dhe për të caktuar burimet e duhura financiare për zbatimin adekuat të politikave, masave dhe programeve të integruara për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës (neni 8). Vëmendje e veçantë i kushtohet detyrimit për zbatimin e Konventës bazuar në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 4), në lidhje me gratë rome dhe gratë me aftësi të ndryshme.

Përkundër kërkesës së Nenit 11 të Konventës së Stambollit, të dhënat për rastet e DhBGj mbeten kryesisht të padisponueshme në të gjithë rajonin. Bazat e të dhënave relevante për legjislacionin e brendshëm nuk përdoren në mënyrë efektive, duke përfaqësuar kështu një sfidë kryesore për ndjekjen e rasteve të DhF dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së përgjigjes institucionale. Duke pasur parasysh mungesën e informacionit publik për DhBGj/DhF dhe që synojnë të vlerësojnë shkallën në të cilën dispozitat e Konventës së Stambollit po zbatoheshin nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor, Kvinna till Kvinna ushtroi të drejtën për të hyrë në informacionin publik përsëri

këtë vit, duke paraqitur të drejtën e lirë për informim në secilin vend, bazuar në ligjet përkatëse. Kërkesat ishin të standardizuara dhe kërkonin informata mbi shumat e alokuara financiare për mbrojtjen dhe parandalimin nga DhBGj, sipas detyrimeve që rrjedhin nga neni 8¹³⁶ i Konventës së Stambollit. Përgjigjet e qeverive të Ballkanit Perëndimor ndryshonin nga informatat e ofruara, ndërsa shumica e tyre ishte e pjesshme dhe e kufizuar në disa sektorë. Informatat e mbledhura përmes përgjigjeve ndaj kërkesave për të dhëna tregojnë se qeveritë nuk i kanë kuptuar detyrimet e tyre për parandalimin dhe mbrojtjen nga DhBGj/DhF. Ato kanë bërë përpjekje të kufizuara për të krijuar sisteme financiare që përshkruajnë zotimin e tyre të përgjithshëm financiar në këtë drejtim.

Angazhimi dhe kapacitetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor për të zbatuar legjislacionin në fuqi dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit mbeten të kufizuara. Ekziston një alokim joadekuat i fondeve për zbatimin e legjislacionit, strategjive dhe politikave që adresojnë DhBGj/DhF në të gjithë rajonin. Dëshmitë mbi alokimin e fondeve janë të fragmentuara. Parandalimi dhe mbrojtja ndaj DhBGj/DhF mbeti subjekt i mbështetjes së donatorëve ndërkombëtarë.¹³⁷ Shërbimet për viktimat/të mbijetuarat e DhBGj/DhF të tilla si strehimoret, linjat e ndihmës, ndihma juridike falas, kujdesi shëndetësor dhe mbështetja ekonomike vuajnë drejtpërdrejt nga nën-financimi.

Kosova është vendi i vetëm jo-nënshkrues i Konventës së Stambollit në rajon për shkak të statusit të saj politik që ndikon në anëtarësimin në Këshillin e Evropës. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të vitit 2019 që afirmon ligjshmërinë e ndryshimit kushtetues të propozuar për miratimin e Konventës së Stambollit nga Asambleja e Kosovës megjithatë ka hapur rrugën drejt ratifikimit të saj.¹³⁸ Megjithatë, mungesa e njohjes së Kosovës si një vend nënshkrues do të jetë një mangësi në monitorimin e zbatimit të Konventës.

¹³⁵ Këshilli i Evropës, *The Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence (Konventa e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave)*, Stamboll, Këshilli i Evropës, 2011, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008482e>, (e qasur më 21 shtator 2020).

¹³⁶ Neni 8 i Konventës së Stambollit bën thirrje për nënshkruesit që të alokojnë burimet e duhura financiare dhe njerëzore për zbatimin adekuat të politikave, masave dhe programeve të integruara për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa, përfshirë ato të udhëhequra nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile.

Këshilli i Evropës, *The Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence (Konventa e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave)*, Stamboll, Këshilli i Evropës, 2011.

¹³⁷ N. Farnsworth et al., *Where's the Money for Women's Rights? Funding Trends in the Western Balkans (Ku janë Parat për të Drejtat e Grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020.

¹³⁸ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, *Judgment in the application of the President of the Assembly of the Republic of Kosovo (Aktgjykimi në kërkesën e Presidentit të Kuvendit të Republikës së Kosovës)* (2009), Rasti Nr. K0162/18, Prishtina, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës 2019, https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/ko_162_18_agj_ang.pdf, (e qasur më 9 maj 2020).

Incidentet e ndërlydhura me DhBGj/DhF në të gjithë rajonin janë rritur ndjeshëm që nga fillimi i pandemisë COVID – 19. Kjo ka çuar në një numër në rritje të rasteve të raportuara, si dhe në një rritje drastike të thirrjeve drejt linjave të nxehta të drejtuara nga organizatat e shoqërisë civile të grave (OSHC).¹³⁹ Ndërkohë, bllokimet

dhe masat e marra nga qeveritë e kanë bërë të vështirë për viktimat/të mbijetuarat të raportojnë rastet e tyre të DhBGj/DhF dhe të marrin mbrojtje të përshtatshme dhe shërbime të tjera. Pasojat e plota të pandemisë në lidhje me DhBGj mbeten për t'u parë.

NUMRI I STREHIMOREVE FUNKSIONALE DHE LINJAT E NDIHMËS SOS

Dispozitat e Konventës së Stambollit, të specifikuara në Nenin 23 dhe Nenin 24, u kërkojnë shteteve të ndërmarrin masat e nevojshme legjislative dhe praktike për të siguruar strehim të sigurt dhe të mjaftueshëm, që përfshin krijimin e strehimoreve të përshtatshme, sigurimin e mbështetjes së shtetit dhe krijimin dhe mirëmbajtjen e linjave të ndihmës të qasshme për viktimat/të mbijetuarat e DhBGj. Ky seksion ofron informata për shkallën në të cilën shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë përbushur

detyrimet e tyre në lidhje me disponueshmërinë e strehimoreve dhe linjave të ndihmës si masa thelbësore për adresimin e DhBGj. Në këtë seksion vlerësohet edhe progresi i tyre krahasuar me vitet e mëparshme.

Të dhënat tregojnë se numri i strehimoreve dhe linjave telefonike të ndihmës në nivel nacional nuk kanë ndryshuar dukshëm gjatë kësaj periudhe raportuese.

SHQIPËRIA

Ekzistojnë nëntë strehimore për gratë që veprojnë në Shqipëri, katër prej të cilave u dedikohen viktimave/të mbijetuarave të trafikimit njerëzor dhe pesë atyre të DhF.¹⁴⁰ Dy strehimore drejtohen nga qeveria dhe shtatë menaxhohen nga OSHC-të e grave.¹⁴¹ Vetëm tre strehimore janë strehimore afatgjata ose ri-integruese.¹⁴² Financimi i strehimoreve të OSHC-ve të grave është përmirësuar pak gjatë viteve të fundit, megjithëse ato ende përballen me sfida në lidhje me financimin joadekuat.¹⁴³

Shumica e strehimoreve gjinden në qytetet kryesore, duke e bërë kështu të vështirë qasjen për viktimat/të mbijetuarat nga zonat e largëta ose rurale.¹⁴⁴ Qasja e viktimave/të mbijetuarave në shërbimet e

strehimores pengohet më tej nga fakti se atyre u kërkohej të paraqesin një kopje të noterizuar të urdhrave të tyre të mbrojtjes, referimet nga policia, punonjësit socialë ose raportet mjekësore për t'u pranuar.¹⁴⁵ Në mungesë të strehimoreve emergjente, komunat shpesh përdorin ambiente që nuk janë të pajisura për t'u marrë me rastet e DhF, të tilla si spitale, qendra të kujdesit ndaj të moshuarve, konvikte etj.¹⁴⁶ Kjo është një çështje e vazhdueshme që ende nuk është adresuar nga shteti. Qendra Kombëtare e Krizave për viktimat e dhunës seksuale "Lilium" e krijuar nga qeveria shqiptare në fund të vitit 2018 mbetet kryesisht e panjohur për viktimat/të mbijetuarat. Një raport hulumtimi tregoi se vetëm 28% e të anketuarve të intervistuar që punojnë në

¹³⁹ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Serbi

¹⁴⁰ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, *Survey on Well-Being and Safety of Women in Albania (Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Shqipëri)*, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/434849?download=true>, (e qasur më 21 maj 2020), fq. 15.

¹⁴¹ Po aty.

¹⁴² Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Shqipëri.

¹⁴³ L. Gačanica et al, *Women's Rights in Western Balkans (Tw Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, <https://kinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2019/11/Womens-rights-in-Western-Balkans.pdf>, (e qasur më 19 qershor 2020), fq. 40.

¹⁴⁴ M. Llubani, *Mapping of Policies and Legislation on Violence Against Women and the Istanbul Convention in Albania (Hartëzimi i Politikave dhe Legjislacionit mbi Dhunën ndaj Grave dhe Konventa e Stambollit në Shqipëri)*, Lobi Evropian i Grave, 2019, https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-albania_report_web.pdf, (e qasur më 21 maj 2020), fq. 11.

¹⁴⁵ *Avokuesit për të Drejtat e Njeriut & Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, Stakeholders Report for the United Nations Universal Periodical Review (Raporti i Palëve me Interes për Rishikimin Periodik Universal të Kombeve të Bashkuara)*, Minneapolis, Avokuesit për të Drejtat e Njeriut & Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, 2019, https://www.theadvocatesforhumanrights.org/uploads/albania_report.pdf, (e qasur më 21 maj 2020), fq. 7.

¹⁴⁶ M. Llubani, *Mapping of Policies and Legislation on Violence Against Women and the Istanbul Convention in Albania (Hartëzimi i Politikave dhe Legjislacionit mbi Dhunën ndaj Grave dhe Konventa e Stambollit në Shqipëri)*, Lobi Evropian i Grave, 2019, fq. 11.

fushën e DhBGj (përfshirë por pa u kufizuar në: polici, punonjës sociale, OShC të grave, spitale) ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e qendrës.¹⁴⁷ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSMP) pret që spitalet lokale dhe profesionistët shëndetësorë të shërbejnë si bashkëpunëtorë në raportimin e rasteve të dhunës seksuale në polici.¹⁴⁸ Duke qenë se "Lilium" shërben si një qendër e menjëhershme e mbështetjes dhe referimit, ndihma afatgjatë për viktimat/të mbijetuarat që u drejtohen atyre për shërbime zakonisht ofrohet përmes strehimore të tjera të DhF-së.

Shqipëria ka një linjë të ndihmës kombëtare që ofron shërbime falas 24-orëshe, e cila drejtohet nga një OShC me mbështetje të kufizuar nga qeveria.¹⁴⁹ Linjat lokale të ndihmës të drejtuara nga OShC-të veprojnë gjatë orëve të ditës me tarifa të rregullta të operatorit telefonik.¹⁵⁰ Kjo paraqet pengesën kryesore për viktimat/të mbijetuarat në zonat rurale ose jashtë qendrave të qytetit, ose atyre që kanë të ardhura të ulëta dhe nuk janë në gjendje të lënë mënjane fonde të mjaftueshme (pa u vërejtur në buxhetin e familjes) për të mbuluar kostot e komunikimit me linjat e ndihmës lokale. Të gjitha shërbimet e linjës së ndihmës janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe jo në gjuhët e pakicave.

BOSNJA AND HERCEGOVINA

Ekzistojnë tetë strehimore/shtëpi të sigurt të OShC-ve të grave për gratë e Bosnjës dhe Hercegovinës (BeH): pesë në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (FBeH), të vendosura në Sarajevë, Zenicë, Tuzell, Bihac dhe Mostar. Në Republikën Serbe ka tre gjithsej, të vendosura në Banja Lukë, Modriq, Bijeljina.¹⁵¹ Ato ofrojnë 174 shtretër nga 353 siç kërkohet me standardet e Konventës së Stambollit, bazuar në popullsinë e BeH sipas të dhënave të fundit të regjistrimit civil. Kapacitetet e kufizuara të strehimoreve nganjëherë çojnë në shërbime joadekuata të mbrojtjes për viktimat/të mbijetuarat e DhF-së, dhe qasja është veçanërisht e vështirë për gratë migrante/refugjate, gratë nga grupet etnike të pakicave dhe gratë me aftësi të ndryshme.¹⁵²

Financimi i strehimoreve rregullohet nga legjislacionin për mbrojtjen nga DhF në nivel të njëjësive, megjithëse në FBeH kjo duhet të plotësohet me legjislacionin sekondar adekuat për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit.¹⁵³ Sipas ligjit, qeverive të FBeH dhe Republika Srpska u kërkohet të financojnë

70 të kostove operacionale të shtëpive të sigurt, ndërsa pjesa tjetër e 30% e kostove duhet të sigurohet nga kantoni/komuna e viktimës/mbijetuarit.¹⁵⁴ Ekzistojnë praktika të ndryshme sa i përket mbështetjes nga buxheti publik për kostot operacionale të strehimoreve në Republika Srpska dhe FBeH. Kjo bën që OShC-të e grave të mbeten të varura nga donatorët ndërkombëtarë në mënyrë që të ofrojnë shërbime të specializuara dhe ndihmë për gratë viktimat/mbijetuarat të DhBGj.

Vështirësitë e financimit ndikojnë në strehimoret, ndonjëherë duke rezultuar në mbështetje të pamjaftueshme psikologjike dhe ekonomike për viktimat/të mbijetuarat. Grupet individuale të këshillimit dhe mbështetjes mbeten të kufizuara në disa, por jo në të gjitha strehimoret.¹⁵⁵ Shërbimet e specializuara të kërkuara sipas Konventës së Stambollit për viktimat/të mbijetuarat e dhunës seksuale mungojnë, pasi nuk ka qendra krizash dhe këshillimi në vend posaçërisht për viktimat/të mbijetuarat e përdhunimit dhe dhunës seksuale.¹⁵⁶

¹⁴⁷ Rrjeti Evropian i Grave Kundër Dhunës, *Mapping of Sexual Violence Services in the Western Balkans and Turkey (Hartëzimi i Shërbimeve lidhur me Dhunën Seksuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi)*, Vjenë, Rrjeti Evropian i Grave Kundër Dhunës, 2019, https://cssplatform.org/wp-content/uploads/2019/10/CSSPWAVE_SVReport190927_web.pdf, (e qasur më 4 gusht 2020), fq. 7.

¹⁴⁸ Po aty.

¹⁴⁹ Avokuesit për të Drejtat e Njeriut & Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, *Stakeholders Report for the United Nations Universal Periodical Review (Raporti i Palëve me Interes për Rishikimin Periodik Universal të Kombeve të Bashkuara)*, Minneapolis, Avokuesit për të Drejtat e Njeriut & Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, 2019, fq. 7.

¹⁵⁰ OSBE, *Survey on Well-Being and Safety of Women in Albania (Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Shqipëri)*, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE, 2019, fq. 15.

¹⁵¹ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

¹⁵² OSCE, *Survey on Well-Being and Safety of Women in Bosnia and Herzegovina (Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Bosnjë dhe Hercegovinë)*, OSCE, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/423470?download=true> (e qasur më 23 maj 2020).

¹⁵³ Po aty.

¹⁵⁴ Po aty.

¹⁵⁵ Po aty.

¹⁵⁶ OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Bosnjë e Hercegovinë*, OSBE, 2019, fq. 15.

BeH ka dy linja ndihmëse SOS për viktimat/të mbijetuarat e dhunës, njëra që vepron në FBeH dhe tjetra në Republika Srpska. Linjat e ndihmës në të dy entitetet menaxhohen nga strehimoret, ndërsa mirëmbajtja e tyre sigurohet nga qendrat gjinore të nivelit të njësive.¹⁵⁷ Linjat e ndihmës janë falas dhe funksionojnë 24 orë, shtatë ditë në javë.¹⁵⁸ Sidoqoftë, vetëdija e grave për ekzistencën e linjave të ndihmës SOS mbetet e ulët. Të dhënat nga një sondazh i Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në

Evropë (OSBE) të kryer gjatë periudhës raportuese tregojnë se vetëm 56% e grave në FBeH dhe 49% e grave në Republika Srpska kanë dëgjuar për linjat e ndihmës në entitetet e tyre përkatëse, megjithatë, ata nuk ishin të sigurt nëse shërbimet ishin falas, gjë që i dekurajoi ata që të qasen.¹⁵⁹ Mungesa e qasjes në informata në lidhje me linjat e ndihmës në dispozicion mbetet një pengesë për viktimat/të mbijetuarat që kanë nevojë për ato shërbime.

KOSOVA

Aktualisht në Kosovë ka nëntë strehimore për viktimat/të mbijetuarat e DhF, një për fëmijë dhe një për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit njerëzor.¹⁶⁰ Të gjitha menaxhohen nga OShC-të me fonde të pjesshme nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe herë pas here nga komunat e tyre përkatëse. Strehimoret për DhF janë të vendosura në Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë të Jugut dhe Novobërdë, me një qendër të re që është hapur në Kosovën Veriore.¹⁶¹ Shteti gjithashtu drejton një Lehtësi të Përkohshme të Sigurisë për personat që janë trafikuar. Një strehë e përkohshme karantine e drejtuar nga qeveria u krijua nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë gjatë mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19.¹⁶² Ajo u përdor për të strehuar viktimat/të mbijetuarat e DhF para se ato të pranoheshin në strehimoret ekzistuese, për të siguruar që nuk kishte përhapje të virusit COVID-19 midis stafit dhe banorëve.¹⁶³

Strehimoret e DhF ofrojnë strehim deri në gjashtë muaj, por kjo mund të zgjatet në marrëveshje me MPMS. Strehimoret ndihmojnë viktimat/të mbijetuarat në procesin e rimëkëmbjes dhe riintegritetit të tyre. Personeli është i licencuar nga MPMS dhe megjithëse ata ofrojnë shërbime të afta për viktimat/të mbijetuarat, ata fitojnë vetëm një pagë minimale.

Duke qenë të varura nga fondet institucionale, OShC-të e grave që operojnë me strehimoret përballen me përpjekje të vazhdueshme financimi, ndonjëherë duke rrezikuar mbylljen e plotë.¹⁶⁴ Në vitin 2019, strehimoret u përballën me një krizë serioze financimi për shkak të mungesës së një linje buxhetore specifike të MPMS-së kushtuar strehimoreve, si dhe vonesave të vazhdueshme të financimit. Të nxitur nga avokimi i OShC-ve të grave, dhe nën udhëheqjen e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), Parlamenti i Kosovës siguroi fonde për strehimoret e viktimave të DhF përmes një ndryshimi të veçantë në Ligjin e Buxhetit 2019. Megjithatë, strehimoret nuk morën ndonjë mbështetje në muajin e parë të vitit. MPMS lëshoi një thirrje të vonuar për financim për vitin 2020, duke shkaktuar kështu një boshllëk tjetër financimi për strehimoret.¹⁶⁵ Boshllëqet e financimit, dhe si rrjedhojë ato operacionale, si në këtë ashtu edhe në periudhën e mëparshme të raportimit janë jashtëzakonisht shqetësuese dhe kanë ndikime masive në viktimat/të mbijetuarat e DhBGJ. Gjatë vitit 2019, Institucioni i Ombudspersonit raportoi se 111 gra viktimat/mbijetuarat të DhBGJ/DhF¹⁶⁶ ishin strehuar në strehimoren e Prishtinës, 105 raste në strehimoren në Gjakovë dhe 47 raste në strehimoren në Ferizaj.¹⁶⁷ Midis janarit dhe korrikut 2020, OShC-të e grave raportuan gjithsej 218 gra dhe fëmijë të strehuar në strehimore në Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë, Mitrovicë.

¹⁵⁷ Po aty.

¹⁵⁸ Halilović, M., *Analysis of the Cost of Domestic Violence: Estimating the Cost of Multi-Sectoral Response at the Local Level in Bosnia and Herzegovina (Analiza e Kostos së Dhunës në Familje: Vlerësimi i Kostos së Reagimit Multisektorial në Nivelin Lokal në Bosnjë e Hercegovinë)*, Sarajevë, UN Women, 2019, <https://tinyurl.com/y2ycs6nw>, (e qasur më 23 shtator 2020), fq. 53.

¹⁵⁹ OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Bosnjë e Hercegovinë*, OSBE, 2019, fq. 55.

¹⁶⁰ Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, Informatë Publike - Thirrja e Viktimave të Dhunës në Familje për të Raportuar Rastet e tyre dhe Sigurimi i Kontaktëve të Strehimoreve dhe Policisë [faqja në internet], <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2208>, (e qasur më 12 maj 2020).

¹⁶¹ Strehimorja është kryesisht për personat e komunitetit serb. Ajo drejtohet nga shteti përmes një bashkëpunimi midis tre komunave.

¹⁶² UN Women pwr Evropë dhe Azi Qëndrore, 'Temporary Shelters set up to Quarantine Safely Domestic Violence Survivors in Kosovo' ('Strehimoret e Përkohshme të Themeluara për të Karantinuar në Mënyrë të Sigurt Të Mbijetuarit e Dhunës në Familje në Kosovë'), *UN Women për Evropë dhe Azi Qëndrore*, 2020, <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2020/5/temporary-shelters-set-up-to-quarantine-safely-domestic-violence-survivors>, (e qasur më 12 maj 2020).

¹⁶³ E. Travers, 'Reports of Domestic Violence Increase in 2020' ('Raportet e Dhunës në Familje Rriten në 2020'), *Prishtina Insight*, 13 maj 2020, <https://prishtinainsight.com/reports-of-domestic-violence-increase-in-2020/>, (e qasur më 4 gusht 2020).

¹⁶⁴ Rrjeti i Grave të Kosovës, 'Letër shqetësuese nga Strehimoret e Kosovës për Koordinatorin Nacional', Prishtina, Rrjeti i Grave të Kosovës, 2019, <https://womensnetwork.org/sq/leter-shqetesuese-nga-strehimoret-e-kosoves-per-koordinatorin-nacional/>, (e qasur më 12 maj 2020).

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶ Institucioni i Ombudspersonit në Republikën e Kosovës, *Raporti Vjetor 2019*, Prishtinë, Institucioni i Ombudspersonit në Republikën e Kosovës, 2020, <https://www.oik-rks.org/2020/04/02/raporti-vjetor-2019/>, (e qasur më 9 maj 2020).

¹⁶⁷ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Kosovë.

Korniza ligjore ekzistuese nuk i ngarkon institucionet me përgjegjësi adekuate në lidhje me strehimoret për DhF. Detyrimi ndaj shërbimeve sociale shpërndahet ndërmjet komunave dhe MPMS-së.¹⁶⁸ Administrimi i shërbimeve sociale përcaktohet si përgjegjësi e vetme e autoriteteve komunale,¹⁶⁹ ndërsa përgjegjësia për krijimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të tilla i mbetet Ministrisë.¹⁷⁰ Në këtë përbërje, kontraktimi i shërbimeve të strehimit për viktimat/të mbijetuarat e DhF të ofruara përmes OShC-ve të licencuara të grave dëmtohet nga fondet e kufizuara.¹⁷¹ Për më tepër, financimit i qëndrueshëm i tyre afektohet nga nën-financimi dhe administrimi i papërshtatshëm i fondeve nga Ministria. Mbikëqyrja e duhur nga Departamenti i Mirëqenies Sociale ka qenë e pamjaftueshme. Programet e riintegrit, strehimit social dhe opsioneve për sigurimin e pavarësisë ekonomike ende vazhdojnë të mungojnë.¹⁷² Sfidat e mëtejme të financimit janë elaboruar më vonë në këtë kapitull (shih: "Alokimi i fondeve për luftimin e dhunës me bazë gjinore").

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) 2016-2020 përcaktojnë përgjegjësinë për të ofruar shërbime mbrojtëse për grupet më të pafavorizuara. Megjithatë, kjo nuk është materializuar në praktikë. Megjithëse është përmendur si e nevojshme në Strategjinë Kombëtare, ende nuk ka strehim për personat e komunitetit LGBTQI + dhe ata dërgohen në Tiranë. Gratë nga grupet e ndryshme etnike, me aftësi, identitet gjinor dhe seksualitet të ndryshëm (p.sh. lezbike, biseksuale) përballen me sfida të qasjes në shërbimet e strehimores dhe shërbimet e tjera sociale.¹⁷³ Kjo nuk është në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit dhe kërkon

vëmendje të veçantë për të siguruar që shërbimet të jenë të arritshme në mënyrë të barabartë për të gjitha viktimat/të mbijetuarat.

Policia e Kosovës ka një linjë të përgjithshme 24-orëshe të policisë emergjente, e cila mund të përdoret për përgjigje të thirrjeve DhF; përgjigja duhet të sigurohet nga Njësitë e Trajnua për Hetimin e DhF të përbërë nga gra dhe burra. Në praktikë, megjithatë, zyrtarë të tjerë me trajnim, njohuri dhe kualifikime më pak të përshtatshme thuhet se mund t'u përgjigjen thirrjeve për shkak të orarit të punës dhe mungesës së personelit. Si e tillë, procedurat e raportimit mund të jenë të pasigurta, të vonuara dhe të mos merren seriozisht, pasi hulumtimet tregojnë se Zyrtarët e Policisë nuk i kanë me prioritet rastet e DhBGj, duke penguar kështu qasjen e grave në drejtësi.¹⁷⁴ Zyra për Ndihmë dhe Avokim të Viktimave (ZNAV) menaxhon një linjë të ndihmës 24-orëshe falas për viktimat e DhBGj/ DhF duke siguruar informata mbi shërbimet dhe mekanizmat përkatës ekzistues.¹⁷⁵ Sidoqoftë, Avokatët e Viktimave nga ZNAV tani gjithashtu duhet t'u përgjigjen edhe rasteve të tjera, të cilat mund të rëndojnë burimet e tyre të kufizuara njerëzore. Megjithëse ZNAV ka ekspertizën e duhur për t'iu përgjigjur rasteve të DhBGj/DhF, atyre u mungojnë burimet njerëzore të nevojshme për të mbuluar të gjithë vendin. Shërbimet në gjuhën serbe, rome, turke dhe boshnjake janë kryesisht të padisponueshme për shkak të deficitit me burime njerëzore dhe mungesë të personelit që flet në gjuhën amtare ose rrjedhshëm.¹⁷⁶ Strehimoret gjithashtu ofrojnë shërbime të mbështetjes telefonike, dhe shumica prej tyre ofrojnë shërbime në gjuhën shqipe dhe serbe.

¹⁶⁸ OSBE, Misioni në Kosovë, *Shelters for the Victims of Domestic Violence in Kosovo (Strehimoret për Viktimat e Dhunës në Familje në Kosovë)*, Prishtinë, OSBE, 2019, https://www.osce.org/files/Report%20on%20Shelters%20for%20victims%20of%20domestic%20violence%20in%20Kosovo_eng.pdf, (e qasur më 23 shtator 2020), fq. 7.

¹⁶⁹ Ligji Nr. 03/L- 040 për Vetë-Qeverisjen Lokale, Neni 17(1), 2008, Republika e Kosovës.

¹⁷⁰ Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Neni 3(3), 2001, Republika e Kosovës.

¹⁷¹ OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë*, OSBE, 2019, <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/439781?download=true>, (e qasur më 12 maj 2020), fq. 28.

¹⁷² Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Kosovë.

¹⁷³ Po aty., p. 10.

¹⁷⁴ Rrjeti i Grave të Kosovës, *Kosovo Gender Analysis (Analiza Gjinore e Kosovës)*, Rrjeti i Grave të Kosovës, 2018, <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>, (e qasur më 10 shtator 2020), fq. 1.

¹⁷⁵ Po aty., fq. 27.

¹⁷⁶ S. Gavric, *Mapping of Policies and Legislation on Violence Against Women and the Istanbul Convention in Kosovo (Hartëzimi i Politikave dhe Legjislacionit mbi Dhunën ndaj Grave dhe Konventa e Stambollit në Kosovë)*, Lobi Evropian i Grave 2019, https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-kosovo_report_web.pdf, (e qasur më 13 maj 2020), fq. 11.

MALI I ZI

Mali i Zi ka gjashtë strehimore të udhëhequra nga OShC-të nga të cilat katër janë për viktimat/ të mbijetuarat e DhF, një për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit dhe një për and viktimat/të mbijetuarat e dhunës nga komuniteti LGBTQI+. ¹⁷⁷ Mali i Zi ende nuk i ka përmbushur kërkesat për strehim sipas Konventës së Stambollit. Strehimoret kanë financim të kufizuar publik dhe janë kryesisht të varura nga donatorët ndërkombëtarë. Ato janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në tërë vendin, kryesisht afër qyteteve kryesore, duke lënë kështu një pjesë të konsiderueshme të vendit pa qasje në strehimore. Kjo e vështirëson për viktimat/të mbijetuarat që të kenë qasje në shërbime duke qenë larg shtëpive të tyre. Qasja në strehimore dhe shërbime përcjellëse mbetet një problem për gratë e pakicave të ndryshme etnike sidomos gratë rome, dhe viktimat/të mbijetuarat me aftësi të ndryshme. ¹⁷⁸

Kapacitetet e kufizuara të strehimoreve ekzistuese poashtu reflektojnë në cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të tyre për viktimat/të mbijetuarat. Shumica e OShC-ve të grave që administrojnë me strehimoret ofrojnë ndihmë juridike, mjekësore dhe këshillim psikosocial për viktimat/të mbijetuarat. ¹⁷⁹ Megjithatë, që gratë të jenë të afta të jetojnë jetët e tyre të pavarura nga kryerësit e krimit, të cilët në shumicën e rasteve janë partnerët e tyre, atyre ju nevojitet strehim afatgjatë dhe përkrahje në punësim. ¹⁸⁰ OShC-të e grave kanë nevojë për më tepër financim në mënyrë që të implementojnë këto

shërbime shtesë, por financimi nga institucionet e vendit është jashtëzakonisht i kufizuar (shih nën-indikatorin "Alokimi i Fondeve për Luftimin e Dhunës me Bazë Gjinore" në këtë raport). OSh-të e grave kanë shprehur shqetësimet e tyre edhe mbi licensimin dhe kufizime tjera me të cilat përballen OShC-të që ofrojnë shërbime të specializuara. ¹⁸¹

Mali i Zi nuk ka shënuar ndonjë progres drejt implementimit të Nenit 25 të Konventës së Stambollit ku kërkohet ofrimi i shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e përdhunimit dhe sulmeve seksuale. Qendrat e Krizës ose të referimit të përdhunimit dhe dhunës seksuale janë ende të padisponueshme. Gratë kanë raportuar një ndërgjegjësim të kufizuar dhe njohuri të pakta mbi strehimoret ekzistuese dhe shërbimet e tyre dhe kjo është një fakt shqetësues. Kjo është më theksuar në mesin e grave nga zonat rurale, grave të moshuara, dhe grave të papunësuar. ¹⁸²

Ka një linjë të ndihmës në nivel kombëtar në Nikšić e cila drejtohet nga një OShC e grave dhe është pjesërisht e financuar nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale dhe donatorët ndërkombëtarë. E njëjta ofron shërbime 24-orëshe falas në gjuhën malazeze, shqipe dhe angleze. ¹⁸³ Përveç linjës kombëtare të ndihmës në Mal të Zi ekzistojnë edhe pesë linja tjera të ndihmës në nivel lokal që ofrojnë përkrahje për viktimat/të mbijetuarat e DhF dhe udhëhiqen nga OShC-të e grave. ¹⁸⁴

¹⁷⁷ OOSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Mal të Zi*, OSBE, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/424985?download=true>, (e qasur më 12 maj 2020), fq. 16.

¹⁷⁸ Po aty.

¹⁷⁹ Po aty.

¹⁸⁰ Po aty.

¹⁸¹ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Mal të Zi.

¹⁸² OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Mal të Zi*, OSBE, 2019, fq. 16.

¹⁸³ Po aty.

¹⁸⁴ Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje (GREVIO), GREVIO's (Baseline) Evaluation Report on Legislative and other Measures Giving Effect to the Provisions of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention) [Raporti i Vlerësimit të GREVIO-s (Fillestar) mbi Masat Legjislative dhe të Tjera që i japin fuqi Dispozitive të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)]: *Mali i Zi*, Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në (GREVIO), 2018, <https://rm.coe.int/grevio-report-montenegro/16808e5614UNDP>, (e qasur më 23 shtatorë 2020), fq. 36.

MAQEDONIA VERIORE

Duke filluar nga dhjetori 2019, Maqedonia Veriore ka rritur numrin e shërbimeve të specializuara për viktimat/të mbijetuarat e DhBGj/DhF në 11: tetë strehimore dhe tre qendra të krizave. Nga gjithsej 11, tre udhëheqen nga OShC-të e grave dhe pjesa tjetër nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale (MPPS) përmes Qendrave të Mirëqenies Sociale. Megjithatë, rritja e numrit të shërbimeve nuk është shoqëruar me rritjen e qëndrueshmërisë së tyre financiare, prandaj kapacitetet e tyre të kufizuara nuk përmbushin nevojat e viktimave/të mbijetuarave të DhBGj/DhF. OShC-të e grave kanë shprehur shqetësimet e tyre mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara nga strehimoret dhe qendrat e krizave që drejtohen nga shteti, duke shprehur dyshime mbi kualifikimet dhe njohuritë e personelit të angazhuar për të ofruar përkrahje adekuate për viktimat/të mbijetuarat.¹⁸⁵

Sic është e zakonshme në nivelin rajonal, shumica e strehimoreve janë të vendosura në disa nga qytetet më të mëdha duke mos qenë të arritshme për gratë nga zonat e thella.¹⁸⁶ Në vijim, ndërgjegjësimi i grave mbi ekzistencën e shërbimeve të përkrahjes mbetet i kufizuar; një sondazh i fundit nga OSBE tregon se gratë nga zonat rurale janë të bindura se nuk ka shërbim të përkrahjes për to, derisa ato nga zonat urbane megjithëse kanë njohuri për strehimoret, një numër i tyre besojnë se kjo është një përkrahje afatshkurte dhe vetëm me qëndrim ditor.¹⁸⁷ Të anketuarit poashtu kanë shprehur dyshime mbi sigurinë e viktimave/të mbijetuarave duke marrë parasysh se vendndodhja e strehimoreve është një informatë publike.¹⁸⁸

Ekzistojnë tre qendra referimit për viktimat e përdhunimit dhe dhunës seksuale në kuadër të klinikave gjinekologjike-obstretike në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë, të cilat drejtohen nga Ministria e Shëndetësisë.¹⁸⁹ Këto ofrojnë kujdes mjekësor për viktimat/të mbijetuarat si dhe mbledhin prova forenzike me rastin e raportimit në polici. Raportimi vullnetar i rasteve nga ana e viktimave/të mbijetuarave është rezultat i mospërputhjes së midis procedurave standarde të operimit të qendrave të referimit dhe protokoleve e brendshme të policisë dhe të procedurës penale.¹⁹⁰ Numri i grave që kanë vizituar qendrat që nga themelimi i tyre në 2018 mbetet shumë i ulët, dhe pasqyron mungesën e njohurive rreth shërbimeve që ato ofrojnë. Kjo është mjaft shqetësuese, pasi që DhBGj vazhdon të jetë problem në të gjithë vendin, derisa viktimat/të mbijetuarat nuk janë të njohur me opsionet e tyre.

Maqedonia Veriore ka tre linja kombëtare të ndihmës SOS që ofrojnë shërbime falas për viktimat/të mbijetuarat e DhF. Përvec kësaj, ka edhe një linjë të vecantë të ndihmës të destinuar për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit njerëzor. Linjat e ndihmës drejtohen nga OShC-të e grave, edhe pse sic është vënë në dukje edhe në botimin e mëparshëm të këtij raporti, mbetet e panjohur nëse ato janë duke punuar me kapacitet të plotë. Edhe për këtë periudhë të raportimit hulumtuesit e patën të pamundur të sigurojnë konfirmim rreth kapacitetit të tyre. Një linjë e ndihmës ofron shërbime të kufizuara në gjuhën shqipe, gjersa nuk ekziston ndonjë shërbim i linjave të ndihmës në gjuhët tjera minoritare, si psh në atë rome apo turke. Shërbimet nuk janë tërësisht të sensibilizuara ndaj apo të arritshme për viktimat/të mbijetuarat me aftësi të ndryshme.¹⁹¹

¹⁸⁵ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Maqedoninë Veriore.

¹⁸⁶ OSBE, *Survey on Well-Being and Safety of Women in North Macedonia (Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Maqedoni Veriore)*, OSBE, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/419264?download=true>, (e qasur më 27 maj 2020).

¹⁸⁷ Po aty.

¹⁸⁸ Po aty., fq. 67.

¹⁸⁹ Rrjeti Evropian i Grave Kundër Dhunës, *Mapping of Sexual Violence Services in the Western Balkans and Turkey (Hartëzimi i Shërbimeve lidhur me Dhunën Seksuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi)*, Vjenë, Rrjeti Evropian i Grave Kundër Dhunës, 2019.

¹⁹⁰ Po aty.

¹⁹¹ OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Maqedoni Veriore*, OSBE, 2019, fq. 15.

SERBIA

Ka pesëmbëdhjetë strehimore në Serbi, nga të cilat nëntë janë të destinuara për gra dhe fëmijë viktimat/të mbijetuar të DhF dhe tre për viktimat/të mbijetuar të trafikimit njerëzor, duke përfshirë një strehimore shtetërore të hapur së fundmi.¹⁹² Strehimoret drejtohen nga Qendrat për Mirëqenie Sociale dhe financohen nga fonde shtetërore, ose nga OShC-të e grave me fonde të siguruar nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Megjithatë kishte rritje të numrit të strehimoreve nga viti i kaluar, ky numër mbetet i joadekuat krahasuar me nevojat në nivelin kombëtar, sipas Konventës së Stambollit.

Shtrirja dhe cilësia e shërbimeve të ofruara në strehimoret e drejtuara nga Qendrat e Mirëqenies Sociale janë të kufizuara për shkak të deficiteve të financimit dhe numrit të ulët të personelit.¹⁹³ Si rezultat i këtyre mungesave, disa strehimore janë të detyruara të mbyllen me banorët e tyre gjatë natës, deri në fillim të ndërrimit të ardhshëm dhe ndryshimit të personelit.¹⁹⁴ Ky kufizim i mobilitetit të banorëve të strehimoreve është një shqetësim, dhe do të nevojitej rritje e fondeve dhe kapaciteteve të personelit për të siguruar ndërprerjen e kësaj praktike. Shërbimet mbështetëse të specializuara të ofruara nga shteti, siç përshkruhet në Konventën e Stambollit, janë pothuajse inekzistente. Në vend të kësaj, këto shërbime ofrohen nga OShC-të e grave.¹⁹⁵ Monitorimi i rregullt i shërbimit të ofruar nuk sigurohet për asnjë nga strehimoret.¹⁹⁶ Kjo është një pengesë shtesë për monitorimin adekuat të zbatimit të rregulloreve të Konventës së Stambollit. Të dhënat

e sondazhit nga kjo periudhë raportuese tregojnë se vetëm 3% e grave, që kishin vuajtur incidente serioze të dhunës fizike dhe/ose seksuale, kontaktuan një strehimore dhe nga ajo 3%, vetëm 1% kontaktuan një organizatë për mbështetjen e viktimave.¹⁹⁷ Kjo është kryesisht për shkak të ndjenjave të turpits dhe frikës ose mosbesimit ndaj ofruesve të shërbimeve.¹⁹⁸ Disponueshmëria e këtyre shërbimeve në zonat rurale është një pengesë tjetër.¹⁹⁹ Qasja në strehimore për gratë nga pakicat etnike²⁰⁰ dhe migrantët/refugjatët vazhdon të mbetet një problem në të gjithë vendin, ngjajshëm me periudhat e mëparshme të raportimit. OShC-të e grave kanë mbetur t'i adresojnë këto boshllëqe dhe ato janë përgjigjur duke ofruar strehimore ku është e nevojshme, të tilla si qendra për gratë refugjate, e drejtuar nga OShC Atina.

Strategjia Kombëtare e Strehimit Social (2021-2022) përcakton sigurimin e strehimit për viktimat/të mbijetuarat e DhF, megjithatë një numër i kufizuar i komunave mund të ofrojnë shërbime të tilla. Programi Kombëtar i Shërbimit të Punësimit ka ndihmuar vetëm disa gra të fitojnë pavarësi ekonomike nga partnerët e tyre abuzivë.²⁰¹ Shumë përmirësime janë ende të nevojshme për të siguruar numër më të madh të grave të ndihmuara nga këto shërbime. Nga ana tjetër, OShC-të e grave ofrojnë fuqizim socio-ekonomik për viktimat/të mbijetuarat e DhBGJ-së në një përpjekje për të adresuar mungesën e shërbimeve të tilla në nivel shtetëror.

¹⁹² Komiteti i KB për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Serbia (Vërejtjet Përfundimtare mbi Raportin e Katërt Periodik të Serbisë)*, Komiteti i KB për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, 2019, <https://undocs.org/en/CEDA/C/SRB/CO/4>, (e qasur më 16 maj 2020), fq. 9.

¹⁹³ GREVIO, [Raporti i Vlerësimit të GREVIO-s (Fillestar) mbi Masat Legjislative dhe të Tjera që i japin fuqi Dispozitive të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)]: *Serbi*, GREVIO, 2020, <https://rm.coe.int/grevio-report-on-serbia/16809987e3>, (e qasur më 17 maj 2020).

¹⁹⁴ Po aty., fq. 34.

¹⁹⁵ Po aty., fq. 33.

¹⁹⁶ M. Petronijević, *Mapping of Policies and Legislation on Violence against Women and the Istanbul Convention in Serbia (Hartëzimi i Politikave dhe Legjislacionit mbi Dhunën ndaj Grave dhe Konventa e Stambollit në Serbi)*, Lobi Evropian i Grave, 2019, https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-serbia_report_web.pdf, (e qasur më 17 prill 2020), fq. 11.

¹⁹⁷ OSBE, *Well-being and Safety of Women – Serbi (Mirëqenia dhe Siguria e Grave – Serbi)*, OSBE, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/419750?download=true>, (e qasur më 17 maj 2020).

¹⁹⁸ Po aty.

¹⁹⁹ Po aty.

²⁰⁰ GREVIO, [Raporti i Vlerësimit të GREVIO-s (Fillestar) mbi Masat Legjislative dhe të Tjera që i japin fuqi Dispozitive të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)]: *Serbi*, GREVIO, 2020, fq. 31.

²⁰¹ Po aty., fq. 15, 31.

Linja telefonike kombëtare për gratë viktime të dhunës u krijua si pjesë e Qendrës për Mbrojtjen e Foshnjave, Fëmijëve dhe të Rinjve në vitin 2019. Institucionit i mungon përvoja për të ofruar shërbime të tilla, me një staf të trajnuar vetëm disa ditë para se të kishin filluar punën.²⁰² Në edicionin e katërt të raportit të *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor*, dhe siç raportohet nga rrjeti kombëtar Gratë Kundër Dhunës, procesi i prokurimit për këtë linjë kombëtare të ndihmës SOS ishte problematik, si dhe mungesa e trajnimit për stafin që u punësuan për të punuar në linjat e ndihmës. Në këtë periudhë raportimi, mund të konfirmohet se Linja Telefonike Kombëtare për Gratë Viktime të Dhunës ofron vetëm shërbime referimi. OShC-të e grave adresojnë këtë boshllëk në ofrimin e shërbimeve, duke ofruar këshillim të mirëfilltë, ndër format e tjera të shërbimeve të specializuara. Për më tepër, është problematike që referimet e linjës kombëtare të ndihmës përfshijnë kryesisht Qendrën për Mirëqenie Sociale dhe agjencitë e zbatimit të ligjit dhe shumë rrallë përfshijnë OShC-të e grave, të cilat po ofrojnë shërbime të specializuara të nevojshme dhe të kërkuara nga viktimat/të mbijetuarat.²⁰³

Njëzet e dy OShC të grave në Serbi drejtojnë linjat e ndihmës SOS për gratë të mbijetuara të dhunës, nga të cilat dy janë për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit njerëzor dhe katër janë për gratë me aftësi të ndryshme.²⁰⁴ Tri nga linjat e ndihmës të drejtuara nga OSHC-të janë të disponueshme në gjuhët e pakicave etnike,²⁰⁵ OShC e grave ASTRA ka raportuar se që nga fillimi i vitit 2020, numri i thirrjeve në linjën SOS të ASTRA-s nga viktimat/të mbijetuarat e trafikimit njerëzor është rritur deri në 71%.²⁰⁶ Kjo rritje është një arsye për shqetësim, dhe megjithëse ka shumë të ngjarë të jetë rezultat i masave të izolimit COVID-19,

ajo megjithatë nënkupton që ka një rritje të njerëzve që përjetojnë shkelje të të drejtave të njeriut, të ndërlidhura me pandeminë dhe masat aktuale.

OShC-të e grave ngritën shqetësime për shkeljen e të drejtave të viktimave/të mbijetuarave për sa i përket mbrojtjes së të dhënave nga linja kombëtare e ndihmës. Kjo ka çuar në paralajmërimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me shkeljen e të drejtave të viktimave/të mbijetuarave në linjën kombëtare të ndihmës ndërsa ata regjistrin thirrjet e viktimave pa i informuar ata paraprakisht ose pa marrë pëlqimin e tyre.²⁰⁷ Që atëherë, linja e ndihmës ka prezantuar një mesazh që njofton telefonuesit se thirrja e tyre do të regjistrohet.

Duke pasur parasysh mungesën e përgjithshme të bashkëpunimit shtetëror me OShC-të e grave,²⁰⁸ këto të fundit kundërshtuan linjën kombëtare të ndihmës, duke argumentuar se mungesa e profesionalizmit dhe burimeve në linjat e ndihmës pengojnë ofrimin e shërbimit të duhur me koston e mbrojtjes dhe sigurisë së viktimave/të mbijetuarave. Ata sugjerojnë që shteti duhet të mbështesë punën e OShC-ve të grave përmes alokimit të burimeve adekuate financiare, pasi që shumë OShC të grave në Serbi kanë ofruar këto shërbime për dekada dhe ekspertiza e tyre tejkalon atë të Qendrës për Mbrojtjen e Foshnjave, Fëmijëve dhe të Rinjve kur bëhet fjalë për shërbimet e linjës së ndihmës SOS.²⁰⁹ Për më tepër, nuk ka të dhëna të disponueshme për publikun për numrin e përgjithshëm të thirrjeve të pranhuara nga të gjitha linjat e ndihmës, edhe pse shumica e OShC-ve të grave botojnë të dhëna për linjat e tyre të ndihmës në raportet e tyre vjetore.²¹⁰

²⁰² Qendra Autonome e Grave, 'There was No Need to Create a New National SOS Helpline: The First Independent Report on the Activities of the Newly Formed National SOS Helpline for Women with Experience of Violence' (Nuk kishte Nevojë të Krijonim një Linjë e re Kombëtare të Ndihmës SOS: Raporti i Parë i Pavarur mbi Aktivitetet e Linjës Kombëtare të Ndihmës SOS për Gratë me Përvojë të Dhunës), *Qendra Autonome e Grave*, 2020, <https://www.womenngo.org.rs/en/news/1484-there-was-no-need-to-create-a-new-national-sos-helpline-the-first-independent-report-on-the-activities-of-the-newly-formed-national-sos-helpline-for-women-with-experience-of-violence>, (e qasur më 1 shtator 2020).

²⁰³ GREVIO, Raporti i Vlerësimit të GREVIO-s (Fillestar) mbi Masat Legjislative dhe të Tjera që i japin fuqi Dispozitive të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit): *Serbi*, GREVIO, 2020, fq. 31, 35-36.

²⁰⁴ OSBE, *Mirëqenia dhe Siguria e Grave – Serbi*, OSBE, 2019, fq. 15.

²⁰⁵ Qendra Autonome e Grave, 'Linja Kombëtare e Ndihmës SOS: Regjistrimi i Paaautorizuar!', *Qendra Autonome e Grave*, 2019, <https://www.womenngo.org.rs/en/news/1543-national-sos-helpline-unauthorized-recording>, (e qasur më 1 shtator 2020).

²⁰⁶ ASTRA – Veprimi Anti-Trafikim, *Human Trafficking Victims in Criminal Proceedings: Analysis of Judicial Practice for 2019 for the Crimes of Mediation in Prostitution, Trafficking in Human Beings and Trafficking in Minors for Adoption* (Viktimat e Trafikimit Njerëzor në Procedurat Penale: Analiza e Praktikës Gjyqësore për vitin 2019 për Krimet e Ndërmjetësimit në Prostitucion, Trafikim i Qenieve Njerëzore dhe Trafikim i të Miturve për Birësim), ASTRA – Veprimi Anti-Trafikim, 2020, <https://drive.google.com/file/d/1T8nMxvpcAObeVJB9Bc6MNPaz0GOY-tbb/view>, (e qasur më 1 shtator).

²⁰⁷ Po aty.

²⁰⁸ CEDAW, *Vërejtjet Përfundimtare mbi Raportin e Katërt Periodik të Serbisë*, CEDAW, 2019, fq. 5.

²⁰⁹ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Serbi.

²¹⁰ OSBE, *Mirëqenia dhe Siguria e Grave – Serbi*, OSBE, 2019, fq. 15.

Shkalla në të cilën shërbimet DHBGJ janë të ndjeshme ndaj nevojave të grave rome

Gratë rome në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor mbeten shumë të ekspozuara ndaj të gjitha formave të DhBGJ. Në të njëjtën kohë, dëshmitë e incidenteve të dhunës ndaj grave rome janë të pakta të kombinuara me shkallën e ulët të raportimit të tyre në institucione. Raportet e hulumtimit në të gjithë rajonin vërejnë se disa nga arsyet që gratë rome viktimë/mbijetuara nuk raportojnë rastet e tyre të dhunës është për shkak të mungesës së besimit në institucionet shtetërore. Ata mendojnë se profesionistët nuk do t'u besojnë përvojave të tyre, se nuk do të marrin ndihmë dhe mbështetje, dhe për këtë arsye ato rrezikojnë që dhuna të jetë edhe më e rëndë.²¹¹

Shumica e shërbimeve në Ballkanin Perëndimor nuk sensibilizohen as për gratë rome, as për nevojat e tyre specifike, siç kërkohet nga neni 4²¹² i Konventës së Stambollit. Dëshmitë tregojnë se gratë rome në rajon, së pari nuk janë të vetëdijshme për ekzistencën e shërbimeve të linjës së ndihmës²¹³, dhe së dyti, mendojnë se shërbimi i strehimit nuk është i destinuar për to, por për gratë nga popullata e përgjithshme (shumicë).²¹⁴ Rajoni shquhet për shpërndarje të pabarabartë të strehimoreve, të vendosura kryesisht pranë qyteteve më të mëdha, e cila përbën një pengesë për qasjen e grave rome në shërbime. Gratë rome që drejtohen drejt institucioneve dhe strehimoreve e kanë të vështirë të marrin të njëjtën mbështetje ose shërbime që janë

në dispozicion të viktimave/mbijetuarve të tjerë të DhF.²¹⁵ OShC-të e shumta raportojnë se disa profesionistë madje rezistojnë në ofrimin e shërbimeve për gratë rome.²¹⁶ Sidoqoftë, në rastet kur gratë rome shoqërohen nga përfaqësues të OShC-ve, ato priren të marrin mbështetje më të mirë. Ky trajtim i diferencuar mund të jetë një tregues i racizmit strukturor dhe paragjykimet që thuhet se dominon në strehimore dhe institucione të ndryshme.

OShC-të e grave rome ndajnë shqetësimet e tyre për qasjen sistematike dhe diskriminuese nga institucionet mbi dhunën e kryer ndaj grave rome:

“Gratë rome shpesh kërcënohen nga institucionet me marrjen e fëmijëve të tyre, kështu që edhe kur shkojnë në shtëpi të sigurta, ato kthehen tek kryerësit e krimit nga frika e humbjes së fëmijëve të tyre. Kur gratë rome largohen nga shtëpitë e sigurta, ato shpesh nuk kanë ku të shkojnë, por të kthehen te burrat e tyre. Në shumë raste dhuna përsëritet, dhe kur kjo ndodh, punëtorët nga Qendrat për Punë Sociale janë të zemëruar me gratë që janë kthyer sepse 'tani ato kërkojnë ndihmë përsëri'. Kur vendosim kontakt me punonjësit e Qendrave, marrim përgjigje të natyrës 'ne i ofruam ndihmë asaj, ajo refuzoi', ose 'ajo u kthye tek burri i saj', si një nga arsyet pse ata kishin refuzuar të vazhdonin të ndihmonin gratë.”²¹⁷

²¹¹ K. Beker et al., *Regional Report on Compliance with UN Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination against Women (CEDAW) and Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention) Relating to Discrimination of Roma Women in the Area of Healthcare, Child Marriages and Offering Support and Protection to Roma Women in Cases of Domestic Violence* [Raporti Rajonal mbi Përputhshmërinë me Konventën e KB për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në lidhje me Diskriminimin e Grave Rome në fushën e Shëndetësisë, Martesat e Fëmijëve dhe Ofrimin e Mbështetjes dhe Mbrojtjes së Grave Rome në Rastet e Dhunës në Familje], Beograd, BIBIJA Qendra e Grave Rome 2019, <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2019/10/regional%20report%20on%20discrimination%20of%20roma%20women%20english.pdf?la=en&vs=1148>, (e qasur më 11 gusht 2020), fq. 53.

²¹² Në nenin 4, Konventa e Stambollit bën thirrje për të gjitha masat e implementuara për të mbrojtur të drejtat e viktimave / të mbijetuarave pa diskriminim në bazë të seksit, gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik ose mendimit tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, asociimit me pakicë kombëtare, pronë, lindje, orientim seksual, identitet gjinor, moshë, gjendje shëndetësore, aftësi, status martesor, status migrant ose refugjati, ose status tjetër, Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Stamboll, Këshilli i Evropës, 2011.

²¹³ K. Beker et al., *Raporti Rajonal mbi Përputhshmërinë me Konventën e KB për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në lidhje me Diskriminimin e Grave Rome në fushën e Shëndetësisë, Martesat e Fëmijëve dhe Ofrimin e Mbështetjes dhe Mbrojtjes së Grave Rome në Rastet e Dhunës në Familje*, Beograd, BIBIJA Qendra e Grave Rome, 2019, fq. 53.

²¹⁴ Po aty.

²¹⁵ Po aty.

²¹⁶ Po aty.

²¹⁷ Informatë e ndarë më Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Serbi.

Sipas të dhënave nga një raport i fundit i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), një arsye e evidentuar pse gratë rome viktimat/të mbijetuara të DhF (të cilat kanë pranuar shërbime të mbështetjes në të kaluarën) nganjëherë nuk pranohen në strehimore është numri i fëmijëve që kanë, pasi viktimat/të mbijetuara të DhF kanë mesatarisht pesë deri në shtatë fëmijë.²¹⁸

Në Malin e Zi, prezantimi i shërbimeve të OshC-ve për gratë u bë i disponueshëm edhe për grupet e cenushme dhe për vendbanimet Rome dhe Egjiptiane për të promovuar shërbimet e linjës kombëtare të ndihmës SOS për viktimat/të mbijetuara të DhF, e financuar nga buxheti i shtetit dhe e drejtuar nga OshC-të e grave në Nikšić dhe për përmirësimin e komunikimit me viktimat/të mbijetuara romë. Në periudhën mars 2018 – gusht 2019, 51 gra dhe vajza rome dhe egjiptiane kërkuar ndihmë përmes linjës kombëtare të ndihmës për Mal

të Zi.²¹⁹ Sidoqoftë, pamundësia e qasjes në të dhëna nga periudhat e mëparshme të raportimit do të thotë që hulumtuesit e këtij raporti nuk kanë një numër bazë, dhe për këtë arsye nuk mund të konfirmojnë se sa është rritja në krahasim me vitet e mëparshme.

Mundësimi i qasjes më të lehtë në strehimore dhe përshtatja e shërbimeve, përfshirë ato të ofruara përmes linjave të ndihmës, për nevojat e grave rome viktimat/të mbijetuara të DhBGj është thelbësore për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Shërbimet gjithashtu duhet të ofrohen në gjuhën rome. Kjo kërkon angazhimin e shteteve në luftimin e DhBGj në mesin e komunitetit rom dhe çrrënjësjes së racizmit strukturor duke ngritur besimin në institucione. Koordinimi i autoriteteve shtetërore me OshC-të e grave që punojnë në këto çështje është thelbësore për përmirësimin e qasjes dhe shërbimeve për gratë rome.

Shkalla në të cilën shërbimet lidhur me DhBGj janë sensibilizuar ndaj grave me aftësi të ndryshme

Shumica e strehimoreve në të gjithë shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk janë mirë të përshtatura për nevojat e grave me aftësi të ndryshme dhe për këtë arsye nuk plotësojnë kërkesat e përshkruara në Nenin 4 të Konventës së Stambollit. Dallimet në aftësi përfshijnë dallime në lëvizshmëri, shikim, dëgjim, aftësi konjitive dhe tjera, megjithëse ka qenë shumë e vështirë për të siguruar ndonjë të dhënë në lidhje me këto dallime në aftësi, dhe shumica e informatave të disponueshme përqëndrohet në qasjen në strehimore për gratë me nevoja të ndryshme të lëvizjes. Një sfidë e vazhdueshme në rajon është që të gjitha strehimoret po përballen me pengesa arkitektonike (p.sh. hyrja dhe ambientet, përfshirë banjot dhe tualetet) që nuk përshtaten me gratë me nevoja të ndryshme të lëvizjes.²²⁰ Personelit shpesh i mungon trajnimi i sensibilizuar për të përmbushur nevojat e atyre me aftësi të ndryshme,²²¹ duke përfshirë gjuhën e shenjave, disponueshmërinë e informatave në alfabetin Braille,²²² dhe njohurinë se si të punojnë me përfituesit me aftësi ose barriera të ndryshme konjitive. Në përgjithësi, strehimoret përballen me sfidën e burimeve financiare të nevojshme për të punësuar përkthyes ose punëtorë të aftë me përvojë në këtë fushë.

Sfidat për të ofruar ndihmë ose këshillim përmes linjave të ndihmës janë shumë të dukshme. Gjegjësisht, informacioni mbi shërbimet e linjës së ndihmës të përshtatshme për gratë me aftësi të ndryshme është i kufizuar në të gjithë rajonin. Për më tepër, gratë me aftësi të ndryshme, veçanërisht ato që jetojnë me kufizime financiare, ose të varura financiarisht nga të tjerët, përjetojnë sfida për të telefonuar dhe për të folur privatisht.

OshC-të e grave në Ballkanin Perëndimor theksojnë se institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për viktimat/të mbijetuara të DhBGj shpesh i "harrojnë" gratë me aftësi të ndryshme, që do të thotë që nevojat e tyre nuk plotësohen me shërbime të ndjeshme ndaj nevojave të tyre. Kjo gjithashtu do të thotë se ka një mungesë progresi në zbutjen dhe eliminimin e pengesave me të cilat përballen gratë me aftësi të ndryshme për sa i përket qasjes në shërbimet për DhBGj. Në Kosovë, një përfaqësues i Ombudspersonit raportoi se ata nuk kishin informata nëse gratë me aftësi të ndryshme lejohen në strehimore gjatë pandemisë COVID-19 dhe konfirmoi që institucioni i tyre nuk i kontrollon ato.²²³ Kjo tregon se dhe monitorimi nuk po zbatohet në mënyrë adekuate.

²¹⁸ K. Beker et al., *Raporti Rajonal mbi Përputhshmërinë me Konventën e KB për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në lidhje me Diskriminimin e Grave Rome në fushën e Shëndetësisë, Martesat e Fëmijëve dhe Ofrimin e Mbështetjes dhe Mbrojtjes së Grave Rome në Rastet e Dhunës në Familje*, Beograd, BIBIJA Qendra e Grave Rome, 2019, p. 50.

²¹⁹ S. Elezovic, *Gender Analysis and Recommendations for Strengthening the Inclusion of Gender Perspective in the Implementation of the Action 'Improving Procedural Safeguards in Judicial Proceedings in Montenegro' (Analiza dhe Rekomandimet Gjinore për Forcimin e Perspektivës Gjinore në Implementimin e Veprimt 'Përmirësimi i Masave Mbrojtëse Procedurale në Procedurat Gjyqësore në Mal të Zi')*, Këshilli i Evropës, 2019, <https://rm.coe.int/gender-analysis-final-hf7/16809963c1>, (e qasur më 11 gusht 2020), fq. 16.

²²⁰ Informatë e ndarë më Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH dhe Maqedoninë Veriore.

²²¹ Informatë e ndarë më Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Malin e Zi.

²²² Informatë e ndarë më Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

²²³ Po aty.

TË DHËNAT STATISTIKORE TREGOJNË:

STREHIMORET E GRAVE NË NIVEL KOMBËTAR 2020

Vendet	Popullata e përgjithshme (viti i regjistrimit të fundit) ²²⁴	Viti	Përmbush standardet minimale të Konventës së Stambollit	Numri i Strehimoreve të Grave	Numri i shtretërve në Strehimoret e Grave	Numri i shtretërve të nevojshëm në Strehimoret e Grave	Numri i shtretërve të nevojshëm në Strehimoret e Grave
Shqipëria	2 821 977 (2011)	2016	Jo	5	153	290	137
		2020	Jo	9	153	287	134
Bosnja e Hercegovina	3 531 159 (2013)	2016	Jo	9	204	379	175
		2020	Jo	8	187	353	179
Kosova	1 739 825 (2011)	2016	Jo	8	140	179	39
		2020	Jo	9	105	173	68
Mali i Zi	620 029 (2011)	2016	Jo	3	44	62	18
		2020	Jo	4	38	62	24
Maqedonia Veriore	2 022 547 (2002)	2016	Jo	5	22	202	180
		2020	Jo	11	101	202	101
Serbia	7 186 862 (2011)	2016	Jo	12	257	715	458
		2020	Jo	9	257	715	461

LINJAT E NDIHMËS PËR GRATË NË NIVEL KOMBËTAR 2020

Vendet	Linja/t e Ndihmës për Gratë në Nivel Kombëtar	Falas	Operative 24/7	Përkrahje shumëgjuhëshe
Shqipëria	Po	Po	Po	n/a
BeH	Po	Po	Po	n/a
Kosova	Po	Po	Po	Herë pas here
Mali i Zi	Po	Po	Po	Po
Maqedonia Veriore	Po	Po	Po*	Po
Serbia	Po	Po	Po	n/a

* Shërbimi në gjuhën e pakicës shqiptare nuk ofrohet 24/7.

²²⁴Për qëllime të këtij raporti hulumtues, statistikave të popullsisë janë kalkuluar në përputhje me numrat e popullsisë që rrjedhin nga regjistrimi më i fundit i popullsisë së përgjithshme, të disponueshme për secilin vend përkatës.

ALOKIMI I FONDEVE PËR LUFTIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE (DHBGJ)

Konventa e Stambollit kërkon që shtetet nënshkruese të caktojnë burime të adekuate financiare dhe njerëzore për zbatimin e politikave, masave dhe programeve të integruara për të luftuar të gjitha format e DhBGJ.²²⁵ Pa sasinë e duhur të fondeve, kërkesat e Konventës së Stambollit nuk mund të zbatohen ose monitorohen si duhet. Kjo paraqet një pengesë të rëndësishme për eliminimin e DhBGJ dhe për rolin e OShC-ve të grave që po zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet relevante, pasi të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida të mëdha në këtë fushë.

Ky seksion ofron një përmbledhje të fondeve të alokuara për parandalimin dhe mbrojtjen nga DhBGJ, në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Disponueshmëria publike e një informacioni të tillë mbetet e kufizuar, prandaj Kvinna till Kvinna ka dërguar kërkesa për qasje në dokumente publike institucioneve relevante,²²⁶ duke përdorur dispozitat e ligjeve përkatëse. Përgjigjet ndryshonin sipas vendit për sa i përket sasisë dhe saktësisë së informacionit të dhënë, ku disa vende ofronin vetëm përgjigje të pjesërishtme.

Informacioni i marrë nuk tregon ndonjë përmirësim të dukshëm të zotimeve financiare nga ana e qeverive të Ballkanit Perëndimor për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në Nenin 8 i Konventës së Stambollit. Financimi i qeverisë kalon përmes ministrive dhe/ose organeve të ndryshme dhe nuk ka të dhëna të integruara mbi shumën e përgjithshme të fondeve të alokuara për DhBGJ në asnjë nga gjashtë vendet.

OShC-të e grave janë në front të adresimit të DhBGJ dhe ofrimit të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat. Megjithatë, mbështetja qeveritare, si financiare dhe e ndryshme, për punën e tyre mbetet e kufizuar. Një studim i fundit mbi alokimin e fondeve për OShC-të e grave në shtetet e Ballkanit Perëndimor tregon se vetëm 5% e fondeve të OShC-ve të grave në rajon vijnë nga qeveritë e tyre respektive kombëtare.²²⁷ Ndër fushat tematike të financuara në Ballkanin Perëndimor, adresimi i DhBGJ siguroi më së shumti fonde, duke përbërë të paktën 27% të fondeve të alokuara.²²⁸

SHQIPËRIA

MSMS është e mandatuar të koordinojë dhe monitorojë përfshirjen efektive të barazisë gjinore në Sistemin e Menaxhimit të Financave Publike. Përgjigja e dhënë për Kvinna till Kvinna në kërkesën e tyre për të dhëna tregoi që alokimi i fondeve ishte bërë si rezultat i përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2016 - 2020. Gjatë vitit 2019, MSMS siguroi gjithsej 18 181 000 lekë (afërsisht 146 818 EUR) për mbështetjen ekonomike të 505 viktimave/të mbijetuarave të DhF dhe 11 800 000 lekë (rrreth 95 295 EUR) për strehimoret dhe shërbimet për viktimat/të mbijetuarat e DhF-së.²²⁹

Një total prej 21 516 866 lekësh (afërsisht 173 769 EUR)²³⁰ u alokua për qendrat e trafikimit të qenieve njerëzore, me 31% për rajonin e Tiranës²³¹, 42% për Vlorën²³² dhe 27% për Elbasanin.²³³ Qendra e qëndrimit për komunitetin LGBTQI+ STREHA u mbështet me 2 875 725 lekë (rrreth 23 224 EUR).²³⁴ Linja Kombëtare e Ndhmës për Fëmijët Shqiptarë - ALP 116 mori 4 267 242 lekë (rrreth 34 462 EUR), ndërsa Linja e Këshillimit për Vajza dhe Gra mori 2 926 125 lekë (rrreth 23 631 EUR).²³⁵

²²⁵ Këshilli i Evropës, *The Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje)*, Stamboll, Këshilli i Evropës, 2011.

²²⁶ Në Shqipëri, tre kërkesa për qasje në dokumente publike u dërguan në institucionet përkatëse qeveritare, nga të cilat dy morën përgjigje. Në BeH, kërkesat u dërguan në katër institucione, nga të cilët vetëm tre u përgjigjën. Në Kosovë, pesë kërkesa u dërguan tek institucionet qeveritare dhe u pranuan tre përgjigje. Në Maqedoninë Veriore gjashtë kërkesa u dërguan tek institucionet qeveritare nga të cilat morën katër përgjigje. Në Serbi u dërguan dy kërkesa për qasje në dokumente publike dhe morën një përgjigje.

²²⁷ N. Farnsworth et al. *Where's the Money for Women's Rights? Funding Trends in the Western Balkans (Ku janë Parat për të Drejtat e Grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020, <https://kvinnatillkvinna.org/2020/06/01/wheres-the-money-for-womens-rights-2020/>, (e qasur më 26 gusht 2020), fq. 7.

²²⁸ Po aty.

²²⁹ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Republika e Shqipërisë, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, Përgjigja e marrë më 18 maj 2020.

²³¹ Po aty.

²³² 6 747 687 ALL (afër. 54 494 EUR)

²³³ 8 976 564 ALL (72 494 EUR)

²³⁴ 5 792 615 ALL (afër. 46 780 EUR)

²³⁵ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Republika e Shqipërisë, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, Përgjigja e marrë më 18 maj 2020.

²³⁶ Po aty.

Përgjigja e kërkesës për të dhëna nga Ministria e Drejtësisë, megjithatë, ishte e kufizuar në mbështetje përmes ndihmës juridike falas, pa dhënë ndonjë numër specifik. Në përgjigje u specifikua se thirrja për financimin e OShC-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas nuk ishte përfunduar për shkak të sfidave gjatë pandemisë COVID-19, dhe për këtë arsye, nuk u ofrua asnjë dëshmi mbi alokimin e fondeve për shërbime të tilla.²³⁶ Kjo shtrun pyetje nëse reagimi i shtetit është i mjaftueshëm, duke pasur parasysh rritjen e DhF të shkaktuar nga masat e izolimit që ndërlihen me pandeminë.²³⁷

Të dhënat e mësipërme mbi alokimin e fondeve të qeverisë shqiptare për strehimoret, linjat e ndihmës dhe mbështetjen financiare për aktivitetet në lidhje me mbështetjen për viktimat/të mbijetuarat e

DhBGj/DhF tregojnë një shumë të përgjithshme prej 61 566 958 lekë (afërsisht 494 447 EUR). Krahasuar me të dhënat e marra në periudhën e mëparshme të raportimit, financimi i qeverisë ka shënuar një rritje. Akoma, mungesa e të dhënave zyrtare gjithëpërfshirëse për këtë çështje paraqet kufizime për një vlerësim efektiv të fondeve qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga DhBGj/DhF, dhe për konkludime të mundshme. Përkundër rritjes së fondeve, shuma totale për zbutjen, parandalimin dhe aktivitetet e ndërlihdura me DhBGj në të gjithë vendin, përfundimisht mbetet e pamjaftueshme, aq më pak në sigurimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat/të mbijetuarat. Në Shqipëri kemi forma të ndryshme të DhBGj dhe nevojiten më shumë fonde për të adresuar dhe për t'iu përgjigjur këtyre çështjeve në mënyrë adekuate.

BOSNA I HERCEGOVINA

Agjencia e BeH për Barazi Gjinore (ABGJ) është mekanizmi kryesor koordinues për barazinë gjinore në BeH. Që nga qershori 2017, USAID ka mbështetur projektin e ABGJ *"Ndërtimi i Kapaciteteve të Institucioneve për Luftimin e Dhunës me Bazë Gjinore në BeH"* me 850 000 USD (afërsisht 434 598 EUR). Brenda kornizës së këtij projekti, në fund të vitit 2018, ABGJ financoi nëntë OSHC të grave me një shumë totale prej 16 000 BAM (afërsisht 8 180 EUR). ABGJ raportoi një kosto prej 16 391 BAM (afërsisht 8 380 EUR) për aktivitetet e parandalimit të DhBGj/DhF në 2019. Një shumë shtesë prej 8 000 BAM (afërsisht 4 090 EUR) u shpenzua nga ABGJ për analizën e kapaciteteve të sektorit gjyqësor për zbatimin e Konventës së Stambollit në BeH, duke u përqëndruar në mbledhjen e të dhënave. 290 000 BAM (rreth 148 274 EUR) ishin alokuar për të mbështetur aktivitetet e Qendrës Gjinore të FBeH.²³⁸

Përgjigja nga ABGJ përmend një shpenzim prej 180 500 BAM (afërsisht 92 288 EUR) për sigurimin e mbështetjes për viktimat e DhBGj në 2019. Nga janari deri në maj 2020, ajo raportoi 14 780 BAM (afërsisht 7 556 EUR) të alokuara për mbështetjen e viktimave të DhBGj dhe DhF. Mbetet e paqartë nga përgjigja e

ABGJ, megjithatë, nëse këto fonde janë alokuar nga buxheti i shtetit, apo nga donatorët ndërkombëtarë.

ABGJ gjithashtu vuri në dukje mbështetjen e gjashtë projekteve të OShC-ve që synojnë rritjen e sigurisë njerëzore nga një perspektivë gjinore, gjithsej 80 000 BAM (rreth 40 903 EUR) në 2020, të alokuara nga Mekanizmi Financiar për Zbatimin e Planit të Veprimtari Gjinor në BeH 2018-2022, një program i financuar nga donatorë ndërkombëtarë. Një prej këtyre OShC-ve u mbështet për një program mbi DhBGj, duke marrë 14 780 BAM (rreth 7 500 EUR).

Qendra Gjinore e FBeH koordinon zbatimin e *Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës në Familje*. Sipas përgjigjes së tyre në kërkesën për të dhëna, buxheti vjetor i Qendrës për adresimin e DhF në 2019 ishte 43 000 BAM (rreth 23 000 EUR), ndërsa shpenzimet e saj për projektet e ndërlihdura me DhF ishin 58 500 BAM (afërsisht 29 900 EUR).²³⁹ Buxheti vjetor i vitit 2020 për fondet e alokuara për parandalimin e DhBGj kishte një rritje të dukshme, me fonde vjetore të planifikuara prej 563 000 BAM (rreth 287 800 EUR).

²³⁶ Ministria e Drejtësisë – Republika e Shqipërisë, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, Përgjigja e marrë më 11 maj 2020.

²³⁷ Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - AWEN, 'COVID-19, Threefold Increase in Calls for Help at the National Hotline for Domestic Violence Cases / Up to 6 Protection Orders Issued within One Day in Durrës District' ('COVID-19, Rritje e Trefishtë e Thirrjeve për Ndihmë në Linjën Kombëtare të Ndihmës për Rastet e Dhunës në Familje / Deri në 6 Urdhëra për Mbrojtje të Lëshuara Brenda Një Dite në Rajonin e Durrësit'), Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - AWEN, 2020, <https://awenetwork.org/covid-19-threefold-increase-in-calls-for-help-at-the-national-hotlinefor-domestic-violence-cases-up-to-6-protection-orders-issued-within-oneday-in-durresdistrict/?lang=en>, (e qasur më 8 gusht 2020). G

²³⁸ Agjencia për Barazi Gjinore, Bosnja e Hercegovina, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, Përgjigja e marrë më 27 maj 2020.

²³⁹ Qendra Gjinore e Federatës – BeH, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, Përgjigja e marrë më 21 maj 2020.

Në krahasim, Qendra Gjinore - Qendra për Drejtësi dhe Barazi në Republikën Srpska, gjatë vitit 2019 shpenzoi gjithsej vetëm 14 538 BAM (afërsisht 7 433 EUR) për të luftuar DhBGj/DhF.²⁴⁰ Shpenzimet ndodhën brenda kornizës së projektit *"Rritja e qasjes në shërbime më të mira multisektoriale për të mbijetuarit e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në nivelin lokal - Faza 2"*, financuar nga zyra e UN Women në BeH. Aktivitetet përfshinin: 1) një konferencë ndërkombëtare mbi zbatimin e Konventës së Stambollit; 2) një analizë e qëndrimeve dhe kompetencave të ofruesve të shërbimeve të mbrojtjes në gjashtë komuna të Republika Srpska; dhe 3) zhvillimi i një moduli trajnimi për profesionistët që punojnë me viktimat/të mbijetuarat e shumta të DhBGj të marginalizuara.

Duke pasur parasysh mospërputhjen e të dhënave qeveritare për alokimin e fondeve për parandalimin dhe mbrojtjen kundër DhF, është e vështirë të vlerësohet dallimi në financim me vitet e mëparshme në BeH. Përgjigjet e shtetit ndaj Kvinna till Kvinna në kërkesat e tyre për të dhëna nuk ofruan informata mbi të njëjtat fusha të financimit si në përgjigjen e marrë në vitin e kaluar, dhe përgjigja e fundit tregoi përpjekjet e tyre të kufizuara sa i përket shumës totale të fondeve të alokuara për DhBGj. Përkundër mungesës së mbështetjes financiare nga shteti, mbështetja e donatorëve për OShC-të e grave që punojnë në çështjet e DhBGj në BeH, mbetet një burim i rëndësishëm i financimit.

KOSOVA

Ministria e Financave e Kosovës nuk ka mekanizëm zyrtar të mbledhjes së të dhënave për gjurmimin e fondeve të alokuara për parandalimin dhe mbrojtjen nga DhBGj/DhF.²⁴¹ Kjo është një sfidë për monitorimin e fondeve të alokuara për DhBGj në Kosovë sepse, në mungesë të një sistemi të hollësishëm të të dhënave, gjurmimi është i shpërndarë ndërmjet institucioneve të ndryshme relevante prandaj nuk është e mundur të sigurohen informata rreth shumës së saktë dhe të gjithëmbarshme.

ABGJ nën juridiksionin e Zyrës së Kryeministrit, është organi kryesor i mandatuar për të avancuar barazinë gjinore. Gjatë vitit 2019, ABGJ raportohet të ketë organizuar disa trajnime për zhvillimin e kapaciteteve për palët e përfshira në zbatimin e Procedurave Standarde të Operimit në lidhje me DhF si: policia, prokurorët, gjykatësit, zyrtarët e mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave, punonjësit socialë, profesionistët shëndetësorë dhe stafin e strehimoreve. Shuma totale për këto trajnime ishte 10 713 EUR (krahasuar me 16 770 EUR në 2018).²⁴² Një vlerësim mbi zbatimin e Procedurave Standarde të Operimit DhF u realizua për 12 159 EUR, me 9 500 EUR mbështetje nga Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).²⁴³ Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet u

mbështet për procesin e rishikimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje me një shumë prej 5 820 EUR, dhe me ekspertizë nga konsulenca NIRAS-Menaxhimi i Korporatave Publike Ndërkombëtare.²⁴⁴ Mbështetja financiare për OShC-të e grave që adresojnë DhF në 2019 u zvogëlua në 5 820 EUR²⁴⁵ nga 7 490 EUR në 2018.²⁴⁶ Kjo përbën një rënie nga një shumë tashmë modeste. Kjo shumë nuk është aspak e mjaftueshme për OShC-të e grave për të adresuar në mënyrë adekuate DhBGj, dhe për të krijuar programe për mbështetjen e viktimave/të mbijetuarave. ABGJ gjithashtu raportoi shpenzime për aktivitete për sensibilizim publik që adresojnë DhBGj, përfshirë "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave" në 2019, me rritje të shumës në 14 267 EUR²⁴⁷ nga 10 409 EUR në 2018.²⁴⁸ Pjesa dërmuese e këtij financimi, megjithatë, u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Në vitin 2020, shpenzimet e ABGJ-së u përqendruan në ngritjen e kapaciteteve të stafit të saj në lidhje me DhF me një mbështetje prej 25 000 EUR nga Sida.²⁴⁹ Mbështetja nga donatorët ndërkombëtarë si CPM International, GIZ, Sida dhe UNFPA tregon që organizatat ndërkombëtare të donatorëve po sigurojnë fonde për mbështetjen e projekteve për të mbushur boshllëqet e financimit nga shteti.

²⁴⁰ Qendra për Drejtësi dhe Barazi e BeH – Republika Srpska, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, Përgjigja e marrë më 27 maj 2020.

²⁴¹ Ministria e Financave – Republika e Kosovës, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes përmes telefonit më 14 maj 2020.

²⁴² Agjencia për Barazi Gjinore – Republika e Kosovës, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 20 maj 2020.

²⁴³ Po aty.

²⁴⁴ Po aty. Vëreni se ABGJ ishte financuar nga Sida për përkrahje teknike.

²⁴⁵ Po aty.

²⁴⁶ L. Gačanica et al, *Women's Rights in Western Balkans (Tw Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor)*, The Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, fq. 48.

²⁴⁷ Agjencia për Barazi Gjinore – Republika e Kosovës, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 20 maj 2020.

²⁴⁸ L. Gačanica et al, *Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor*, The Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2019, fq. 48.

²⁴⁹ Agjencia për Barazi Gjinore – Republika e Kosovës, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 20 maj 2020.

Gjatë periudhës së raportimit në vitin 2019, MPMS alokoi 257 000 EUR për gjashtë OShC të grave që drejtojnë strehimore për viktimat/të mbijetuarat e DhBGJ. Në vitin 2020, fondet e alokuara u rritën në 495 000 EURO për 10 strehimore.²⁵⁰ Kjo ishte alokuar para shfaqjes së pandemisë COVID-19 në vend dhe është një rritje e mirëpritur. Është e rëndësishme të theksohet se kjo ndodhi pas një avokimi të fuqishëm dhe të gjatë nga OShC-të e grave, institucionet ndërkombëtare dhe lokale.

Ministria e Drejtësisë, si një nga institucionet kryesore në fushën e mbrojtjes nga DhBGJ/DhF, nuk raportoi asnjë shpenzim nga buxheti i shtetit. Kjo është arsye për shqetësim, pasi të gjitha aktivitetet e saj lidhur me këtë çështje u financuan nga donatorë ndërkombëtarë. Në vitin 2019, Zyra e Koordinatorit

për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (Zyra e Koordinatorit) brenda Ministrisë së Drejtësisë organizoi një trajnim mbi azhurnimet e databazës së integruar për rastet e DhF për avokatët, zyrtarët e policisë, prokurorët, gjyqtarët, viktimat/të mbijetuarat, dhe punonjësit socialë. Një trajnim i ngjashëm raportohet të jetë mbajtur gjatë vitit 2020. Zyra e Koordinatorit gjithashtu ka raportuar punëtori të sponsorizuara nga donatorët për vlerësimin e Planit të Veprimit për Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe efikasitetin e mekanizmave dhe strehimoreve përkatëse.²⁵¹ Megjithatë zyrtarët dhe institucionet përkatëse kërkojnë trajnime të rregullta për adresimin e DhBGJ vlen të përmendet se ky trajnim i veçantë u financua nga donatorë ndërkombëtarë e jo nga shteti.

MALI I ZI

Në nivelin shtetëror, fondet për barazinë gjinore në Mal të Zi shpërndahen kryesisht përmes Ministrisë së Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave.²⁵² Në vitin 2019, Ministria financoi 24 OShC, me gjithsej, 290 000 EUR nga të cilat 10 ishin OShC të grave, të cilat morën një total prej 107 970 EUR. Sidoqoftë, OShC-të e grave kanë në dukje fondet e pamjaftueshme dhe se komisionet të përzgjedhjes shpesh u mungon ndjeshmëria dhe kuptimi i barazisë gjinore.²⁵³ Kjo paraqet një pengesë për OShC-të që marrin fonde shtetërore për mbrojtjen dhe parandalimin e DhBGJ. Përveç kësaj, jo të gjitha fondet e alokuara për OShC-të e grave adresojnë çështjet e DhBGJ në veçanti. Ekzistojnë fonde të kufizuara për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Financimi shpërndahet kryesisht përmes thirrjes së hapur publike nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Vetëm OShC-të e licencuara mund të aplikojnë për këtë financim shtetëror.²⁵⁴

Informatat publike mbi burimet financiare të qeverisë malazeze për zbatimin e legjislacionit, strategjive dhe politikave për parandalimin dhe luftimin e DhBGJ mbeten të kufizuara. Kërkesa për të dhëna nga Kvinna till Kvinna bazuar në dispozitat e Ligjit për Lirinë e Qasjes në Informim nuk arriti të marrë ndonjë përgjigje nga qeveria gjatë këtij raportimi, ndryshe nga raporti i kaluar. Kjo përbën një mangësi të madhe në përmbytjen e detyrimeve të Konventës së Stambollit kur bëhet fjalë për të ndjekur progresin e qeverisë në zbatimin e PKV-së,²⁵⁵ si dhe monitorimin e vetë zbatimit. Mungesa e të dhënave gjithashtu tregon jo-transparencën e qeverisë, barrierat kryesore për qasje në informatat e nevojshme për hulumtim dhe hartim të politikave dhe kontribuon në tkurrjen e hapësirës për rolin mbikëqyrës të shoqërisë civile.

²⁵⁰ Ministry e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Republika e Kosovës, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 13 maj 2020.

²⁵¹ Ministria e Drejtësisë – Republika e Kosovës, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 4 qershor 2020.

²⁵² N. Farnsworth et al. *Ku janë Parat për të Drejtat e Grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020, fq. 50.

²⁵³ Po aty.

²⁵⁴ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Malin e Zi.

²⁵⁵ Plani aktual Kombëtar i Veprimit 2016-2020 përfundon në fund të vitit 2020 dhe plani pasues është ende në formë të draftit.

MAQEDONIA VERIORE

Qeveria e Maqedonisë Veriore miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Konventës së Stambollit 2018 - 2023 në gusht 2018, menjëherë pas ratifikimit të Konventës së Stambollit në mars 2018. Dokumenti përcakton përgjegjësitë e secilit institucion përkatës pa specifikuar kërkesat e tyre financiare në luftimin e DhBGj. Për të përmbushur detyrimet që vijnë nga Plani i Veprimit, Ministria e Drejtësisë hartoi *Ligjin për Kompenzimin e Viktimave të Akteve Penale*.²⁵⁶ *Ligji i ri për Ndihmën Juridike Falas* u miratua në maj 2019 ndërsa procesi i rishikimit të *Kodit Penal dhe Ligjit të Procedurës Penale* ka filluar gjatë kësaj periudhe raportuese.²⁵⁷ Financimi i rishikimit të infrastrukturës ligjore për përmirësimin e sfondit të mbrojtjes për viktimat/të mbijetuarat e DHBGJ është thelbësore. Përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë në kërkesën për të dhëna nga Kvinna till Kvinna nuk përmbante asnjë informatë mbi fondet e alokuara për parandalimin dhe mbrojtjen nga DhBGJ/DhF, duke sugjeruar që ligjet nuk i kategorizojnë viktimat, prandaj kostot që afektojnë viktimat/të mbijetuarat e DhBGJ/DhF nuk mund të llogariten. Mungesa e të dhënave të ndara gjinore, si dhe të dhënave të ndara sipas veprës penale, paraqesin sfida për mbledhjen e këtyre informatave dhe monitorimin e çdo programi të zbatuar për PKV.

Ministria e Drejtësisë raportoi se aktivitetet specifike të Ministrisë do të mbështeten financiarisht jo vetëm nga buxheti i tyre por edhe nga donatorët.²⁵⁸

Në vitin 2019, MPPS siguroi gjithsej 5 346 000 MKD (rreth 87 014 EUR) për gjashtë OShC që punojnë me viktimat/të mbijetuarat të DhBGJ/DhF.²⁵⁹ Në vitin 2020, mbështetja e MPMS për OShC-të e grave u zbrit në 4 000 000 MKD (afërsisht 65 106 EUR) me vetëm katër organizata të mbështetura.²⁶⁰ Fondet e alokuara vijnë nga të ardhurat e fituara nga shitja e biletave të llotarisë, si dhe nga lojërat e fatit dhe argëtimit.²⁶¹ MPPS vuri në dukje se ata alokojnë fonde për të mbështetur fusha të ndryshme të ndërhyrjes, parandalimit dhe mbrojtjes nga DhBGJ/DhF, megjithatë, nuk kanë dhënë asnjë përgjigje rreth shumës së saktë të këtyre fondeve.²⁶²

Financimi i OShC-ve nga qeveria e Maqedonisë Veriore është rritur gjatë viteve.²⁶³ Megjithatë, në baza vjetore, OShC-të e grave marrin mesatarisht 73% më pak fonde qeveritare krahasuar me OShC-të e tjera.²⁶⁴ Kjo pasqyron një mungesë të zotimit të qeverisë për parandalimin dhe mbrojtjen nga DhBGJ/DhF duke pasur parasysh që pjesa dërmuese e shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat ofrohen nga OShC-të e grave.

²⁵⁶ Ministria e Drejtësisë – Republika e Maqedonisë Veriore, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 19 maj 2020.

²⁵⁷ Po aty.

²⁵⁸ Po aty.

²⁵⁹ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale – Republika e Maqedonisë Veriore, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 20 maj 2020.

²⁶⁰ Po aty.

²⁶¹ Po aty.

²⁶² Po aty.

²⁶³ N. Farnsworth et al. *Ku janw Parat për të Drejtat e Grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020, fq. 51.

²⁶⁴ Po aty.

SERBIA

Trupi Koordinues për Barazi Gjinore është mekanizmi zyrtar qeveritar i mandatuar për të siguruar zbatimin e Konventës së Stambollit,²⁶⁵ megjithatë, ky institucion nuk ka asnjë staf të përhershëm ose linjë buxhetore të caktuar për të nxjerrë mandatin e tij.²⁶⁶ Duke pasur parasysh këtë fakt, në përgjigjen e tyre ndaj kërkesës së Kvinna till Kvinna për të dhëna mbi shumën e alokuar për parandalimin dhe luftimin e DhBGj, ata rekomanduan që kërkesa duhet të adresohet në organe tjera qeveritare, që në vetvete është një zbulim interesant. Kjo shmangie në ofrimin e të dhënave të kërkuara paraqet një pengesë për marrjen e të dhënave nga institucioni i mandatuar për të zbatuar Konventën e Stambollit. Në të njëjtën mënyrë, Ministria e Financave pohoi që informacioni duhet të kërket nga institucionet përgjegjëse sipas Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje, pasi ata nuk kanë të dhëna për fondet e alokuara për luftimin e DhBGj.²⁶⁷

Të dhënat e qeverisë serbe për fondet e alokuara për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave nuk regjistrohen ose nuk janë të disponueshme për publikun, siç përcaktohet në nenin 11 të Konventës së Stambollit. Financimi i qeverisë për këtë fushë mbetet i kufizuar,²⁶⁸ ndërsa një pjesë e madhe e financimit sigurohet nga donatorët ndërkombëtarë.²⁶⁹ Kjo përbën një mangësi të madhe në përmbushjen e detyrimeve të Konventës së Stambollit, gjurmimin e progresit të qeverisë në zbatimin e PKV-së, si dhe monitorimin e vetë

zbatimit. Kjo paraqet një sfidë shtesë në avokimin për ndryshimet e duhura të politikave, pasi që qasja në këto të dhëna është e nevojshme për avokim dhe hartim të politikave të bazuar në prova.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, *Strategjia e re Kombëtare për Parandalimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Familje dhe në Marrëdhëniet Intime* mes Partnerëve është duke u hartuar.²⁷⁰ Ligji i ri mbi Sistemin e Planifikimit të Republikës së Serbisë kërkon që autoritetet të sigurojnë një llogaritje financiare dhe vlerësim të kostos përpara miratimit të strategjisë.²⁷¹ Alokimi i fondeve për zbatimin e këtij dokumenti politikash i jep qeverisë një mundësi për të siguruar një angazhim gjithëpërfshirës drejt parandalimit dhe mbrojtjes ndaj DhBGj. Financimi i politikave të spektrit të gjerë nga qeveria është thelbësor për përmbushjen e detyrimeve të Konventës së Stambollit si dhe avancimin e luftës kundër DhBGj, të cilat ende nuk janë dëshmuar. Kjo iniciativë legjislative dhe proceset shoqëruese gjithashtu ofrojnë një mjet për të luftuar dhe matur progresin në luftën kundër DhBGj. Sidoqoftë, OShC-të e grave kanë shprehur shqetësimin e tyre për mungesën e angazhimit të qeverisë në mbështetjen e viktimave/të mbijetuarave të DhBGj/DhF. Një nga shembujt që organizatat e grave vunë në pah është se në shkurt 2020, Ministria e Drejtësisë kishte një thirrje të hapur për grante të projekteve dhe nga një fond total prej 500 milion RSD (afërsisht 4 252 507 EUR), asnjë grant nuk u dha për të mbështetur gratë viktimat/të mbijetuara të dhunës.²⁷²

²⁶⁵ GREVIO, Raporti i Vlerësimit (Fillestar) të GREVIO-s mbi Masat Legjislative dhe Masa të Tjera që i japin fuqi Dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe Viktimat e Trafikimit Njerëzor në Procedurat Penale: Analiza e praktikës gjyqësore për vitin 2019 për krimet e ndërmjetësimit në prostitucion, trafikim të qenieve njerëzore dhe trafikim i të miturve për birësim: Serbi, GREVIO, 2020.

²⁶⁶ Trupi Koordinues për Barazi Gjinore, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 15 maj 2020.

²⁶⁷ Ministria e Financave – Republika e Serbisë, Kërkesa e bërë nga Kvinna till Kvinna, dhënia e përgjigjes më 15 maj 2020.

²⁶⁸ Në vend të angazhimeve për rritjen e fondeve për parandalimin e DhBGj, gjatë kësaj periudhe raportuese, qeveria serbe u përqëndrua në investime të tjera, të tilla si ushtria. Gjatë vitit 2019, Serbia u rendit e 5-të në nivel global për rritjen e shpenzimeve ushtarake - rritja më e lartë e shpenzimeve ushtarake në Ballkanin Perëndimor dhe ndër më të lartat në Evropë. (Burimi: N. Tian et al., *SIPRI Fact Sheet April 2020: Trends in World Military Expenditure (Fletë faktesh prill 2020: Trendet në Shpenzimet Ushtarake Botërore*, 2019, SIPRI, 2020).

²⁶⁹ GREVIO, Raporti i Vlerësimit (Fillestar) të GREVIO-s mbi Masat Legjislative dhe Masa të Tjera që i japin fuqi Dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe Viktimat e Trafikimit Njerëzor në Procedurat Penale: Analiza e praktikës gjyqësore për vitin 2019 për krimet e ndërmjetësimit në prostitucion, trafikim të qenieve njerëzore dhe trafikim i të miturve për birësim (*Konventa e Stambollit: Serbi*, GREVIO, 2020).

²⁷⁰ Po aty.

²⁷¹ Po aty.

²⁷² Qendra Autonome e Grave, 'Komunikatë për Media, Qendra Autonome e Grave, 2020, <https://www.womenngo.org.rs/en/news/1596-press-release>, (e qasur më 1 shtator 2020).

NUMRI I RASTEVE TË SANKSIONUARA TË DHUNËS ME BAZË GJINORE

Sanksionimi (ndëshkimi) i DhBGj²⁷³ është një kërkesë thelbësore e Konventës së Stambollit. Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë shënuar progres të konsiderueshëm në përshtatjen e masave legjislative kundër DhF dhe disa aspekteve të tjera të DhBGj. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit për DhF dhe DhBGj mbetet një shqetësim.

Sfidat për zbatimin e ligjit në rajon përfshijnë reagimin joadekuat të policisë, të kombinuar me ndjekje penale joadequate dhe dënime të rasteve DhBGj/DhF. Në rajon, zyrtarët e policisë thuhet se kanë fajësuar viktimat, janë përpjekur të ndërmjetësojnë rastet e raportuara, kanë injoruar forma të ndryshme të dhunës dhe peshën e krimeve, si dhe kanë rrezikuar jetën e viktimave, duke refuzuar të lëshojnë ose zbatojnë siç duhet urdhrat e mbrojtjes kundër autorëve të krimeve. Për kryerësit e krimeve, krimet e të cilëve regjistrohen në sistemin gjyqësor, dënimi është i butë dhe shumë herë me kusht, duke rezultuar vetëm në një gjobë, dhe kjo vlen për të gjithë Ballkanin Perëndimor. Kompenzimi për viktimat vështirë se është zbatuar ndonjëherë, edhe në raste kur është shqiptuar dënimi. Viktimat/të mbijetuarat nuk kanë besim te institucionet dhe raportimi është i lidhur ngushtë me stigmën dhe frikën. E gjithë kjo ndikon në shkallën e ulët të raportimit nga ana e viktimave/të mbijetuarave, duke krijuar një precedent negativ për kryerësit e dhunës.

Pavarësisht nga mungesa e të dhënave gjinore gjithëpërfshirëse dhe të ndara për rastet e sanksionuara të DhBGj/DhF, kjo pjesë ofron një përmbledhje

që përshkruan boshllëqet dhe sfidat në këtë drejtim. Ky seksion hulumtimi mëton të sigurojë një pasqyrë të të dhënave të disponueshme për rastet e sanksionuara të DhBGj në secilin vend të Ballkanit Perëndimor. Duke vepruar kështu, është e rëndësishme të theksohet se shumica e qeverive të Ballkanit Perëndimor dhe institucioneve përkatëse nuk kanë të dhëna të disponueshme për rastet e DhF. Gjatë vlerësimit të rasteve të sanksionuara dhe nivelit të raportimit, dhe duke marrë parasysh që DhBGj sistematike është një çështje e përhapur në të gjithë Ballkanin Perëndimor, një rënie në raportim nuk tregon më pak raste të dhunës, përkundrazi, kjo shpesh mund të tregojë pengesa të tjera të jashtme që ndikojnë në raportim. Kjo është e rëndësishme të theksohet gjatë kësaj periudhe raportuese veçanërisht sa i përket pandemisë aktuale COVID-19, masave emergjente dhe masave të distancimit social të ndërmarra. Shkalla e ulët e raportimit mund të tregojë që viktimat/e mbijetuarat nuk është në gjendje, ose ndihet i/e pasigurt për të raportuar autorin e krimit, ose u mungon besimi në institucionet përkatëse. Nga ana tjetër, një rritje në shkallën e raportimit mund të tregojë një shifër më të saktë të nivelit të dhunës. Kur bëhet fjalë për vrasjen e grave (vrasja e grave në baza gjinore dhe me paramendim), qeveritë e Ballkanit Perëndimor rrallë e veçojnë këtë formë të vrasjes nga llojet e tjera të vrasjeve në bazat e tyre të të dhënave. Në shumicën e rasteve, kur të dhënat janë të disponueshme, janë OShC-të e grave që po monitorojnë normën e femicidit, duke mbledhur të dhëna dhe duke luajtur një rol vëzhgues në vrasjet e ndërlydhura me DhBGj.

²⁷³Për shkak të kufizimeve në fushën e këtij raporti, u mor një vendim për të hequr temën e dhunës seksuale në kohë të luftës, që obrađena u prethodnim izvještajima, zato što ishte përfshirë në raportet e mëparshme, pasi që kërkon një shtjellim më kontekstual dhe më të detajuar.

SHQIPËRIA

Pati një rënie të rasteve të raportuara të DhF në Shqipëri gjatë vitit 2019 krahasuar me një vit më parë. Prokuroria regjistroi një numër të përgjithshëm prej 1 140 rastesh në 2019 (krahasuar me 1 209 në 2018), nga të cilat 834 (dhe 1 007 në 2018) përfunduan në gjykatë.²⁷⁴ Kishte 1 024 autorë të dhunës të regjistruar në 2019 (krahasuar me 1 195 në 2018), nga të cilët 888 (dhe 1 069 në 2018) u sollën para gjykatave, dhe 793 (826 në 2018) u dënuan.²⁷⁵

Një trend në rënie i rasteve të raportuara të DhF u identifikua gjithashtu në fillim të vitit 2020. Në shkurt të vitit 2020, ishin raportuar 321 raste të DhF në polici, ndërsa në Mars ky numër ra në 245 raste, nga të cilat 89 u proceduan penalisht, 33 shkelës të ligjit u arrestuan, dhe janë lëshuar 141 urdhra mbrojtje.²⁷⁶ Nga ana tjetër, linjat e ndihmës të OSHC-ve të grave raportuan një numër të rritur të thirrjeve në lidhje me DhF gjatë kësaj periudhe, e cila përkoi me pandeminë COVID-19, duke theksuar pengesat e viktimave/të mbijetuarave për të raportuar rastet e tyre në institucionet përkatëse për shkak të masave emergjente dhe mbylljeve të sanksionuara nga shteti.²⁷⁷

Numri i rasteve të raportuara të ngacmimeve seksuale gjatë vitit 2019 pati një rritje në krahasim me 2018. Prokuroria regjistroi 57 raste të ngacmimeve seksuale në 2019 (krahasuar me 51 në 2018), nga të cilat 34 u sollën para gjykatave (18 në 2018).²⁷⁸ Nga rastet e raportuara të ngacmimit seksual, u regjistruan 34 autorë (27 në 2018), i njëjti numër u soll para gjykatave (18 në 2018) dhe 23 u dënuan (13 në 2018).²⁷⁹ Përdhunimi bashkëshortor mbetet i keqkuptuar nga autoritetet shqiptare duke rezultuar kështu në një shkallë të ulët të ndjekjes penale.²⁸⁰ Duke qenë se përdhunimi bashkëshortor shpesh nuk

konsiderohet krim nga autoritetet, ai dekurajon viktimat/të mbijetuarat nga raportimi pasi që ekzistojnë dëshmi dhe përvoja që tregojnë se autoritetet përkatëse nuk e procesojnë krimin në mënyrë adekuate.

Deri në korrik 2019, Policia e Shtetit Shqiptar raportoi 11 vrasje të lidhura me DhF.²⁸¹ Të dhënat tregojnë se në më pak se dy muaj të vitit 2019, çdo tetë ditë një grua ishte viktimë e femicidit.²⁸² Në korrik të vitit 2020, një rast i përdhunimit të fëmijëve u raportua në media dhe në institucione, duke tërhequr vëmendje të madhe. Kjo çështje publike përfshiu një vajzë 15-vjeçare, e cila u përdhunua dhe kërcënua vazhdimisht nga roja i shkollës dhe tre burra të tjerë.²⁸³ Të katër kryerësit e krimit u arrestuan nga policia dhe hetimet janë duke u zhvilluar gjatë shkimit të këtij raporti. Një incident si ky, që është i dukshëm në publik dhe në media, hedh dritë mbi DhBGj dhe brutalitetin e krimeve të kryera në trupat e grave dhe vajzave.

Në një rast tjetër të DhBGj që pati një vëmendje të lartë publike, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) publikoi vendimin e saj më 4 gusht, 2020, për çështjen Tërshana kundër Shqipërisë, duke përmendur dështimin e autoriteteve shqiptare në hetimin efektiv të çështjes së ankuesit, si dhe u kërkoi atyre të paguanin dëmshpërblim për viktimën.²⁸⁴ Më 29 korrik 2009, pala e ankuar u sulmua me acid nga një sulmues i panjohur në rrugë, duke i shkakuar asaj lëndime të rënda.²⁸⁵ Ajo dyshoi se sulmi ishte organizuar nga ish burri i saj.²⁸⁶ Vendimi i GjEDNJ-së për këtë rast ishte një rikujtim domethënës për shtetin se ai është përgjegjës për luftimin dhe hetimin e mirëfilltë të DhBGj siç kërkohet nga Konventa e Stambollit dhe legjislacioni kombëtar.

²⁷⁴ Prokuroria e Përgjithshme, *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2019*, Prokuroria e Përgjithshme, 2020, fq. 108, http://www.pp.gov.al/web/kuvendit_raporti_vjetor_2019_28_3_2020_pp_perf_1864.pdf, (e qasur më 22 maj 2020).

²⁷⁵ Po aty.

²⁷⁶ 'UNDP and Swedish Government Join Forces to Combat Domestic Violence amid COVID-19' ('UNDP dhe Qeveria Suedeze i Bashkojnë Forcat për të Luftuar Dhunën në Familje në mes të pandemisë COVID-19'), *Medium.com*, 19 prill 2020, <https://medium.com/@albania.undp/undp-and-swedish-government-join-forces-to-combat-domestic-violence-amid-covid-19-3670c09c75b1>, (e qasur më 22 maj 2020).

²⁷⁷ E. Ballhysa, 'Debat: Karantina dhe Dhuna në Familje: Ulje e Rasteve apo mos Raportim i Saj?', *portavendore.al*, 24 prill 2020, <https://portavendore.al/2020/04/24/debat-karantina-dhe-dhuna-ne-familje-ulje-e-rasteve-apo-mos-raportim-i-saj/>, (e qasur më 22 maj 2020).

²⁷⁸ Prokuroria e Përgjithshme, *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2019*, Prokuroria e Përgjithshme, 2020, fq. 93.

²⁷⁹ Po aty.

²⁸⁰ Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara – Byroja Demokratike, të Drejtat e Njeriut dhe Puna, '2019 Country Reports on Human Rights Practices: Albania' (Raportet e Vendeve mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut 2019), *Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara – Byroja Demokratike, të Drejtat e Njeriut dhe Puna*, 2020, <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>, (e qasur më 22 maj 2020).

²⁸¹ Po aty.

²⁸² Puna me Autorë të Krimit – Rrjeti Evropian, 'Femicide across Albania: Every Eight Days a Woman is Killed!' ('Femicidi në të gjithë Shqipërinë: Çdo Tetë Ditë Vritet një Grua!'), *Puna me Autorë të Krimit – Rrjeti Evropian*, 2020, <https://www.work-with-perpetrators.eu/about-us/members/woman-to-woman-on-femicide>, (e qasur më 22 maj 2020).

²⁸³ N. Bogdani, 'Qindra Protestues Marshojnë në Tiranë për t'i thënë STOP Dhunës Seksuale', *Reporter.al*, 4 qershor 2020, <https://www.reporter.al/qindra-protestues-marshojne-ne-tirane-per-ti-thene-stop-dhunes-seksuale/>, (e qasur më 12 qershor 2020).

²⁸⁴ *Tershana v. Albania (Tershana vs. Shqipëria)* (2020) 48756/14, [https://hudoc.echr.coe.int/eng?fbclid=IwAR067Tq4YivTzQxGoA8xDuerd5besXwj7bbqmCchKd-AvFAAISM-uZO5-Ol#{"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-203825"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng?fbclid=IwAR067Tq4YivTzQxGoA8xDuerd5besXwj7bbqmCchKd-AvFAAISM-uZO5-Ol#{), (e qasur më 11 gusht 2020).

²⁸⁵ Po aty.

²⁸⁶ Po aty.

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Legjislacioni në lidhje me DhF në FBeH dhe Republika Srpska ka shënuar përparim me miratimin e ligjeve respektive për mbrojtje nga DhF dhe kriminalizimin e DhF/DhBGj. Megjithatë, përparimi sa i përket zbatimit, mbetet i kufizuar. Bashkëpunimi multi-sektorial i palëve të interesuara relevante në zbatimin e ligjit mungon, kryesisht në FBeH.²⁸⁷ Nuk ka një sistem zyrtar të mbledhjes së të dhënave për rastet e DhF.²⁸ Baza e të dhënave e FBeH që integron të dhëna nga stacionet e policisë, qendrat e mirëqenies sociale, shtëpitë e sigurta, strehimoret dhe linjat e ndihmës SOS nuk është bërë ende funksionale, pavarësisht nga themelimi i saj në 2014.²⁸⁹

Në vitin 2019, policia e FBeH regjistroi 1004 vepra penale të DhF, me 1010 autorë të raportuar, nga të cilët 523 u mbajtën në arrest.²⁹⁰ Duke qenë se të njëjtat të dhëna nuk janë në dispozicion për vitet e mëparshme, është e pamundur të përcaktohet nëse numri i rasteve të raportuara nga policia është rritur ose zvogëluar në këtë drejtim. Në Republika Srpska, numri i rasteve të DhF të raportuara në polici në 2019 ishte 1178, një rritje prej 16% nga 2018.²⁹¹ Numri i autorëve të DhF në 2019 ishte 1223, një rritje prej 16% kur krahasohet me të dhënat nga 2018, gjersa numri i viktimave/të mbijetuarave të DhF u rrit në 14% në 2019, me një total prej 1438 të identifikuar.²⁹² Policia në Republika Srpska raportoi se, nga numri i përgjithshëm i viktimave/të mbijetuarave në 2019, 488 kishin përjetuar dhunë të shkaktuar nga burrat e tyre, në 39% të numrit të përgjithshëm të viktimave/të mbijetuarave, lloji i dhunës ishte dhunë fizike ndërsa në 33% të rasteve ishte dhunë psikologjike.²⁹³

Mosdisponueshmëria dhe paarritshmëria e të dhënave DhF/DhBGj paraqet një sfidë të madhe në gjurmimin e efektivitetit të mekanizmave të zbatimit të ligjit si në nivelin e vendit ashtu edhe të njësive. Raportet e OShC-ve të grave, megjithatë, vërejnë pasaktësi në vlerësimin e numrit të rasteve të raportuara nga policia që regjistrohen në sistemin gjyqësor.²⁹⁴ Policia dekurajon viktimat/të mbijetuarat të raportojnë rastet e tyre dhe të kërkojnë mbrojtje duke i fajësuar ata, ose duke u përpjekur të ndërmjetësojë rastet e tyre dhe t'i bind ata që të mos ndërmarrin veprime kundër autorëve të krimit.²⁹⁵ Ka pasur raporte të policisë që urdhëron urdhëra mbrojtës emergjentë me vonesa, duke dështuar kështu të sigurojë mbrojtje efektive për viktimat/të mbijetuarat.²⁹⁶ Në përgjithësi, krimet e DhF shpesh trajtohen dhe paraqiten si prishje të rendit publik.

Asnjë përmirësim në çështjet që kanë të bëjnë me sanksionimin e rasteve të DhF/DhBGj nuk është vërejtur që nga periudha e mëparshme e raportimit. Proceset e gjata të procedurave gjyqësore mbeten shqetësuese dhe dekurajuese. Viktimave/të mbijetuarave të DhF nuk u sigurohet mbrojtja e duhur fizike e viktimës/të mbijetuarit dhe familjes së tyre gjatë kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, duke i lënë ata të prekshëm ndaj kërcënimeve ose sulmeve të mëtejshme nga kryerësit e tyre gjatë periudhës ndërmjet momentit të raportimit dhe momentit kur gjykata arrin një vendim. Për më tepër, prokurorëve thuhet se u mungon gatishmëria për të drejtuar hetimet e duhura të çështjeve të DhF duke siguruar që ka prova mbështetëse, të cilat do t'i lejonin ata të vazhdonin me ndjekjen penale edhe pas tërheqjes së mundshme të viktimave, siç parashikohet nga ligji.²⁹⁷

²⁸⁷ Avokuesit për të Drejtat e Njeriut & Qendra e Grave Trebinje, *Bosnia and Herzegovina: Stakeholder Report for the United Nations Universal Periodic Review (Bosnja e Hercegovina: Raporti i Palëve me Interes për Rishikimin Periodik Universal të Kombeve të Bashkuara)*, 2019, file:///C:/Users/elidel/Downloads/JS1_UPR34_BIH_E_CoverPage.pdf, (e qasur më 23 shtator 2020).

²⁸⁸ Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara – Byroja Demokratike, të Drejtat e Njeriut dhe Puna, 'Raportet e Vendeve mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut 2019', *Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara – Byroja Demokratike, të Drejtat e Njeriut dhe Puna*, 2020, <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/bosnia-and-herzegovina/>, (e qasur më 23 shtator 2020).

²⁸⁹ OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Bosnjë e Hercegovinë*, OSBE, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/423470?download=true>, (e qasur më 23 Maj 2020), fq. 14.

²⁹⁰ Federata e Bosnjës e Hercegovinës – Ministria e Punëve të Brendshme, *Informacija o Stanju Sigurnosti na Području Federacije BiH za Period Januar-Decembar 2019. Godine (Informata mbi Gjendjen e Sigurisë në Rajonin e Federatës së BeH për Periudhën janar-dhjetor 2019)*, Federata e Bosnjës e Hercegovinës – Ministria e Punëve të Brendshme, 2020, <http://www.fup.gov.ba/wp-content/uploads/2020/02/Informacija-2019.-godine-konacna.pdf>, (e qasur më 25 maj 2020), fq. 12.

²⁹¹ Ministria e Familjes, Rinisë dhe Sportit, *Republika Srpska, Informacija o Sprovođenju Opištem Protokola o Postupaњу u Slučajeva Nasilja u Porođici za 2019. Godine u Penubliци Српској (Informata mbi Zbatimin e Protokolit të Përgjithshëm të Operimit në rastet e Dhunës në Familje për vitin 2019 në Republikën Serbe)*, 2020, <https://tinyurl.com/y35u436l>, (e qasur më 18 shtator 2020), fq. 6.

²⁹² Po aty.

²⁹³ Po aty.

²⁹⁴ Avokuesit për të Drejtat e Njeriut & Qendra e Grave Trebinje, *Bosnja e Hercegovina: Raporti i Palëve me Interes për Rishikimin Periodik Universal të Kombeve të Bashkuara*, nëntor 2019.

²⁹⁵ Po aty.

²⁹⁶ Po aty.

²⁹⁷ Po aty.

KOSOVA

Numri i rasteve të DhF të raportuara në polici gjatë vitit 2019 u rrit në 1 915 krahasuar me 1 541 të raportuara në 2018.²⁹⁸ Zyra për Ndihmë dhe Avokim Viktimave (ZNAV) pranoi 1 353 raste të raportuara të DhF.²⁹⁹ Masat emergjente të sanksionuara nga qeveria dhe mbyllja e imponuar për shkak të pandemisë COVID-19 rezultoi në një numër të rritur të rasteve DhBGj/DhF në gjysmën e parë të vitit 2020.³⁰⁰ Nga janari deri në mars të vitit 2020, kishte një numër më të madh të rasteve të regjistruara krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019.³⁰¹ Rritja e rasteve të raportuara të DhF gjatë pandemisë COVID-19 ishte 30%.³⁰² Për më tepër, mbi 40 raste të dhunës seksuale u raportuan në polici në pesë muajt e parë të vitit 2020.³⁰³ Kjo rritje e rasteve të lidhura me DhF raportohet nga të gjitha grupet etnike në Kosovë.³⁰⁴ Vrasjet në lidhje me DhBGj/DhF kanë qenë të shpeshta në vitet e fundit. Tre gra u vranë nga anëtarët e familjes së tyre në 2019. Në qershor 2020, një grua tjetër u vra nga burri i saj, i cili më parë kishte marrë një dënim me kusht për ushtrim të dhunës fizike ndaj viktimës në të kaluarën.³⁰⁵ Mungesa e të dhënave publike dhe të qasshme mbi numrin e vrasjeve e bën të vështirë krahasimin e numrave nga një vit në tjetrin. Sidoqoftë, niveli i femicidit mbetet një shkak i madh shqetësimi.

ZNAV kërkoi urdhëra mbrojtje për 668 raste të DhF gjatë vitit 2019, nga të cilat 447 ishin të aprovuara nga gjykata.³⁰⁶ Të dhënat për numrin e rasteve të DhF që u

sollën para gjykatave nuk u bënë të disponueshme për publikun.³⁰⁷ Një bazë e integruar e të dhënave që mundëson monitorimin dhe ndjekjen penale të rasteve të DhF në Kosovë u krijua në fillim të vitit 2019,³⁰⁸ megjithatë institucionet kanë demonstruar hezitim për ta përdorur atë.³⁰⁹ Ky ngurrim paraqet një pengesë për mbledhjen e të dhënave për qëllime hulumtimi dhe avokimi, por gjithashtu tregon se si mbledhja e të dhënave për DhBGj ose DhF nuk trajtohet si prioritet.

E drejta për kompensim për familjen e një viktime të DhF, e vrarë nga burri i saj në 2011, u themelua me një vendim të Gjykatës Themelore në Prizren në nëntor 2019, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila konfirmoi dështimin e shtetit për të mbrojtur viktimën.³¹⁰ Megjithatë, Zyra Shtetërore e Avokimit parashtrroi një ankesë kundër vendimit, duke pretenduar se përgjegjësia për dëmshpërblim i takon Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke e çuar rastin përpara Gjykatës së Apelit, ku edhe ka mbetur gjatë shkrimit të këtij raporti.³¹¹

Një nga rastet e DhF-së të sanksionuara me burgim të përjetshëm, dënimi më i lartë, ishte ai në 2018 për vrasjen e një gruaje dhe vajzës së saj 9-vjeçare nga burri i gruas. Vendimi i shtatorit 2018 u kthye për rigjykim me një vendim të Gjykatës Supreme në qershor 2019, pavarësisht protestës së fuqishme kundër një rigjykimi nga OSHC-të e grave.³¹²

²⁹⁸ 'Komunikatë për Media', *Policia e Kosovës*, 15 prill 2020, <https://www.kosovopolice.com/komunikate-per-media-5/>, (e qasur më 13 prill 2020).

²⁹⁹ B. Iberdemaj, 'Gratë dhe Thirrjet e Humbura për Mbrojtje nga Dhuna në Familje', *Kallxo.com*, 14 prill 2020, <https://kallxo.com/gjate/analize/grate-dhe-thirrjet-e-humbura-per-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje/>, (e qasur më 13 maj 2020).

³⁰⁰ E. Billaca, 'Worrying Increase in Cases of Domestic Violence in Kosovo' (Rritje Shqetësuese e Rasteve të Dhunës në Familje), *Zëri i Amerikës*, 15 prill 2020, <https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-osce-domestic-violence/5373091.html>, (e qasur më 13 prill 2020).

³⁰¹ 'Komunikatë për Media', *Policia e Kosovës*, 15 prill 2020, <https://www.kosovopolice.com/komunikate-per-media-5/>, (e qasur më 13 prill 2020).

³⁰² 'UN Women: Ka rritje të dhunës në familje për 30 për qind', *epokaere.com*, 27 prill 2020, <https://www.epokaere.com/un-women-ka-rritje-te-dhunes-ne-familje-30-per-qind/>, (e qasur më 10 shtator 2020).

³⁰³ B. Bajrami, 'Mbi 40 Raste të Dhunës Seksuale për Pesë Muaj në Kosovë', *Koha.net*, 25 maj 2020, <https://www.koha.net/arberi/223236/mbi-40-raste-te-dhunes-seksuale-per-pese-muaj-ne-kosove/>, (e qasur më 13 qershor 2020).

³⁰⁴ Portali KoSsev, 'Domestic Violence Cases on the Increase Compared to Last Year' ('Rastet e Dhunës në Familje në Rritje Krahasuar me Vitin e Kaluar'), *KoSsev*, 24 prill 2020, <https://kossev.info/domestic-violence-cases-on-the-increase-compared-to-last-year/>, (e qasur më 13 prill 2020).

³⁰⁵ B. Iberdemaj, 'Dështimi në Parandalim, i Dyshuari për Vrasjen e Gruas e Kishte Rrahur edhe më Parë me Bisht të Sëpatës', *Kallxo.com*, 30 korrik 2020, <https://kallxo.com/ligji/deshtimi-ne-parandalim-i-dyshuari-per-vrasjen-e-gruas-e-kishte-rrahur-edhe-me-pare-me-bisht-te-sepates/>, (e qasur më 26 gusht 2020).

³⁰⁶ B. Iberdemaj, 'Gratë dhe Thirrjet e Humbura për Mbrojtje nga Dhuna në Familje', *Kallxo.com*, 14 prill 2020.

³⁰⁷ Po aty.

³⁰⁸ UN Women Evropë dhe Azi Qëndrore, 'Kosovo to Start Using an Integrated Database for Cases of Domestic Violence' ('Kosova do të Fillojë Përdorimin e një Databaze të Integruar për Rastet e Dhunës në Familje'), *UN UN Women Evropë dhe Azi Qëndrore*, 2019, <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2019/04/kosovo-to-start-using-an-integrated-database-for-cases-of-domestic-violence>, (e qasur më 13 maj 2020).

³⁰⁹ B. Iberdemaj, 'Gratë dhe Thirrjet e Humbura për Mbrojtje nga Dhuna në Familje', *Kallxo.com*, 14 prill 2020.

³¹⁰ B. Iberdemaj, 'Court Awards Family of Diana Kastrati 950000 Euros in Compensation' (Gjykata cakton kompensimin prej 950000 Euro për Familjen e Diana Kastratit), *Prishtina Insight*, 11 shtator 2019, <https://prishtinainsight.com/court-awards-family-of-diana-kastrati-950000-euros-in-compensation/>, (e qasur më 13 maj 2020).

³¹¹ B. Iberdemaj, 'Shteti Ankohet për Kompensimin e Familjes së Diana Kastratit', *Kallxo.com*, 29 tetor 2019, <https://kallxo.com/lajm/video-shteti-ankohet-per-kompensimin-e-familjes-se-diana-kastratit/>, (e qasur më 13 maj 2020).

³¹² RrGK, 'RrGK Kundër Kthimit në Rigjykim të Rastit të Vrasësit Pjetër Nrecaj', *RrGK*, 2019, <https://womensnetwork.org/sq/rrgk-kunder-kthimit-ne-rigjykim-te-rastit-te-vrasesit-pjeter-nrecaj/>, (e qasur më 13 maj 2020).

Profesionistët, përfshirë OShC-të e grave, që përfaqësojnë viktimat/të mbijetuarat kanë bërë publike raste të shumta të trajtimit joadekuat të rasteve të DhF nga institucionet përgjegjëse. Ato tregojnë se trajtimi jo i duhur i rastit, dënimi i butë, mos lëshimi i urdhreve detyrues të mbrojtjes ose largimit ose reagimi joadekuat, të gjitha shërbejnë si faktorë shtytës që kryerësit të pësërisin veprën penale. Një qëndrim i pakënaqësisë me Policinë e Kosovës për trajtimin e tyre të përgjithshëm të rasteve të DhF është i zakonshëm, duke filluar me

intervistimin joadekuat të viktimave deri tek masat që ata marrin kundër autorëve të veprës.³¹³ Krahës reagimit të policisë, gjykatat gjithashtu janë kritikuar gjerësisht në trajtimin e tyre neglizhent të gjykimeve të ndërlikdhura me DhF, përkatësisht për rritraumatizimin e viktimave/të mbijetuarave përmes intervistave të përsëritura të panevojshme, mungesës së infrastrukturës gjyqësore për të mbrojtur viktimat/të mbijetuarat nga përballja me kryerësit e tyre, si dhe si shkeljen e Procedurave të tjera të Kodit Penal.³¹⁴

MALI I ZI

Të dhënat mbi numrin e rasteve të raportuara dhe të sanksionuara të DhBGj/DhF për vitin 2019, në kohën e shkrimit të këtij raporti, nuk janë bërë ende të disponueshme për publikun. Një bazë e të dhënave që mundëson shkëmbimin e informatave midis Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Policisë, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Qendrave për Punë Sociale për rastet e DhF është krijuar në maj 2019.³¹⁵ Rezultatet në rritjen e efikasitetit të institucioneve në gjurmimin dhe luftimin e DhF mbeten të shihen. Gatishmëria dhe angazhimi për përdorimin efektiv të bazës së të dhënave është e domosdoshme për të siguruar që ajo i shërben qëllimit të saj të koordinimit ndërinstitutional për adresimin e DhF.

Legjislacioni i Malit të Zi për DhF/DhBGj është kryesisht në përputhje me Konventën e Stambollit, me përjashtim të ngacmimit seksual, i cili mbetet i pa sanksionuar me ligj, duke kontribuar në një numër të madh të viktimave/të mbijetuarave të pambrojtur. Përveç legjislacionit të avancuar, raportet kanë vërejtur pak progres në zbatimin efektiv të tij. Mungesa e vullnetit politik për promovim dhe mbrojtje nga DhBGj reflektohet kryesisht përmes koordinimit të dobët ndërinstitutional. Viktimat/të mbijetuarat kritikojnë trajtimin e ngadaltë dhe

joadekuat të rasteve të tyre, e cila është një nga pengesat kryesore për raportimin e tyre. Pengesat në raportim janë jashtëzakonisht shqetësuese, pasi ato mund të çojnë në rreziqe të vazhdueshme ose në rritje të dhunës.

Faktorët kulturorë të ngulitur në institucione përbëjnë një nga sfidat më të mëdha për mbrojtjen efektive të viktimave/të mbijetuarave të DhBGj. Policia rregullisht vendos barrën e dëshmisë mbi viktimën/të mbijetuarin, shpesh duke marrë anën e autorëve të krimit.³¹⁶ Megjithatë ligji parashikon dëbimin nga shtëpia të autorëve të krimit në rastet e DhF, kjo zbatohet rrallë nga policia.³¹⁷ Në vend të kësaj, viktimat/të mbijetuarat dhe fëmijët e tyre dërgohen në strehimore me strehim të përkohshëm. Në mungesë të strehimit dhe kufizimeve financiare alternative për ta siguruar atë, viktimat/të mbijetuarat e DhF nuk kanë asnjë alternativë tjetër përveç kthimit të kryerësit të tyre. Ky hendek në shërbimet dhe reagimet institucionale është mjaft shqetësues dhe është raportuar në botimet e mëparshme të *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor*. Gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk është vërejtur përmirësim në këtë drejtim as në të dhënat dhe burimet e disponueshme, as nga ana e OShC-ve e grave që luftojnë DhBGj.

³¹³ B. Iberdemaj, 'Gratë dhe Thirrjet e Humbura për Mbrojtje nga Dhuna në Familje', *Kallxo.com*, 14 prill 2020.

³¹⁴ Po aty.

³¹⁵ Delegacioni i Bashkimit Evropian në Malin e Zi, 'The Domestic Violence Data Base has been Established' ('Themelohet Databaza për Dhunën në Familje'), *Delegacioni i Bashkimit Evropian në Malin e Zi*, 2019, https://eeas.europa.eu/delegations/montenegro/63167/node/63167_id, (e qasur më 30 maj 2020).

³¹⁶ OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Malin e Zi*, OSBE, 2019.

³¹⁷ Po aty., fq. 16.

Dënimi i butë i DhF nga gjykatat mbetet një shqetësim kryesor në Malin e Zi dhe një trend simptomatik në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë me ligj, DhF dënohet me një dënim me burg prej një deri në dhjetë vjet, në praktikë, gjykatat malazeze në përgjithësi sanksionojnë kryerësit me gjobë ose me burgim mesatarisht deri në tre vjet.³¹⁸ Dhuna psikologjike dhe seksuale në pjesën më të madhe mbeten pa u gjykuar.³¹⁹ Në nëntor 2019, një autor i dhunës seksuale u dënua me vetëm gjashtë muaj burg nga Gjykata e Lartë e Bijelo Polje, pas vendimit të gjykatës paraprake që fillimisht liroi autorin e veprës.³²⁰ Numri i urdhrave të mbrojtjes mbetet i ulët, edhe në rastet e dhunës së përsëritur.³²¹

Në Malin e Zi, zbatimi i ligjit mbetet i ndryshueshëm varësisht nga zona gjeografike. Reagimi i policisë ndaj viktimave/të mbijetuarave nga komunitetet e ndryshme etnike besohet të jetë joadekuat dhe i bazuar në nocione paragjyquese. Për më tepër, informatat për raportimin e DhF në gjuhë të tjera nga ajo malazeze janë të padisponueshme, duke rezultuar kështu në qasje të pabarabartë në mbrojtjen e shtetit për viktimat e pakicave etnike.³²²

MAQEDONIA VERIORE

Maqedonia Veriore vazhdon të përballët me sfida kur bëhet fjalë për reagimet institucionale ndaj DhBGj. Platforma e Barazisë Gjinore raportoi se kishte tre vrasje nga janari deri në verën e vitit 2020 dhe në të gjitha rastet, institucionet kishin njohuri për rastet duke qenë se dhuna ishte raportuar edhe më parë, megjithatë ato nuk arritën të siguronin mbrojtjen e duhur.³²³

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Maqedonia Veriore ishte dëshmitare e një rënie të lehtë të numrit të rasteve të DhF të raportuara në polici. Sipas të dhënave nga Ministria e Brendshme,³²⁴ në vitin 2019 kishte gjithsej 989 raste (krahasuar me 1 006 në 2018) të raportuara për vepra penale në lidhje me DhF, nga të cilat 588 ishin raste të lëndimeve trupore (506 gra viktimat/të mbijetuara), 23 me lëndime të rënda trupore (14 gra viktimat/të mbijetuara), 366 raste të veprave penale që rrezikojnë sigurinë (318 gra viktimat/të mbijetuara) dhe pesë ishin raste të femicidit. Nga janari deri në mars të vitit 2020, kishte 241 vepra penale të raportuara rishtas në lidhje me DhF, nga të cilat 207 ishin gra viktimat/të mbijetuara.

Sidoqoftë, gjatë mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19, policia e Maqedonisë Veriore regjistroi një ulje të numrit të rasteve të DhF-së krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, gjë që mund të tregojë pamundësinë e viktimave/të mbijetuarave të DhF-së për qasje në një hapësirë të sigurt nga e cila do të mund të raportonin rastet e tyre ndërsa ishin vetë-izoluar me autorin e veprës. Gjatë mbylljes së vendit, si pasojë e masave emergjente të lidhura me COVID-19, dy gra u vranë nga partnerët e tyre.³²⁵ Ngjajshëm, në periudhën prill - qershor 2020, Ministria e Brendshme raportoi 193 vepra penale të lidhura me DhF krahasuar me 226 në të njëjtën periudhë të 2019.³²⁶

Nga ana tjetër, në vitin 2019 MPMS,³²⁷ regjistroi 1 555 raste të reja të DhF me 1 135 gra viktimat/të mbijetuara dhe 173 fëmijë viktimat/të mbijetuara. Gjatë periudhës ndërmjet 1 janarit dhe 15 majit 2020, kishte 505 raste të DhF të regjistruara rishtas. Dhuna psikologjike (në 1 275 raste) dhe dhuna fizike (në 787 raste) ishin format më të raportuara të DhF.

³¹⁸ Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara – Byroja Demokratike, Të Drejtat e Njeriut dhe Puna, 'Raportet e Vendeve mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut 2019', *Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara – Byroja Demokratike, të Drejtat e Njeriut dhe Puna*, 2020, <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/montenegro/>, (e qasur më 30 maj 2020).

³¹⁹ OSBE, *Sondazh mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Malin e Zi*, OSBE, 2019, fq. 12.

³²⁰ Po aty.

³²¹ Po aty., fq. 12.

³²² Po aty, fq. 58.

³²³ Platforma e Barazisë Gjinore, 'Reakcija: Nенавремената реакција на полицијата може да резултира во феминид' (*Reagim: Reagimi jo në kohë i policisë mund të rezultojë në feminid*), *Platforma e Barazisë Gjinore*, 2020, <https://tinyurl.com/y4lmffm5>, (e qasur më 18 shtator 2020).

³²⁴ Informatë e ndarë nga Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Maqedoninë Veriore.

³²⁵ Z. Hajro Jajaga, 'Shkup: Dy Viktima nga Dhuna në Familje Gjatë Pandemisë - Nuk Raportohen Rastet', *Radio Evropa e Lirë*, 16 maj 2020, <https://www.evropaelire.org/a/30615661.html>, (e qasur më 3 qershor 2020).

³²⁶ Informatë e ndarë nga Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Maqedoninë Veriore.

³²⁷ Po aty.

OSHC-të e grave deklarojnë se jo të gjitha rastet e DhF të raportuara në polici regjistrohen si të tilla. Ndonjëherë ato klasifikohen si kundërvajtje për prishjen e rendit dhe qetësisë publike, prandaj nuk marrin statusin e DhF.³²⁸ Klasifikime të tilla të gabuara janë konfirmuar gjithashtu nga Raporti Vjetor 2019 i Ministrisë së Brendshme, ku është identifikuar që stacionet e policisë pranuan 3196 ankesa të DhF dhe 470 prej tyre u klasifikuan si kundërvajtje.³²⁹ OSHC-të e grave gjithashtu vërejnë se shumë prej rasteve të raportuara në polici kanë të bëjnë me dhunë fizike, ndërsa viktimat/të mbijetuarat nuk raportojnë forma të tjera të dhunës, të tilla si dhunë psikologjike ose ekonomike, sepse ata besojnë se zyrtarët e policisë nuk do të veprojnë për këtë lloj dhune.³³⁰ Disa herë, viktimat/të mbijetuarat e DhF tërheqin deklaratat e tyre, që do të thotë se në raporte ato nuk do të regjistrohen më si të lidhura me DhF, por vetëm si ankesa, mbi të cilat policia nuk ndërmerr asnjë veprim tjetër.³³¹ Për më tepër, zyrtarët e policisë ndonjëherë i referojnë viktimat/të mbijetuarat e DhF

në Qendrat për Mirëqenie Sociale vetëm nëse fëmijët janë të përfshirë.³³² Kjo është problematike sepse gratë viktimat/të mbijetuarat të DhBGj duhet të referohen në qendra pavarësisht nëse kanë apo jo fëmijë apo nëse fëmijët e tyre ishin viktimat/të mbijetuar gjithashtu.

Megjithëse nga Ministria e Brendshme dhe MPMS kërkohet që të bashkëpunojnë dhe të informojnë njëri-tjetrin për rastet e reja të raportuara, kjo nuk ndodh në praktikë.³³³ Mungesa e një databaze të integruar për rastet e DhBGj/DhF paraqet një sfidë të madhe si për një numër të unifikuar të rasteve të raportuara para institucioneve përkatëse, ashtu edhe për sanksionimin përkatës të tyre. Në mungesë të të dhënave të tilla, është e vështirë të ndiqet trendi i rasteve të raportuara nga një vit në tjetrin si dhe të bëhen analiza në lidhje me efikasitetin institucional në trajtimin e tyre, dhe të zbatohet roli monitorues dhe avokues.

SRBIJA

Në vitin 2019, policia regjistroi gjithsej 28 214 raste të DhF në Serbi. Të dhënat tregojnë se 68% e rasteve të raportuara të DhF u vlerësuan nga policia si "me rrezik të lartë". Si është vepruar në rastet e DhF-së që nuk janë vlerësuar si me rrezik të lartë dhe për të cilat nuk është lëshuar asnjë urdhër masash urgjente, nuk mund të konkludohet në bazë të të dhënave në dispozicion. Hulmuesit gjithashtu nuk janë në gjendje të sigurojnë të dhëna se çfarë hapash janë ndërmarrë për rastet që janë vlerësuar nga policia si me rrezik të lartë. Duke pasur parasysh se Serbia ka nivel të lartë të femicidit dhe përpjekje për vrasje të grave në kontekstin e marrëdhënieve mes partnerëve dhe në familje, është e nevojshme të hetohet më tej nëse vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut ishin të përshtatshme në këto situata.³³⁴

Natyrë gjinore e dhunës ndaj grave në partneritet dhe në familje tregohet vazhdimisht në ndarjen gjinore të dhunuesve dhe viktimave/të mbijetuarave, sipas të dhënave të marra nga Qendra Autonome e

Grave në formën e kërkesave për Lirinë e Informimit. Gratë janë kryesisht viktimat/të mbijetuarat të dhunës së kryer nga partnerët e tyre aktualë ose të mëparshëm (në 69% të rasteve), si dhe të afërm të tjerë meshkuj (afërsisht 24%). Kur burrat janë viktimat/të mbijetuarat të DhF, në 73% të rasteve dhuna është kryer nga anëtarët të tjerë të familjes që janë burra.³³⁵

Përfaqësuesit e prokurorisë propozuan shtrirjen e 97% të të gjitha urdhrave të policisë për masa urgjente dhe përfaqësuesit e gjykatës miratuan 96% të propozimeve të prokurorisë. Kjo do të thotë që në vitin 2019, në Serbi, deri në 93% të urdhrave të policisë për masa emergjente (48 orë) u zgjatën deri në 30 ditë. Nëntë për qind e autorëve të krimeve shkelën urdhërat, megjithatë, duke pasur parasysh këto të dhëna, nuk ka asnjë mënyrë për të vlerësuar se numrin e shkeljeve të raportuara, ose sa shkelje të raportuara ishin proceduar në mënyrë joadekuate nga autoritetet.³³⁶

³²⁸ Po aty.

³²⁹ Ministria për Punë të Brendshme, *Годишен Извештај на Министертството за Внатрешни Работи (Raporti Vjetor i Ministrisë së Punëve të Brendshme)* 2019, <https://tinyurl.com/yxbo755k>, (e qasur më 1 shtator 2020).

³³⁰ Informatë e ndarë nga Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Maqedoninë Veriore.

³³¹ Po aty.

³³² Po aty.

³³³ Po aty.

³³⁴ T. Ignjatović, *Primena Zakona o Sprečavanju Nasilja u Porodici u Srbiji za Period Januar – Decembar 2019. Godine, Osmi Izveštaj o Nezavisnom Praćenju Primene Zakona (Zbatimi i Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje në Serbi për Periudhën janar–dhjetor 2019, Raporti i Tetë i Monitorimit të Pavarur të Zbatimit të Ligjit)*, Beograd, Qendra Autonome e Grave, 2020, https://www.womenngo.org.rs/images/vesti-20/Osmi_nezavisni_izvestaj_jan_dec_2019.pdf (e qasur më 11 gusht 2020), fq. 1.

³³⁵ Po aty., fq. 2.

³³⁶ Po aty., fq. 1.

Të dhënat tregojnë se mbrojtja afatgjatë e viktimave/të mbijetuarave të DhF mbetet një "pikë e dobët". Zyrat e prokurorëve në Serbi kanë ngritur padi për masa mbrojtëse në vetëm 2% të rasteve të dhunshme për të cilat masat urgjente janë zgjidhur, ndërsa procedurat civile, megjithëse urgjente, po tregohen joefektive, çfarë e dëshmon edhe dhuna e përsëritur.³³⁷ Tridhjetë përqind e autorëve ndaj të cilëve u aplikuan masa emergjente e kanë përsëritur dhunën.³³⁸

Bazuar në të dhënat nga Zyra e Dytë Themelore e Prokurorit Publik në Beograd, numri i aktakuzave kundër autorëve të DhF në periferitë përreth Beogradit u ul nga 654 në 2018 në 414 në 2019. Zyra e Prokurorit refuzoi gati një të katërtën e numrit të përgjithshëm të nxitjeve të dhunës në familje të ngritura në vitin 2019, duke i konsideruar të pabazuara. Paraburgimi u urdhërua kundër 120 autorëve të DhF, rastet e të cilëve kaluan nëpër gjykatë, ndërsa masat emergjente të largimit nga shtëpia dhe ndalimin e komunikimit me viktimën/të mbijetuarin u aplikuan ndaj 515 autorëve. Gjatë vitit 2019, bazuar në aktakuzat nga Zyra e Dytë Themelore e Prokurorit Publik në Beograd, 135 autorë të DhF u dënuan, u arrit marrëveshja për pranimin e fajësisë për 60 autorë dhe masat e sigurisë u vendosën ndaj 33 autorëve. Një total prej 230 autorësh janë sanksionuar penalisht. Në vitin 2019, gjykata i liroi si të pafajshëm pesë raste dhe një e treta u dënua me burgim, nga të cilët dënimi më i lartë ishte gjashtë vjet.³³⁹

Një krahasim i të dhënave sasiore bazuar në dosjet e Ministrisë e Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë Publike, të dhënat nga viti 2019 me të dhënat nga viti 2018 tregojnë trende të caktuara në parametrat kryesorë: raportimet e dhunës u rritën për 10% krahasuar me 2018; përsëritja e akteve të dhunës u

rrit për 60% krahasuar me vitin e kaluar; 42% më shumë plane individuale të përpiluara për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave krahasuar me vitin 2018.³⁴⁰

Megjithëse është e pamundur të përcaktohet numri i grave që vdiqën si rezultat i drejtpërdrejtë i DhBGj/DhF,³⁴¹ trendet e nivelit të lartë të femicidit nuk tregojnë asnjë ulje përgjatë viteve në Serbi.³⁴² Shifrat e larta të femicidit janë shqetësimi më i madh dhe kjo kërkon adresim të menjëhershëm në nivelin institucional.

Sa i përket viktimave/të mbijetuarave të trafikimit, të dhënat për 29 vendime gjyqësore të arritura në procedurat penale gjatë vitit 2019 u bënë të disponueshme nga Gjykata Themelore, të Larta dhe të Apelit në Serbi.³⁴³ Vendimet e shkallës së parë përfshinin 16 aktgjykime që mbulonin gjithsej 18 autorë: gjashtë persona u akuzuan për krime të trafikimit njerëzor, dy u akuzuan për trafikim njerëzor dhe ndërmjetësim në prostitucion, nëntë u akuzuan për ndërmjetësim në prostitucion dhe një u akuzua për trafikim të të miturve për birësim.³⁴⁴ Po atë vit, kishte një total prej 37 palësh të dëmtuara në vendimet e shkallës së parë, nga të cilët 14 (38%) ishin të mitur në kohën e kryerjes së veprës penale.³⁴⁵ Tridhjetë e gjashtë palë të dëmtuara (97%) ishin gra, ndërsa vetëm një palë e dëmtuar ishte burrë (3%).³⁴⁶ Aktgjykimet e shkallës së dytë përfshijnë 13 vendime gjyqësore të marra gjatë vitit 2019.³⁴⁷ Numri i përgjithshëm i autorëve në këto aktgjykime ishte 21.³⁴⁸ Vendimet e gjykatave tregojnë një trend të politikës së butë të ndëshkimit penal dhe një numër të madh të marrëveshjeve për pranim të fajësisë.³⁴⁹ Që nga fillimi i vitit 2020, Ekipi i Mbështetjes së Viktimave i organizatës së grave ASTRA identifikoi 22 viktima/të mbijetuara të reja të trafikimit njerëzor.³⁵⁰

³³⁷ Po aty.

³³⁸ Po aty., fq. 2.

³³⁹ Tanjug, 'Drugo Tuzilastvo: Pad Krivičnik Dela Porodično Nasilje' ('Zyra e Dytë Themelore e Prokurorit Publik: Rënia e Krimeve të Dhunës në Familje'), *Dnevnik*, 03 janar 2020, <https://www.dnevnik.rs/hronika/drugo-tuzilastvo-pad-krivichnik-dela-porodicnog-nasila-03-01-2020>, (e qasur më 18 maj 2020).

³⁴⁰ T. Ignjatović, *Zbatimi i Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje në Serbi për Periudhën janar-dhjetor 2019, Raporti i Tetë i Monitorimit të Pavarur të Zbatimit të Ligjit*, Beograd, Qendra Autonome e Grave, 2019, fq. 3.

³⁴¹ K. Stevanović, 'Dan Sećanja na Žene Žrtve Nasilja u Srbiji: Od Početka Godine Šest Žena Ubijeno u Porodičnom Nasilju' ('Dita Memoriale e Grave Viktima të Dhunës në Serbi: Që nga Fillimi i Vitit Gjashtë Gra Janë Vrrarë si Pasojë e Dhunës në Familje'), *BBC në gjuhën serbe*, 18 maj 2020, <https://www.bbc.com/serbian/lat/srbija-52704802>, (e qasur më 18 maj 2020).

³⁴² K. Đorđević, 'Osam Žrtava Porodičnog Nasilja od Početka Godine' ('Tetë Viktima të Dhunës në Familje nga Fillimi i Vitit'), *Politika*, 18 maj 2020, <http://www.politika.rs/sr/clanak/429841/Друштво/Осам-жртва-породичног-насилја-од-почетка-године>, (e qasur më 18 maj 2020).

³⁴³ ASTRA – Veprimi Anti-Trafikim, *Viktimat e Trafikimit Njerëzor në Procedurat Penale: Analiza e Praktikës Gjyqësore për vitin 2019 për Krimet e Ndërmjetësimit në Prostitucion, Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Trafikimi i të Miturve për Birësim*, ASTRA – Veprimi Anti-Trafikim, 2020, fq. 9.

³⁴⁴ Po aty., fq. 10.

³⁴⁵ Po aty., fq. 14.

³⁴⁶ Po aty.

³⁴⁷ Po aty., fq. 9.

³⁴⁸ Po aty., fq. 21.

³⁴⁹ Po aty., fq. 34.

³⁵⁰ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Serbi.

Hetimet joefektive në rastet e DhBGj janë si rezultat i mospërputhjes së vazhdueshme midis numrit të kallëzimeve penale dhe numrit të dënimeve, ku shumica e tyre rezultojnë në dënime me kusht.³⁵¹ Në vitin 2019, për 514 autorë të (stalking) ndjekjes (neni 138a i Kodit Penal), kallëzimet penale u refuzuan në 21% të rasteve, aktakuzat u ngritën për vetëm 13.4% të autorëve, dhe vetëm 9% e autorëve u dënuan.³⁵² Kur bëhet fjalë për ngacmim seksual, në vitin 2019, u raportuan vetëm 231 persona, 10.4% e raportimeve u refuzuan, u ngrit aktakuzë për 18.2% të personave dhe vetëm 14.3% u dënuan. Në vitin 2019, asnjë kërkesë për martesë të detyruar nuk u regjistrua në Serbi.³⁵³ Vlerësimi joadekuat i rrezikut për të parandaluar DhBGj përfshirë femicidin, dhe mungesa e lëshimit në kohë dhe zbatimit efektiv të urdhrave të mbrojtjes emergjente është evidente.³⁵⁴ Viktimat/të mbijetuarat të cilët raportojnë abuzuesit e tyre dhe vendosin të ngrisin padi në sistemin gjyqësor, marrin mbrojtje të pamjaftueshme gjatë procedurave gjyqësore, duke i ekspozuar ato tutje ndaj rrezikut të dhunës nga duart e autorit të veprës.³⁵⁵

Pretendimet se numri i zvogëluar i aktakuzave penale reflekton incidencën e zvogëluar të rasteve të DhF, mbeten të diskutueshme duke marrë parasysh mungesën e sistemit rigoroz të mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave për rastet e DhBGj në Serbi.³⁵⁶ Edhe tre vjet pas zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje, në kohën e shkrimit të këtij raporti, asnjë regjistër qendror nuk është krijuar në formë elektronike. Ky sistem elektronik i mbledhjes së të dhënave do të lehtësonte monitorimin dhe rishikimin e të dhënave nga institucionet kryesore si policia, zyrat e prokurorisë, gjykatat dhe qendrat e punës sociale.³⁵⁷ Mungesa e një sistemi që siguron mbledhjen e të gjitha të dhënave për të gjitha format e dhunës ndaj grave, si dhe reagimi institucional ndaj tyre, tregon mungesën e progresit në zbatimin e kërkesave të nenit 11 të Konventës së Stambollit.

³⁵¹ CEDAW, Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë, CEDAW, 2019, fq. 7.

³⁵² T. Ignjatović, *Zbatimi i Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje në Serbi për Periudhën janar-dhjetor 2019, Raporti i Tetë i Monitorimit të Pavarur të Zbatimit të Ligjit*, Beograd, Qendra Autonome e Grave, 2020.

³⁵³ Po aty.

³⁵⁴ CEDAW, Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë, CEDAW, 2019, fq. 7.

³⁵⁵ OSBE, *Mirëqenia dhe Siguria e Grave – Serbi*, OSBE, 2019.

³⁵⁶ CEDAW, Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë, CEDAW, 2019, fq. 8.

³⁵⁷ T. Ignjatović, *Zbatimi i Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje në Serbi për Periudhën janar-dhjetor 2019, Raporti i Tetë i Monitorimit të Pavarur të Zbatimit të Ligjit*, Beograd, Qendra Autonome e Grave, 2020, fq. 3.

Rekomandimet^{358*}

Përveç kornizës thelbësore ligjore për luftimin e DhBGj dhe DhF, Konventa e Stambollit (dhe Paketa e OKB-së e Shërbimeve Themelore) kërkon krijimin e një kornize institucionale për hartimin e politikave, koordinimin e

shërbimeve, mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe vlerësimin dhe bashkëpunimin me OShC-të. Krijimi i këtyre strukturave të kërkuara mbetet i mangët në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Numri i rasteve të sanksionuara të DhBGj

SHKURTIMISHT:

Përkundër progresit në harmonizimin e kornizave ligjore kombëtare me Konventën e Stambollit, jo të gjitha kërkesat janë transferuar në nivelet kombëtare, zbatimi i standardeve të sapo-vendosura mbetet i pabarabartë në rastin më të mirë. Kornizat ekzistuese ligjore nuk arrijnë të adresojnë në mënyrë efektive të gjitha format e dhunës, përfshirë ato që prekin në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat nga grupet e ndjeshme. Sanksionet e vendosura nuk janë në përpjesëtim me krimet dhe nuk arrijnë të shërbejnë si një parandalues.

BRENDA NJË VITI:

Legjislacioni mund të revidohet duke përfshirë ndryshime si: harmonizimin e plotë të Konventës së Stambollit, të gjitha format e dhunës dhe sanksioneve që shërbejnë si parandaluese dhe janë në përpjesëtim me peshën e krimit.

Qeveritë:

- Të penalizojnë të gjitha format e DhBGj (sipas Konventës së Stambollit).
- Të penalizojnë të gjitha format e ngacmimit kibernetik, kërcënimit dhe dhunës. Të ndryshojnë legjislacionin dhe/ose protokollet për të kërkuar hetimet ex. officio dhe ndjekjen penale për krime me bazë gjinore në mënyrë që veprat penale të mos varen plotësisht nga ankesa e parashtruar nga viktimat/të mbijetuarat dhe se procedurat mund të vazhdojnë edhe nëse viktimat/e mbijetuara tërhiqet nga deklarata ose ankesa.
- Të sigurojnë që legjislacioni e definon përdhunimin duke iu referuar elementit të vetëm përbërës – dhënies së pëlqimit.
- Të ndryshojnë legjislacionin për heqjen e gjobave si një formë dënimi për DhF.
- Të ndryshojnë kodet penale për të siguruar përfshirjen e rrethanave të rënduara të përcaktuara në Konventën e Stambollit, përfshirë krimet e kryera nga anëtarët e familjes.
- Të vendosin urdhra mbrojtjeje afatgjatë dhe/ose të përhershëm, të ndryshohet legjislacioni për t'u siguruar që shkella e një urdhëri mbrojtjeje është vepër penale.
- Heqja dhe sanksionimi i praktikës së ndërmjetësimit në rastet e DhBGj/DhF. Të krijojnë njësi të specializuara për të adresuar DhBGj/DhF brenda policisë dhe prokurorisë.

- Të përpilojnë udhëzime dhe forma të specializuara për të dokumentuar lëndimet për përdorim në procedurat penale (Shembull: Austri)
- Të njohin gjininë, orientimin seksual dhe shprehjen/identitetin gjinor si bazë për krime të urrejtjes.
- Të krijojnë dhe implementojnë baza të integruara të të dhënave me informacione mbi rastet e DhBGj
- Statistikat e DhBGj të jenë të disponueshme për publikun.

Institucionet e BE-së, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe organizatat donatore:

- Të mbështesin harmonizimin e plotë të legjislacionit në fuqi me Konventën e Stambollit, duke ndjekur rekomandimet e raporteve të GREVIOs.
- Të mbështesin kapacitetet e vendeve për të mbledhur statistika të ndara gjinore, përfshirë rastet e raportuara dhe të sanksionuara të DhBGj/DhF.
- Të financohen studime mbi format prevalente të ndryshme të DhBGj dhe normat e raportimit në shtetet e Ballkanit Perëndimor si pjesë e mbështetjes së përgjithshme për programet e parandalimit dhe mbrojtjes nga DhBGj.

^{358*} Duke pasur parasysh situatën e larmishme në secilin vend, rekomandimet janë të përgjithësuara, duke qenë të aplikueshme në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për secilin veprim të rekomanduar.

Numri i strehimoreve dhe linjave të ndihmës SOS

SHKURTIMISHT:

Shumica e vendeve në rajon përballen me një mungesë kronike të hapësirës së strehimit, veçanërisht jashtë kryeqyteteve, për viktimat/të mbijetuarat e DhBGJ për shkak të financimit të kufizuar nga shtetet.

BRENDA NJË VITI:

: Të krijohen mekanizmat e brendshëm të ankesave dhe formularët e vlerësimit para nisjes për t'u përdorur në të gjitha strehimoret si një çështje e rregulloreve të brendshme dhe të sigurohet alokimi shtesë për strehimoret dhe shërbimet e tjera të specializuara nga buxhetet kombëtare dhe lokale.

Qeveritë:

- Të sigurojnë që OShC-të e specializuara të grave mund të vazhdojnë të menaxhojnë strehimoret dhe të ofrojnë shërbime të tjera për gratë viktimat/të mbijetuarat të DhBGJ/DhF.
- Të sigurojnë financim të qëndrueshëm për strehimoret ekzistuese dhe të mundësojnë rritjen e numrit të strehimoreve dhe linjave të ndihmës me financim adekuat nga buxhetet në fuqi.
- Të sigurojnë strehimore dhe shërbime të linjave të ndihmës për të gjitha viktimat/të mbijetuarat e të gjitha formave të DhBGJ e jo vetëm për viktimat/të mbijetuarat e DhF.
- Të sigurojnë shpërndarjen proporcionale të strehimoreve në të gjithë vendet.
- Të sigurojnë disponueshmërinë e të gjitha shërbimeve për gratë nga komunitetet pakicë, përfshirë gratë rome.
- Të mbështesin zhvillimi i shërbimeve të specializuara për viktimat/të mbijetuarat e komunitetit LGBTQI+.
- Të sigurojnë që strehimoret janë të arritshme për viktimat/të mbijetuarat me aftësi të kufizuara.
- Të sigurojnë ofrimin e ndihmës (strehimore, OShC, punonjës socialë) pa ndonjë kërkesë për ngritjen e një kallëzimi penal dhe zbulimin e identitetit personal.
- Të krijojnë një standard minimal për strehimoret dhe linjat e ndihmës në përputhje me Konventën e Stambollit në bashkëpunim me ekspertët e fushës nga OShC-të e grave për të siguruar cilësinë e shërbimeve.

Institucionet e BE-së, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe organizatat donatore:

- Të apelojnë te qeveritë që të alokojnë fonde të mjaftueshme për strehimore siç kërkohet nga Konventa e Stambollit.
- Të bëjnë presion mbi qeveritë për të njohur rolin e OShC-ve të grave në ofrimin e shërbimeve të specializuara mbështetëse për gratë viktimat/të mbijetuarat të DhBGJ, heqjen e kufizimeve të panevojshme administrative dhe sigurimin e financimit të qëndrueshëm të këtyre shërbimeve përmes granteve afatgjata.
- Të inkurajojnë zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet e GREVIOs dhe të përfshihen këto rekomandime në Raportet e Vendeve të KE për Ballkanin Perëndimor.

Alokimi i fondeve për luftimin e DhBGJ

SHKURTIMISHT:

Fondet e pamjaftueshme, dhe në disa vende fondet e ulëta, pengojnë qasjen në strehimore, shërbime dhe mbrojtje të mirëfilltë për viktimat/të mbijetuarat e dhunës. Mbështetja për partnerët e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve që shteti është i detyruar të ofrojë në bazë të angazhimeve të tij ndërkombëtare, duhet të jetë e qëndrueshme.

BRENDA NJË VITI:

Të avancohet zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor për të siguruar burime të përshtatshme për shërbimet e DhBGJ.

Qeveritë:

- Të alokojnë burime financiare të përshtatshme dhe të qëndrueshme për OShC-të e grave për një ofrim të plotë të shërbimeve për gratë viktimat/të mbijetuarat të DhBGJ sipas detyrimeve që rrjedhin nga neni 8 i Konventës së Stambollit.
- Të sigurojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në të gjitha nivelet e qeverisjes.
- Të avancojnë sistemet e financave për të treguar të gjitha fondet shtetërore të grumbulluara për DhBGJ/DhF.
- Të themelojnë mekanizma transparentë për vlerësimin e zbatimit të politikave dhe përdorimit të buxhetit për DhBGJ në përputhje me nenin 10 të Konventës së Stambollit.

Institucionet e BE-së, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe organizatat donatore:

- Të ushtrojnë presion të shtuar diplomatik dhe politik për të siguruar financimin e duhur shtetëror sipas kërkesave të Konventës së Stambollit.
- Të apelojnë te qeveritë që të sigurojnë fonde të mjaftueshme për OShC-të e grave të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e DhBGJ/DhF, përfshirë grante afatgjata.
- Të adresojnë financimin e OShC-ve e grave dhe OShC-ve dhe se mbështetja financiare po drejtohet drejt organizatave jo qeveritare të organizuara nga qeveria në të gjithë rajonin.
- Të inkurajojnë qeveritë të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha nivelet e qeverisjes.
- Të shqyrtojnë mbështetjen e ofrimit të shërbimeve të specializuara për viktimat/të mbijetuarat e DhBGJ/DhF të ofruara nga OShC-të e grave përmes programeve rajonale siç është IPA III në rastet kur alokimet kombëtare dhe lokale nuk janë të mjaftueshme.

Lista e referencave

- The Advocates for Human Rights & Human Rights in Democracy, *Albania: Stakeholders Report for the United Nations Universal Periodic Review*, The Advocates for Human Rights & Human Rights in Democracy, 2019, https://www.theadvocatesforhumanrights.org/uploads/albania_report.pdf, (accessed 21 May 2020).
- The Advocates for Human Rights & Ženski Centar Trebinje, *Bosnia and Herzegovina: Stakeholder Report for the United Nations Universal Periodic Review*, The Advocates for Human Rights & Ženski Centar Trebinje, 2019, file:///C:/Users/elidel/Downloads/JS1_UPR34_BEH_E_CoverPage.pdf, (accessed 23 September 2020).
- ASTRA – Anti Trafficking Action, *Human Trafficking Victims in Criminal Proceedings: Analysis of Judicial Practice for 2019 for the Crimes of Mediation in Prostitution, Trafficking in Human Beings and Trafficking in Minors for Adoption*, ASTRA – Anti Trafficking Action, 2020, <https://drive.google.com/file/d/1T8nMxvpcAObeVjB9Bc6MNPaz0GOY-tbb/view>, (accessed 1 September).
- Autonomni Ženski Centar, 'National SOS Helpline: Unauthorised Recording!', *Autonomni Ženski Centar*, 2019, <https://www.womenngo.org.rs/en/news/1543-national-sos-helpline-unauthorized-recording>, (accessed 1 September 2020).
- Autonomni Ženski Centar, 'There was No Need to Create a New National SOS Helpline: The First Independent Report on the Activities of the Newly Formed National SOS Helpline for Women with Experience of Violence', *Autonomni Ženski Centar*, 2020, <https://www.womenngo.org.rs/en/news/1484-there-was-no-need-to-create-a-new-national-sos-helpline-the-first-independent-report-on-the-activities-of-the-newly-formed-national-sos-helpline-for-women-with-experience-of-violence>, (accessed 1 September 2020).
- Autonomous Women's Centre, 'Press Release', *Autonomous Women's Centre*, 2020, <https://www.womenngo.org.rs/en/news/1596-press-release>, (accessed 1 September 2020).
- AWEN Network, 'COVID-19, Threefold Increase in Calls for Help at the National Hotline for Domestic Violence Cases/Up to 6 Protection Orders Issued within One Day in Durrës District', *AWEN Network*, <https://awenetwork.org/covid-19-threefold-increase-in-calls-for-help-at-the-national-hotlinefor-domestic-violence-cases-up-to-6-protection-orders-issued-within-one-day-in-durresdistrict/?lang=en>, (accessed 8 August 2020).
- Ballhysa, E., 'Debati: Karantina dhe Dhuna në Familje : Ulje e Rasteve apo mos Raportim i Saj?', *portavendore.al*, 24 April 2020, <https://portavendore.al/2020/04/24/debati-karantina-dhe-dhuna-ne-familje-ulje-e-rasteve-apo-mos-raportim-i-saj/>, (accessed 22 May 2020).
- Beker K. et al., *Regional Report on Compliance with UN Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination against Women (CEDAW) and Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention) Relating to Discrimination of Roma Women in the Area of Healthcare, Child Marriages and Offering Support and Protection to Roma Women in Cases of Domestic Violence*, Belgrade, BIBIJA Roma Women Centre, 2019, <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2019/10/regional%20report%20on%20discrimination%20of%20roma%20women%20english.pdf?la=en&vs=1148>, (accessed 11 August 2020).
- Bogdani, N., 'Qindra Protestues Marshojnë në Tiranë për t'i thënë STOP Dhunës Seksuale', *Reporter.al*, 4 June 2020, <https://www.reporter.al/qindra-protestues-marshojne-ne-tirane-per-ti-thene-stop-dhunes-seksuale/>, (accessed 12 June 2020).
- Božović, N., 'Milutin Jeličić Jutka osuđen na tri meseca zatvora', *N1*, 10 July 2020, <http://rs.n1info.com/Vesti/a618438/Jutka-osudjen-na-tri-meseca-zatvora.html>, (accessed 12 September 2020).
- Constitutional Court of the Republic of Kosovo, *Judgment in the application of the President of the Assembly of the Republic of Kosovo (2009), Case No. K0162/18*, Prishtina, Constitutional Court of the Republic of Kosovo, 2019, https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/ko_162_18_agj_ang.pdf, (accessed 9 May 2020).
- Council of Europe, *The Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence*, Istanbul, Council of Europe, 2011, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000168008482e>, (accessed 22 September 2020).
- Delegation of the European Union to Montenegro, 'The Domestic Violence Data Base has been Established', *Delegation of the European Union to Montenegro*, 2019, https://eeas.europa.eu/delegations/montenegro/63167/node/63167_id, (accessed 30 May 2020).
- Đorđević, K., 'Osam Žrtava Porodičnog Nasilja od Početka Godine', *Politika*, 18 May 2020, <http://www.politika.rs/sr/clanak/429841/Друштво/Осам-жртва-породичног-насилја-од-почетка-године>, (accessed 18 May 2020).
- Elezovic, S., *Gender Analysis and Recommendations for Strengthening the Inclusion of Gender Perspective in the Implementation of the Action 'Improving Procedural Safeguards in Judicial Proceedings in Montenegro'*, Council of Europe, 2019, <https://rm.coe.int/gender-analysis-final-hf7/16809963c1>, (accessed 11 August 2020).
- Farnsworth, N. et al., *Where's the Money for Women's Rights? Funding Trends in the Western Balkans*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2020, <https://kvinna.tillkvinna.org/2020/06/01/wheres-the-money-for-womens-rights-2020/>, (accessed 26 August 2020).
- Federation of Bosnia and Herzegovina – Ministry of Interior, *Informacija o Stanju Sigurnosti na Području Federacije BiH za Period Januar-Decembar 2019. Godine*, Federation of Bosnia and Herzegovina – Ministry of Interior, 2020, <http://www.fup.gov.ba/wp-content/uploads/2020/02/Informacija-2019.-godine-konacna.pdf>, (accessed 25 May 2020).

- Gaćanica, L. et al, *Women's Rights in Western Balkans*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2019, <https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2019/11/Womens-rights-in-Western-Balkans.pdf>, (accessed 19 June 2020).
- Gavric, S., *Mapping of Policies and Legislation on Violence Against Women and the Istanbul Convention in Kosovo*, European Women's Lobby, 2019, https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-kosovo_report_web.pdf, (accessed 13 May 2020).
- Gender Equality Platform, 'Реакција: Ненавремената реакција на полицијата може да резултира во фемицид', *Gender Equality Platform*, 2020, <https://tinyurl.com/y4lmffm5>, (accessed 18 September 2020).
- Prokuroria e Pergjithshme, *Raport I Prokurorit te Pergjithshem mbi Gjendjen e Kriminalitetit per Vitin 2019*, Prokuroria e Pergjithshme, 2020, http://www.pp.gov.al/web/kuvendit-raporti_vjetor_2019_28_3_2020_pp_perf_1864.pdf, (accessed 22 May 2020).
- Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO), *GREVIO's (Baseline) Evaluation Report on Legislative and other Measures Giving Effect to the Provisions of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention): Montenegro*, Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO), 2018, <https://rm.coe.int/grevio-report-montenegro/16808e5614UNDP>, (accessed 23 September 2020).
- Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO), *GREVIO's (Baseline) Evaluation Report on Legislative and other Measures Giving Effect to the Provisions of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention): Serbia*, Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO), 2020, <https://rm.coe.int/grevio-report-on-serbia/16809987e3>, (accessed 17 May 2020).
- Hajro Jajaga, Z., 'Shkup: Dy Viktima nga Dhuna në Familje Gjatë Pandemisë - Nuk Raportohen Rastet', *Radio Evropa e Lirë*, 16 May 2020, <https://www.evropaelire.org/a/30615661.html>, (accessed 03 June 2020).
- Halilović, M., *Analysis of the Cost of Domestic Violence: Estimating the Cost of Multi-Sectoral Response at the Local Level in Bosnia and Herzegovina*, Sarajevo, UN Women, 2019, <https://tinyurl.com/y2ycs6nw>, (accessed 23 September 2020).
- Iberdemaj, B., 'Court Awards Family of Diana Kastrati 950000 Euros in Compensation', *Prishtina Insight*, 11 September 2019, <https://prishtinainsight.com/court-awards-family-of-diana-kastrati-95000-euros-in-compensation/>, (accessed 13 May 2020).
- Iberdemaj, B., 'Dështimi në Parandalim, i Dyshuari për Vrasjen e Gruas e Kishte Rrahur edhe më Parë me Bisht të Sëpatës', *Kallxo.com*, 30 July 2020, <https://kallxo.com/ligji/deshtimi-ne-parandalim-i-dyshuari-per-vrasjen-e-gruas-e-kishte-rrahur-edhe-me-pare-me-bisht-te-sepates/>, (accessed 26 August 2020).
- Iberdemaj, B., 'Gratë dhe Thirrjet e Humbura për Mbrojtje nga Dhuna në Familje', *Kallxo.com*, 14 April 2020, <https://kallxo.com/gjate/analize/grate-dhe-thirrjet-e-humbura-per-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje/>, (accessed 13 May 2020).
- Iberdemaj, B., 'Shteti Ankohet për Kompensimin e Familjes së Diana Kastrati', *Kallxo.com*, 29 October 2019, <https://kallxo.com/lajm/video-shteti-ankohet-per-kompensimin-e-familjes-se-diana-kastrati/>, (accessed 13 May 2020).
- Ignjatović, T., *Primena Zakona o Sprečavanju Nasilja u Porodici u Srbiji za Period Januar – Decembar 2019. Godine, Osmi Izveštaj o Nezavisnom Praćenju Primene Zakona*, Belgrade, Autonomous Women's Centre, 2020, https://www.womenngo.org.rs/images/vesti-20/Osmi_nezavisni_izvestaj_jan_dec_2019.pdf, (accessed 11 August 2020).
- 'Komunikatë për Media', *Kosovo Police*, 15 April 2020, <https://www.kosovopolice.com/komunikate-per-media-5/>, (accessed 13 April 2020).
- Kosovo Women's Network, *Kosovo Gender Analysis*, Kosovo Women's Network, 2018, <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>, (accessed 10 September 2020).
- Kosovo Women's Network, 'Letër shqetësuese nga Strehimoret e Kosovës për Koordinatorin Nacional', Prishtina, *Kosovo Women's Network*, 2019, <https://womensnetwork.org/sq/leter-shqetesuese-nga-strehimoret-e-kosoves-per-koordinatorin-nacional/>, (accessed 12 May 2020).
- Kosovo Women's Network, 'RrGK Kundër Kthimit në Rigjykim të Rastit të Vrasësit Pjetër Nrecaj', *Kosovo Women's Network*, 2019, <https://womensnetwork.org/sq/rrgk-kunder-kthimit-ne-rigjykim-te-rastit-te-vrasesit-pjeter-nrecaj/>, (accessed 13 May 2020).
- Law No. 02/L-17 on Social and Family Services, 2001, Republic of Kosovo.
- Law No. 03/L- 040 on Local Self Government, 2008, Republic of Kosovo.
- Lubani, M., *Mapping of Policies and Legislation on Violence Against Women and the Istanbul Convention in Albania*, European Women's Lobby, 2019, https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-albania_report_web.pdf, (accessed 21 May 2020).
- Министарство Породице, Омладине и Спорта, Република Српска, *Информација о Спровођењу Општег Протокола о Поступању у Случајева Насиља у Породици за 2019. Године у Републици Српској*, 2020, <https://tinyurl.com/y35u436l>, (accessed 18 September 2020).
- Министерство за Внатрешни Работи, *Годишен Извештај на Министерството за Внатрешни Работи*, 2019, <https://tinyurl.com/yxbo755k>, (accessed 1 September 2020).
- Ministry of Justice of the Republic of Kosovo, *Public Information Calling the Victims of Domestic Violence to Report their Cases Providing the Contacts of the Shelters and Police* [website], <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2208>, (accessed 12 May 2020).
- Organisation for Security and Co-operation in Europe Mission in Kosovo, *Shelters for the Victims of Domestic Violence in Kosovo*, Prishtina, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, https://www.osce.org/files/Report%20on%20Shelters%20for%20victims%20of%20domestic%20violence%20in%20Kosovo_eng.pdf, (accessed 23 September 2020).

Organisation for Security and Co-operation in Europe, *Survey on Well-Being and Safety of Women in Albania*, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/434849?download=true>, (accessed 21 May 2020).

Organisation for Security and Co-operation in Europe, *Survey on Well-Being and Safety of Women in Bosnia and Herzegovina*, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/423470?download=true>, (accessed 23 May 2020).

Organisation for Security and Co-operation in Europe, *Survey on Well-Being and Safety of Women in Montenegro*, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/424985?download=true>, (accessed 12 May 2020).

Organisation for Security and Co-operation in Europe, *Survey on Well-Being and Safety of Women in North Macedonia*, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/419264?download=true>, (accessed 27 May 2020).

Organisation for Security and Co-operation in Europe, *Survey on Well-Being and Safety of Women in Kosovo*, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/439781?download=true>, (accessed 12 May 2020).

Organisation for Security and Co-operation in Europe, *Well-being and Safety of Women – Serbia*, Organisation for Security and Co-operation in Europe, 2019, <https://www.osce.org/secretariat/419750?download=true>, (accessed 17 May 2020).

Petronijević, M., *Mapping of Policies and Legislation on Violence against Women and the Istanbul Convention in Serbia*, Europeans Women's Lobby, 2019, https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-serbia_report_web.pdf, (accessed 17 April 2020).

Republic of Kosovo Ombudsperson Institution, *Raporti Vjetor 2019 (Annual Report 2019)*, Prishtina, Republic of Kosovo Ombudsperson Institution, 2020, <https://www.oik-rks.org/2020/04/02/raporti-vjetor-2019/>, (accessed 09 May 2020).

Stevanović, K., 'Dan Sećanja na Žene Žrtve Nasilja u Srbiji: Od Početka Godine Šest Žena Ubijeno u Porodičnom Nasilju', *BBC na Srpskom*, 18 May 2020, <https://www.bbc.com/serbian/lat/srbija-52704802>, (accessed 18 May 2020).

Tanjug, 'Drugo Turobstvo: Pad Krivičkih Dela Porodično Nasilje', *Dnevnik*, 03 January 2020, <https://www.dnevnik.rs/hronika/drugo-tuzilastvo-pad-krivicnih-dela-porodicnog-nasila-03-01-2020>, (accesses 18 May 2020).

Tershana v. Albania (2020) 48756/14, [https://hudoc.echr.coe.int/eng?fbclid=IwAR067Tq4YivtZqXoGA8xDuerd5besXwj7bbqmCchKd-AvFAAISM-uZO5-OI#{"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-203825"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng?fbclid=IwAR067Tq4YivtZqXoGA8xDuerd5besXwj7bbqmCchKd-AvFAAISM-uZO5-OI#{), (accessed on 11 August 2020).

Tian, N. et al., *SIPRI Fact Sheet April 2020: Trends in World Military Expenditure*, 2019, SIPRI, 2020, https://www.sipri.org/sites/default/files/2020-04/fs_2020_04_milex_0.pdf, (accessed 28 April 2020).

Travers, E., 'Reports of Domestic Violence Increase in 2020', *Prishtina Insight*, 13 May 2020, <https://prishtinainsight.com/reports-of-domestic-violence-increase-in-2020/>, (accessed 4 August 2020).

UN Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Serbia*, UN Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, 2019, <https://undocs.org/en/CEDAW/C/SRB/CO/4>, (accessed 16 May 2020).

'UNDP and Swedish Government Join Forces to Combat Domestic Violence amid COVID-19', *Medium.com*, 19 April 2020, <https://medium.com/@albania.undp/undp-and-swedish-government-join-forces-to-combat-domestic-violence-amid-covid-19-3670c09c75b1>, (accessed 22 May 2020).

United States Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, *2019 Country Reports on Human Rights Practices: Albania*, United States Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, 2020, <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>, (accessed 22 May 2020).

United States Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, *2019 Country Reports on Human Rights Practices: Bosnia and Herzegovina*, United States Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, 2020, <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/bosnia-and-herzegovina/>, (accessed 23 September 2020).

United States Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, *2019 Country Reports on Human Rights Practices: Montenegro*, United States Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labour, 2020, <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/montenegro/>, (accessed 30 May 2020).

'UN Women: Ka rritje të dhunës në familje për 30 për qind', *epokaere.com*, 27 April 2020, <https://www.epokaere.com/un-women-ka-rritje-te-dhunes-ne-familje-30-per-qind/>, (accessed 10 September 2020).

UN Women Europe and Central Asia, *Temporary Shelters set up to Quarantine Safely Domestic Violence Survivors in Kosovo*, UN Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, 2020, <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2020/5/temporary-shelters-set-up-to-quarantine-safely-domestic-violence-survivors>, (accessed 12 May 2020).

Women Against Violence European Network, *Mapping of Sexual Violence Services in the Western Balkans and Turkey*, Vienna, Women Against Violence European Network, 2019, https://cssplatform.org/wp-content/uploads/2019/10/CSSPWAVE_SVReport190927_web.pdf, (accesses 4 August 2020).

Work with Perpetrators – European Network, 'Femicide across Albania: Every Eight Days a Woman is Killed!', *Work with Perpetrators – European Network*, 2020, <https://www.work-with-perpetrators.eu/about-us/members/woman-to-woman-on-femicide>, (accesses 22 May 2020).

GRATË MBROJTËSE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Pozicioni i Grave Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut (GMDNJ) nuk ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe raportuese. Gratë aktiviste janë akoma më të ekspozuara ndaj fyerjeve dhe kërcënimeve si për shkak të aktivizimit ashtu edhe për shkak të gjinisë së tyre. Duke analizuar situatën në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, është e dukshme që dy çështje kryesore përcaktojnë pozicionin e GMDNJ-ve: (mungesa e) njohjes së statusit ligjor të GMDNJ-ve, dhe normave shoqërore (përfshirë qëndrimet patriarkale) ndaj grave dhe rrjedhimisht GMDNJ.

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk kanë përkufizime ligjore ose kategori ligjore për Gratë Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut (GMDNJ).³⁵⁹ Në BeH, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë Veriore, MDNJ,³⁶⁰ ose ndryshe GMDNJ³⁶¹ nuk njihen si një kategori e veçantë ligjore. Kjo do të thotë që të gjitha shkeljet dhe sulmet ndaj tyre konsiderohen vepra të përgjithshme penale. Për më tepër, sulmet, kërcënimet, sulmet fizike dhe psikologjike ose kërcënimet e raportuara tek autoritetet shtetërore shpesh neglizhohen, nuk merren parasysh ose nuk hetohen si duhet, duke kontribuar kështu në një praktikë të mosndëshkimit ndaj autorëve të krimit. Për më tepër, GMDNJ-të nuk kanë as qasje më të lehtë në institucione që mund të lehtësojnë punën e tyre, as mbrojtje institucionale në raste kërcënimesh ose presionesh nga akterë politikë ose shoqërorë.³⁶² Këta janë faktorë që do ta lehtësojnë punën e tyre në mënyrë thelbësore. Deklarata për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) vendosi një moment të rëndësishëm në njohjen universale të rolit thelbësor dhe legjitim të luajtur nga MDNJ -të. Jo vetëm që ka siguruar njohjen e MDNJ -ve, por gjithashtu ka kontribuar në rritjen e visibilitetit dhe legjitimitetit të punës së tyre, si dhe nevojën për një mbrojtje më të mirë. Në 2019, Shqipëria ratifikoi Deklaratën e OKB-së mbi

Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut, ndërsa Deklarata e njëjtë është ratifikuar edhe në Serbi, megjithëse termi MDNJ nuk njihet në mënyrë eksplicite në sistemin ligjor. Këtu Kodi Penal (nën titullin "Diskriminimi Racor dhe Diskriminimi Tjetër") përcakton se do të shqiptohet një ndëshkim për këdo që persekuton organizata ose individë për shkak të angazhimit të tyre për barazinë e njerëzve. Nuk ka asnjë provë të zbatimit të këtij neni në sistemin juridik të Serbisë, përkundër faktit se kishte një numër rastesh të paraqitura para gjykatave. Qëllimi i këtij neni është gjithashtu i kufizuar vetëm në MDNJ -të që punojnë në çështje të barazisë, duke i lënë jashtë të gjitha MDNJ-të e tjera.³⁶³

GMDNJ-të janë të ekspozuara ndaj formave dhe shkallëve të ndryshme të sulmeve në bazë të gjinisë së tyre. Llojet dhe mjetet e sulmeve zakonisht motivohen nga normat, qëndrimet dhe vlerat mbizotëruese, tradicionale shoqërore, kulturore ose fetare, të pranishme në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. GMDNJ-të më së shumti të prekura nga këto norma janë ato të përfshira në fushën e përgjithshme të të drejtave të njeriut si barazia gjinore, dhuna me bazë gjinore (GMDNJ), të drejtat e personave LGBTQI +, por edhe në fusha që sfidojnë dhe mbajnë përgjegjësi qeveritë, siç është korrupsioni dhe krimet e luftës.

Në Ballkanin Perëndimor, njohja e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të grave ndahet midis nevojës së qeverive kombëtare për njohuritë, përvojën dhe të dhënat e tyre, dhe qasjeve kufizuese ndaj shoqërisë civile në përgjithësi. Përkundër tkurrjes së vazhdueshme të hapësirës për shoqërinë civile, kontributet e tyre në legjislacion dhe avancimin e të drejtave të grave vazhdojnë. Beteja e gjatë për qasje dhe ndikim ende vazhdon në këto periudha të pasigurisë për demokracitë e Ballkanit Perëndimor.

³⁵⁹ A. Xhaho et al., *Human Rights Defenders in the Western Balkans: Intimidation Instead of Recognition (Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes)*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, <https://crd.org/wp-content/uploads/2019/12/Human-Rights-Defenders-Report.pdf>, (e qasur më 10 qershor 2020).

³⁶⁰ MDNJ vepron individualisht dhe / ose në bashkëpunim me të tjerët, për të promovuar dhe për t'u përpjekur për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga: Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të Komisionerit të Lartë, *Neni 1, Deklarata për të Drejtën dhe Përgjegjësinë e Individëve, Grupeve dhe Organeve të Shoqërisë për të Promovuar dhe Mbrojtur të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut të Njohura Universalisht*, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/rightandresponsibility.aspx>, (e qasur më 6 qershor 2020).

³⁶¹ Sipas përkufizimit të dhënë nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, GMDNJ-të janë gra të cilat, individualisht ose në bashkëpunim me të tjerët, veprojnë për të promovuar ose mbrojtur të drejtat e njeriut, duke mbuluar të drejtat e grave dhe çështjet e barazisë gjinore. Për shkak të ngjashmërive të situatave me të cilat përballen, termi do të shqyrtohet në mënyrë që të përfshijë burra dhe mbrojtës jo-binarë të të drejtave të njeriut që punojnë në çështjet e barazisë gjinore.

³⁶² A. Xhaho et al. *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, fq. 4, 50.

³⁶³ Po aty.

Koalicioni Rajonal për Integrimin e Perspektivës Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE

(I përbërë nga organizata partnere të Kvinna till Kvinna, anëtarët e tyre dhe organizata të tjera brenda rrjeteve të tyre) i dërgoi një letër të hapur përfaqësuesve të ndryshëm të rangut të lartë në Komisionin Evropian, duke adresuar, midis çështjeve të tjera, mungesën e perspektivave gjinore në diskutimet mbi reformat që shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëjnë gjatë procesit të pranimit në BE, në kuadër të Samitit të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Zagreb në maj 2020. Letra e hapur ngriti çështjen e mungesës së zotimeve në të gjithë rajonin për avancimin e barazisë gjinore, veçanërisht e lidhur

me rritjen shqetësuese të DhBGj në Ballkanin Perëndimor dhe mungesën e një vlerësimi gjinor se si pandemia COVID-19 mund të ndikojë ndryshe te burrat dhe gratë, veçanërisht në lidhje me të drejtat e tyre të punës, duke marrë parasysh shkeljet e të drejtave të punës në shkallë të gjerë.³⁶⁴ Në këtë shembull, dhe të gjithë të tjerët në këtë kapitull, OShC-të e grave tregojnë se ato reagojnë shpejt dhe vazhdimisht. Për më tepër, OShC-të e grave organizohen nëpër rrjetet e tyre për të bërë presion mbi qeveritë, në nivel rajonal dhe kombëtar, duke përfaqësuar zërat e grave në zona ku ato përndryshe mund të jenë të heshtura ose të nën-përfaqësuar.

SULMET NDAJ GRAVE MBROJTËSE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Kjo periudhë raportuese u shënua nga sulme, kërcënime dhe ngacmime të GMDNJ, përfshirë gratë aktiviste dhe gazetare. Sulmet nuk ishin të motivuara ekskluzivisht nga tema specifike, por shpesh ishin të rrënjësura në nocionin e gjinisë dhe gjithçka që ngërthen ky konstrukt shoqëror. Prandaj, gratë gazetare, politike dhe aktiviste u vunë në shënjestër dhe u sulmuan në mënyra shumë të veçanta dhe me bazë gjinore - duke iu referuar integritetit të tyre psikik (kërcënime me përdhunim, fyerje për pamjen e jashtme ose orientimin seksual), kërcënime ndaj anëtarëve të familjes së tyre (veçanërisht fëmijëve të tyre) dhe diskreditim i punës së tyre (thirrja mbi vlerat morale, vlerat fetare, turpërimi). Normat shoqërore dhe mentaliteti patriarkal vazhduan të nxisin forma të ndryshme të dhunës në këtë periudhë raportuese. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në Ballkanin Perëndimor, zyrat ose hapësirat e OShC-ve ku ato organizohen janë hapësira dhune dhe shpesh janë nën shënjestër të sulmeve nga nacionalistët e ekstremist të djathtë ose grupet që kanë lidhje me regjimet në pushtet. Lidhur me GMDNJ-të që punojnë ose janë vullnetarë për këto OShC, dhe janë publik në aktivizmin e tyre dhe ngritjen e vetëdijes, sulmet mund të mos jenë të drejtuara

gjithmonë ndaj tyre personalisht, përkundrazi, këto GMDNJ ndonjëherë shërbejnë si magnet për sulme në vendet e tyre të punës. Ata që kundërshtojnë punën e OShC-ve në Ballkanin Perëndimor dhe sulmojnë zyrat e OShC-ve gjithashtu tkurri në mënyrë hapësirë për veprimtarinë e tyre siç është raportuar në secilin botim të *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor*, përfshirë këtë raport.

Personat dhe aktivistët LGBTQI + (veçanërisht aktivistë të shquar/publik) mbeten më të shënjestruarit dhe sulmet janë konstante në hapësirat publike. Personat LGBTQI + janë nën kërcënim thjesht në bazë të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore. Është bërë përparim shumë i kufizuar në këtë drejtim në secilin vend të Ballkanit Perëndimor. Sulmet janë gjithashtu të lidhura ngushtë me boshllëqet ekzistuese në legjislacion, gjuhën e urrejtjes nga zyrtarët qeveritarë dhe një mungesë serioze të ndërhyrjes nga policia dhe autoritetet shtetërore. Si rezultat i konteksteve armiqësore në të cilat jetojnë njerëzit, gjithnjë e më tepër persona LGBTQI + raportohet se kanë emigruar nga vende të tilla si Shqipëria dhe BeH.³⁶⁵

³⁶⁴ Koalicioni Rajonal për Integrimin e Perspektivës Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE, 'Open letter - The 2020 Western Balkans Summit: A Missed Opportunity' (Letër e Hapur - Samiti i Ballkanit Perëndimor 2020: Një Shans I Humbur), *Koalicioni Rajonal për Integrimin e Perspektivës Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE*, 2020, https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/05/WB-Summit-Gender-Perspective_2020-05-15-18.pdf, (e qasur më 21 qershor 2020).

³⁶⁵ ILGA-Evropë, *Annual Review of the Human Rights Situation of Lesbian, Gay, Bisexual, Trans and Intersex People Covering Events that Occurred in Europe and Central Asia between January-December 2019* (Rishikimi Vjetor i Situatës së të Drejtave të Njeriut të personave Lezbike, Homoseksual, Biseksual, Trans dhe Interseks me Mbulim të Ngjarjeve që ndodhën në Evropë dhe Azi Qëndrore ndërmjet janarit dhe dhjetorit), Bruksel, ILGA-Evropë, 2020, <https://www.ilga-europe.org/sites/default/files/Annual%20Review%202020.pdf>, (e qasur më 1 qershor 2020).

Për GMDNJ-të, kanalet më të shpeshta për sulme verbale dhe ngacmime gjatë periudhës së raportimit ishin mediat sociale, të shoqëruara nga posta elektronike dhe telefonatat. Pandemia globale COVID-19 ka pasur gjithashtu një ndikim negativ në GMDNJ, pasi hapësira për aktivizëm dhe lirinë e medias u tkuir më tej në Ballkanin Perëndimor. Për shembull, në BeH, propozimet legislative që synojnë ndëshkimin e qarkullimit të informacionit që mund të shkaktojë panik shoqëror rrezikuan të kufizonin punën e gazetarëve dhe lirinë e tyre të shprehjes në platformat e mediave sociale. Në Serbi, ka pasur raporte për gazetarë të cilët u ndaluan të merrnin pjesë në konferenca për shtyp, dhe nga marrja e informacionit nga autoritetet shëndetësore ose dokumentimi i operacioneve të zyrtarëve të zbatimit të ligjit.³⁶⁶ Fushatat e shpifjeve mediatike vazhdojnë të jenë një metodë popullore kundër MDNJ-ve, dhe në shumë raste, GMDNJ-ve në veçanti. Sulmet fizike ndaj aktivistëve dhe gazetarëve LGBTQI + vazhdojnë (shih shembujt specifikë të vendit në këtë kapitull) por janë më pak në krahasim me sulmet në internet. Në Malin e Zi, sipas *Raportit të Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut në Ballkanin*

*Perëndimor*³⁶⁷, shumë MDNJ u përpoqën të raportonin sulme në internet (në formën e abuzimit verbal dhe/ose kërcënimeve), por këto ankesa janë hedhur poshtë pothuajse të gjitha nga prokurorët të cilët nuk gjetën në to prova të aktivitetit kriminal ose baza të mjaftueshme për ngritjen e akuzave. Ndjekja penale për krimet e urrejtjes ose sulmet ndaj GMDNJ është e ngadaltë dhe joefikase. Ndërsa procedurat zyrtare shpesh zgjasin shumë vite, GMDNJ-të mbeten të pambrojtura dhe të ekspozuara ndaj kërcënimeve dhe presionit të vazhduar. Normalizimi i mosndëshkimit për këto krime dërgon një mesazh të rrezikshëm për të gjithë individët dhe grupet që synojnë GMDNJ në shtetet e Ballkanit Perëndimor, derisa veprimet e tyre ka të ngjarë të mbeten pa u ndëshkuar.

Kvinna till Kvinna gjurmon të gjitha incidentet dhe sulmet ndaj GMDNJ-së në Ballkanin Perëndimor në bazë vjetore. Qëllimi i këtij kapitulli mbi *Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor* është të raportojë lidhur me këto incidente dhe të bëjë azhurnimin e të dhënave nga botimet e mëparshme të raportit mbi procedurat në vazhdim, aty ku është e mundur.

SHQIPËRIA

Krahasuar me periudhat e mëparshme të raportimit, nuk ka pasur as përmirësime as veprime në favor të mbrojtjes, ndërgjegjësimit ose promovimit të GMDNJ. Janë regjistruar sulme të reja ndaj personave LGBTQI + dhe grave gazetare. Mbrojtësit e të Drejtave Civile – një OShC me bazë në Suedi, identifikojnë që MDNJ -të dhe GMDNJ-të më të rrezikuara në Shqipëri janë ato që punojnë për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve LGBTQI +, viktimat/të mbijetuarat e trafikimit dhe forma të tjera të DhBGj, si dhe gazetarë hulumtues që sfidojnë qeverinë në pushtet. GMDNJ janë veçanërisht subjekt i sulmeve me bazë gjinore, të tilla si frikësimi në internet dhe ngacmimi seksual.³⁶⁸ Këto taktika të seksualizuara të frikësimit dhe ngacmimit nuk janë prezente tek burrat aktivistë. Sipas Mbrojtësve të të Drejtave Civile, aktivistët LGBTQI + dhe ata që punojnë për të drejtat e personave në prostitucion, janë subjekt i sulmeve të shënjestruara dhe më shumë se të tjerët kanë gjasa të përballen me dhunë të përhershme psikologjike,

dhunë seksuale dhe kërcënime anonime të sulmit fizik. GMDNJ-të që punojnë me viktimat/të mbijetuarat e trafikimit ose rastet e dhunës në familje (DhF), janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të mëdha të sigurisë dhe është e zakonshme që ata të jenë nën kërcënime akute nga kryerësit e krimit të përfshirë në rastet në të cilat ata punojnë. GMDNJ-të u përballën me diskriminime të shumta, për shkak të gjinisë dhe statusit të tyre specifik personal - aktivizmit të tyre.

Më 12 nëntor, Anxhela, një grua transgjimore nga Tirana, u rrah rëndë nga pesë burra. Anxhela ishte ulur në një stol kur u godit në pjesën e pasme të kokës dhe u rrah derisa ishte pa ndjenja, duke pësuar dëmtime në kokë dhe në fytyrë. Deri më tani nuk ka pasur arrestime, megjithëse zona ishte e mbuluar me kamera. Sipas Aleancës Kundër Diskriminimit të Personave LGBT, Anxhela është sulmuar shpesh dhe ka bërë shumë vizita në spitale dhe stacione policie.

³⁶⁶ Këshilli i Evropës, 'Statement by Council of Europe Commissioner for Human Rights: Press Freedom Must not be Undermined by Measures to Counter Disinformation about COVID-19' ('Deklaratë nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës: Liria e Shtypit nuk duhet Minuar për shkak të Masave Kundër Dezinformimit rreth COVID-19'), *Council of Europe*, 2020, <https://www.coe.int/en/web/media-freedom/-/press-freedom-must-not-be-undermined-by-measures-to-counter-disinformation-about-covid-19>, (e qasur më 10 qershor 2020).

³⁶⁷ A. Xhaho et al., *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019.

³⁶⁸ Po aty., p. 6.

Aktivizmi i Anxhelës e bën atë të dukshme në hapësirat publike dhe qytetare; ajo ishte pjesë aktive e konferencës së fundit ndërkombëtare LGBTQI + që u zhvillua në Tiranë si dhe ajo ishte në rreshtin e parë të aktivistëve që marshuan në marshimin e parë të Tiranës Dyke.³⁶⁹ Një sulm i tillë i dhunshëm nënkupton pasoja të mëdha për njerëzit që punojnë jashtë konteksteve heteronormative, ku shëndeti dhe siguria e tyre mund të rrezikohen në një shkallë serioze. Deklaratat negative dhe gjuha e urrejtjes janë përdorur shpesh edhe si mjete kundër grave përfaqësuese të OShC-ve.³⁷⁰

Gjuha e urrejtjes nga udhëheqësit politikë dhe figurat publike është rritur gjithashtu. Në tetor, deputeti Kujtim Gjuzi (Partia Konservatore) kërcënoi publikisht njerëzit LGBTQI + në një emision televiziv politik që transmetohet në një kohë të shikueshmërisë së lartë. Deklarata negative kishte gjithashtu nga Drejtuesi i emisionit. Të dy rastet u raportuan në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit Shqiptar të Medias, i cili lëshoi një paralajmërim, por nuk vendosi asnjë sanksion ndaj Gjuzit ose kanalit.³⁷¹

Në vitin 2020 Shqipëria ra për dy pikë në renditjen e Lirisë së Shtypit Botëror për vitin 2020, në vendin e 84-të nga vendi 82 një vit më parë.³⁷² 2019 është përshkruar si viti më i vështirë për gazetarët në Shqipëri për shkak të një rritje shqetësuese të kërcënimeve verbale dhe fizike ndaj tyre. Pothuajse gjysma e sulmeve në vend ishin "sulme ndaj sigurisë

fizike dhe integritetit të gazetarëve", pasuar nga "ngacmimi dhe frikësimi i gazetarëve", dhe "akte të tjera që kanë një efekt tronditës mbi lirinë e medias".³⁷³ Gazetarja shqiptare Sonila Meco ishte subjekt i abuzimit dhe ngacmimit në internet pasi disa portale mediatike e akuzuan atë për mosrespektim të mjekëve vendorë në një postim në rrjetet sociale: Pas një komenti në Facebook, duke kritikuar komentet e bëra nga një mjek i vetëm në lidhje me shtetasit shqiptarë të bllokuar në kufi me Greqinë dhe në pamundësi të kthehen, gazeta Gazeta Tema botoi një artikull që paraqet znj. Meço si një armik për sigurinë kombëtare çfarë rezultoi në reagime publike dhe komente abuzive në internet, përfshirë kërcënime të dhunës seksuale ndaj saj.³⁷⁴

Neglizhenca e autoriteteve shqiptare ndaj incidenteve të tilla dhe neglizhimi ose hetimi jo i duhur, kontribuon në mosndëshkimin e autorëve të sulmeve ndaj GMDNJ-ve. GMDNJ-të gjithashtu raportojnë se autoritetet e qeverisë qendrore janë përpjekur të heshtin aktivizmin e tyre duke i etiketuar si 'armiç', duke kërcënuar se ata do të ndalojnë bashkëpunimin me ta dhe se do të vendosin kufizime të mëtejshme mbi ta, që do të vështirësojnë qasjen e tyre në financim dhe në rrjetet e donatorëve.³⁷⁵ Veprime të tilla jo vetëm që janë mekanizma heshtës, por ato kontribuojnë në mënyrë aktive në shtypjen dhe zvogëlimin e hapësirës për GMDNJ-të, duke ju pamundësuar atyre punën në mënyrë të sigurt dhe të plotë.

BOSNA I HERCEGOVINA

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në *Vërejtjet e tyre Përfundimtare mbi Raportin e Gjashtë Periodik të Bosnjës e Hercegovinës* vuri në dukje shqetësimet në lidhje me një diskurs anti-gjinor dhe kërcënimet në internet kundër grave politikane, gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe OShC-ve të grave, përfshirë

kërcënimet e bëra nga politikanë të nivelit të lartë dhe mungesa e sanksioneve efektive për akte të tilla.³⁷⁶ Ashtu si me të gjitha botimet e mëparshme të *Drejtave e Grave në Ballkanin Perëndimor*, kërcënimet, sulmet dhe presionet vazhdojnë në Bosnjë e Hercegovinë (BeH) edhe gjatë kësaj periudhe raportuese.

³⁶⁹ 'Press Release on the Latest Attack on the Albanian Trans Activist Anxhela' (Komunikatë për Media mbi Sulmin e Fundit ndaj Aktivistes Shqiptare Transgjimore Anxhela), *Historia Ime*, 13 nëntor 2019, <https://www.historia-ime.com/english/press-release-on-the-latest-attack-on-the-trans-activist-anxhela/>, (e qasur më 28 prill 2020).

³⁷⁰ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Shqipëri.

³⁷¹ ILGA-Evropë, *Rishikimi Vjetor i Situatës së të Drejtave të Njeriut të personave Lezbike, Homoseksual, Biseksual, Trans dhe Interseks me Mbulim të Ngjarjeve që ndodhën në Evropë dhe Azi Qendrore ndërmjet janarit dhe dhjetorit*, Brussels, ILGA-Evropë, 2020.

³⁷² Reporterët Pa Kufij, Shqipëria [faqja në internet], <https://rsf.org/en/albania>, (e qasur më 24 prill 2020).

³⁷³ 'KE: 2019 Was Worst Year for Albanian Media Freedom' (2019 ishte Viti më i Keq për Lirinë e Mediave Shqiptare), *Exit*, 29 janar 2020, <https://exit.al/en/2020/01/29/coe-2019-was-worst-year-for-albanian-media-freedom/> (e qasur më 3 qershor 2020).

³⁷⁴ 'Online Harassment and Abuse of Albanian Journalist Reported by Mapping Media Freedom', ('Ngacmimi dhe Abuzimi në Internet i Gazetarit Shqiptar i Raportuar nga Hartëzimi i Lirisë së Mediave') *Exit*, 17 prill 2020, <https://exit.al/en/2020/04/17/online-harassment-and-abuse-of-albanian-journalist-reported-by-mapping-media-freedom/>, (e qasur më 3 qershor 2020).

³⁷⁵ A. Xhaho et al., *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, fq. 14.

³⁷⁶ CEDAW, *Concluding Observations on the Sixth Periodic Report of Bosnia and Herzegovina (Vërejtjet Përfundimtare mbi Raportin e Gjashtë Periodik të Bosnjës e Hercegovinës)*, CEDAW, 2019, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2fC%2fBIH%2fCO%2f6&Lang=en (e qasur më 6 qershor 2020).

Në fund të vitit 2019, pas Paradës së parë të Krenarisë në BeH, numri i raportimeve të sulmeve kundër personave LGBTQI + u rrit.³⁷⁷ Incidentet homofobike përfshinin cilësime armiqësore për personat LGBTQI + nga figura publike, gjuhë urrejtjeje në mediat sociale dhe akte dhune. Sidoqoftë, incidentet e dhunës raportohen rrallë në mediat lokale.³⁷⁸ Për shembull, në Banja Luka, një çift lezbike u sulmua fizikisht dhe verbalisht. Ato menjëherë kontaktuan policinë, megjithatë për shkak të sjelljes armiqësore të policisë, çifti humbi besimin në ndjekjen e rastit, dhe përfundimisht vendosi të mos ngriste akuza dhe të largohej nga vendi në kërkim të sigurisë.³⁷⁹ Kristina Ljevak, një gazetare dhe aleate e spikatur e lëvizjes për të drejtat e LGBTQI +, ishte shënjestër e një fushate shpifjesh pasi u emërua Drejtore e TVSA, kanali televiziv publik i Kantonit Sarajevë.³⁸⁰

Kur bëhet fjalë për sulme gjinore ndaj grave gazetare, sulmuesit shpesh i quajnë gratë gazetare me epitete të ndryshme që aludojnë në pamjen e tyre fizike: "shtriga", "prostituta", "monstra", "kurva". Sulmuesit iu drejtuan atyre me gjuhë nënçmuese, komente në lidhje me pamjen e tyre fizike dhe kërcënime për jetën dhe sigurinë e tyre.³⁸¹ Vanja Stokić, redaktore e portalit eTrafika.net, së fundmi mori kërcënime me vdekje përmes mediave sociale për shkak të një fotoje të saj me migrantë në BeH gjatë rrugës për në vendet e BE-së. Një i huaj e kërcënoi atë me "prerje koke" jo vetëm për migrantët, por edhe "të gjithë ju kujdestarët e shpirtit që i mirëpritni". Ajo e raportoi rastin në policinë e Banja Lukës, e cila nuk e mori seriozisht dhe i tha që të kthehej pas dy ditësh. Ndërkohë, kërcënimet e burrit të panjohur vazhduan: ai e kontaktoi atë përsëri, madje ai kontaktoi miqtë e saj, duke përsëritur kërcënimet dhe madje duke lënë numrin e tij të telefonit në mënyrë që ajo të raportonte atë në polici. Vetëm pas një reagimi të shpejtë dhe të mprehtë nga publiku, Stokić u thirr në stacionin e policisë për të dhënë një deklaratë. Pas kësaj, burri u arrestua, por përfundimisht u lalirë.³⁸²

Gazetarja e Fokus.ba, Semira Degirmendžić, e cila është përgjegjëse për zbulimin e çështjes "Respiratorët" të vitit 2020,³⁸³ u linçua publikisht. Një video klip u shfaq në rrjetet sociale, duke thënë se të pavërtetat më të këqija vijnë prej saj dhe se ajo që zbuloi nuk ishte një skandal, por "gazetari e porositur". Pas kësaj, posterat me imazhin e Degirmendžić u ngjitën në hapësirat publike në Sarajevë, me tekst shoqërues që përmbante një mesazh politik. Kjo ishte një përpjekje për të rrezikuar sigurinë personale të gazetares Degirmendžić dhe një thirrje për një linçim publik.³⁸⁴

Sulmet u raportuan gjithashtu në diskursin politik. Në një seancë të Asamblesë Kombëtare të Republika Srpska, deputeti Nebojsa Vukanović bëri komente nënçmuese dhe të ndërlidhura me aftësi, duke deklaruar se një deputet tjetër u soll si dikush me aftësi të ndryshme, veprim që ai e përsëriti më vonë në një deklaratë për TV N1. Ana Kotur Erkić, një aktiviste dhe një grua me aftësi të ndryshme, reagoi në profilin e saj personal në Facebook ndaj këtyre deklaratave, duke theksuar se deklarata të tilla fyejnë dhe nënçmojnë njerëzit me aftësi të ndryshme. Deputeti Vukanović reagoi përsëri përmes videos, duke lënë të kuptohet se aktivistja prej kohësh Kotur Erkić ishte e mentoruar politikisht, e angazhuar politikisht dhe një shërbëtoe e autoriteteve në Republika Srpska, duke shtuar se ajo kishte "abuzuar me vetë popullsinë të cilës i përket" dhe "duke bërë lajka të fuqishmëve" në mënyrë që të sigurojë fonde dhe fushata kundër veprimeve të tij.³⁸⁵ Sulmet e tilla publike ndaj GMDNJ-ve të kryera nga autoritetet qeveritare në pushtet janë veçanërisht të dëmshme për GMDNJ-të sepse dinamika e pushtetit anon në favor të zyrtarit qeveritar.

OShC-të që organizuan aktivitete për Ditën Ndërkombëtare të Gruas në 2019 në Banja Luka ishin subjekt i marrjes në pyetje të policisë për shkak të pranisë së aktivisteve të mirënjohura nga grupe të ndryshme të zëshme të aktivistëve. Ky ishte një kërcënim dhe përpjekje për të mbjellë frikë, duke dekurajuar aktivistët nga pjesëmarrja në aktivitete të drejtpërdrejta në vende publike.³⁸⁶

³⁷⁷ G. Katana, BH Duboko Homofobno Društvo (BeH Shoqëri Thellë Homofobe), *LGBTI.ba*, 4 janar 2020, <https://lgbti.ba/bih-duboko-homofobno-drustvo/>, (e qasur më 3 qershor 2020).

³⁷⁸ USAID, *Fact Sheet: Strengthening LGBTI Rights in Bosnia and Herzegovina (Fletë Faktesh: Fuqizimi të Drejtave LGBTI në Bosnjë e Hercegovinë)* [ëebsite], <https://ëw.usaid.gov/bosnia/fact-sheets/strengthening-lgbt-rights-bosnia-and-herzegovina>, (e qasur më 3 qershor 2020).

³⁷⁹ ILGA-Evropë, *Rishikimi Vjetor i Situatsë së Të Drejtave të Njeriut për Personat Lezbike, Gej, Biseksuale, Transgjinnor dhe Interseks me Mbulim të Ngjarjeve që ndodhën në Evropë dhe Azi Qëndrore ndërmjet janarit dhe dhjetorit*, Brussels, ILGA-Evropë, 2020.

³⁸⁰ Po aty.

³⁸¹ T.Gatarić, 'Milica Samardžić za VOA: Mrežom Novinarki do Boljeg Položaja Žena u bh. Medijima' ('Milica Samardžić për Zërin e Amerikës: Me Rrjetën e Gazetareve drejt Pozitës më të Mirë të Grave në Mediat e BeH', VOA, 3 maj 2020, <https://ba.voanews.com/a/milica-samardzic-za-voa-mrejom-novinarki-do-boljeg-polo%C5%BEaja-zena-u-bh-medijima/5402858.html>, (e qasur më 6 qershor 2020).

³⁸² I. Sandžakarević, 'Vanja Stokić: Napad na Vanju je manje bitan, a da se desio nekom političaru, napadač bi bio istog trena priveden' ('Vanja Stokić: Sulmi ndaj Vanjës është më pak i rëndësishëm, por nëse do t'i kishte ndodhur ndonjë politikani sulmuesi do të arrestohej menjëherë'), *Intervistë*, 29 maj 2020, <https://interview.ba/interview/item/32382-b-vanja-stokic-b-napad-na-vanju-je-manje-bitan-a-da-se-desio-nekom-politicaru-napadac-bi-bio-istog-trena-priveden>, (e qasur më 6 qershor 2020).

³⁸³ Një skandal që ndodhi në mes të pandemisë COVID-19, në të cilën një fermë boshnjake e mjedrave u pajis me një kontratë nga autoritetet qeveritare për të importuar respiratorë me një çmim tepër të shtrenjtë, pavarësisht se një kompani mjekësore propozoi të blinte makineritë me një çmim më të ulët. Ferma e mjedrës dështoi të dorëzonte respiratorët e blera, duke çuar në arrestime dhe marrje në pyetje të personave të përfshirë, duke përfshirë edhe Kryeministrin e BeH Fadih Novali, pronarin e fermës së mjedrave dhe drejtuesin e TV-së Fikret Hodžić dhe Fahrudin Solak, shefin e pezulluar i Mbrojtjes Civile

³⁸⁴ BH Novinari, 'Utvrditi ko stoji iza napada na novinarku Semiru Degirmendžić' ('Të vërtetohet kush qëndron prapa sulmit ndaj gazetares Semira Degirmendžić'), *BH Novinari*, 2020, <https://bhnovinari.ba/bs/2014/03/26/utvrditi-ko-stoji-iza-napada-na-novinarku-semiru-degirmendzic/>, (e qasur më 7 qershor 2020).

³⁸⁵ Rrjeti për Ndërtimin e Paqes, 'Reakcija Povodom Vrijeđanja Aktivistice Ane Kotur Erkić i Osoba sa Invaliditetom od Strane Narodnog Zastupnika Vukanovića' (Reagim ndaj Fyerjes së Aktivistes Ana Kotur Erkić dhe Personave me Aftësi të Veçanta nga Përfaqësuesi i Popullit Vukanović), *Rrjeti për Ndërtimin e Paqes*, 2020, <https://www.mreza-mira.net/vijesti/aktivnosti-mreze/reakcija-povodom-vrijeđanja-aktivistice-ane-kotur-erkić/>, (e qasur më 6 qershor 2020).

³⁸⁶ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

KOSOVA

Normat kulturore shoqërore, politike dhe dominuese në Kosovë kanë krijuar një sistem patriarkal në të cilin puna aktive në fushën e barazisë gjinore, dhunës ndaj grave, të drejtave të personave LGBTQI + dhe lirisë së shprehjes shpesh hasë në rezistencë institucionale.³⁸⁷

Një OSHC e Kosovës Qendra për Barazi dhe Liri deklaroi se aktivistët LGBTQI + kishin marrë më shumë se 150 kërcënime me vdekje në internet gjatë vitit 2019. Të gjitha u raportuan në polici, por asnjë çështje nuk u ndoq penalisht.³⁸⁸ Kur aktivistët LGBTQI + raportojnë tek autoritetet për një vepër penale, shkelje ose pengim të kryer kundër tyre,³⁸⁹ policia në shumicën e rasteve nuk i merr seriozisht, nuk kryen procedurat e duhura të hetimit dhe nuk i informon ata për zhvillimet mbi rastin e tyre. Injeksi trajtim është përjetuar nga një GMDNJ tjetër. Ardiana Mehmeti, një nga fitueset e Çmimit të BE-së për Gazetari Hulumtuese në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi për storjen "Eksplotimi në Telekom", dëshmoi për betejat me të cilat u përball gjatë shkrimit të hetimit të saj në Telekom: "Ata më pyetën drejtpërdrejt" sa [para] 'duhen që unë të ndaloja punën time. Ata më shpuan gomat. Policia nuk bëri asgjë".³⁹⁰

Policia arrestoi për pak kohë kryeredaktoren e portalit KoSsev, Tatjana Lazarević, për pretendimin e shkeljes së orës policore si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19. Sipas KoSsev, Lazarević ishte në nisur për

të raportuar mbi situatën në Qendrën Shëndetësore të Zveçanit, në lidhje me pandeminë. Gjatë arrestimit, ajo e identifikoi veten në polici duke u paraqitur kartën e saj të shtypit. Raportohet se ajo tani përballlet me procedime penale.³⁹¹ Portali KoSsev tashmë ka një histori të ekspozimit ndaj kufizimit të lirisë së mediave nga autoritetet lokale. Ky incident ishte një shembull tjetër i tkurrjes së hapësirës për gazetarët, veçanërisht gratë gazetare.

Drejtoresha Ekzekutive i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), Igballe Rogova, vuri re se sa herë që RrGK punon në çështje gjyqësore strategjike për DhBGj ose ajo personalisht ngre çështje LGBTQI + në publik, ajo merr kërcënime në internet dhe nganjëherë ngacmohet në publik. "Unë jam figura që [kryerësit] e fajësojnë. Ne po kërkojmë drejtësi për ata që vrasin gratë e tyre, ata të cilët rrahin gratë e tyre. Prandaj, kryerësit e krimit na sulmojnë. Pas sulmeve qëndrojnë njerëzit që urrejnë faktin që ne po ngrihem për mbrojtjen e grave. Kështu që sa herë që trondisim botën e një abuzuesi, ata zemërohen - ata duan të sulmojnë ato që tronditin botën e tyre".³⁹² Një aktiviste tjetër nga RrGK gjithashtu mori kërcënime pasi marshoi për të drejtat LGBTQI + në shtator 2019. GMDNJ në Kosovë kanë marrë mesazhe dhe kërcënime verbale të vazhdueshme në rrugë nëse njerëzit e dinë kush janë. Shumica e këtyre kërcënimeve nuk raportohen.³⁹³

³⁸⁷ A. Xhaho et al. *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, p. 39.

³⁸⁸ Human Rights Watch, *World Report 2020 – Events of 2019 (Raporti Botëror 2020 – Ngjarjet e 2019)*, Human Rights Watch, 2019, https://www.hrw.org/sites/default/files/world_report_download/hrw_world_report_2020_0.pdf, (e qasur më 6 qershor 2020), fq. 338.

³⁸⁹ Po aty.

³⁹⁰ Forcimi i Lajmeve Cilësore dhe Gazetarisë së Pavarur në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, 'Winners of EU Investigative Awards in Kosovo Announced' (*Shpallen Fituesit e Çmimeve Hulumtuese të BE-së në Kosovë*), *Forcimi i Lajmeve të Cilësisë dhe Gazetarisë së Pavarur në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi*, 2019

<https://euwbmedia.com/2019/10/winners-of-eu-investigative-awards-in-kosovo-announced/>, (e qasur më 6 qershor 2020).

³⁹¹ OSBE, 'OSCE Media Freedom Representative concerned about pressure on KoSsev online portal and its editor-in-chief in Kosovo' ('Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave i shqetësuar rreth presionit mbi portalin online KoSsev dhe kryeredaktorin e saj në Kosovë'), OSCE, Vjenë 2020, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/450085>, (e qasur më 6 qershor 2020).

³⁹² Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Kosovë.

³⁹³ Po aty.

MALI I ZI

GMDNJ-të në Mal të Zi janë të ekspozuar ndaj ndikimit të vazhdueshëm negativ të kishës dhe komuniteteve fetare në përhapjen e ideve konservatore. Sulmet e rregullta të mediave kundër GMDNJ, të drejtura nga media pro-qeveritare, përfshijnë "mizogjini të theksuar" që synon të diskreditojë integritetin dhe imazhin publik të GMDNJ-ve.³⁹⁴ Në Malin e Zi, GMDNJ-të më të ekspozuara ndaj sulmeve janë ato që punojnë në fushën e të drejtave LGBTQI + të drejtat e grave, dhe gratë gazetare.

Procedimi i krimeve të urrejtjes, përfshirë sulmet ndaj personave LGBTQI +, është një progres shumë i ngadaltë. Sulmuesi i një gruaje trans në vitin 2017 u dënua me katër muaj burg gjatë kësaj periudhe raportuese, tre vjet pas incidentit. Dënimi i marrë ishte më pak se dënimi minimal, dhe Gjykata e Lartë më vonë e pezulloi dënimin.³⁹⁵ Avokati që përfaqëson paditësin nuk u informua për këtë nga Gjykata e Lartë, por u informua për këtë përmes kanaleve të tjera. Vetëm Prokurori ka fuqi të kundërshtojë këtë vendim dhe ai nuk e bëri atë pavarësisht kërkesës së paraqitur nga avokati.³⁹⁶

Në vitin 2019, Zëvendës Ombudsmeni Siniša Bjeković publikoi një opinion, duke konkluduar se dy infermiere në Qendrën Shëndetësore Podgorica demonstuan sjellje transfobike dhe diskriminuese kur ata qeshën me Hana Konatar i cili erdhi për terapi hormonale, një aktivist i zëshëm transgjinnor për të drejtat e LGBTQI + nga OSHC Shoqata Spektra.³⁹⁷ Rasti është duke u shqyrtuar nga Komisioni për Kontrollin

e Cilësisë. Devijimet nga heteronormativiteti brenda narrativës dominuese shoqërore dekurajohen dhe denoncohen.

Sipas CIVICUS, ka pasur shqetësime të vazhdueshme mbi lirinë e medias në Malin e Zi ndërsa ka ende shumë raste të pazgjidhura të dhunës ndaj gazetarëve.³⁹⁸ Shumë nga këto shqetësime dhe kërcënime ndaj sigurisë përfshijnë gratë gazetare. Olivera Lakić është një gazetare hulumtuese që rregullisht raporton për korrupsionin brenda qeverisë. Në botimin e mëparshëm të *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor*, Kvinna till Kvinna raportoi për rastin e saj lidhur me një sulm të vitit 2018 në të cilin ajo u qëllua në këmbë dhe çështja mbetet ende e pazgjidhur në këtë periudhë raportuese.³⁹⁹

Në fillim të janarit 2020, policia arrestoi dhe ndaloi Kryeredaktoren e *FOS Media*, Anđela Đikanović, nën dyshimin e shkakut të panikut dhe trazirave për dyshimin e shpërndarjes së lajmeve të rreme. Incidenti filloi kur Đikanović botoi një artikull duke thënë se qeveria mund të përdorë forcat e sigurisë në Kosovën fqinje për të ndihmuar në shuarjen e protestave të mbështetësve të Kishës Ortodokse Serbe.⁴⁰⁰ Pas arrestimit të saj dhe paraburgimit 72 orësh, gazetarja u shkarkua si Kryeredaktore për një "gabim të rëndë profesional".⁴⁰¹ Rasti i Đikanović është një shembull se sa i pasigurt është ambienti për gratë gazetare që hetojnë regjimin në pushtet në⁴⁰² Malin e Zi dhe sa serioze mund të jenë pasojat në karrierën e tyre.

³⁹⁴ A. Xhaho et al. *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, fq. 57.

³⁹⁵ ILGA-Evropë, *Rishikimi Vjetor i Situatës së të Drejtave të Njeriut për Personat Lezbike, Gej, Biseksuale, Transgjinnor dhe Interseks me Mbulim të Ngjarjeve që ndodhën në Evropë dhe Azi Qendrore ndërmjet janarit dhe dhjetorit 2019*, Bruksel, ILGA Evropë, 2020.

³⁹⁶ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Malin e Zi.

³⁹⁷ Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive - Ombudspersoni Mali i Zi, *Ispunjenja Preporuka o Poštovanju Prava Transrodne Osobe (Zbatimi i Rekomandimeve mbi Respektimin e të Drejtave të Personave Transgjinnor)* [faqja në internet], 2019, <https://www.ombudsman.co.me/article.php?id=34128&display=1>, (e qasur më 28 shtator 2020).

³⁹⁸ CIVICUS, 'Attacks on Journalists on the Rise as Religious Groups Clash with Police' ('Sulmet ndaj Gazetarëve në Britje ndërsa Grupet Religjioze Përplasen me Policinë'), CIVICUS, 2020, <https://monitor.civicus.org/updates/2020/04/03/attacks-journalists-rise-religious-groups-clash-police/>, (e qasur më 23 prill 2020).

³⁹⁹ Reporterët Pa Kufij, *Mali i Zi* [faqja në internet], <https://rsf.org/en/montenegro>, (e qasur më 24 prill 2020).

⁴⁰⁰ CIVICUS, 'Measures to Combat "Fake News" Used to Silence Journalists' ('Masat për të Luftuar "Lajmet e rreme" Përdoren për Heshtur Gazetarët'), CIVICUS, 2020, <https://monitor.civicus.org/updates/2020/02/18/measures-combat-fake-news-used-silence-journalists/>, (e qasur më 23 prill 2020).

⁴⁰¹ Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, 'Montenegro journalist Anđela Đikanović charged with incitement over retracted report' ('Gazetarja malazeze Anđela Đikanović e akuzuar për nxitje lidhur me raportin e tërhequr'), 2020, <https://cpj.org/2020/01/montenegro-journalist-andela-dikanovic-charged-wit/>, (e qasur më 6 qershor 2020).

⁴⁰² Regjimi në pushtet për këtë periudhë të raportimit deri më 1 qershor, 2020.

MAQEDONIA VERIORE

Gjatë periudhës raportuese, GMDNj në Maqedoninë Veriore përjetuan raste të shumta të ngacmimit seksual dhe kërcënimeve për dhunë seksuale dhe përdhunim, sipas raportit të *Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor*. Sulmet dallojnë dhe mbrojtësit e shënjestruar përfshijnë një GMDNj lezbike që u përball me sulme fizike gjatë ngjarjeve feministe publike.⁴⁰³

Botimi i vitit të kaluar i *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor* raportoi për shtatë aktivistë LGBTQI + të cilët u sulmuan nga një grup prej 20 personash pas Paradës së parë të Krenarisë në Shkup. Aktivistët u nxorrën nga taksitë, u rrahën dhe u kërcënuan me vrasje dhe përdhunim. Tre zyrtarë të policisë u sulmuan gjithashtu kur përpiqeshin të ndërhyjnë. Gjatë kësaj periudhe raportuese, ka pasur pak progres në lidhje me rastin, hetimi është duke vazhduar dhe procedurat gjyqësore ende nuk janë filluar.⁴⁰⁴ Në disa raste, u dëmtua edhe zyra e OShC Qendra e Mbështetjes LGBTI në Shkup. Asnjë sulmues nuk është identifikuar ende, me disa raste që janë në pritje me vite.⁴⁰⁵ Sipas Mbrojtësve të të Drejtave Civile, deri më tani në Maqedoninë Veriore nuk ka asnjë rast të vetëm të ndjekur penalisht për krim të urrejtjes bazuar në gjini, identitet gjinor ose orientim seksual.⁴⁰⁶

Krimet e urrejtjes, ose krimet me një motiv të bazuar në paragjykim, janë të ndaluara nga Kodi Penal dhe marrin dënime më të ashpra. Sidoqoftë, çështja është se ka hapësirë për interpretim gjyqësor të krimeve të urrejtjes sepse legjislacioni anti-diskriminim është i kufizuar në përkufizimet e tij se cilat dispozita përbëjnë një krim të urrejtjes. Arsye të tilla si shprehja gjinore ose orientimi seksual nuk përcaktohen në mënyrë të qartë si motive të bazuara

në paragjykim ose diskriminim për tu sanksionuar me dënime më të ashpra, duke lënë hapësirë për interpretim gjyqësor nga gjyqtarët individualë në kohën e dënimit, në vend të dispozitave të përcaktuara qartë në legjislacion.

Grupet për të drejtat e mediave raportojnë një rritje të kërcënimeve ndaj punonjësve të mediave. Ndërsa numri i sulmeve fizike ndaj gazetarëve ka rënë, ekziston një praktikë në rritje e ngacmimit kibernetik dhe abuzimit verbal.⁴⁰⁷ Më 15 janar, 2020, Shoqata e Gazetarëve në Maqedoninë Veriore reagoi ndaj mesazheve kërcënuese të drejtuar ndaj dy gazetarëve. Meri Jordanovska, redaktore e A1on.mk dhe Iskra Koroveshovska, redaktore e *Alfa TV*, u vunë në shënjestër të një ish-punonjësi të qeverisë për punën e tyre si gazetare hulumtuese. Të dy gratë morën mesazhe nga Emil Jakimovski, në atë kohë punonjës në Regjistrin Qendror, që përmbanin kërcënime që pretendonin se ai "do të krijonte një funeral për to" dhe duke i quajtur "Sorospija" (e cila mund të përkthet si "Soros lavire") së bashku me të tjera epitete nënçmuese gjinore. Jakimovski u shkarkua nga puna pasi komentet e tij në internet dolën në dritë. Një rast tjetër u deponua më vonë në polici në Maqedoninë Veriore që rezultoi në arrestimin e Jakimovskit si dhe një çështje kundër tij po përgatitet aktualisht nga prokuroria. Një incident i ngjashëm ndodhi me gazetaren e *TV21* Almedina Ismaili, dhe në këtë rast, autori ishte anëtar i një partie politike. Ismaili u vu në shënjestër pasi hulumtoi një storje lidhur me Neshat Ademin, një anëtar i krahut të Aleancës për Shqiptarët, për të cilin thuhej se po largohej nga partia. Ademi reagoi duke telefonuar Ismailin dhe duke lënë një breshëri ofendimesh dhe kërcënimesh në postën e saj zanore.⁴⁰⁸

⁴⁰³ A. Xhaho et al. *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, fq. 76.

⁴⁰⁴ ILGA-Evropë, *Rishikimi Vjetor i Situatës së të Drejtave të Njeriut për Personat Lezbike, Gej, Biseksuale, Transgjinnor dhe Interseks me Mbulim të Ngjarjeve që ndodhën në Evropë dhe Azi Qendrore ndërmjet janarit dhe dhjetorit 2019*, Bruksel, ILGA-Evropë 2020.

⁴⁰⁵ A. Xhaho et al. *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, fq. 68.

⁴⁰⁶ Po aty.

⁴⁰⁷ Reporterët Pa Kufij, *Maqedonia Veriore* [website], <https://rsf.org/en/north-macedonia>, (e qasur më 24 prill 2020).

⁴⁰⁸ CIVICUS, 'Media Watchdogs Raise the Alarm After Female Journalists Threatened' ('Rojtarët e Medias Ngrisin Alarmin pas Kërcënimeve ndaj Gazetarëve Gra'), *CIVICUS*, 2019, <https://monitor.civicus.org/updates/2020/03/30/media-watchdogs-raise-alarm-after-female-journalists-threatened/>, (e qasur më 23 prill 2020).

SERBIA

Sulmet serioze ndaj GMDNJ-ve vazhduan në Serbi gjatë kësaj periudhe raportuese. Aktivistët si dhe OShC-të ishin shënjestër e formave të ndryshme të sulmeve nga ana e policisë, civilëve dhe grupeve të pamentifikuar. Shembuj të ndryshëm janë regjistruar gjatë periudhës së vëzhguar, dhe për fusha të ndryshme të punës. Në shumë vija të frontit, GMDNJ-të, gazetarë dhe OShC ishin në shënjestër më së shumti në lidhje me punën e tyre mbi të drejtat e grave, të drejtat LGBTQI +, të drejtat e njeriut dhe krimet e luftës. Popullsia e përgjithshme është nën ndikimin e konsiderueshëm të mediave të kontrolluara nga qeveria, të cilët lavdërojnë kriminelët e luftës, promovojnë urrejtje dhe fjalime diskriminatore të synuara kundër aktivistëve.⁴⁰⁹ Mediat pro-qeveritare shpesh njollosin media dhe gazetarë të pavarur, duke i përshkruar ata si "tradhtarë" dhe "mercenarë të huaj".⁴¹⁰ Kjo ndikon jashtëzakonisht në pozicionin dhe sigurinë e GMDNJ, të cilët janë vetë shënjestër e fushatave të shpifjeve mediatike, sulmeve fizike, shkeljeve të dinjitetit të tyre dhe kërcënimeve ndaj sigurisë së tyre. Kemi "Raste të rritura të diskursit anti gjinor në domenin publik dhe një regres publik në perceptimin e barazisë gjinore; deklarata mizogjene të shprehura përmes mediave dhe gjithashtu nga politikanë të nivelit të lartë, udhëheqës fetarë dhe akademikë që kalojnë pa u ndëshkuar", siç konkludohet nga CEDAW në *Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë*.⁴¹¹

Nataša Kandić, themeluese e Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH), së bashku me pesë aktivistë të tjerë të FDH, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut dhe Forumi Ziviler Friedensdienst, u sulmuan fizikisht nga anëtarët e Partisë Radikale Serbe (SRS) të ekstremit të djathtë politik në një ngjarje të promovimit të librit. Ngjarja u organizua nga udhëheqësi i partisë dhe kriminel i dënuar i luftës Vojislav Šešelj, autor i librave, në të cilat ai mohon sistematikisht gjenocidin e Srebrenicës në BeH dhe krime të tjera kundër njerëzimit të kryera nga forcat serbe në luftërat e viteve 1990. Kandić dhe aktivistët e tjerë u sulmuan fizikisht nga mbështetësit e SRS në këtë ngjarje

ndërsa shpërndanin një raport të FDH-së që detajonte provat e krimeve të luftës të kryera kundër kroatëve në krahinën e Vojvodinës. MDNJ-të, u shtynë për tokë dhe u shkelmuan nga anëtarët e SRS pas një urdhri që vinte nga Šešelj. Sulmi ndodhi në ambientet e komunës Stari Grad në Beograd, e cila është një hapësirë publike, megjithatë asnjë personel apo personel sigurie nuk u përpoq të ndërhynte për të parandaluar konfrontimin.⁴¹²

Në një rast tjetër në Twitter, Šešelj bëri thirrje për përdhunimin e Brankica Janković, Komisionere për Mbrojtjen e Barazisë në 2019. Šešelj gjithashtu vazhdimisht dhe publikisht kundërshton dhe kërcënon rrjetin e grave aktiviste të paqes Gratë në të Zeza dhe një nga themelueset e saj, Staša Zajović-in, duke përfshirë tallje, deklarata publike për kërcënime me vdekje dhe përqeshje të vazhdueshme.⁴¹³

Gazetarja Ana Lalić, e cila u arrestua për botimin e një artikulli në të cilin kritikoi situatën dhe kushtet e Qendrës Klinike të Vojvodinës gjatë pandemisë COVID-19, ishte shënjestër e sulmeve nga tabloidet dhe faqet e reze në mediat sociale. Si pjesë e sulmeve ishte një reklamë e paguar me foton e saj dhe mbishkrimin se si ajo punon kundër interesave të Serbisë.⁴¹⁴ E fundit në një seri sulmesh ndaj Lalić ndodhi në maj të vitit 2020, gjatë periudhës së raportimit, kur dikush i shpoi gomën e makinës në Novi Sad.⁴¹⁵

Portali Prismotra publikoi dy tekste në të cilat zbuloi informata të pahijshme në lidhje me punën dhe jetën private të grave gazetare Vanja Đurić dhe Žaklina Tatalović. Gazetarja e TV N1 Đurić u shënjua si personi që "bëri filma kundër Serbisë", duke aluduar në pjesëmarrjen e saj në filmin *Shqiptaret janë Motrat Tona*. Fotografite private të Tatalović-it u publikuan në portal.⁴¹⁶ Në mënyrë të ngjashme, portali në internet Istraga publikoi një listë të titulluar "Gazetaret Gra që Turpëruan Serbinë" për shkak të të njëjtit film. U publikuan informacione rreth këtyre gazetareve, përfshirë fotografite dhe vendet e tyre të punës, si dhe emrat e OShC-ve në të cilat ato punojnë,

⁴⁰⁹ A. Xhaho et al. *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes*, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, fq. 88.

⁴¹⁰ Human Rights Watch, *Raporti Botëror 2020 – Ngjarjet e 2019*, Human Rights Watch, 2020, fq. 496.

⁴¹¹ CEDAW, *Vërejtjet Përfundimtare të Raportit të Katërt Periodik të Serbisë*, CEDAW, 2019 https://www.womenngo.org.rs/images/CEDAW/CEDAW_Concluding_observations.pdf, (e qasur më 6 qershor 2020).

⁴¹² Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 'Attack Against Civil Rights Defender of the Year Recipient Nataša Kandic in Belgrade' ('Sulmi Ndaj Mbrojtëses së të Drejtave Civile të Vitit Nataša Kandic në Beograd') *Mbrojtësit e të Drejtave Civile*, 2020, <https://crd.org/2020/02/06/attack-against-civil-rights-defender-of-the-year-recipient-natasa-kandic-in-belgrade/>, (e qasur më 6 qershor 2020).

⁴¹³ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Serbi.

⁴¹⁴ Iniciativat Qytetare, *Tri Slobode Pod Lupom: Prikaz Slučajeva Kršenja Osnovnih Ljudskih Prava u Srbiji Tokom Vanrednog Stanja (Tri Liri nën Lupë: Prezantimi i Rasteve të Shkeljes së të Drejtave Themelore të Njeriut në Serbi Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme)*, Iniciativat Qytetare, 2020, <https://www.gradjanske.org/wp-content/uploads/2020/04/Tri-slobode-pod-lupom-13-15-april-.pdf>, (e qasur më 22 qershor 2020).

⁴¹⁵ 'Novi napad na novinarku Anu Lalić' ('Sulmi i ri kundër gazetares Ana Lalić'), *Patria*, 1 maj 2020, <https://nap.ba/news/65099>, (e qasur më 6 qershor 2020).

⁴¹⁶ Iniciativat Qytetare, *Tri Slobode Pod Lupom: Prikaz Slučajeva Kršenja Sloboda Udruživanja, Okupljanja i Izražavanja u Srbiji 16-28. Februar 2020. Godine (Tri Liri nën Lupë: Prezantimi i Rasteve të Shkeljes së Lirive të Shoqatave, Tubimit dhe Shprehjes së Lirë në Serbi 16-28 shkurt 2020)* Iniciativat Qytetare 2020, <https://www.gradjanske.org/wp-content/uploads/2020/02/Tri-slobode-pod-lupom-16-28-februar.pdf>, (e qasur më 22 qershor 2020).

dhe shuma e fondeve që morën ato organizata, pa cituar burimet e informimit.⁴¹⁷ TV N1 pretendon se një strategji e re e mediave pro-qeveritare në Serbi është fotografimi i grave gazetare N1 në konferencat zyrtare për shtyp të Presidentit, në një mënyrë të paturpshme, në mënyrë që të krijojë një imazh që do t'i poshtëronte ato dhe do të projektonte paragjykimet më të këqija seksiste kundër tyre.⁴¹⁸

Aktivistja Milinka Nikolić u mor disa herë në pyetje nga zyrtarët e policisë, madje duke përfshirë një ekzaminim me poligraf, për shkak të një "fjalimi të ndezur" të mbajtur në 2019 para ndërtesës së Presidencës në Beograd gjatë protestës së ambientalistëve kundër ndërtimit të mini hidrocentraleve.⁴¹⁹ Anita Mitić, një aktiviste dhe përfaqësuese e Nismës Rinore për të Drejtat e Njeriut, u sulmua nga kryeredaktori i *Informer* Dragan J. Vučićević, në një proces gjyqësor kundër tij. Vučićević i tha asaj se ajo ishte një "prostitutë shiptare"⁴²⁰ dhe ishte paguar nga vrasësit serbë" si dhe e ofendoi atë në bazë të pamjes së saj fizike.⁴²¹

Në mars të vitit 2020, aktivistja dhe artistja Jovana Popović u arrestua dhe u ndalua në Požarevac me

pretendimin se kishte lënë karantinën shtëpiake të sanksionuar nga shteti pasi që hyri në Serbi nga një shtet tjetër gjatë pandemisë COVID-19. Popović pohon se ajo u kthye në Serbi para se të zbatohet karantina e detyrueshme. OShC të shumta kanë kërkuar lirim të saj, duke rikujtuar se dispozitat dhe ligjet nuk mund të zbatohen në mënyrë retroaktive. Ata gjithashtu vlerësuan se arrestimi i saj ishte hakmarrje për këngën me konotacione politike "Bagra" të inçizuar nga ajo, në të cilën ajo kritikon situatën në Serbi dhe qeverinë në pushtet.⁴²²

Qendra Informative e Krenarisë së Beogradit u sulmua më 6 tetor 2019 nga një bandë tifozësh të ekipit futbollistik Crvena Zvezda, të cilët shkelmuan dritaret dhe hodhën shishe qelqi. Autoritetet serbe nuk pranuan të hetojnë sulmin pasi askush nuk u lëndua dhe prona nuk u dëmtua.⁴²³ Që nga hapja e saj në gusht 2018, Qendra është sulmuar dhjetë herë dhe asnjë nga incidentet e deritanishme nuk është zgjidhur nga autoritetet përkatëse. Rritja e nacionalizmit të djathtë në Serbi shkon paralel me rritjen e homofobisë dhe transfobisë, me raportet e incidenteve homofobike, shumë prej tyre të kryera nga të rinjtë, dhe është duke u rritur çdo vit.

⁴¹⁷ D. Popović et al., *Udruženje Građana: Sužavanje Prostora za Delovanje, Srbija 2019 (Asociacioni i Qytetarëve: Tkurrrja e Hapësirës për Veprim, Serbi 2019)*, Belgrade, Građanske Inicijative, Fondacija za Otvoreno Društvo, 2020, <https://www.gradjanske.org/wp-content/uploads/2020/02/Udruženja-građana-Sužavanje-prostora-za-delovanje-OCD-2019-.pdf>, (e qasur më 22 qershor 2020).

⁴¹⁸ 'N1 traži reakciju države na seksističke napade na novinarku' ('N1 kërkon reagimin e shtetit për sulmet seksiste ndaj gazetares'), *N1 Beograd* 25 prill 2020, <http://rs.n1info.com/Vesti/a592978/N1-trazi-reakciju-drzave-na-seksisticke-napade-na-novinarku.html>, (e qasur më 7 qershor 2020).

⁴¹⁹ D. Popović, et al., *Asociacioni i Qytetarëve: Tkurrrja e Hapësirës për Veprim, Serbi 2019*, Inicijativat Qytetare, Fondacioni për Shoqëri të Hapur, Beograd, 2020.

⁴²⁰ Term derogativ për një person shqiptar ose shqipfolës, që përdoret shpesh në lidhje me njerëzit nga Shqipëria ose Kosova..

⁴²¹ "Vučićević mi govorio da sam šiptarska kurva"?! ("Vučićević më quajti kurvë shqiptare"?!), *Direktno.rs*, 2 qershor 2020, <https://direktno.rs/beograd/278213/vucicevic-mi-govorilo-da-sam-siptarska-kurva.html>, (e qasur më 8 qershor 2020).

⁴²² M.P., 'Jovana Popović, Autorka Pesme "Bagra", Puštena na slobodu' (Jovana Popović, Autorja e Këngës "Bagra", Lëshohet në Liri), *Danas*, 13 April 2020, <https://www.danas.rs/drustvo/umetnica-iz-kikinde-jovana-popovic-pustena-na-slobodu>, (e qasur më 22 prill 2020).

⁴²³ ILGA-Evropë, *Rishikimi Vjetor i Situatës së të Drejtave të Njeriut për Personat Lezbike, Gej, Biseksuale, Transgjinnor dhe Interseks me Mbulim të Ngjarjeve që ndodhën në Evropë dhe Azi Qendrore ndërmjet janarit dhe dhjetorit 2019*, Bruksel, ILGA-Evropë, 2020.

Informata Përcjellëse lidhur me Sulmet kundër Grave Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut

Në botimin e mëparshëm të katërt të *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor*, Kvinna till Kvinna raportoi një numër rekord të sulmeve ndaj GMDNJ-ve në Serbi - aq shumë, sa që disa sulme nuk mund të përfshiheshin në raport për hir të shkurtësisë. Në këtë edicion të pestë, hulumtueset kanë siguruar informata shtesë për ngjarjet që kanë ndodhur në periudhën e mëparshme të raportimit por nuk janë përfshirë në raport. Një nga këto incidente ndodhi më 6 mars 2019 në Serbi, ku gratë aktiviste nga organizata dhe grupe të shumta të grave (Gratë në të Zeza, Qendra për Studime të Grave, ndër të tjera) organizuan një aksion simbolik me mesazhe të shkruara në përparëse, me të cilat u mbështollën statujat e figurave historike të burrave në të gjithë Beogradin, duke përfshirë një statujë të Nikola Tesla dhe ish Patriarkut Pavle të Kishës Ortodokse Serbe. Një reagim i ashpër publik pasoi në të gjitha mediat dhe të gjitha platformat e mediave sociale për disa ditë me radhë pas aksionit. Nadja Duhaček, një nga aktivistët e përfshira, u intervistua atë ditë dhe fotot e saj u shfaqën në faqet e internetit dhe forumet e krahut të djathtë dhe të nacionalistëve ekstremë. Gratë aktiviste të përfshira ishin subjekt i gjuhës së urrejtjes, abuzimit verbal dhe kërcënimeve. Një ankesë për kundërvajtje u paraqit nga shoqata 'Ko nam truje decu?' (Kush po i helmon fëmijët tanë?), për gjoja përdhosjen e statujës së Patriarkut Pavle duke e mbështjellë me një përparëse ku shkruhej

"Aborti është e drejta e një gruaje". Mocioni kundër Qendrës së Studimeve të Grave dhe aktivistëve në fjalë u rrëzua për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv nga ana e 'Ko nam truje decu?' dhe mungesës së mocionit të organizatës për fillimin e procedurave, duke qenë se organizata nuk i përkiste spektrit të një pale të dëmtuar sipas ligjit serb, pasi kjo nuk u cilësua si shkelje e të drejtave të organizatës ankuese.⁴²⁴

Në katër vitet e fundit, 13 sulme (të regjistruara) janë kryer ndaj aktivisteve të organizatës Gratë në të Zeza.⁴²⁵ Gjatë kësaj periudhe raportuese, ka pasur pak progres në lidhje me një incident të ngritur si rast kundër Gratë në të Zeza në lidhje me performancën e tyre protestuese përpara Patriarkanës së Kishës Ortodokse Serbe, me titull "Trupi im - E drejta ime", e cila ndodhi më 28 maj 2019. Disa ditë pas performancës, partia politike e krahut të djathtë nacionalist Zavetnici parashtroi një ankesë penale kundër Gratë në të Zeza, duke cituar se shfaqja provokoi urrejtje dhe intolerancë kombëtare, racore dhe fetare.⁴²⁶ Protesta mori lejen e policisë paraprakisht dhe ishte një performancë protestuese e ligjshme. Pavarësisht nga kjo, shumë aktivistë që morën pjesë në protestë u sollën para Prokurorisë dhe u dëgjuan para gjykatës. Këto gjykime janë procese që zvarriten, që ju marrin shumë kohë aktivistëve, të cilën kohë mund të shfrytëzojnë për punë dhe aktivitete organizative të tyre, duke dëshmuar se janë një taktikë që kontribuon në zvogëlimin e hapësirës për shoqërinë civile në Serbi. Procesi mbetet në gjykatë dhe ende nuk është arritur një vendim.⁴²⁷

”

Kur jeni aktivist - kjo nuk mjafton. Duhet të dini të gjitha ligjet nëse thirrreni në polici, në mënyrë që të mos gjendeni në një pozitë 'Mos e dhëntë të Zoti të palakmuar'. Dhe kjo është e tmerrshme: që në këtë vend ne duhet të jemi të kujdesshëm gjatë gjithë kohës në mënyrë që dikush të mos na mashtrojë".

Dragana Dardić, Asambleja Qytetare e Helsinkit Banja Luka, BeH

”

"Është nën dinjitetin tim që një zyrtar policie të më diskriminojë dhe të më thotë 'Dëgjo vajzë, ti po shëtisje në park në mbrëmje, a mos e provokove?'"

Dajana Dangubić, në lidhje me një sulm në Banja Luka, BeH, duke shtuar se ajo supozon se zyrtari i ka folur asaj në atë mënyrë sepse ai dyshonte se ajo ishte homoseksuale.

⁴²⁴ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga YUCOM.

⁴²⁵ 'Međunarodni dan Braniteljki Ženskih Prava' ('Dita Ndërkombëtare e Mbrojtëseve të të Drejtave të Grave'), *Peščanik*, 29 November 2019, <https://udruzenjepescanik.org/aktuelnosti/medjunarodni-dan-braniteljki-zenskih-ljudskih-prava/>, (e qasur më 8 qershor 2020).

⁴²⁶ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga YUCOM.

⁴²⁷ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizatat partnere në Serbi.

”

“Gjatë gjithë këtyre viteve ata u përpoqën të më mbyllnin gojën duke përdorur seksualitetin tim. Sa herë që jam duke punuar për diçka të madhe për të drejtat e grave, ata gjejnë një mënyrë për të bërë publik orientimin tim seksual, me synimin që të më poshtërojnë.”

Igballe (Igo) Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGGK

”

“Ajo që ndikon tek unë nuk është frika. Ajo që ndikon tek unë është rraskapitja.”

Igballe (Igo) Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGGK

”

“Gjatë Revolucionit me Ngjyra burrat nuk u referuan kurrë duke përdorur konotacione seksuale ose për pamjen apo veshjet e tyre, ndërsa kjo ende ndodh me gratë në shoqërinë maqedonase. 'Si guxoni të kritikoni qeverinë, të shkoni në shtëpi dhe të gatuani' - këto ishin mesazhet që mora nga njerëzit që nuk po luftonin të njëjtën betejë si ne gjatë Revolucionit me Ngjyra”.

Uranija Pirovska, Komiteti i Helsinkit në Maqedoninë Veriore⁴²⁸

”

“Që nga themelimi i tyre, Gratë në të Zeza kanë qenë të ekspozuara ndaj çdo lloj sulmi të mundshëm. Askush nga sulmuesit e aktivisteve të Grave në të Zeza nuk është ndëshkuar ndonjëherë. Pati disa procedura gjyqësore që gjithmonë kishin të njëjtin rezultat - institucionet gjyqësore të shtetit serb liruan të gjithë sulmuesit e Grave në të Zeza. Sulmet ndaj Grave në të Zeza nuk ndodhin rastësisht, kryerësit e tyre nuk janë të çorganizuar, nuk është diçka spontane. Përkundrazi. "përdorur konotacione seksuale ose për pamjen apo veshjet e tyre, ndërsa kjo ende ndodh me gratë në shoqërinë maqedonase. 'Si guxoni të kritikoni qeverinë, të shkoni në shtëpi dhe të gatuani' - këto ishin mesazhet që mora nga njerëzit që nuk po luftonin të njëjtën betejë si ne gjatë Revolucionit me Ngjyra”.

Miloš Urošević, aktivist ne organizatën Gratë në të Zeza⁴²⁹

⁴²⁸ J. Georgievski, *Civil Rights Defenders: Regional Solidarity Crucial for Defending European Values (Mbrotjtësit e të Drejtave Civile: Solidariteti Rajonal Jetik për Mbrotjtjen e Vlerave Evropiane)*, European Western Values, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/12/04/civil-rights-defenders-regional-solidarity-crucial-for-defending-european-values/>, (e qasur më 6 qershor 2020).

⁴²⁹ J. Diković, 'Vučićev Režim - Stanje Gore od Zločina' (Regjimi i Vucicit - Një Situatë më e Keqe se një Krim), *Danas*, 3 janar 2020, <https://www.danas.rs/drustvo/suocavanje/vucicev-rezim-stanje-gore-od-zlocina/>, (e qasur më 28 prill 2020).

MIRËNJOHJA DHE NJOHJA E OSHC-VE TË GRAVE NGA QEVERTITË KOMBËTARE

Një tendencë serioze dhe e vazhdueshme në secilin botim të *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor*, është tkurja e hapësirës për OShC-të e grave dhe GMDNJ-të në Ballkanin Perëndimor. Nacionalizmi i rrënjësor thellë, populizmi, konservatorizmi dhe lëvizjet anti-gjinore shoqëruar kontribuojnë në zvogëlimin e hapësirës për aktivistet/ët e të drejtave të grave dhe OShC-të e grave.⁴³⁰ GMDNJ-të përballen me zvogëlime të fondeve⁴³¹ dhe burimeve, duke i deklaruar OShC-të mercenarë të huaj dhe duke bërë thirrje për bojkot, presion politik, reagim të ngadaltë ose inekzistent nga sistemi i drejtësisë në sulmet ndaj aktivistëve dhe/ose OShC-ve.⁴³² Gjithashtu, Freedom House me bazë në SH.B.A. deklaroi në raportin e saj vjetor *Kombet në Tranzit* se Serbia dhe Mali i Zi nuk mund të klasifikohen më si demokraci pas një regresi demokratik të paparë.⁴³³ Lista e rangimit të Freedom House në këtë periudhë raportuese, për herë të parë, klasifikon të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor si Regjime Kalimtare ose Hibride. Kjo ka ndikime kumbuese në OShC-të e grave.

Njohja e punës së OShC-ve të grave, pothuajse si rregull në Ballkanin Perëndimor, shfaqet në formën e kontributeve që ato japin në proceset zyrtare shtetërore. Në shumicën e rasteve, prapëseprapë janë organizatat e grave ato që fillojnë proceset. OShC-të e grave në fund të fundit shërbejnë si një burim informatash dhe ekspertize në këto procese. Në të gjitha kontekstet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ka përparim të dukshëm në

përfshirjen e OShC-ve të grave në proceset legjislativë dhe grupet e punës,⁴³⁴ duke përdorur njohuritë dhe kapacitetin e tyre për të trajnuar institucionet dhe përfaqësuesit e tyre, dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet relevante. Megjithatë, këto përmirësime janë fundja rezultat i punës afatgjatë të bërë nga OShC-të e grave dhe shumë viteve të burimeve dhe energjisë së shpenzuar duke kërkuar që të bëhen pjesë e këtyre proceseve. Shtetet përgjithësisht mbeten pasive, me mungesë interesi dhe përkushtimi ndaj proceseve që duhet të jenë gjithëpërfshirëse për, ose që përfshijnë drejtpërdrejt shoqërinë civile, ndërsa barazia gjinore mbetet një zonë e marginalizuar në përgjithësi. Njohja e vërtetë e punës së OShC-ve të grave ende shpesh reduktohet në përdorimin e kapaciteteve dhe arritjeve të këtyre organizatave. Vite të tëra pune në përmirësimin e të drejtave të grave në shtetet e Ballkanit Perëndimor, megjithatë, i ka pozicionuar OShC-të e grave si një burim i pazëvendësueshëm dhe si pjesëmarrës aktivë në zhvillimin e legjislacionit, politikave dhe dokumenteve strategjike (veçanërisht në legjislacionin që mbulon DhBGJ dhe të drejtat LGBTQI + në të gjitha vendet), dhe si identifikues të pikave për veprim dhe si edukatorë për zyrtarët në disa vende të Ballkanit Perëndimor. Ekzistojnë ende shumë boshllëqe dhe vështirësi sa i përket bashkëpunimit, përfshirjes në procese vendimtare për të drejtat e grave në secilin shtet, megjithatë është bërë një lloj progresi.

⁴³⁰ N. Farnsworth et al. *Ku janë Parat për të Drejtat e Grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor Balkans*, Foundation Kwinna till Kwinna, 2020, https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/06/Funding-WCSOs_FINAL_2020-06-11.pdf, (e qasur më 26 gusht 2020), fq. 6.

⁴³¹ Për shembull, GMDNJ-të serbe që merren me dhunën ndaj grave, të cilët ishin mbështetur tradicionalisht (megjithëse me fonde të vogla) nga shteti për të siguruar mbështetje për viktimat e DhBGJ përmes linjave të ndihmës SOS, nuk marrin më fonde shtetërore. Në vend të kësaj, financimi iu drejtua një njësie ekonomike të sapo krijuar, në pronësi të shtetit (Burimi: A. Xhaho et al. *Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes, Mbrojtësit e të Drejtave Civile*, 2019). Në Ballkanin Perëndimor, shtetet nuk kanë krijuar fonde të qëndrueshme për OShC-të, ndërkohë që mjedisi i financimit në Ballkanin Perëndimor mbetet i fragmentuar me një mori fondesh të zotuar dhe rrallë të koordinuara mire.

(burimi: N. Farnsworth et al. *Ku janë Parat për të Drejtat e Grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor*, Foundation Kwinna till Kwinna, 2020).

⁴³² Pas pesë vitesh gjykimi, në Mars 2020, tre shoqata në BeH - Transparency International, revista BUKA dhe Asambleja Qytetare e Helsinkit - fituan një proces të përbashkët shpifjeje si paditës kundër shtëpisë botuese Besjeda, e cila botoi librin *Rrërimi i Republikës Serbe, Teoria and Teknologjia e Puçit*. Libri, i cili është ende në dispozicion në internet, rendit "OJQ-të e rreme në gatishmëri dhe që presin për një moment nga komandantët e huaj për t'u përfshirë në nxitjen e trazirave dhe minimin e rendit kushtetues". Gjykata arriti në përfundimin se ky fabrikim kishte për qëllim të shpifte dhe diskreditonte paditësit.

(burimi: E. Padalović, 'Donesena Presuda: Izdavačka Kuća "Besjeda" i Stefan Karganović Krivi Zbog Objave Liste Rušilaca Republike Srpske' (Aktgjykimi i Dhënë: Shtëpia Botuese "Besjeda" dhe Stefan Karganović Fajtor për Publikimin e Listës së Rrënuesve të Republikës Serbe), BUKA, 2 mars 2020).

⁴³³ 'Hungary, Serbia, Montenegro "No Longer Democracies": Report' (Raport: 'Hungaria, Serbia, Mali i Zi "Jo më demokraci"'), Al Jazeera, 6 maj 2020, <https://www.aljazeera.com/news/2020/05/hungary-serbia-montenegro-longer-democracies-report-200506161223889.html>, (e qasur më 8 qershor 2020).

⁴³⁴ Shënim për lexuesit se kjo nuk është njëjtë si vendimarrja. Sugjerimet dhe kontributet e paraqitura nga OShC-të e grave mund të respektohen ose jo, dhe OShC-të e grave pritet që si rregull të kontribuojnë pa kompensim, gjatë kryerjes së detyrave të tilla si mbajtja e shënimeve dhe madje edhe hartimi i legjislacionit: detyra që përndryshe duhet të kryhen nga zyrtarët e paguar të autoritetit.

Për sa i përket integritimit në BE, nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor kërkohet që të përfshijnë akterët e shoqërisë civile në reformat e nevojshme përmes konsultimeve dhe si monitorues të zbatimit të tyre, i cili nganjëherë rezultoi vetëm në një "mënyrë *pro forma* sepse është kërkesë e BE-së".⁴³⁵ Disa forma të kornizës zyrtare të bashkëpunimit formal qeveri-shoqëri civile janë të pranishme në të gjitha vendet. OShC-të e grave janë të pranishme në disa negociata të Kapitullit Acquis, por kontributet dhe rekomandimet e tyre nuk janë gjithmonë të përfshira, apo edhe të shqyrtuara, në vendimet përfundimtare. Progresi rajonal në periudhën e vëzhguar për qëllime të këtij raporti është dokumentuar, veçanërisht përmes pjesëmarrjes aktive të ekspertëve dhe krijimit të task forcave në zhvillimin e dokumenteve strategjike.

Në këtë botim të pestë të *Të Drejtave të Grave në Ballkanin Perëndimor*, ia vlen të përmendet se tendencat

e regjistruara në periudhën pesë-vjeçare të monitorimit të indikatorëve të raportit kanë treguar një përkeqësim rajonal të demokracisë dhe regres të lirive themelore. Ballkani Perëndimor ka demonstruar një rritje të nacionalizmit, të kontribuar nga lëvizja në rritje e krahut të djathtë në nivelet sociale dhe shtetërore. Kur flisim për tkurrjen e hapësirës për OShC-të e grave dhe aktivistet në rajon, hapësira në fjalë, qoftë pesë vjet më parë, ishte dukshëm e vogël. Përkeqësimi i demokracisë në Ballkanin Perëndimor dhe të gjitha pasojat që vijnë me këtë, kanë bërë që autorët e këtij botimi të vërejnë se mirënjohja dhe njohja e OShC-ve të grave nga ana e shtetit nuk do të thotë më e njëjta gjë si në kohën e edicionit të parë. Në kontekstin e përkeqësimit të vazhdueshëm në këtë rajon, është e rëndësishme që të mos kalojë pa u njohur puna jetike për barazinë gjinore e bërë nga OShC-të e grave, dhe se mirënjohjet vijnë nga ana e pjesëtarëve të organizatave dhe nga bashkësia ndërkombëtare.

SHQIPËRIA

Në shtator 2019, Shqipëria miratoi për herë të parë Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) për implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të KB mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Procesi ishte gjithëpërfshirës dhe përfshiu koalicionin "Gratë, Paqja dhe Siguria në Shqipëri", i përbërë nga 32 OShC vendore. Ky koalicion ka qenë organizata kryesore në lobimin dhe avokimin për përgatitjen e Planit të Veprimit për 1325.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) vazhdon të njihet si një nga akterët kryesorë në luftën për barazinë gjinore në vend, duke ofruar kontribute dhe rekomandime për dokumentet me rëndësi në nivel kombëtar dhe të BE-së, në lidhje me situatën e grave në vend. Gjatë periudhës raportuese, AWEN ka bashkëpunuar me autoritetet në forma të ndryshme: pjesëmarrje në seancën dëgjimore për buxhetimin e integruar gjinor për vitin 2020 në prezencën e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; pjesëmarrja dhe informimi në një konferencë të

organizuar nga Ombudspersoni në Shqipëri mbi çështjet e barazisë gjinore; duke kontribuar në Ligjin e Shërbimeve Sociale duke prezantuar informata me fokus në vajzat dhe gratë viktimat/të mbijetuara të DhBGj; organizimi i takimeve avokuese mbi politikën dhe instrumentet gjinore të BE-së me përfaqësuesit e Aleancës së Grave Këshilltare të Vlorës, Himarë dhe Selenicë.

Sa i përket procesit të integritimit në BE, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian është një model për informimin, konsultimin, komunikimin dhe angazhimin e shoqërisë civile, palëve të interesit, akademisë dhe qeverisjes vendore në procesin e negociatave të anëtarësimit në BE, në Shqipëri. Sidoqoftë, ka mungesë të aktivitetit të Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian; autoriteti përgjegjës për këtë çështje, si dhe mungesë të vullnetit politik për të forcuar më tej procesin e zhvillimit të shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë jo-shtetërorë.

⁴³⁵ J. Juzová, 'Civil Society and the EU Integration Process: Key Importance, Little Impact?', ('Shoqëria Civile dhe Procesi i Integritimit Evropian: Rëndësia kryesore, Ndikimi i vogël?') *European Western Balkans*, 11 shtator 2019, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/09/11/civil-society-and-the-eu-integration-process-key-importance-little-impact/>, (e qasur më 7 qershor 2020).

⁴³⁶ UN Women, 'The First Report on the Implementation of Resolution 1325 in Albania Launched' ('Lansohet Raporti i Parë mbi Implementimin e Rezolutës 1325 në Shqipëri'), *UN Women*, 2019, <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2019/10/the-first-report-on-the-implementation-of-resolution-1325-in-albania-launched>, (e qasur më 7 qershor 2020).

⁴³⁷ Informat e ndarë me Kvinna nga organizata partnere në Shqipëri.

⁴³⁸ J. Marović, I. Stefanovski, and I. Ivanovik, *Comparative Study, Civil Society in the Western Balkans: Involvement in the EU Accession Negotiation and EU Integration Processes from Initiatives to a Structured Dialogue* (Studim Krahësor, Shoqëria Civile në Ballkanin Perëndimor: Përfshirja në Negociatat për Anëtarësim në BE dhe Proceset e Integritimit Evropian nga Iniciativat në një Dialog të Strukturuar), Beograd, CRTA, 2019, <http://www.centaronline.org/userfiles/files/publikacije/comparative-study-civil-society-in-the-western-balkans.pdf>, (e qasur më 16 prill 2020), fq. 23-24.

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

OSHC-të e grave rregullisht u ofrojnë institucioneve ndihmën e tyre, në fushat specifike ku ata punojnë dhe ku ato posedojnë ekspertizë më të thelluar.⁴³⁹ Përfaqësuesit e OShC-ve të grave u emëruan në grupe pune në nivele të ndryshme qeveritare gjatë kësaj periudhe raportuese. Në vitin 2019, koordinatoja e projektit të Fondacionit CURE, Selma Hadžihalić, është emëruar zyrtarisht nga Qeveria e Kantonit të Sarajevës për të marrë pjesë në ekipin punues përgjegjës për zhvillimin e Planit të Veprimit Gjinnor dhe planin financiar të Kantonit Sarajevë. Fondacioni i Grave të Bashkuara është një nga përfaqësuesit e OShC-ve të zgjedhura në Këshillin për Luftimin e Dhunës në Familje të Republikës Srpska, i cili mundëson përfshirje më aktive të OShC-ve në proceset e vendimmarrjes në lidhje me DhBGj. Përfaqësuesit e Fondacionit janë caktuar gjithashtu si anëtarë të Trupit Këshillëdhënës të Këshillit të Ministrave të BeH për bashkëpunim me OShC-të.⁴⁴⁰

Gjatë periudhës raportuese, OShC-të e grave vazhduan të nisin dhe përmirësojnë bashkëpunimin me ofruesit e shërbimeve. Shoqata HORIZONTI nga Tuzla dhe Forumi Žena Bratunac përmirësuan bashkëpunimin midis grupeve të lobit të grave në Tuzla, Bratunac, Milići, Srebrenica dhe Gračanica dhe përmes Komisioneve të tyre përkatëse Gjinnore Komunale, përmes takimeve të cilat i ofruan OShC-ve të grave mundësi konkrete për të avokuar për krijimin e Planeve Lokale të Veprimit Gjinnor në komunat e tyre.⁴⁴¹ Një Memorandum Bashkëpunimi midis Fondacionit Lara dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Srpska u nënshkrua në 2019, duke u mundësuar OShC-ve të grave të kryejnë monitorim të pavarur të reagimit të policisë ndaj dhunës me bazë gjinnore në territorin e Republika Srpska. Memorandumi i Bashkëpunimit gjithashtu i mundësoi Fondacionit Lara dhe OShC-së së grave Ženski Centar të grumbullojnë të dhëna për hetimet e pezulluara në rastet e DhF-së në Republikën Srpska për 2016 dhe 2017. Qasja në këto të dhëna që rezultuan nga bashkëpunimi midis OShC-ve të grave dhe institucioneve përkatëse është një sukses i madh për OShC-të e grave që punojnë në fushën e luftimit të DhBGj.

OSHC-të vazhdojnë të njihen si edukatore, ndërsa gjatë periudhës raportuese OShC-të e grave ofruan trajnime dhe punëtori të shumta të rëndësishme për përfaqësuesit institucionalë. TRIAL International zhvilloi një mjet për edukimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve kur bëhet fjalë për mospërputhjet në politikat e dënimit për krime të dhunës seksuale të lidhura me konfliktin, dhe avokoi për Qendrat për Trajnim Gjyqësor dhe Prokurorial. Për herë të parë, tema e politikës jokonsistente të dënimit u përfshi në programet zyrtare të trajnimit të të dy Qendrave për Trajnim Gjyqësor dhe Prokurorial në vitin 2020, si rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre trajnimeve.⁴⁴² Qendra e të Drejtave të Grave Zenica mbajti një seri trajnimesh për policinë dhe përfaqësuesit e qendrave të punës sociale. Për më tepër, trajnimet për gjykatës dhe prokurorë të kryera në 2018 dhe 2019 krijuan një modalitet të ndikimit për të ndryshuar qëndrimet dhe qasjet ndaj viktimave/të mbijetuarave të DhBGj në procedurat gjyqësore.⁴⁴³ Praktika e mirë tregon se trajnimet e rregullta dhe të vazhdueshme për përfaqësuesit institucionalë që punojnë në ragimin ndaj ose parandalimin e DhBGj kanë një ndikim të madh dhe është e rëndësishme të theksohet se gjykatësit dhe prokurorët në BeH kanë marrë në vëmendje OShC-të e grave, duke njohur ekspertizën e tyre në përpjekjet e tyre trajnuese.

Iniciativat e OShC-ve në lidhje me ndryshimet legislative ishin të suksesshme në periudhën e vëzhguar. Republika Srpska miratoi ndryshimet dhe amandamentet e propozuara të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e kërkuara nga Fondacioni Gratë e Bashkuara dhe organizatat e tyre partnere.⁴⁴⁴ Gratë e Bashkuara avokuan për ndryshime të Ligjit për Ndihmën Juridike Falas në njohjen e grave viktimave/të mbijetuarave të DHF si përfituese të ndihmës juridike falas pavarësisht nga regjistrimi i pasurisë, një iniciativë që më herët është pranuar në projektligjin e miratuar nga Asambleja Popullore e Republika Srpska.⁴⁴⁵ Fondacioni CURE filloi një iniciativë në nivelin komunal në Sarajevën Qendrore, për adresimin e çështjeve me të cilat përballen familjet me një prind, duke rezultuar në studimin e vitit 2019 *Harta e të Drejtave dhe Nevojave të Familjeve me Një-Prind në Komunën e Centar Sarajevo*⁴⁴⁶ të financuar nga komuna.⁴⁴⁷

⁴³⁹ JPo aty., fq. 27.

⁴⁴⁰ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

⁴⁴¹ Po aty.

⁴⁴² Po aty.

⁴⁴³ Po aty.

⁴⁴⁴ Nene të reja në lidhje me prezantimin e personave të besueshëm për viktimat / të mbijetuarat e dhunës janë miratuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Kjo përfshin informimin e detyrueshëm të viktimave / të mbijetuarave të dhunës për të drejtat e tyre. Ndryshimet e tjera thelbësore në ligj përfshijnë heqjen e sanksioneve për DhF si vepra kundërvajtje dhe të njihet vetëm si vepër penale sipas Kodit Penal të Republika Srpska.

⁴⁴⁵ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

⁴⁴⁶ S. Sadić, A. Ždralović, and M. Emirhafić, *Jedno Roditeljske Porodice - Mapiranje Prava i Potreba Samostalnih Roditelja/ki na području općine Centar Sarajevo (Familjet Një Prindër – Hartëzimi i të Drejtave dhe Nevojave të Prindërve Vetëushqyes në zonën e komunës Centar Sarajevo)*, Fondacioni CURE, 2020, http://www.fondacijacure.org/files/Jednoroditeljske_.pdf, (e qasur më 7 qershor 2020).

⁴⁴⁷ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në BeH.

KOSOVA

Trajnimet e vazhdueshme për përfaqësuesit institucionalë vazhduan me sukses gjatë periudhës së vëzhguar për këtë raport. Si rezultat i bashkëpunimit të mirë me autoritetet lokale, Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë u ftua nga Njësia e Dhunës në Familje të kuadër të Policisë së Kosovës për të zhvilluar së bashku ligjërata mbi DhBGj/DhF për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në komunën e Mitrovicës dhe Fushë Kosovës, gjatë fushatës “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Gruas”.

OSHC-të e grave ishin të përfshira në proceset legislative dhe suksesi i këtyre iniciativave përshkruan rëndësinë e përfshirjes së OSHC-ve të grave në proceset legislative dhe politikë-bërëse përkitazi me fushat e tyre⁴⁴⁸ të ekspertizës. Për shembull, Medica Kosova, RrGGK dhe KGSC midis shumë OSHC-ve të tjera ishin përqëndruar në rishikimin dhe finalizimin e Procedurave Standarde të Operimit për qasjen e viktimave/të mbijetuarave të DHBGJ në legjislacion dhe drejtësi, dhe ishin gjithashtu pjesë e hartimit të këtyre procedurave, ndërsa sugjerimet e tyre u përfshinë edhe në draftin përfundimtar. RrGGK ndihmoi Ministrinë e Integritit Evropian duke shqyrtuar draftin e Agjendës për Reforma Evropiane II, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), si dhe shumë draft politika dhe ligje të tjera që do të miratohen në të ardhmen, në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në BE.⁴⁴⁹ RrGGK ka qenë gjithashtu një nga palët kryesore të interesit në procesin e hartimit të Planit Kombëtar për Barazinë Gjinore 2020-2024 duke siguruar se ai bazohet në një analizë të mirëfilltë dhe të bazuar në prova dhe

rekomandime nga ekspertë të fushës. KGSC u bë pjesë e grupit punues për hartimin e Ligjit të ri mbi Regjistrimin e Popullsisë dhe Strehimit të Kosovës, të organizuar nga Agjencia e Statistikave.⁴⁵⁰

Në shtator, një aktivist trans në Kosovë fitoi rastin gjyqësor që personave trans t'u lejohej të ndryshonin emrin dhe gjininë e tyre në regjistrin civil dhe dokumentet e lëshuara nga qeveria.⁴⁵¹ Ky vendim gjykate nuk do të ishte arritur po të mos ishin përpjekjet avokuese të OSHC-ve për të drejtat e LGBTQI + dhe përpjekjet e tyre për të bërë presion mbi institucionet përkatëse.

Një shembull tjetër i suksesshëm është vendimi i qeverisë së Kosovës, së bashku me BE-në, për të ndërmarrë 11 hapa për t'i dhënë prioritet më të lartë çështjeve për të drejtat e njeriut të grave në lidhje me procesin e pranimit në BE, si rezultat i drejtpërdrejtë i punës avokuese të RrGGK-së. Shembuj të tjerë të ndryshimeve që ishin rezultat i drejtpërdrejtë i avokimit të përbashkët nga RrGGK dhe OSHC-të e grave gjatë periudhës raportuese përfshijnë: Parlamenti i Kosovës krijon një vijë buxhetore për mbështetje të mjaftueshme financiare për strehimoret për vitin 2019; inputet e integruara në NPISAA 2019-2023; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ndryshon një rregullore të brendshme, ku Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës shtohet si përfaqësues zyrtar për komunitetin e të verbërve; dhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale pezulloi projektligjin e Punës me arsyetimin se nuk ishte përfshirë pushimi i maternitetit.

⁴⁴⁸ Për shembull: mbështetja psikosociale e detyrueshme për viktimat/të mbijetuarat që futen në procesin e dokumentimit në Prokurorinë e Kosovës të ofrohet para, gjatë dhe pas gjyqimit.

⁴⁴⁹ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Kosovë.

⁴⁵⁰ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Kosovë.

⁴⁵¹ X. Bami, 'Kosovo Pride Activists Put Law Under Spotlight' (Aktivistët e Krenarisë në Kosovë e Vendosin Ligjin në Qendër të Vëmendjes), *BIRN*, 10 October 2019, <https://balkaninsight.com/2019/10/10/kosovos-3rd-pride-parade-demands-law-implementation/#gsc.tab=0>, (e qasur më 7 qershor 2020).

MALI I ZI

Sondazhet e opinionit publik të kryera në vitin 2019 kanë treguar një nivel të lartë besimi të OShC-të në Mal të Zi; më të lartë se niveli i besimit publik tek qeveria.⁴⁵² Komisioni Evropian, megjithatë, theksoi se përfshirja e mirëfilltë e OShC-ve në procesin e politikëbërjes ende nuk është dëshmuar në praktikë.⁴⁵³ Shembuj pozitivë të njohjes së OSHC-ve të grave janë ilustruar me përfshirjen e tyre në hartimin e legjislacionit, edukimin dhe trajnimin për institucionet që kryhet nga OSHC-të e grave, dhe pjesëmarrjen e tyre si ekspertë në task forcat qeveritare.

Një Strategji e re LGBTI u miratua në 2019 dhe përfshin masa më konkrete, një buxhet më të definuar dhe indikatorë më të qartë në krahasim me strategjinë e mëparshme, e cila skadoi në vitin 2018. Komiteti për Çështje Sociale në komunën e Kolashin miratoi Planin e parë Lokal të Veprimit LGBT për Malin e Zi me një shumicë votash. Bijelo Polje ishte qyteti i dytë që veproi njëjtë. Këto zhvillime pozitive janë rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm midis komunave dhe OSHC-ve, të tilla si Juventas dhe Queer Montenegro. Të dy organizatat po punojnë gjithashtu me Podgoricën dhe Kotorin, me shpresën se ato komuna do të ndjekin shembullin. Megjithatë, Plani i Veprimit LGBT për komunën e Mojkovac, ishte refuzuar.⁴⁵⁴

Gjatë periudhës së raportimit, Ministria e Drejtësisë nisi procedurën e ndryshimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe krijoi një grup punues, anëtare e të cilit është Drejtorja Ekzekutive e Qendrës për të Drejtat e Grave (QDG). QDG hartoi propozimet ligjore dhe bëri koordinimin e organizatave për të dorëzuar së bashku ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, bazuar në përvojën

e gjerë praktike në ofrimin e mbështetjes për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës. Drejtorja Ekzekutive e QDG-së ishte gjithashtu anëtare e Ekipit Operacional për luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, i formuar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi.

Më tej, QDG vazhdoi avokimin përmes anëtarësimit në disa grupe punuese të themeluara nga shteti: një grup punues për përgatitjen e Protokollit të ri për Parandalimin, Trajtimin dhe Mbrojtjen nga Dhunimi dhe Dhuna ndaj Grave; një grup punues për Kapitullin 23 brenda procesit të anëtarësimit në BE; dhe grupet punuese për ndryshimin e Ligjit mbi Dhunën në Familje dhe për ndryshimin e Kodit Penal të Malit të Zi. Në vitin 2019 u mbajtën dy takime me Kryeministrin për çështje të rëndësishme lidhur me mangësitë në mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave, mungesën e mbrojtjes së fëmijëve - dëshmitarë të DhF, diskriminimin institucional dhe mosndëshkimin e zyrtarëve publikë në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fëmijëve.

Për fat të keq, pjesëmarrja e OSHC-ve në grupet punuese të negociatave, me kalimin e kohës, është bërë gjithnjë e më shumë *pro forma*, pjesërisht për shkak të Planeve të vjetruara të Veprimit të cilat nuk e mundësojnë hapjen e diskutimeve mbi reformat. Përkundër faktit që pjesëmarrja e OSHC-ve (e Grave) në nivelet kombëtare dhe lokale të proceseve të vendimmarrjes është e mirëseardhur, është raportuar se përfaqësuesit nga sektori civil janë të mbivotuar në shumë prej grupeve punuese, pasi që bilanci i fuqisë është natyrshëm në anën e atyre që vijnë nga administrata publike dhe organet qeveritare.⁴⁵⁵

⁴⁵² A. Xhaho et al. Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Ballkanin Perëndimor: Frikësimi në vend të Njohjes, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2019, fq 52.

⁴⁵³ Komisioni Evropian, *Raporti i Malit të Zi 2019*, Bruksel, Komisioni Evropian, 2019.

⁴⁵⁴ ILGA-Evropë, *Rishikimi Vjetor i Situatës së të Drejtave të Njeriut për Personat Lezbike, Gej, Biseksuale, Transgjedor dhe Interseks me Mbulim të Ngjarjeve që ndodhën në Evropë dhe Azi Qendrore ndërmjet janarit dhe dhjetorit 2019*, Bruksel, 2020.

⁴⁵⁵ 'The role of CSOs in Montenegro's EU integration: Substantial or Make-believe?' ('Roli i OShC-ve në Integrimin Evropian të Malit të Zi: Thelbësor apo i Imagjinuar?'), *European Western Balkans*, 21 shkurt 2020, <https://europeanwesternbalkans.com/2020/02/21/the-role-of-csos-in-montenegros-eu-integration-substantial-or-make-believe/>, (e qasur më 7 qershor 2020).

MAQEDONIA VERIORE

Pavarësisht se kapacitetet dhe rezultatet e punës së OShC-ve të grave janë të dukshme përmes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së tyre në proceset legislative, në të njëjtën kohë nuk ka asnjë ndryshim të paradigmes në marrëdhëniet e shtetit me OShC-të e grave. Si në të kaluarën, OShC-të e grave shpesh trajtohen si "sekretare" për qeverinë, me pritjen që ato të ofrojnë hulumtimin dhe kontributin në vend të zyrtarëve shtetërorë, por pa u njohur për punën ose ekspertizën e tyre. Mungesa e ekspertizës mbi barazinë gjinore brenda institucioneve dhe rraskapitja e aktivistëve nga puna shtesë u vërejt edhe gjatë periudhës raportuese. Gjatë periudhës së raportimit, OShC-të e grave u ftuan të marrin pjesë në grupe punuese për përgatitjet dhe ndryshimet e ligjeve, dokumenteve dhe politikave. Rekomandimet, kontributet dhe rekomandimet e tyre u morën parasysh në një masë të madhe si dhe u integruan në verzionet përfundimtare të dokumenteve të përgatitura, por ishte evidente mungesa e priorizimit të çështjeve nga fusha e të drejtave të grave.

Gjatë periudhës në fjalë, OShC-të kanë raportuar se qeveria e zgjedhur në vitin 2017 është shumë më e hapur për të bashkëpunuar me shoqërinë civile sesa regjimi i mëparshëm. Brenda institucioneve shtetërore janë krijuar grupe të ndryshme punuese, ku OShC-të e grave janë ftuar të marrin pjesë në hartimin e ligjeve të reja, ose ndryshimin e ligjeve ekzistuese. Ky është një aspekt pozitiv, pasi përfshirja e OShC-ve të grave ka një ndikim afirmativ në legjislacionin e miratuar në vitin 2019, siç është Ligji për Ndërprerjen e Shtatëzansisë dhe Ligji për Mbrojtjen Sociale. Gjatë periudhës raportuese, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi u miratua pas një procesi dhjetëvjeçar të hartimit nga institucionet dhe shoqëria civile. Pas këtij procesi, ligji u miratua në vitin 2019, duke filluar me mbrojtje të reja anti-diskriminim, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara. Megjithatë miratimi i legjislacionit anti-diskriminim nga Maqedonia Veriore u festua anëmbanë për përmbajtjen dhe për procesin e bashkëpunimit në hartimin e tij, është e rëndësishme të theksohet se shteti shfuqizoi ligjin në 14 maj 2020, pas refuzimit të Gjykatës Kushtetuese për të pranuar ligjin pa votën e shumicës kushtetuese.⁴⁵⁶ Parlamenti Nacional miratoi ligjin për herë të parë në maj 2019 me 55 vota nga 120, me më pak se 61 vota të

nevojshme për një shumicë kushtetuese.⁴⁵⁷ Shfuqizimi i Ligjit të ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nënkuptonte se të gjitha format e reja të mbrojtjes të ofruara për komunitetet e marginalizuara, veçanërisht mbrojtja për komunitetin LGBTQI + ishin shfuqizuar poashtu. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, nuk ka pasur ndonjë ndryshim sa i përket statusit të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Legjislacioni i ri mbi DhBGj u përgatit së bashku me rekomandimet dhe kontributin nga think-tank Reactor - Research in Action dhe Rrjeti Kombëtar i OShC-ve të grave për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje "Zëri kundër Dhunës" (Rrjeti Kombëtar). Të dy organizatat morën pjesë në proceset e konsultimit dhe ngjarjeve të vlerësimit, ku propozimet rishikohen dhe vërtetohen përpara se të aprovohen, me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). Për më tepër, Rrjeti Kombëtar forcoi partneritetin e tyre me Klubin Parlamentar të Grave, organizoi disa takime të përbashkëta, një ngjarje publike dhe avokoi bashkërisht për miratimin e një modeli për riintegrimin dhe socializimin e grave viktimat/të mbijetuara të DhBGj.

Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara" (Koalicioni MARGINS) ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe është pranuar si pjesë e grupit punues për hartimin e ligjit të ri për arsimin në shkollën e mesme, duke ofruar një mundësi për të siguruar që parandalimi i DhBGj dhe ngacmimit në shkollat e mesme është i përfshirë në legjislacion.

Reaktori vazhdoi punën në mbështetjen e punës së institucioneve qeveritare në integrimin e çështjeve gjinore në procesin e pranimi në BE dhe avancimin e barazisë gjinore në vend. Gjatë vitit 2019, Rrjeti Kombëtar vendosi bashkëpunim me më shumë se 10 palë të interesit, duke përfshirë MPPS, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin Parlamentar për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat, Klubin Parlamentar të Grave, Sindikatat/Forumet e Grave në kuadër të partive politike, Qytetin e Shkupit dhe katër komuna të tjera brenda rajonit të Shkupit.

⁴⁵⁶ Rrjeti Evropian i Ekspertëve Ligjorë për Barazi Gjinore dhe Mosdiskriminim, *Flash Report: The Constitutional Court Repealed the 2019 Anti-Discrimination Law (Raport i Shpejtë: Gjykatat Kushtetuese Shfuqizojnë Ligjin Anti-Diskriminim të vitit 2019)*, Komisioni Evropian, 2020, <https://www.equalitylaw.eu/downloads/5148-north-macedonia-the-constitutional-court-repealed-the-2019-anti-discrimination-law-104-kb>, (e qasur më 3 korrik 2020).

⁴⁵⁷ Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 'North Macedonia's Repeal of Anti-Discrimination Law Poses Major Setback to Human Rights Protection' ('Shfuqizimi i Ligjit Anti-Diskriminim në Maqedoninë Veriore Përbën Kthim Mbrapa në Fushën e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut'), *Mbrojtësit e të Drejtave Civile*, 2020, <https://crd.org/2020/05/19/north-macedonias-repeal-of-anti-discrimination-law-poses-major-setback-to-human-rights-protection/>, (e qasur më 3 korrik 2020).

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Maqedoninë Veriore vendosi bashkëpunim të shkëlqyeshëm me institucione të ndryshme relevante dhe akterë të rëndësishëm për zbatimin e Konventës së Stambollit, të tilla si MPPS, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe komunat. Ky bashkëpunim ka rezultuar në ngjarje dhe aktivitete të organizuara me sukses siç janë trajnime dhe dialogje politikash në lidhje me Konventën e Stambollit dhe DHBGJ. Puna e Shoqatës së Edukimit dhe Hulumtimit Shëndetësor (HERA) u njoh dhe disa nga rekomandimet e organizatës u prezantuan në raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë Veriore të vitit 2019 në fushën e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Në nivelin lokal, komuna e Shtipit nënshkroi një marrëveshje me OShC Organizata Arsimore-

Humanitare (ECHO), duke autorizuar organizatën për përgatitjen e një Plani të Veprimit komunal për mbrojtje nga DhBGJ. Komuna gjithashtu njoftoi mbi mbështetjen financiare për organizatën përmes Programit të Mbrojtjes Sociale, si dhe Ekipet lokale Multisektoriale të Komunitetit kundër DHBGJ të cilat do të punojnë në avancimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet agjencive.

Akcija Zdruzenska dha një kontribut të duhur politik në drejtim të rishikimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta midis Grave dhe Burrave, përfshirë reformimin dhe përmirësimin e efikasitetit të makinerisë lokale dhe kombëtare për barazinë gjinore. Dokumentet e vlerësimit dhe të politikave do të shërbejnë si dokumente bazë për grupin punues (me përfshirjen e Akcija Zdruzenska) të krijuar nga MPMS për të propozuar ndryshime legislative.

SERBIA

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Serbia ka rënë në rangim në Gjurmimin e Monitorimit të Hapësirës Qytetare të rrjetit ndërkombëtar të OSHC-ve CIVICUS, dhe tani është në kategorinë e vendeve, ku shkelen liritë themelore.⁴⁵⁸ Rangimi tregon një kontekst ku shteti vendos një shumëllojshmëri të kufizimeve ligjore dhe ekstra-ligjore mbi shoqërinë civile përmes deklaratave poshtëruese dhe procedurave burokratike.⁴⁵⁹ Kjo pasqyrohet në trajtimin dhe mungesën e njohjes së OSHC-ve të grave nga qeveria kombëtare, dhe tkurrjen e vazhdueshme të hapësirës për shoqërinë civile.

Qendra Autonome e Grave ka raportuar se komunikimi me organet qeveritare në të gjitha nivelet u zvogëlua gjatë periudhës raportuese për shkak të vonesave në të gjitha ndryshimet e planifikuara legislative, hartimin e strategjive dhe Planeve të Veprimit për shkak të zhvillimeve politike në Parlament, si dhe faktit se pikëpamjet e organizatave të specializuara të grave u injoruan dukshëm, gjë që rezultoi në bojkot të grupit punues për hartimin e Strategjisë së Re për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave 2020-2025. Kjo është një masë e fortë, që përdoret vetëm pas konsideratave të kujdesshme dhe vetëdijes për publicitetin negativ të mundshëm që mund të sjellë një vendim i tillë, por duke gjykuar se legjitimitimi me pjesëmarrje do të ishte më i keq.

Në komunën e Aleksandrovac, një mural për solidaritetin e grave u pikturua në një ndërtesë publike. Ky mural ishte rezultat i Mreža Žena Rasinskog Okruga (Rrjeti i Grave të Rrethit të Rasinës), respektivisht bashkëpunimit të rrjetit me qeverinë komunale,⁴⁶⁰ anëtare i të cilit është organizata e grave Sandglass. Murali është një përfaqësim simbolik i fuqizimit të grave në fshat dhe në zona të vogla urbane, ndërsa në Aleksandrovac ilustron vullnetin logjistik dhe politik për ta shprehur atë publikisht.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile serbe vazhduan të përballen me pengesa thelbësore në përpjekjet e tyre për të marrë pjesë në procesin e anëtarësimit në BE. Prandaj, ndikimi i shoqërisë civile në proceset e negociatave me BE-në është i kufizuar, përkundër proceseve të domosdoshme të konsultimit me OSHC-të që është pjesë integrale e anëtarësimit në BE. Transparenca e këtyre proceseve në Serbi mbetet e kufizuar, ndërsa sfidat me të cilat përballen organizatat gjatë hyrjes në këto procese dhe në ofrimin e kontributeve në projektligje i privon ato të kontribuojnë në mënyrë domethënëse.⁴⁶¹ Bashkëpunimi qeveritar me OSHC-të (e grave) është i një natyre më simbolike, pa respekt të mirëfilltë për opinionin dhe ekspertizën e tyre. Bllokimi ose ndërprerja e komunikimit me OShC-të (ato autonome dhe të orientuara kah kritika) nga ana e organeve shtetërore është një dukuri e

⁴⁵⁸ CIVICUS, *Monitor Tracking Civic Space: Serbia* (Monitorimi i Gjurmimit të Hapësirës Qytetare: Serbia) [faqja e internetit], <https://monitor.civics.org/country/serbia/>, (e qasur më 23 prill 2020).

⁴⁵⁹ CIVICUS, 'Serbia's Civic Space Downgraded' ('Hapësira Qytetare e Serbisë e Degraduar'), CIVICUS, 2019, <https://www.civics.org/index.php/media-resources/news/4113-serbia-s-civic-space-downgraded>, (e qasur më 22 prill 2020).

⁴⁶⁰ Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Serbi.

⁴⁶¹ J. Marović, I. Stefanovski, and I. Ivanovik, *Studim Krahasmor, Shoqëria Civile në Ballkanin Perëndimor: Përfshirja në Negociatat për Anëtarësim në BE dhe Proceset e Integrimit Evropian nga Iniciativat në një Dialog të Strukturuar*, Beograd, CRTA, 2019, fq. 18.

zakonshme.⁴⁶² Dy raporte radhazi të Indeksit të Qëndrueshmërisë së OSHC-ve për Serbinë (në vitin 2017 dhe 2018) treguan se situata sa i përket tkurrjes së hapësirës për OSHC-të në Serbi është përkeqësuar gjatë kësaj periudhe. Është e rëndësishme të

theksohet se Komisioni Evropian në vitin 2019 arriti në përfundimin se "nuk është bërë asnjë përparim drejt krijimit të një mjedisi që do të mundësonte zhvillimin dhe financimin e shoqërisë civile".⁴⁶³

”

“Në kontekstin aktual politik, OSHC-të e grave janë ndër zërat kryesorë që kërkojnë një qeverisje të mirë dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Pabarazitë gjinore mbeten të shpërndara në Ballkanin Perëndimor dhe OSHC-të e grave janë mirë të etabluara për t'i adresuar këto, duke përfshirë hulumtime të bazuara në dëshmi, avokim, propozime politikash, monitorim të qeverisë dhe ofrimin e shërbimeve me benefit publik. Dëshmitë tregojnë se OSHC-të e grave kanë kontribuar në shumë ndryshime shoqërore, duke sugjeruar që mbështetja e OSHC-ve të grave do të thotë të investosh në ndryshime sociale”⁴⁶⁴

”

“Globalisht, 2019 na solli rritje të nacionalizmit, i cili përkeqësoi kushtet për gratë mbrojtëse të drejtave të njeriut që janë në shënjestër me kërcënime dhe gjuhë urrejtjeje. Në të njëjtën kohë, ne gjithashtu pamë gra që dilnin në rrugë dhe kërkonin të drejtat e tyre në forume vendimmarrëse, duke filluar nga këshillat lokale deri në negociatat ndërkombëtare të paqes”.

Petra Tötterman Andorff, Sekretare e Përgjithshme, Fondacioni Kvinna till Kvinna⁴⁶⁵

”

“Presioni shprehet përmes [...]: Përgjashtimi nga negociatat, veçanërisht në lidhje me procesin e integritetit në BE; dhe institucionet qeveritare 'kanë kohë të kufizuar' për të marrë pjesë në përpjekje të ndryshme të inicluara nga organizata të shoqërisë civile, veçanërisht organizata të grave si e jona. Kjo dërgon mesazhe që organizatat janë të parëndësishme. Ne gjithashtu shohim një mosgatishmëri për t'iu përgjigjur thirrjeve tona për bashkëpunim me hartuesit e politikave lokale.”

GMDNJ, BeH⁴⁶⁶

⁴⁶² Informatë e ndarë me Kvinna till Kvinna nga organizata partnere në Serbi.

⁴⁶³ ‘Tangled up in Bureaucracy. What is Hindering Serbian CSOs to Participate in the EU Negotiation Process?’ (‘Të Ngatërruar në Burokraci. Çfarë po i Pengon OSHC-të Serbe për Pjesëmarrje në Procesin e Negociatave për Anëtarësim në BE?’), *European Western Balkans*, 28 janar 2020, <https://europeanwesternbalkans.com/2020/01/28/what-is-hindering-serbian-csos-to-participate-the-eu-negotiation-process/>, (e qasur më 7 qershor 2020.).

⁴⁶⁴ N. Farnsworth et al., *Ku janë Parat për të Drejtat e Grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020, fq. 7.

⁴⁶⁵ Fondacioni Kvinna till Kvinna, *Annual Report 2019 (Raporti Vjetor 2019)*, Stokholm, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020, <https://kvinnatillkvinna.org/2020/04/29/annual-report-2019/>, (e qasur më 1 shtator 2020).

⁴⁶⁶ C. Wassholm, *Suffocating the Movement - Shrinking Space for Women's Rights (Ngulfatja e Lëvizjes – Tkurrrja e Hapësirës për të Drejtat e Grave)*, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2018, <https://kvinnatillkvinna.se/wp-content/uploads/2018/03/kvinna-till-kvinna-suffocating-the-movement-report-eng-2018.pdf>, (e qasur më 20 gusht 2020), fq. 18.

Rekomandimet⁴⁶⁷*

Sulmet ndaj GMDNJ-ve

SHKURTIMISHT:

Sulmet ndaj GMDNJ-ve, përveç grave gazetare dhe politikane, janë nën-raportuar dhe hetuar në mënyrë joadekuate. Në rastet kur raportohen sulmet, raportet shpesh nuk merren seriozisht nga institucionet përkatëse. Nuk ekzistojnë mekanizma për shqyrtimin e ankesave dhe mekanizma të mbështetjes dhe nuk mbledhen të dhëna sistematike për politikëbërje të bazuar në dëshmi.

BRENDA NJË VITI:

Të shtohen Mbrojtësit/et e të Drejtave të Njeriut (MDNJ) si një kategori ligjore në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të gjitha shkeljet, sulmet dhe kërcënimet e bëra kundër MDNJ-ve të gjykohen me status të veçantë ligjor, për të siguruar ruajtjen e pozitës së tyre të rëndësishme si promovues të paqes dhe të drejtave të njeriut. Të themelohen mekanizmat për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e rasteve të sulmeve ndaj këtyre grupeve.

Për Qeveritë:

- Përcaktoni MDNJ si një kategori ligjore në legjislacionin përkatës për të përshkruar ndjeshmëritë e tyre të veçanta dhe për të siguruar që sulmet dhe kërcënimet ndaj MDNJ-ve trajtohen nga institucionet gjyqësore si një kategori me një status të veçantë ligjor dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare (të tilla si Deklarata për Mbrojtësit/et e të Drejtave të Njeriut).
- Zhvilloni një plan veprimi që synon posaçërisht adresimin e dhunës, ngacmimit (si në internet dhe jashtë) dhe gjuhës së urrejtjes drejtuar GMDNJ-ve, politikaneve, gazetarëve dhe grupeve të tjera të grave në diskursin publik (p.sh. artistët) (Shembuj: Finlanda, Suedia).
- Sigurohuni që paragjykimi gjinor është një rrethanë rënduese për dënimin e këtyre krimeve.
- Institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe/ose organeve të barazisë gjinore duhet t'u kërkohej të mbledhin, analizojnë dhe shpërndajnë të dhëna mbi sulmet ndaj GMDNJ-ve dhe gazetarëve (Shembuj: Finlandë).

Institucionet e BE-së, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe organizatat donatore:

- Sigurohuni që Strategjitë e BE-së për të Drejtat e Njeriut përfshijnë një analizë të nevojave dhe sfidave të GMDNJ-ve dhe përfshijnë masa specifike për t'i adresuar ato.
- Në mënyrë domethënëse përfshini OShC-të e grave në zhvillimin dhe zbatimin e politikave specifike siç janë Strategjitë e BE-së për të Drejtat e Njeriut të vendit dhe Plani i BE-së për Veprim Gjinor II (së shpejti III).
- Financoi hulumtimin dhe mbledhjen e të dhënave për GMDNJ-të dhe gratë gazetare në Ballkanin Perëndimor për t'u përdorur si kornizë bazë, duke dokumentuar incidente, reagime dhe kornizën ligjore në fuqi.
- Bëni presion për zhvillimin e një planveprimi ose politikave për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhunën me bazë gjinore kundër GMDNJ-ve, duke përfshirë ngacmimin dixhital.

⁴⁶⁷ *Duke pasur parasysh situatën e larmishme në secilin vend, rekomandimet janë të përgjithësuara, duke qenë të aplikueshme në shumicën e shteteve të Ballkanit Perëndimor për secilin veprim të rekomanduar.

Njohja e OShC-ve të grave nga qeveritë kombëtare

SHKURTIMISHT:

Trendet e regresit demokratik kanë çrregulluar modelet e bashkëpunimit midis OShC-ve dhe akterëve shtetërorë. Disa vende janë bërë më armiqësore ndaj konceptit të barazisë gjinore dhe e diskreditojnë atë si një qëllim me implikime të qarta për mënyrat në të cilat punojnë OShC-të e grave dhe për demokracinë e bazuar në të drejta të barabarta.

BRENDA NJË VITI:

Të sigurohet mbështetje për ngritje të shkathtësive dhe zhvillim të strategjisë për OShC-të e grave për të riorientuar marrëdhëniet e tyre me qeverinë dhe akterët opozitarë brenda shoqërisë civile.

Për Qeveritë:

- Formalizoni bashkëpunimin institucional me OShC-të në të gjitha sektorët e politikave, si psh Memorandumet e Mirëkuptimit për bashkëpunim ndërmjet agjencish.
- Siguroni pjesëmarrjen e OShC-ve në hartimin e politikave për spektrin e gjerë të çështjeve në lidhje me anëtarësimin në BE dhe në të gjitha nivelet.
- Siguroni mekanizmat për përfshirjen e të dhënave të mbledhura nga OShC-të në proceset raportimit shtetëror tek organet ndërkombëtare.

Institucionet e BE-së, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe organizatat donatore:

- Nxiti përfshirjen sistematike të OShC-ve ndërsektoriale në dialogun e hartimit të politikave në përputhje me nenin 11 të Traktatit të Lisbonës, dhe në veçanti në të gjitha konsultimet në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE
- Përcaktoni prioritetet për programe dhe politika për të luftuar tkurrjen e hapësirës në shtetet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu:
- Financoji një analizë të implikimeve të regresit demokratik për marrëdhëniet Shtet-OShC e grave.
- Siguroni një hapësirë të sigurt për takime dhe konsultime ndërmjet BE-së dhe shoqërisë civile.
- Përfshini OShC-të e grave në zhvillimin dhe zbatimin e politikave specifike të BE-së që synojnë mbështetjen e parimeve demokratike, barazisë gjinore dhe rolin e OShC-ve të pavarura.
- Mbështetni OShC-të e caktuara të grave dhe rrjetet e OShC-ve të grave në nivel kombëtar dhe rajonal përmes Instrumenti i Ndihmës për Shoqërinë Civile IPA III i Komisionit Evropian për të konsoliduar praninë e tyre, forcuar kapacitetet e tyre dhe nxitur angazhimin në nivelin e politikave.
- Përfshini një pikë të axhendës mbi rolet dhe pjesëmarrjen e grave në çdo dialog politik me përfaqësuesit e qeverive kombëtare.
- Zhvilloni modalitete fleksibile, afatgjata dhe inovative të financimit për OShC-të e grave bazuar në nevojat, kapacitetet dhe aftësinë e tyre për të menaxhuar fondet. Shqyrtoni ndarjen e fondeve afatgjata dhe qëndrueshme për t'i mundësuar organizatave të veprojnë në kushte të kufizuara dhe të jenë më rezistente. Të sigurohet disponueshmëria e fondeve emergjente gjithashtu.

Lista e referencave

- Bami, X., 'Kosovo Pride Activists Put Law Under Spotlight', *BIRN*, 10 October 2019, <https://balkaninsight.com/2019/10/10/kosovos-3rd-pride-parade-demands-law-implementation/#gsc.tab=0>, (accessed 7 June 2020).
- BH Novinari, 'Utvrditi ko Stoji iza Napada na Novinarku Semiru Degirmendžić', *BH Novinari*, 2020, <https://bhnovinari.ba/bs/2014/03/26/utvrditi-ko-stoji-iza-napada-na-novinarku-semiru-degirmendi/>, (accessed 7 June 2020).
- CIVICUS, 'Attacks on Journalists on the Rise as Religious Groups Clash with Police', *CIVICUS*, 2020, <https://monitor.civicus.org/updates/2020/04/03/attacks-journalists-rise-religious-groups-clash-police/>, (accessed 23 April 2020).
- CIVICUS, 'Measures to Combat "Fake News" Used to Silence Journalists', *CIVICUS*, 2020, <https://monitor.civicus.org/updates/2020/02/18/measures-combat-fake-news-used-silence-journalists/>, (accessed 23 April 2020).
- CIVICUS, 'Media Watchdogs Raise the Alarm After Female Journalists Threatened', *CIVICUS*, 2019, <https://monitor.civicus.org/updates/2020/03/30/media-watchdogs-raise-alarm-after-female-journalists-threatened/>, (accessed 23 April 2020).
- CIVICUS, *Monitor Tracking Civic Space: Serbia* [website], <https://monitor.civicus.org/country/serbia/>, (accessed 23 April 2020).
- CIVICUS, 'Serbia's Civic Space Downgraded', *CIVICUS*, 2019, <https://www.civicus.org/index.php/media-resources/news/4113-serbia-s-civic-space-downgraded>, (accessed 22 April 2020).
- Civil Rights Defenders, 'Attack Against Civil Rights Defender of the Year Recipient Natasa Kandic in Belgrade' *Civil Rights Defenders*, 2020, <https://crd.org/2020/02/06/attack-against-civil-rights-defender-of-the-year-recipient-natasa-kandic-in-belgrade/>, (accessed 6 June 2020).
- Civil Rights Defenders, 'North Macedonia's Repeal of Anti-Discrimination Law Poses Major Setback to Human Rights Protection', *Civil Rights Defenders*, 2020, <https://crd.org/2020/05/19/north-macedonias-repeal-of-anti-discrimination-law-poses-major-setback-to-human-rights-protection/>, (accessed 3 July 2020).
- 'CoE: 2019 Was Worst Year for Albanian Media Freedom', *Exit*, 29 January 2020, <https://exit.al/en/2020/01/29/coe-2019-was-worst-year-for-albanian-media-freedom/>, (accessed 3 June 2020).
- Committee on the Elimination of Discrimination against Women, *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Serbia*, Committee on the Elimination of Discrimination against Women, 2019, https://www.womenngo.org.rs/images/CEDAW/CEDAW_Concluding_observations.pdf, (accessed 6 June 2020).
- Committee on the Elimination of Discrimination against Women, *Concluding Observations on the Sixth Periodic Report of Bosnia and Herzegovina*, Committee on the Elimination of Discrimination against Women, 2019, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2fC%2fBEH%2fCO%2f6&Lang=en, (accessed 6 June 2020).
- Committee to Protect Journalists, 'Montenegro Journalist Anđela Đikanović Charged with Incitement over Retracted Report', *Committee to Protect Journalists*, 2020, <https://cpj.org/2020/01/montenegro-journalist-andela-dikanovic-charged-wit/>, (accessed 6 June 2020).
- Council of Europe, 'Statement by Council of Europe Commissioner for Human Rights: Press Freedom Must not be Undermined by Measures to Counter Disinformation about COVID-19', *Council of Europe*, 2020, <https://www.coe.int/en/web/media-freedom/-/press-freedom-must-not-be-undermined-by-measures-to-counter-disinformation-about-covid-19>, (accessed 3 June 2020).
- Diković, J., 'Vučićev Režim - Stanje Gore od Zločina', *Danas*, 3 January 2020, <https://www.danas.rs/drustvo/suocavanje/vucicev-rezim-stanje-gore-od-zlocina/>, (accessed 28 April 2020).
- European Commission, *Montenegro 2019 Report*, Brussels, European Commission, 2019, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-montenegro-report.pdf>, (accessed 7 June 2020).
- European Network of Legal Experts in Gender Equality and Non-discrimination, *Flash Report: The Constitutional Court Repealed the 2019 Anti-Discrimination Law*, European Commission, 2020, <https://www.equalitylaw.eu/downloads/5148-north-macedonia-the-constitutional-court-repealed-the-2019-anti-discrimination-law-104-kb>, (accessed 3 July 2020).
- Farnsworth, N. et al., *Where's the Money for Women's Rights? Funding Trends in the Western Balkans*, Kvinna till Kvinna Foundation, 2020, <https://kvinna.tillkvinna.org/2020/06/01/wheres-the-money-for-womens-rights-2020/>, (accessed 26 August 2020).
- Gatarić, T. 'Milica Samardžić za VOA: Mrežom Novinarki do Boljeg Položaja Žena u bh. Medijima', *VOA*, 3 May 2020, <https://ba.voanews.com/a/milica-samardzic-za-voa-mrezom-novinarki-do-boljeg-polo%C5%BEaja-zena-u-bh-medijima/5402858.html>, (accessed 6 June 2020).
- Georgievski, J., 'Civil Rights Defenders: Regional Solidarity Crucial for Defending European Values', *European Western Balkans*, 4 December 2019, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/12/04/civil-rights-defenders-regional-solidarity-crucial-for-defending-european-values/>, (accessed 6 June 2020).
- Građanske Inicijative, 'Tri Slobode Pod Lupom: Prikaz Slučajeva Kršenja Osnovnih Ljudskih Prava u Srbiji Tokom Vanrednog Stanja', *Građanske Inicijative*, 2020, <https://www.gradjanske.org/wp-content/uploads/2020/04/Tri-slobode-pod-lupom-13-15-april-.pdf>, (accessed 22 June 2020).

- Human Rights Watch, *World Report 2020 – Events of 2019*, Human Rights Watch, 2020, https://www.hrw.org/sites/default/files/world_report_download/hrw_world_report_2020_0.pdf, (accessed 6 June 2020).
- 'Hungary, Serbia, Montenegro "No Longer Democracies": Report', *Al Jazeera*, 6 May 2020, <https://www.aljazeera.com/news/2020/05/hungary-serbia-montenegro-longer-democracies-report-200506161223889.html>, (accessed 8 June 2020).
- ILGA-Europe, *Annual Review of the Human Rights Situation of Lesbian, Gay, Bisexual, Trans and Intersex People Covering Events that Occurred in Europe and Central Asia between January-December 2019*, Brussels, ILGA-Europe, 2020, <https://www.ilga-europe.org/sites/default/files/Annual%20Review%202020.pdf>, (accessed 1 June 2020).
- Juzová J., 'Civil Society and the EU Integration Process: Key Importance, Little Impact?', *European Western Balkans*, 11 September 2019, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/09/11/civil-society-and-the-eu-integration-process-key-importance-little-impact/>, (accessed 7 June 2020).
- Katana, G., 'BH Duboko Homofobno Društvo', *LGBT.ba*, 4 January 2020, <https://lgbti.ba/BeH-duboko-homofobno-drustvo/>, (accessed 3 June 2020).
- Kosovo Women's Network, 'KWN Welcomes the Adoption of the National Plan on Gender Equality 2020 – 2024', *Kosovo Women's Network*, 2020, <https://womensnetwork.org/kwn-welcomes-the-adoption-of-the-national-plan-on-gender-equality-2020-2024/>, (accessed 7 June 2020).
- The Kvinna till Kvinna Foundation, *Annual Report 2019*, Stockholm, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2020, <https://kvinnatillkvinna.org/2020/04/29/annual-report-2019/>, (accessed 1 September 2020).
- Marović, J., Stefanovski, I., and Ivanović, I., *Comparative Study, Civil Society in the Western Balkans: Involvement in the EU Accession Negotiation and EU Integration Processes from Initiatives to a Structured Dialogue*, Belgrade, CRTA, 2019, <http://www.centaronline.org/userfiles/files/publikacije/comparative-study-civil-society-in-the-western-balkans.pdf>, (accessed 16 April 2020).
- 'Međunarodni dan Braniteljki Ženskih Prava', *Peščanik*, 29 November 2019, <https://udruzenjepescanik.org/aktuelnosti/međunarodni-dan-braniteljki-zenskih-ljudskih-prava/>, (accessed 8 June 2020).
- M.P., 'Jovana Popović, Autorka Pesme "Bagra", Puštena na slobodu', *Danas*, 13 April 2020, <https://www.danas.rs/drustvo/umetnica-iz-kikinde-jovana-popovic-pustena-na-slobodu>, (accessed 22 April 2020).
- 'N1 Traži Reakciju Države na Seksističke Napade na Novinariku', *N1*, 25 April 2020, <http://rs.n1info.com/Vesti/a592978/N1-trazi-reakciju-drzave-na-seksisticke-napade-na-novinariku.html>, (accessed 7 June 2020).
- 'Novi Napad na Novinariku Anu Lalić', *Patria*, 1 May 2020, <https://nap.ba/news/65099>, (accessed 6 June 2020).
- 'Online Harassment and Abuse of Albanian Journalist Reported by Mapping Media Freedom', *Exit*, 17 April 2020, <https://exit.al/en/2020/04/17/online-harassment-and-abuse-of-albanian-journalist-reported-by-mapping-media-freedom/>, (accessed 3 June 2020).
- OSCE, 'OSCE Media Freedom Representative concerned about pressure on KoSsev online portal and its editor-in-chief in Kosovo', *OSCE*, Vienna 2020, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/450085>, (accessed 6 June 2020).
- Padalović, E., 'Donesena Presuda: Izdavačka Kuća "Besjeda" i Stefan Karganović Krivi Zbog Objave Liste Rušilaca Republike Srpske', *BUKA*, 2 March 2020, <https://www.6yka.com/novosti/donesena-presuda-izdavacka-kuca-besjeda-i-stefan-karganovic-krivi-zbog-objave-liste-rusilaca-republike-srpske>, (accessed 9 June 2020).
- Popović, D. et al., *Udruženje Građana: Sužavanje Prostora za Delovanje, Srbija 2019*, Belgrade, Građanske Inicijative, Fondacija za Otvoreno Društvo, 2020, <https://www.gradjanske.org/wp-content/uploads/2020/02/Udruzenja-gradana-Suzavanje-prostora-za-delovanje-OCD-2019-.pdf>, (accessed 22 April 2020).
- 'Press Release on the Latest Attack on the Albanian Trans Activist Anxhela', *Historia Ime*, 2019, <https://www.historia-ime.com/english/press-release-on-the-latest-attack-on-the-trans-activist-anxhela/>, (accessed 28 April 2020).
- Mreža za Izgradnju Mira, 'Reakcija Povodom Vrijeđanja Aktivistice Ane Kotur Erkić i Osoba sa Invaliditetom od Strane Narodnog Zastupnika Vukanovića', *Mreža za Izgradnju Mira*, 2020, <https://www.mreza-mira.net/vijesti/aktivnosti-mreze/reakcija-povodom-vrijeđanja-aktivistice-ane-kotur-erkic/>, (accessed 6 June 2020).
- Regional Coalition for Gender Mainstreaming the EU Accession Process, 'Open letter - The 2020 Western Balkans Summit: A Missed Opportunity', *Regional Coalition for Gender Mainstreaming the EU Accession Process*, 2020, https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/05/WB-Summit-Gender-Perspective_2020-05-15-18.pdf, (accessed 21 June 2020).
- Reporters Without Borders, *Albania* [website], <https://rsf.org/en/albania>, (accessed 24 April 2020).
- Reporters Without Borders, *Montenegro* [website], <https://rsf.org/en/montenegro>, (accessed 24 April 2020).
- Reporters Without Borders, *North Macedonia* [website], <https://rsf.org/en/north-macedonia>, (accessed 24 April 2020).
- 'The Role of CSOs in Montenegro's EU Integration: Substantial or Make-Believe?', *European Western Balkans*, 21 February 2020, <https://europeanwesternbalkans.com/2020/02/21/the-role-of-csos-in-montenegros-eu-integration-substantial-or-make-believe/>, (accessed 7 June 2020).
- Šadić, S., Ždralović, A., and Emirhafić, M., *Jednoroditeljske Porodice - Mapiranje Prava i Potreba Samostalnih Roditelja/ki na Području Općine Centar Sarajevo*, Fondacija CURE, 2020, http://www.fondacijacure.org/files/Jednoroditeljske_.pdf, (accessed 7 June 2020).
- Sandžaktarević, I., 'Vanja Stokić: Napad na Vanju je Manje Bitan, a da se Desio Nekom Političaru, Napadač bi bio Istog Trena Priveden', *Interview.ba*, 29 May 2020, <https://interview.ba/interview/item/32382-b-vanja-stokic-b-napad-na-vanju-je-manje-bitan-a-da-se-desio-nekom-politicaru-napadac-bi-bio-istog-trena-priveden>, (accessed 6 June 2020).
- Strengthening Quality News and Independent Journalism in the Western Balkans and Turkey, 'Winners of EU Investigative Awards in Kosovo Announced', *Strengthening Quality News and Independent Journalism in the Western Balkans and Turkey*,

2019, <https://euwbmedia.com/2019/10/winners-of-eu-investigative-awards-in-kosovo-announced/>, (accessed 6 June 2020).

'Tangled Up in Bureaucracy. What is Hindering Serbian CSOs to Participate the EU Negotiation Process?', *European Western Balkans*, 28 January 2020, <https://europeanwesternbalkans.com/2020/01/28/what-is-hindering-serbian-csos-to-participate-the-eu-negotiation-process/>, (accessed 7 June 2020).

UN Women, 'The First Report on the Implementation of Resolution 1325 in Albania Launched', *UN Women*, 2019, <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2019/10/the-first-report-on-the-implementation-of-resolution-1325-in-albania-launched>, (accessed 7 June 2020).

United Nations Human Rights Office of the High Commissioner, *Declaration on the Right and Responsibility of Individuals, Groups and Organs of Society to Promote and Protect Universally Recognized Human Rights and Fundamental Freedoms*, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/rightandresponsibility.aspx>, (accessed 6 June 2020).

USAID, *Fact Sheet: Strengthening LGBTI Rights in Bosnia and Herzegovina* [website], 2019, <https://www.usaid.gov/bosnia/fact-sheets/strengthening-lgbt-rights-bosnia-and-herzegovina>, (accessed 3 June 2020).

Vučičević mi Govorio da sam Šiptarska Kurva?!, *Direktno.rs*, 2 June 2020, <https://direktno.rs/beograd/278213/vucicevic-mi-govorilo-da-sam-siptarska-kurva.html>, (accessed 8 June 2020).

Wassholm, C., *Suffocating the Movement - Shrinking Space for Women's Rights*, The Kvinna till Kvinna Foundation, 2018, <https://kvinnatillkvinna.se/wp-content/uploads/2018/03/kvinna-till-kvinna-suffocating-the-movement-report-eng-2018.pdf>, (accessed 20 August 2020).

Xhaho, A. et al., *Human Rights Defenders in the Western Balkans*, Civil Rights Defenders, 2019, <https://crd.org/wp-content/uploads/2019/12/Human-Rights-Defenders-Report.pdf>, (accessed 1 June 2020).

Zaštitnik Ljudskih Prava i Sloboda Crne Gore Ombudsman, *Ispunjenja Preporuka o Poštovanju Prava Transrodne Osobe* [website], 2019, <https://www.ombudsman.co.me/article.php?id=34128&display=1>, (accessed 28 September 2020).

**For all women's rights,
in every corner of the world.**